GEORGE ORWELL



1984

ZENIT
EDITIONS

George Orwell

1984



Koleksioni *Klasik*

George Orwell

Njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër

Përktheu nga origjinali:
Çelo Hoxha



Përmbajtja

Epitaf i të ardhmes	9
Parathënie	13
Pjesa e parë	25
Pjesa e dytë	119
Pjesa e tretë	231
Shtojcë	299
Në vend të pasthënies	312

George Orwell (pseudonimi i Eric Arthur Blair, 1903-1950), shkrimtar britanik, lindi në Indi, studioi në shkollën e mirënjohur të Eton-it, shërbeu në radhët e policisë perandorake të Indisë nga viti 1922 në vitin 1927, viti kur ai vendosi të rikthehet në Europë. Shëndetlig dhe me dëshirën e fuqishme për t'u bërë shkrimtar, ai jetoi disa vite në varfëri mes Parisit dhe Londrës, përvojë të cilën e përmblodhi në librin *Down and Out in Paris and London* (1933). Romani i parë *Burmese Days* (1934), aktakuzë kundër imperializmit, është kryesisht autobiografik. Në vitin 1936, Orwell-i u rreshtua në radhët e ushtrisë republikane gjatë luftës civile të Spanjës (1936-1939), nga e cila na ofron një panoramë të qartë në veprën *Homage to Catalonia* (1938). Të njëjtës periudhë i përket edhe vepra *The Road to Wigan Pier* (1937), përshkrim i dhimbshëm i kushteve të jetës së minatorëve të veriut të Anglisë.

Mbrojtës i lirisë së individit, Orwell luftoi kundër çdo forme shtypjeje. Ndëshkimi i totalitarizmit fillimisht shprehet në alegorinë e veprës *Ferma e Kafshëve* (1945), një roman që pati popullaritet të gjerë në gjithë botën, me tone të një shpotie të thekshme që merr shtysë nga ngjarjet e Revolucionit rus dhe tradhëtisë që Stalini u bëri idealeve të tij, dhe më pas në utopinë negative të romanit *Njëmijë Nëndëqind e Tetëdhjetë e Katër*, (1949), një kuadër trondites i një shoqërie ku Vëllai i Madh mishëron një fuqi të aftë të kushtëzojë dhe shtypë individualitetin e qytetarit. Me shkrimeve të tjera me tone autobiografike të Orwell-it, mund të përmendim përbledhjet e letrave dhe artikujve, esetë dhe romanin *Keep the Aspidistra Flying* (1936).

EPITAF I TË ARDHMES

Nuk do ketë të qeshura
veç të qeshurës së triumfit mbi armikun.
Në doni një imazh të së ardhmes,
përfytyroni një çizme
ngjeshur në fytyrën e dikujt,
...përjetësisht.

Ky epigraf i profecisë së veprës, me valencë shumëpërfshirëse, është i vlerëshëm të na e risjellë, fare shqip, edhe kumtin mbi imazhin e të shkuarës nën vragën e çizmes, edhe përfytrimin e të ardhmes si marrëdhënie me leximin në vijim... Nëse doni një pamje të ndjesisë së fundme të një lexuesi të ndjeshëm, përfytyroni shenjimin e shollës në fytyrën e tij ...përgjithmonë. Sugjerimi ndaj lexuesit, veçanërisht shqiptar, për të mos e nisur këtë libër, mbetet i barasvlerëshëm me lutjen për të mos e evituar kurrësesi.

Pjella metaforike e gjenisë oruelliane – Metafora e Vëllait të Madh – sintetizë emblematike e territ dhe shtypjes nën maskën e paternalizmit, te ne u lind nga incesti i çiftit Tirania dhe Diktati.

Asokohe tymnaje paslufte, gjindja ia mbërriti në vakt ta shpallte Metaforën (tek vetshpallej) edhe Big Brother edhe Pater Nostrum. Merr dy, shpago një. Porse gjindja e ka të vështirë të

mbajë përgjegjësinë e gjëndjes ku shpie veten. As kur kthen kokën pas tek e sheh atë si një e pësuar e shkuar. Ajo e ka tashmë tiranin e dikatorin e saj, ku, nga njëra anë sot të derdhë tërë mërinë me epitete epitafi dhe gjer krahasime krematoriumi dhe, nga ana tjetër, të vari përgjegjësinë si në një kremastar.

Vëllababazoti ynë do të bëhej e bekohej gati njëzëri si teza e sintetizës, mënyra e mynxyrës, emblema e damkës, liria e diktatit – gjer më metaforë se Metafora vetë.

Megjithë përshkrimin tronditës dhe kapërcimin imagjinar deri në profeci, natyrisht Orwelli nuk do e mbërrinte dot cakun e përfytyrimit të një soj ciber-kolektiviteti gjetkë, hundebuzë Adriatikut, por pa asfare nevojë teknologjie e shkence të madhe për bashkëpunimin në gjurmimin e pareshtur dhe voyerist të qytetarit qyqar. As Orwelli vetë nuk do e rrokte ta shqyrtonte dot realitetin e përgjunjies dhe përgjumjes orwelliane të bashkësisë së njerëzisë diku, sakaq edhe në gatishmëri të lartë e syhapur për të tradhtuar çdo ndjenjë, ndjeshmëri, afekt e dashuri ndaj të afërmve, dhe deri te ndërsimi i njëri-tjetrit ndaj njëri-tjetrit. E pastaj, ndërzimi i fateve dhe fataliteti i përbashkët kolektiv.

A jemi ne ata që duhet t'i paguajmë të drejtën e autorit Orwellit për vënien në skenë të fallit të tij, apo Orwelli të na paguajë haraçin për procesionin, aty heroik këtu komik, mbi erzin dhe kurrizet tona, që faktikisht i dëshmoi dhe shtoi atributin që i shndërron shkresat e tij prej gazetarie kronikane, në profeci kronike?!

Librat më të mirë, mendoi Uinstoni, janë librat që të thonë atë që e ke ditur. Ndoshta ky botim do t'i thotë lexuesit të vet, njeriut të fundëm oruellian në Europë, veç asaj që e ka ditur edhe atë çka ka bërë, apo ia bënë. Të bërë që ç'ke me të. Njeriu i aftë për të bërë; e për të bërë, kështu, gjer dhe të pabërën. Një sistem që ka patur sukses ta shkatërrojë viktimën para se t'i vejë litarin, vërente Arendt, është më i suksesshmi për me e mbajt popullin nën skllavëri. Dhe na lypset një dallim arendtian, gjithashtu, mes konceptimit të tiranisë edhe diktaturës; e para, e ushtron dhunën e vet duke e shpallur hapur pozicionimin dhe synimin, kurse diktatura, përmes ideologjisë e instrumentave të saj: shtrëngon të të bëjë edhe ta duash atë. Ne kaq e dimë me lëkurë, e prapëseprapë,

zor se e bëjmë këtë diferencim kur i përdorim këta shenjues. Shkatërrimi dhe shtrëngimi e dashurimi i gjatë mishërohen në vonesat e pasojat e zgjatura. Edhe në dëmtime të gjuhës e ligjërimit, prej ushtrimit e pësimit të gjatë të gjuhëzimit orwellian të regjimit.

Ne, aq më tepër ne – dyfish krijesa trans-orwelliane, nga tirania e syrit të Vëllait të madh ciklopik, në diktatin e kontrollit të syrit Big brother teknologjik – ne, për ta lexuar drejt e sipas modelit Orwell veprën e tij, na duhet të mendojmë atë që ai ka tentuar të mendojë mbi atë çka mund të mendonin të tjerët, dhe ndër të tjerët më të spikatur qemë e jemi tipikisht edhe ne. Me bëmën e veprën tonë të hapur plagë e në vijim. Çdo lexim i 1984-ës endet në një territor psikologjik të terrtë e të tmerrtë. Çdo lexues që nuk e përjeton si eksperiencë unike marrëdhënien me librin e tij, thjesht nuk e paska patur të mundur kuptimin e një vepre unikale. E ndër lexuesit e mbarëbotshëm të 1984-ës, ne jemi njëherit: lexuesi unikal. I përvojës direkte të çizmes në fytyrë, pa e humbur sot mbase as shansin e "përparimit" kah atij universi totalitar të asoj të ardhmeje demokraci që libri parasheh. Porse në këtë fjalë, po bëjmë thjesht të riskicojmë vetëm njërin profil të fytyrës në tablonë orwelliane; atë anë që na lidh me të shkuarën tonë dhe vendin që ajo zë si e jona, pra si autentike endemike, e prej së cilës as nuk jemi zgjidhur ende, dhe ende pak bëjmë për ta njohur. Profili tjetër orwellian, është duke u ravijëzuar vetiu nga vetë e tashmja...

Në kakofoninë e kontekstit në të cilin botojmë 1984-ën (fatkeqësisht përtej shekullit që profetizon vepra) ky soj epitafi empatik - dekalog oruellian regjimi totalitar, qoftë ai tiranik apo në dukje demokratik-, tingëllon te ne sakaq edhe polifonik. Një pjesë e "ansamblit popullor" i këndon vargjet përmendësh e me pathosin e asokohës. Ca e ca mbajnë iso të besës së dhënë. Tjetra pjesë, nën peshën e të shkuarës së patejflakur, i përcjell vargjet e marshit funebër me dridhje të thekshme të zërit tashmë të mekur. Ata që lëkurën e kanë cipëhollë, ndjejnë purpurin e turpit prej groteskut tragjik. Por aradha e madhe i përket asojve që recitojnë ende sipas vendit dhe kuvendit. Ata që ngjizën Njeriun e Ri,

nginjën Gjuhën e Re, farkëtuan Psikohetuesinë dhe ia mbërritën t'i thurin lavde vetë Orwellit për qesëndinë. Ata që ditën të ngrehin për vete alibinë: ka ngjarë ç'ka ngjarë, por ama... jo unë.

Dikush... dikë me dorën e vërtetë të krimit. Dikush... dikur me ca copëra dëshmi vrastare të rreme. Të hareshme si një gol me dorë, që verdikti gjykues e di por bën sikur s'e sheh e s'fryn asnjë birbil, në emër të ngadhënjimit dhe shpërblimit për tifon e turmës. Dikush... diku me ndoca çikërrima të mprehta pësh-pëshi. Si gozhdët dhe hekurishtet që mblidhte vullnetarisht Lej Feni për depot e kinezërisë, në emër të së mirës së përgjithshme. Alibia e stisur kësisoj, i heq edhe atë çikë burrëri gjithë asaj ç'bëri vaki sidoqë ishte; e zhvesh edhe nga ajo çfarë Deleuze e quan dinjiteti i ngjarjes. Nuk isha unë... thërret dado Alibia me pallton që vishet nga të dyja anët. Frika e zvargut të jehonës e ngut Umberto Eco-n të lajmërojë që historia është duke rrugëtuar në kthim mbrapsht. E thënë sot. Dhe është po ai që dekada përpara, në vitin oruellian 1984, në parathënien e ribotimit të 1984-ës së Orwellit, shkruante se si suksesi i jashtëzakonshëm e në vijim i librit vjen prej energjisë vizionare që e tejkalon bëmën thjesht letrare; dhe na bind se pse gjatë gjithë këtyre viteve, nëse nga njëra anë fliste për çka pat ngjarë, në fakt më shumë sesa mbi atë çka mund të kish bërë vaki, fliste për atë që po ndodhte.

Grupit polifonik lokal në fjalë, së fundi i bëhen pjesë edhe ata që u rritën rreth e rrotull vitit të mbrapshtë dhe rezonancës së 1984-ës.

Camus denoncon: "Njeriu s'është plotësisht fajtor, pasi nuk është ai që e filloi historinë, por as edhe krejtësisht pa faj përsa që e vazhdon atë„.

Pasardhësit e Njeriut të Ri – brez i tashëm i ri - do të mund ta thurnin alibinë me shprehjen prekëse: "Plaga ime ekzistonte para meje, kam lindur për ta mishëruar" (Joe Bousquet). Bukur. Është një alibi që mund të shtyhet edhe tërë jetën, si fanella e leshit të qëmotit. Gjer në epitaf. Veç ky i fundmi thirret e thurret, por nuk shkruhet nga vetja. E shkruajnë. Diku, dikur. Mishërimi fatkeq i së njëjtës plagë do të vijojë të mbrujë hiçidentitetin. Me të njëjtin epitaf. Emri epitaf i përbashkësisë: Jo Uni, 19XX - XX84

K. Zejno

PARATHËNIE

Nuk është e vështirë të kuptohet pse romani i fundit i George Orwell-it, i botuar në qershor të vitit 1949, shtatë muaj para vdekjes së autorit, pati sukses të menjëhershëm. E para, ajo është një histori diskredituese dhe djallëzore që e çon fantazinë e adoleshentëve – të etur për kryeneçësi, seks të fshehtë dhe terror ekstrem – drejt një skaji tronditës dhe të papranueshëm. E dyta, dhe më e rëndësishmja, kjo rrëfenjë e pashoqe u lexua si një koment social, madje si profeci.

Ndoshta nuk ka pse të habitemi që ajo u trajtua si e tillë. Monotonia, varfëria dhe absurditetet qeveritare ishin mënyrë të jetuari jo vetëm në roman, por edhe në Britani gjatë kohës që u shkrua libri. Ndërkohë totalitarizmi ishte rrezik real. Gjermania naziste më herët dhe Rusia e Kina atë kohë, kishin lënë gjurmë në ndërgjegjen politike të shoqërive perëndimore. Parashikimet për të ardhmen e afërt nuk ishin shumë optimiste.

Në ditët e sotme mbahet qëndrim krejt tjetër ndaj këtij romani. Fakti që, me afrimin e afatit të famshëm kalendarik, viti 1984 diskujtohej me ankth në gjithë botën, njëlloj si të ishte fundi i një mijëvjeçari, tregon ndikimin e madh të George Orwell-it. Mirëpo tashmë kjo datë ka kaluar dhe dikush mund të mendojë se romani e ka humbur vlerën. Për sa kohë mund t'i ngacmojë lexuesit e vet një libër i shkruar për një të ardhme që tashmë i përket të shkuarës?

Natyrisht që ky roman ka aspekte të veçanta të cilat e tundojnë kritikun modern t'i kushtojë vëmendje. Paralajmërimi

i kësaj vepre ka dalë pothuajse i gabuar jo vetëm në kohëzgjatje (lufta e tretë botërore ose revolucioni Perëndimor nuk ka ndodhur ende, ndërsa sistemet totalitare janë më të rralla se dyzet vjet më parë). Tani mund të shihet më qartë brishtësia artistike e romanit. Në qoftë se *1984* është ende një roman i pranueshëm, kjo ndodh falë mjeshtërisë rrëfimtare të Orwell-it. Dhe falë mungesës së detajeve në ndërtimin e personazheve dhe fabulës së papërpunuar.

Fare shkurt fabula mund të përmblidhet kështu: ngjarjet e romanit janë vendosur në vitin *1984* në Londër ("Shiriti Ajror i Parë"), pjesë e Oqeanisë, një superfuqi e kontrolluar me dorë të hekurt nga "Partia" që udhëhiqet nga figura simbolike e Vëllait të Madh. Ky shtet nuk ka ligje, ai ka vetëm një rregull: bindje absolute në veprime dhe mendime. Shoqëria e Oqeanisë është e ndarë në hierarki midis të privilegjuarve: Besnikëve të Partisë, servilëve – anëtarëve të thjeshtë të Partisë – dhe masës së përulur të proletarëve. Personazhi kryesor, Uinston Smithi, është një anëtar i thjeshtë partie që punon në Ministrinë e së Vërtetës (që nënkupton, Ministria e Gënjeshtrave) si falsifikues i zakonshëm i arkivave. Pavarësisht presionit të madh për të respektuar sistemin, në fshehtësi Uinstoni vepronte kundër tij. Duke pikasur ngjashmërinë, me të bashkohet edhe Xhulia, një zyrtare e rangut të ulët. Me guximin që u fal dashuria, ata i kërkojnë O'Brajënit, anëtar i lart i Besnikëve të Partisë, t'i lidhë me *Vëllazërinë*, një forcë opozitare që mendohet se udhëhiqet nga armiku kryesor i Vëllait të Madh, "sozia" e Trockit, Emanuel Goldshteini. Përkrahja që ata gjejnë tek O'Brajëni del se është mashtrim. Ata arrestohen dhe ndahen. I liruar pak para eleminimit, Uinstoni zbulon se nuk ka mësuar ta dojë Vëllain e Madh.

Romani është argëtues, por ka kufizime të natyrës artistike. Rrëfimit i mungon zhvillimi, shpeshherë dialogu është i dobët dhe shumica e njerëzve janë dy dimesionalë, ata ekzistojnë vetëm të shpjegojnë një pikëpamje politike ose për të ironizuar njerëz nga jeta e përditshme. Gruaja që përherë var rroba në kopsht duke kënduar, e që na fal ngrohtësi, dhe imazhi i trishtuar i nënës së Uinstonit, e zhdukur shumë kohë më parë, që nuk na

shqitet lehtë nga kujtesa, janë dy personazhe dytësore të arrira. Ndërsa shokët e personazhit kryesor që janë anëtarë të thjeshtë partie – për shembull, i padurueshmi Parsons kungulli, ose i zellshmi Sajm – janë thjeshtë karikatura aktivistësh politikë; ndërsa shumica e proleve (proletarët) me klishetë e tyre në dialektin *cockney*[1] dhe fjalët me tingullin "h" të ngrënë, duket sikur janë nxjerrë nga ndonjë kopje e *Punch*-it[2] të para luftës. Zotin Karrington, shitësin e dyqanit të vjeturinave, që i jep Uinstonit dhomën me qera për takimet me Xhulian dhe që del se është Polic Mendimi i maskuar, mund ta gjesh në qindra romane policeskë që nuk vlejnë një dyshkë.

Djallëzori O'Brajën, njëri nga tre personazhet kryesore, është një figurë intelektuale, imazhi i errët, skaji i fundmë i totalitarizmit, por i mungon lënda njerëzore, mishi dhe gjaku. Ndërsa Uinstoni dhe Xhulia janë figura më të plota. Detaje nga personazhi i Uinstonit ndeshen edhe në romanet e mëparshme të Orwell-it. Ai është i vetmuar dhe dështak, një anëtar pa perspektivë i klasës së mesme, i mbushur me zemërim të pafuqishëm ndaj atyre që kontrollojnë jetën e tij. Lexuesi preket nga gjendja e vështirë e Uinstonit, por kur ai lartësohet nga dashuria dhe angazhimi politik lexuesi i dëshiron të mirën. Megjithatë ai nuk arrin të ngrihet mbi pesimizmin e vet dhe është e vështirë ta shikosh si tragjedi shkatërrimin e këtij njeriu jo fort tërheqës.

Ndërsa Xhulia është personazh më i pëlqyeshëm. Ndoshta ajo ka diçka nga gruaja e parë e Orwell-it, Eileen-i, e cila vdiq në vitin 1945. Padyshim që Xhulia zotëron forcë dhe është njeri me humor – diçka që mungon tek të tjerët. Ndërsa lexuesit gati sa nuk i merret fryma në moçalishten e dëshpërimit të Oqeanisë, ai çlirohet kur mëson se Xhulias nuk i pëlqen politika:

---

1 - Dialekt i banorëve të skajit lindor të Londrës, një zonë e varfër.

2 - Gazetë e përjavshme angleze e ilustruar dhe humoristike, themeluar në vitin 1841.

- Mua s'më intereson brezi tjetër, i dashur. Unë jam e interesuar veç për ne të dy.
- Ti je rebele vetëm nga mesi e poshtë, - i tha ai.
Xhulias kjo iu duk shumë e mençur dhe e mbështolli me krahë e lumturuar.

Mirëpo në figurën e Xhulias ka një kontradiktë. Megjithëse është personazhi më tërheqës i romanit, ajo duket se nuk shkon. Ndryshe nga Uinstoni i zymtë, ajo është shpirt i lirë. "Sipas saj jeta ishte e thjeshtë," shkruan autori. "Njeriu do që të kënaqet; "ata", Partia e kishte fjalën, mundoheshin të të privonin nga kjo; ndërsa ti përpiqeshe t'i shkelje ligjet deri ku të të shkonte."

Ne i jemi mirënjohës Xhulias. Megjithatë është e çuditshme sesi kjo ëndërr e adoleshentëve, ideali i feminitetit të thjeshtë dhe të shëndoshë të jetës së përditshme ka mbijetuar propagandën e Partisë që ka depërtuar në çdo qelizë. Ose, pse ajo ia del mbanë të mbijetojë, ndërsa të tjerët jo? Uinstoni ("njeriu i fundit në Europë") është një figurë e pranueshme si relike e së shkuarës, ndërsa Xhulia është dëshmi e faktit që metodat e erës së re nuk funksionojnë. Mirëpo, një nga temat e librit është fakti që ata janë pashmangshmërisht realë. Në kontekstin e romanit, Xhulia duket anakronike: lidhjet erotike të saj më tepër duket se ndodhin në një vend të pushtuar, si në librat e Odetës[1], sesa në një diktaturë të egër.

Xhulia (me gjithë kontradiktat e saj) i jep jetë veprës; por prania e saj në roman nuk e kalon hapësirën e një tregimi. Në qoftë se romani nuk do të kishte gjë tjetër veç personazheve dhe narracionit, ndoshta sot nuk do të lexohej as për kuriozitet. Në fakt, ai ka shumë më tepër se kaq. Lënda e tij e jashtëzakonshme e kthen romanin në një kryevepër, – në *Leviathan* e kohëve moderne të Thomas Hobes-it, siç e ka quajtur me shumë të drejtë Bernard Crick-u. *1984* është një ese për demonin e pushtetit e

1 - Odette Keun, 1888 -1978, autore romanesh romantikë, simpantizante e komunizmit dhe e zhgënjyer prej tij, e njohur për lidhjet e saj dashurore dhe e dyshuar edhe si spiune gjatë Luftës së Dytë Botërore.

maskuar si vepër ku përzihet trillimi, makthi dhe grotesku. Sot ai na shërben po në atë mënyrë që i shërbeu Uinstonit vepra heretike e Manuel Goldshteinit, për të analizuar dhe sulmuar sistemin politik:

> Në fakt, ai (libri) nuk i thoshte ndonjë gjë të re, por kjo qe pjesë e joshjes. Libri thoshte ato çfarë mund t'i kishte thënë edhe ai, në qoftë se do të kishte qenë në gjendje t'i sistemonte mendimet e veta të hapërdara.
> ... Librat më të mirë, mendoi, janë librat që të thonë atë që e ke ditur.

Si kudo në shkrimet e Orwell-it, thjeshtësia dhe qartësia e stilit të autorit, që shpesh merren për amatorizëm, ndihmojnë të kuptojmë jo vetëm që ai ka të drejtë, por edhe thotë diçka që ne gjithmonë e kemi menduar dhe kurrë nuk ia dolëm mbanë ta formulonim me zë të lartë.

Ka qenë e vështirë të përcaktohej se kë satirizon romani *1984*. Disa e kanë parë si sulm ndaj stalinizmit, ose ndaj totalitarizmit në përgjithësi, ose ndaj prirjeve drejtuese (gjatë qeverisjes laburiste) të qeverisë socialiste britanike. Ndërsa disa e kanë kuptuar si sulm ndaj pretendimeve dhe mungesës së liberalizmit të intelektualëve perëndimorë të majtë. Ndërsa disa e kanë shpjeguar si haluçinacion të autorit gjatë etheve të turbekulozit, si një pamflet satirik të jetës shkollore ose (që mund të konsiderohet e njëjtë me të) si një ëndërr sado-mazokiste. Ndoshta libri ka elemente nga të gjitha këto cilësime. Megjithatë ai është më shumë se një sulm satirik i thjeshtë dhe shumë më tepër se frut i një imagjinate në ethe. Libri nuk është as profeci, megjithëse përmban një lloj paralajmërimi (Orwelli, ashtu si të gjithë e dinte që profecia është diçka e pakuptimtë dhe e pamundur). Romani nuk trajton as ngjarjet e së tashmes. Ai është një libër rreth të tashmes së vazhduar: ritrajtim i gjendjes njerëzore. Gjëja më e rëndësishme është afrimi në vëmendjen tonë i shumë gjërave që zakonisht i anashkalojmë.

Libri godet më shumë pikërisht aty ku është i saktë. Takimet e Uinstonit me prolet nuk na bëjnë ndonjë përshtypje të madhe

– gjë që më tepër tregon vështirësitë klasore të autorit sesa aparteidin social në botën reale apo të kërcënuar. Ndërkohë që ndikohemi menjëherë nga pasqyra e një sistemi të bazuar në hipokrizinë ideologjike dhe në manipulimin psikologjik. Asimilimi i arsyes nëpër ëndërr prek edhe instiktet tona të më të verbra. Nuk është e rastit që shumë fjalë, fraza dhe koncepte të *1984* tashmë përdoren në jetën e përditshme edhe nga njerëz që nuk e kanë lexuar librin – për shembull, *Gjuha e Re, krimmendim, Vëllai i Madh, joperson, mendim i dyfishtë* – shumica e të cilave kanë të bëjnë me përpjekjet e shtetit për të shtrembëruar realitetin. Në qendër të vëmendjes së autorit është *mendimi i dyfishtë*, i përkufizuar si "aftësia për të mbajtur në mendje dy mendime të kundërta njëkohësisht dhe t'i aprovosh të dy". Në fillim, si gjithë aforizmat e Orwell-it, kjo duket absurde, ndërsa më vonë shihet si aspekt i jetës politike.

Në romanin *Errësirë në mes të ditës* të Artur Koelster-it, botuar më herët, roman që eksploron kufijtë teorikë të totalitarizmit, autori tregon asgjësimin moral që prodhon një ideologji në të cilën fundi justifikon çdo lloj mjeti. Novatorizmi i Orwell-it është se i shmanget fundit. Ndërsa ideologjitë e tjera e kanë justifikuar veten në emër të së ardhmes, *Anglosoc*-i – doktrina e Partisë së Oqeanisë – nuk ka objektiv. O'Brajëni ia shpjegon qartë Uinstonit: "Ne jemi të interesuar vetëm për pushtetin. S'bëhet fjalë për pasuri, luks, jetëgjatësi apo lumturi, por vetëm pushtet, pushtet i kulluar." Përse duhet ky pushtet? Përgjigjja e O'Brajënit është diçka që ne e dimë nga regjimet e tjera shtypëse: "Qëllimi i persekutimit është persekutimi. Qëllimi i torturës është tortura. Qëllimi i pushtetit është pushteti." Në qoftë se do një imazh të së ardhmes," thotë O'Brajëni, "atëherë përfytyro një çizme të ngjeshur në fytyrën e dikujt – përjetësisht."

1984 mbështetet shumë te vepra *Revolucioni Manaxherial* e James Burnham-it, imazhi i të cilit për një botë të ndarë në tre pjesë të mëdha, secila e drejtuar nga një elitë e vetëzgjedhur, pasqyrohet në librin e Golshteinit *Teoria e Kolektivizimit Oligarkik* dhe në ndarjen e botës në tre superfuqi, Oqeania, Euroazia dhe Azia Lindore që janë në luftë të përhershme me njëra-tjetrën. Në roman duket edhe ndikimi frojdian, megjithëse jo në mënyrë të

drejtpërdrejtë. Furra e shoqërisë së Oqeanisë, ku çdo gjë bëhet në mënyrë kolektive dhe çdokush vazhdon të jetë i vetmuar, është mohimi i erotizmit. Pikërisht kjo i ndez gjendjet emocionale sunduese të "frikës, urrejtjes, adhurimit dhe triumfit si në orgji". Histeria seksuale është përdorur qëllimisht që të mbrujë urrejtje sadiste për armiqtë e imagjinuar dhe të stimulojë dashuri mazokiste dhe depersonalizuese për Vëllain e Madh.

Askush nuk është i imunizuar, madje as skeptiku Uinston. Është e pamundur t'u rezistosh emocioneve të masave, na kujton vazhdimisht autori. "Dy Minutat e Urrejtjes" është një nga risitë më të njohura të *1984*. Autori e tregon personazhin e tij, të vendosur në mes të kësaj manie të organizuar, të pafuqishëm për të qëndruar larg vorbullës. "Ekstazën e shëmtuar të frikës dhe hakmarrjes, që përhapej mes grupit të njerëzve si rrymë elektrike", Uinstoni ia arrin ta kthejë në urrejtje për vajzën që është ulur mbrapa tij (më vonë mëson se ajo ishte Xhulia). "Haluçinacione të gjalla, të bukura, i shkrepëtinë në mendje. Do ta rrihte për vdekje me një shkop gome... Do ta përdhunonte dhe do t'i priste gurmazin në çastin e orgazmës." Pse? "Sepse ajo ishte e re, e bukur dhe pa feminitet, sepse donte të shkonte në shtrat me të dhe nuk do t'ia arrinte kurrë..." Orwell-i e bën të qartë që një urrejtje e tillë personale është qëllimi i puritanizmit të Oqeanisë. Kërcënimi më i madh i sistemit është kënaqësia seksuale dhe kodi i Xhulias ("Nuk ka rëndësi çfarë thua apo nuk thua, rëndësi kanë vetëm ndjenjat") është shumë më i rrezikshëm se dyshimet intelektuale të Uinstonit. "Nuk do të ketë orgazmë," thotë O'Brajëni, me aftësinë e tij të zakonshme të prekë thelbin e çështjes. "Neurologët po punojnë ta eleminojnë atë."

Ekuilibri mes mjerimit personal dhe përshtatjes me egërsinë zyrtare në roman nuk do të thotë që e ardhmmja do të ndihmojë për të formuar mënyrën sipas së cilës njerëzit – përfshi edhe të mbijetuarit – të përshkruajnë totalitarizmin. Në disa vepra të Aleksandër Solzhenicinit (*Një ditë nga jeta e Ivan Denisoviçit* dhe *Rrethi i parë*, për shembull) duken qartë gjurmët e mendimit të Orwell-it mbi një të keqe pa objektiv dhe të qëndrueshme, në të cilën janë të mbyllur edhe persekutorët edhe viktimat. Ndikimin më të madh prej romanit *1984* e ka

patur përshkrimi i përpunimit të arsyes. Tmerri më i madh i librit fillon kur shihet qartë se të gjithë banorët e Oqeanisë, përfshirë edhe cinikët dhe fanatikët e Besnikëve të Partisë, i shmangen logjikës. Kur Orwell-i e paraqet Vëllain e Madh si zotin e universit, ai kishte parasysh Stalinin i cili u përpoq t'i shpjegonte ligjet gjenetike në përputhje me teorinë Marksiste-Leniniste:

> - Ç'janë yjet? – tha O'Brajëni me indiferencë. – Ca thëngjij disa kilometra larg nesh. Po të duam mund t'i arrijmë. Mund t'i hedhim në erë... Natyrisht, për disa veprimtari të caktuara kjo nuk është e vërtetë. Kur lundrojmë apo kur parashikojmë eklipsin na duket më e përshtatshme të themi që toka lëviz rreth diellit ose që yjet janë miliona kilometra larg. Por çfarë do të thotë kjo? Mendon se është e vështirë të krijojmë një sistem astronomik paralel? Yjet mund të jenë larg ose afër, kjo varet nga dëshira jonë. A nuk të mbushet mendja që matematikanët tanë mund ta bëjnë këtë? E ke harruar mendimin e dyfishtë?

Natyrisht, kjo është çmenduri. Por, kush mund të vendosë se çfarë është çmenduri dhe çfarë është e arsyeshme në një shoqëri ku të gjithë, përfshirë edhe kontrolluesit e mendimit, mësojnë sesi të besojnë që dy edhe dy bëjnë pesë? Orwell-i na kujton sa delikate është mbështetja jonë tek njohja objektive dhe sa i paqartë mbërthimi tek e shkuara.

Primo Levi – që i mbijetoi Aushvicit dhe u bë një nga shkrimtarët më të mirë të holokaustit – në librin *Të shpëtuarit dhe të mbyturit*, përshkruan mënyrën si e helmoi Hitleri moralin e subjekteve të tij duke u prerë atyre kontaktet me të vërtetën. Ai arrin në konkluzionin se "gjithë historia e shkurtër e "Rajhut njëmijë vjeçar" mund të lexohet si luftë kundër kujtesës, falsifikim Orwell-ian i realitetit...". Lufta e pandërprerë e Oqeanisë ndaj kujtesës, gjatë së cilës shkatërrohet edhe dëshmia më e vogël që bie në kundërshtim me vijën zyrtare më të fundit dhe zëvendësohet nga fakte të rreme, është një nga mjetet më origjinale dhe të tmerrshme të romanit.

Mjeti tjetër është asgjësimi i gjuhës. Historia e saktë është një anije e rëndësishme e lirisë, ndoshta më e rëndësishmja, dhe romani *1984* duhet parë si një barkë për studime historike. E dyta është pastërtia gjuhësore. Gjuha është dëshmi: ajo përbëhet nga shtresat gjeologjike të ngjarjeve të së shkuarës dhe vlerave të vjetëruara. Me sjelljen në fokus të përkushtimit me të cilin vrasësit e të vërtetës u shmangen fjalëve të mirënjohura dhe i zëvendësojnë me fjalët e tyre, Orwell-i evidentoi një karakteristikë tipike si për burokratët e rëndomtë ashtu edhe për diktatorët. Në Oqeani, Partia ka krijuar një gjuhë të thjeshtëzuar, *Gjuhën e Re*, e cila ka zëvendësuar anglishten tradicionale gjithë asosacione të ndërlikuara. Kjo esperanto ideologjike përbëhet nga fjalë të shkurtra, të bashkuara, "që ndillnin minimumin e mundshëm të asosacioneve në mendjen e folësit", dhe në fund do ta bënin të pamundur përkthimin e mendimeve heretike. Orwell-i jep shembuj të ngjashëm të *Gjuhës së Re* në botën reale: *Nazist, Gestapo, Komintern, Agjiprop*. Ka edhe shumë të tjera. Levi vëren që në Gjermaninë naziste, shprehje si "zgjidhja përfundimtare", "trajtim i veçantë", "skuadra e punësimit të shpejtë", fshihnin një realitet të frikshëm. Ne mund të shtojmë fjalët tona të periudhës së terrorit atomik: *vrasje në masë*, folja *to nuke*[4] ose togfjalëshi gjysmë ironik *lufta e yjeve*.

Mendimi i dyfishtë, Gjuha e Re, ndalkrim, (aftësia "të ndalosh, në mënyrë instiktive, sapo në mendje shfaqet ndonjë mendim i rrezikshëm... që do të thotë budallallepsje mbrojtëse.") janë gjëra të zakonshme në çdo shtet autokratik apo totalitar, gjë që shpjegon arsyen pse libri, i shpërndarë në fshehtësi, u prit shumë mirë në Europën Lindore. Ndërkohë, kjo mënyrë komunikimi vihet re pjesërisht në çdo zyrë, korporatë apo parti politike në demokraci, pa përmenduar këtu ndonjë profesion që përdor zhargon apo ndonjë disciplinë akademike që kërkon fanatizëm. Ato paralajmërojnë njëlloj si një polemikë paralajmëron pasoja të tmerrshme në qoftë se lihet të dalë jashtë kontrollit.

---

4 - to nuke nënkupton bombardimin me armë nukleare, folje që nuk ka të ngjashme në shqip, ose duke u përpjekur ta përkthejmë: me bërthamue.

Sidoqoftë, romani *1984* është një referencë historike specifike. Nuk është rastësi që Orwell-i e quan ideologjinë e Partisë *Anglosoc* dhe e shfaq atë si një shprishje të socializmit anglez. Disa e kanë parë atë si padi kundër qeverisë laburiste të Clement Attlee-së. Në fakt, Orwell-i, që vazhdoi ta konsideronte veten edhe socialist demokrat edhe përkrahës të Partisë Laburiste, nuk ishte shumë i interesuar për politikën e viteve 40-të që zhvillohej me shpejtësi, ndërkohë që gjatë kohës së mbrujtjes dhe shkrimit të librit (ndërprerë nga një periudhë e gjatë në spital prej tuberkulozit) ai qëndroi larg thashethemeve politike të Londrës, në shtëpinë e tij në ishullin e Juras.

Megjithatë romani mund të shikohet – ashtu si paraardhësi i tij, *Ferma e Kafshëve* – si kontribut në debatin brenda socializmit. Ashtu si në veprën *Ferma e Kafshëve*, ai nuk vështron përpara, drejt kundërshtive të së ardhmes, por kthehet tek ato para lufte. Përvoja politike më e rëndësishme në jetën e Orwell-it (e përshkruar në librin *Homazh për Katalonjën*) ishte lufta Civile e Spanjës në të cilën ai u plagos duke luftuar për milicinë revolucionare të POUM-it (*Partido Obrero de Unificación Marxista*). Nga Spanja Orwell-i u kthye tejet i prekur prej komunizmit të udhëhequr nga Moska, ndikimi i të cilit tek inteligjenca britanike vazhdoi të rritej. Ai ishte ndër të paktët në krahun e majtë që nuk habit me marrëveshjen sovjeto-gjermane në gusht të vitit 1939 (që u shoqërua me pushtimin e Rusisë nga Gjermania në vitin 1941, që e futi Stalinin në luftë dhe e kaloi në krahun e Aleatëve, dhe pastaj, pas ftohjes së marrëdhënieve të Rusisë me Aleatët, e ktheu Rusinë në një armik potencial të Perëndimit menjëherë sa mbaroi lufta). Cinizmi dhe paqëndrueshmëria e aleancave të fuqive të mëdha pasqyrohet në romanin *1984*.

Oqeania nuk është shoqëri socialiste, në asnjë mënyrë. Përkundrazi. Një nga shembujt më pikantë të *mendimit të dyfishtë* është kur "Partia shkel dhe diskrediton të gjitha parimet mbi të cilat u ngrit fillimisht lëvizja socialiste dhe e bën këtë pikërisht në emër të Socializmit". Prandaj Oqeania nuk mund të merret si argument për dështimin e socializmit. Çështja nuk është tek arritjet dhe premtimet e socializmit, por te shkelja e ligjeve dhe përbuzja. Dikush mund të vërë re shenja ngjashmërie me librin

Rruga drejt Serfdomit, në përshkrimin e Goldshteinit se si "në çdo variant të socializmit që u shfaq pas 1900-ës e këtej, synimi për të vendosur lirinë dhe barazinë u braktis gjithnjë e më haptazi". Mirëpo Orwell-i është po kaq kritik edhe ndaj anti-socializmit. Derin në vitin 1940, thotë Goldshteini "gjithë rrymat kryesore të mendimit politik qenë totalitare... Çdo teori politike e re, cilido qoftë emri i saj, u mbështet tek hierarkia dhe disiplina ushtarake". Në qoftë se Shiriti Ajror i Parë është variant i ashpërsisë së Londrës (siç sugjeron filmi interesant i Michael Tadford-it bazuar në këtë roman), atëherë socializmi laburist pothuajse nuk është kritikuar fare. Goldshteini e thotë qartë që sistemet në superfuqitë e tjera, Euroazi dhe Azi Lindore, janë identike.

Orwell-i nuk sulmon socializmin, por njerëzit mendjelehtë dhe interesaxhinj që e quajnë veten socialistë dhe disa iluzionistë të tjerë. Një tjetër iluzion – pjesë e kësaj platforme retorike – është: pavarësisht vështirësive dhe pengesave gjatë rrugës, triumfi i klasës punëtore është i pashmangshëm. Orwell-i e përmbys këtë. Liria relative e klasës punëtore në Oqeani është thjesht simptomë e përbuzjes me të cilën ajo trajtohet. "Proletarët nuk përbëjnë asnjë lloj kërcënimi," deklaron Goldshteini. Atyre mund t'u lejohet liria intelektuale, shton ai (duke thumbuar parimet liberale dhe socialiste njëherësh), "sepse ata nuk kanë intelekt."

Megjithatë prolet zënë një vend të rëndësishëm në roman. Në qoftë se shpresa ekziston, mendon Uinstoni, ajo gjendet te prolet. A ka shpresë? Mesazhi i jashtëm i romanit lë të kuptohet që jo. Oqeania është një shoqëri *përtej* totalitarizmit. Edhe te komunistët e Aushvicit apo Gulagut, shpresa mund të vazhdonte të ekzistonte dhe heroizmi ishte një mundësi. Ndërsa në Oqeani heroizmi nuk ekziston sepse nuk ke kë të shpëtosh. Shpresa shfaqet një çast dhe zhduket menjëherë: përpjekja e Uinstonit për të ruajtur identitetin e vet është thjesht një pikë ujë në oqean. Rezistenca fizike ndaj terrorizmit të Partisë është vetëshkatërruese. Orwell-i nënvizon argumentin e Koestler-it në librin *Errësirë në mes të ditës:* që të luftosh shtypjen me mjetet e vetë shtypësit do të thotë të kapitullosh moralisht. Për të vënë në provë vendosmërinë prej komplotisti të Uinstonit, ai përdor O'Brajënin që ta kap heroin në grackë gjatë një betimi monstruoz:

- Në qoftë se do ta kërkojnë interesat tona që të hidhni acid sulfurik në fytyrën e fëmijës – jeni të përgatitur për ta bërë këtë?
- Po.

Më vonë, hetuesi O'Brajën e pyet Uinstonin:

Ti e konsideron vëten më të lartë se ne gënjeshtarët dhe mizorët?

O'Brajënit i mjafton të kthejë mbrapa kasetën e bisedës më të hershme që të realizojë qëllimin e tij.

Megjithatë, romani *1984* nuk është libër dëshpërues. Ai është një rebus intelektual i kopsitur: çdo përgjigje e lehtë apo kundërshtim është parashikuar dhe bllokuar me kujdes. Ndërsa bota groteske që portretizohet aty është imagjinare. Nuk ka arsye që ta shikojmë vizionin e errët letrar të Orwell-it si mohim të alternativave të jetës reale. Sigurisht, romani mund të shikohet si pasqyrë e forcave që rrezikojnë lirinë dhe e nevojës për të rezistuar. Pjesa më e madhe e këtyre forcave mund të përfshihen në një fjalë të vetme: gënjeshtrat. Autori ofron një mundësi politike – midis mbrojtjes së të vërtetës, përqafimit të mashtrimit në dobi të sunduesve dhe shfrytëzimit të të sunduarve, te të cilët gjenden ndjenjat e sinqerta dhe shpresa përfundimtare.

Pra, tek e fundit romani është subversiv, protestë kundër dredhive qeveritare. Është goditje kundër autoritarizmit në çdo individ, polemikë kundër çdo fanatizmi, shpërthim anarkist kundër çdo konformisti të përulur. "Për ne është e pafalshme që dikush në botë të ekzistojë një mendim i gabuar, sado i fshehtë apo i dobët që mund të jetë," thotë O'Brajën djallëzori. Për shkak të qartësisë së tij, *1984* është një roman dhe një trakt i madh që do t'i rezistojë kohës sepse mesazhi i tij është i përjetshëm: mendimet e gabuara janë elementë të lirisë.

BEN PIMLOTT

PJESA E PARË

I

Ishte një ditë e ftohtë dhe e shndritshme prilli, orët e qytetit ranë trembëdhjetë herë. Me mjekrën të zhytur në gjoks, në përpjekje për t'iu shmangur erës, Uinston Smithi nxitoi mes dyerve të xhamta të Bllokut të Fitores, megjithëse jo aq shpejt sa të ndalte pluhurin prej rëre që hyri brenda bashkë me të.

Korridori kundërmonte lakër të zier dhe qilima të vjetër. Në fund të tij, në mur varej një afishe disi e madhe për mjedise të mbyllura. Në të shfaqej një fytyrë masive, më tepër se një metër e gjerë: fytyra e një burri rreth të dyzet e pesave, me mustaqe të trasha, të zeza dhe tipare të rrudhura e të hijshme. Uinstoni bëri për nga shkallët. Ashensorin nuk ia vlente as ta provonte: edhe në kohë më të mira punonte shumë rrallë, ndërsa tani, gjatë ditës, nuk kishte drita. Kjo ishte pjesë e orientimit ekonomik meqë bëheshin përgatitjet për Javën e Urrejtjes. Ndërtesa qe shtatëkatëshe dhe Uinstoni, që ishte tridhjetë e nëntë vjeç dhe kishte një malcim sipër nyellit të djathtë të këmbës, u ngjit me ngadalë, duke pushuar disa herë gjatë rrugës. Në çdo sheshpushim, përballë derës së ashensorit, që prej murit e këqyrte afishja me fytyrën e madhe dhe mustaqet e trasha. Pamja qe e tillë saqë kur i kaloje para të dukej sikur sytë e saj lëvizin në drejtimin tënd. Poshtë kishte diçiturën: VËLLAI I MADH JU VROJTON.

Brenda apartamentit, një zë i sheqerosur lexonte një listë shifrash që kishte të bënte me prodhimin e gizës. Zëri vinte nga një pllakë metalike e gjatë, si një pasqyrë e turbullt, e cila ishte

pjesë e sipërfaqes së murit në krahun e djathtë. Uinstoni shtypi një çelës dhe zëri u zbeh disi, megjithëse fjalët ende vinin të qarta. Zëri i instrumentit (kështu quhej tele-ekrani) mund të zbehej, por ishte e pamundur ta fikje. Shkoi te dritarja: figurë e pakët, e brishtë dhe kominoshet blu, uniforma e Partisë, ia nxirrnin më në pah dobësinë. Me flokë tejet të verdhë, fytyrë natyrshëm sanguine, lëkurë të regjur nga sapuni i ashpër, brisqet e tejpërdorur, dhe të ftohtit e dimrit që sapo kishte ikur.

Bota jashtë dukej e ftohtë, qoftë dhe me kanatet e dritares të mbyllura. Në rrugë, shtjellat e erës ngrinin spirale pluhuri e copash letre dhe, megjithëse dielli shkëlqente e qielli kishte një ngjyrë blu të ashpër, gjithçka dukej e pangjyrë, përveç afisheve të ngjitura gjithandej. Fytyra me mustaqet e zeza kundronte nga të gjitha pikat më të dukshme. Një prej tyre ndodhej në ballinën e shtëpisë përballë. VËLLAI I MADH JU VROJTON, thoshte diçitura, ndërsa sytë e zinj vështruan në sytë e Uinstonit. Më poshtë, në nivelin e rrugës, një tjetër afishe, e grisur në cep, lëkundej në erë me luhatje, duke mbuluar e zbuluar një fjalë të vetme: ANGLOSOC[1]. Në largësi, një helikopter rrëshqiti midis çative, u lëkund një çast si një mizë dheu dhe u largua si shigjetë me trajektore të kurbëzuar. Ishte patrulla e policisë e cila fuste hundët në dritaret e shtëpive. Në fakt, patrullat nuk kishin rëndësi. Njëshi ishte Policia e Mendimit.

Pas shpinës së Uinstonit, vazhdonte ende të llomotitej rreth gizës dhe tejkalimit të Planit të Nëntë Trevjeçar. Tele-ekrani filmonte dhe transmetonte njëkohësisht. Çdo zë i Uinstonit, pak më i lartë se një pëshpërimë, regjistrohej; akoma edhe më, për sa kohë që ai qëndronte brenda fokusit të pllakës metalike, dëgjohej dhe shikohej njëkohësisht. Natyrisht, nuk kishte asnjë mundësi që ta merrje vesh çastin gjatë të cilit vrojtoheshe. Sa herë e bënte lidhjen Policia e Mendimit, apo cilin sistem përdorte ajo për çdo individ, qe veçse hamendje. Madje, ishte shumë e besueshme që ata vrojtonin çdonjërin dhe gjatë gjithë kohës. Sidoqoftë, fishën

1 - *Socializmi anglez. (shënim i përkthyesit)*

tënde mund ta lidhnin kur të donin. Duhet të jetoje – dhe jetuan, nga zakon u bë instinkt – me mendimin se çdo tingull yti dëgjohej dhe, përjashto errësirën, çdo lëvizje tjetër e jotja vëzhgohej.

Uinstoni vazhdoi të rrinte me shpinë nga tele-ekrani. Qe pozicion më i sigurt, megjithëse e dinte që edhe shpina mund të të tradhëtonte. Një kilometër më tutje, e ngritur dukshëm mbi peizazhin e zymtë, krejt e bardhë, ndodhej Ministria e të Vërtetës, vendi i tij i punës. Kjo, mendoi me njëfarë neverie të paqartë – kjo ishte Londra, qyteti kryesor i Shiritit të Parë Ajror, një nga tre provincat më të populluara të Oqeanisë. U mundua të shtrydhte kujtimet e fëmijërisë për të parë nëse Londra kishte qenë gjithmonë kështu. A kishin qenë gjithmonë aty këto pamje shtëpish të ronitura të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të veshura anash me masa dërrasash, dritaret mballosur me dollape, çatitë me llamarinë të valëzuar, muret e kopshteve të çartallosura në të gjitha drejtimet? Po vendet e bombarduara ku pluhuri i zhavorrit krijonte shtjella në ajër, ndërsa shelgjet jepnin e merrnin të dilnin sipër togjeve me copëra gërmadhash; po sheshet, edhe më të mëdhenj, hapur nga bombat ku kishin mbirë, si kotece pulash, koloni të pista banesash prej druri? Por më kot, e kishte të pamundur t'i kujtonte: prej fëmijërisë nuk kishte mbetur asgjë veç një sërë tablosh të shndritshme, pa peizazh dhe gati të pakuptueshme.

Ministria e së Vërtetës – Minivër quhej në Gjuhën e Re[1] - ishte krejt ndryshe nga çdo objekt që të kapte syri. Një strukturë piramidale prej betoni xixëllues që ngrihej, kat pas kati, 300 metra në ajër. Tre sllloganet e Partisë, shkruar me shkronja elegante në fasadën e saj të bardhë, lexoheshin qartë që prej ku ndodhej Uinstoni:

LUFTA ËSHTË PAQE
LIRIA ËSHTË SKLLAVËRI
INJORANCA ËSHTË FUQI

---

1 - Gjuha e Re ishte gjuha zyrtare e Oqeanisë. Për t'u njohur me strukturën dhe etimologjinë e saj shikoni Shtojcën *në fund të librit. (shënim i autorit)*

Thuhej se Ministria e të Vërtetës kishte tre mijë dhoma mbi tokë dhe po kaq degëzime ndën vete. E shpërndarë nëpër Londër, ajo kishte edhe tre godina të tjera me po këtë pamje dhe këto përmasa. Gjithë ndërtesat rreth tyre dukeshin si kërpudha dhe nga çatia e Bllokut të Fitores mund t'i shikoje të katërta njëkohësisht. Ato ishin ndërtesat e katër Ministrive në të cilat ishte vendosur gjithë aparati qeveritar. Ministria e të Vërtetës, e cila merrej me lajmet, argëtimin, edukimin dhe artet e bukura. Ministria e Paqes, e cila merrej me luftën. Ministria e Dashurisë, që merrej me ligjin dhe rendin. Dhe Ministria e Bollëkut, që kishte të bënte me çështjet ekonomike. Emrat e tyre në Gjuhën e Re ishin: Minivër, Minipaq, Minidash dhe Miniboll.

Ministria e Dashurisë ishte më e frikshmja. Nuk kishte asnjë dritare. Uinstoni nuk kishte hyrë kurrë në të, në fakt, nuk i qe afruar dot as dhe një kilometër. Hyrja ishte e pamundur në qoftë se nuk kishe ndonjë punë zyrtare, por, edhe atëherë, duhet të çaje një labirint të pleksur me tela me gjemba, dyer çeliku dhe çerdhe të maskuara armësh me breshëri. Edhe rrugët që të çonin tek barrikadat e saj të jashtme ruheshin nga roje me fytyra gorillash, me uniformë të zezë, armatosur me shkopinj gome të nyjëzuar.

Uinstoni bëri një rrotullim të beftë. Fytyra e tij kishte pamjen e një optimisti të qetë, shprehje të cilën e merrte sa herë që përballej me tele-ekranin. Eci përmes dhomës dhe hyri në kuzhinën e vogël. Duke u larguar nga Ministria në atë orë e kishte humbur drekën në mensë dhe e dinte që në kuzhinën e vet nuk kishte ushqim tjetër përveç një copë buke të zezë e cila duhej të ruhej për mëngjesin e ditës tjetër. Mori në raft një shishe me lëng pa ngjyrë, me një etiketë pothuajse të bardhë ku shkruhej vetëm emri: Xhin Fitorja. Prej shishes u përhap një aromë vaji që trazonte stomakun si raki kineze orizi. Uinstoni mbushi gati plot një filxhan çaji, përgatiti veten për goditjen dhe e kapërdiu si një dozë ilaçesh.

Menjëherë fytyra i mori ngjyrë vishnje dhe i dolën lotë nga sytë. Rakia kishte shijen e acidit nitrik dhe me ta gëlltitur të dukej

sikur të kishin qëlluar pas koke me shkop gome. Megjithatë, pak çaste më vonë, djegia në stomak iu shua ndërsa bota nisi t'i dukej më e gëzueshme. Nxori një cigare nga paketa e shtypur me emrin CIGARE FITORJA, të cilën e mbajti kokë poshtë padashje dhe duhani ra në dysheme. Me cigaren tjetër u tregua më i kujdesshëm. U kthye sërish në dhomën e ndenjjes dhe u ul pranë një tavoline të vogël që ndodhej në krahun e majtë të tele-ekranit. Nga sirtari i tavolinës nxori një mbajtëse penash, një shishe bojë dhe një bllok të trashë e të papërdorur, me shpinë të kuqe dhe ballinën ngjyrë si të mermertë.

Për arsye që ai nuk i dinte, tele-ekrani në dhomën e ndenjjes ndodhej në një pozicion jo të zakonshëm. Në vend që të ishte vendosur si përherë në faqen e murit prej nga zotëronte gjithë dhomën, tashmë ai ndodhej në murin më të gjatë, përballë me dritaren. Në njërën anë ndodhej një kamare ku qe ulur Uinstoni e cila gjatë ndërtimit të godinës ishte planifikuar për rafte librash. Duke qëndruar në kamare dhe goxha i tërhequr mbrapa, ai arriti të mbetej jashtë rrezes së tele-ekranit, ose, të paktën ai vetë nuk e shihte. Natyrisht mund të dëgjohej, por për sa kohë që do të rrinte në pozicionin e tanishëm, ai nuk binte në sy. Atë që po bëhej gati të niste, deri në një farë mase e përcaktoi rregulli jo i zakonshëm i gjërave në dhomë.

Mirëpo edhe blloku i shënimeve që sapo mori nga sirtari, e shtyu për një gjë të tillë. Bukuria e bllokut ishte disi e veçantë. Një letër e tillë, e lëmuar, ngjyrë kremi, pak e zverdhur nga koha, kishte të paktën dyzet vjet që nuk prodhohej më. Megjithëse e mori me mend që blloku i shënimeve ishte shumë më i vjetër se kaq. E kishte parë në dritaren e vjetër të një dyqani rrangullash në një lagje të varfër të qytetit (pikërisht në atë lagje që tani nuk e kujtonte dot) dhe menjëherë e kishte pushtuar dëshira për ta patur. Anëtarët e Partisë nuk duhej të shkonin në dyqane të zakonshme ("blerje në tregun e lirë"), por rregulli nuk respektohej me fanatizëm, sepse kishte shumë gjëra të tjera, si për shembull lidhëse këpucësh apo brisqe, që ishte e pamundur t'i gjeje në rrugë tjetër. Tek dera e dyqanit kishte parë me shpejtësi poshtë e lart rrugës, pastaj kishte hyrë dhe e kishte blerë bllokun për dy

dollarë e gjysmë. Kur e bleu nuk e kishte idenë pse e bënte një gjë të tillë. E kishte futur në valixhe me një ndjenjë faji dhe e kishte çuar në shtëpi. Edhe pse nuk kishte gjë të shkruar, blloku ishte një objekt kompromentues.

Uinstoni kishte vendosur të mbante ditar. Kjo nuk ishte e paligjshme (përderisa nuk ekzistonte kurrfarë ligji), por në qoftë se diktohej, e dinte fare mirë që e priste dënimi me vdekje, ose të paktën njëzet e pesë vjet burg me punë të detyruar. I vendosi penës një xinë dhe e futi në bojë t'i hiqte yndyrën. Pena ishte një instrument arkaik i cili përdorej gjithnjë e më rrallë edhe për nënshkrime personale, mirëpo, ai e shtiu një në dorë, vjedhurazi e me ca vështirësi, vetëm prej ndjesisë se ajo letër e bukur meritonte të shkruhej me një xinë të vërtetë e jo të gërvishtej me stilolaps. E vërteta është se Uinstoni nuk ishte mësuar të shkruante me dorë. Përveç shënimeve shumë të shkurtra, gjithçka tjetër ia diktonte shkrimores me zë, gjë e pamundur për rastin në fjalë. Futi penën në bojë dhe ngurroi një çast. Ndjeu një boshllëk të lehtë në bark. Të linte gjurmë mbi letër ishte një akt i epërm. Me shkronja të vogla e të shtrembëra shkroi:

4 prill 1984

U tërhoq mbrapa. E kaploi një ndjenjë pasigurie. Së pari, nuk e dinte me saktësi që *ishte* viti 1984. Por, meqenëse ndjehej disi i sigurt se ishte 39 vjeç dhe meqenëse besonte që kishte lindur në 1944-ën ose 45-ën, aty rrotull 1984-ës duhet të ishte, megjithëse qe e pamundur të thoje me siguri datën brenda një apo dy vitesh.

Për kë, u habit befas, e shkruante ditarin? Për të ardhmen, për të palindurit ende. U hallakat një hop rreth datës së dyshimtë në ditar, pastaj u përball me togfjalëshin e Gjuhës së Re: *mendim i dyfishtë*. Për herë të parë rroku përmasat e kësaj sipërmarrjeje. Si mund të komunikohej me të ardhmen? Ishte e pamundur nga natyra. E ardhmja ose do t'i ngjante të tashmes dhe, natyrisht, nuk do të mbante vesh Uinstonin, ose do të ishte e ndryshme nga ajo dhe në këtë rast parashikimet e tij do të ishin të pakuptimta.

Një copë herë vështroi letrën si hutaq. Tele-ekrani kishte kaluar në një muzikë ushtarake çjerrëse. Ishte e çuditshme ngaqë ai dukej sikur kishte humbur jo vetëm aftësinë për t'u shprehur, por edhe aftësinë të harronte se çfarë kishte dashur të thoshte qysh në fillim. Gjithë javët e fundit ishte përgatitur veç për këtë moment dhe as që e kishte shkuar fare në mendje se mund t'i duhej diçka tjetër veç kurajos. Të shkruarit e kishte menduar gjë të lehtë. Gjithë puna ishte të hidhte në letër monologun e brendshëm, zevzek, të cilin e kishte përsëritur në mendje për vite të tëra. Mirëpo, atë çast, edhe monologu dukej sikur kishte avulluar. Jo vetëm kaq, malcimi nisi të dhimbte e të bëhej i padurueshëm. Nuk guxoi ta prekte me dorë, ky veprim e nxiste kruarjen edhe më. Sekondat kalonin. Nuk ndiente asgjë veç bardhësisë së fletës përballë tij, kruarjes që lypte lëkura sipër nyellit të këmbës, muzikës çjerrëse dhe marramendjes së lehtë të shkaktuar nga xhini.

Befas filloi të shkruante me panik, i pavetëdijshëm për atë që hidhte në letër. Shkrimi i dorës, i vogël por fëmijënor, lëvizte poshtë e lart fletës, duke lënë jashtë fillimisht shkronjat e mëdha e më tej edhe pikat në fund të fjalive:

4 Prill, 1984. Mbrëmë në kinema. Të gjithë filma lufte. Njëri, film shumë i mirë, bënte fjalë për një barkë plot me refugjatë, diku në Mesdhe, që bombardohej. Publiku u zbavit me një burrë të shëndoshë që mundohej të largohej me not i ndjekur nga breshëria e helikopterit, fillimisht u pa tek zhytej në ujë si delfin, mandej u shfaq në fokusin e breshërive të helikopterit, pastaj u bë shoshë nga plumbat ndërsa uji përreth mori ngjyrë rozë dhe ai u fundos sa hap e mbyll sytë, sikur trupi të ishte mbushur me ujë nëpërmjet vrimave. publiku u shqye gazit kur ai u mbyt. pastaj u shfaq një varkë shpëtimi plot me fëmijë dhe një helikopter sipër saj. një mesogrua, ndoshta çifute, qëndronte në këmbë tek kiçi me një fëmijë nja tre vjeç në duar. vogëlushi ulërinte nga frika dhe fshihte kokën mes gjinjve të saj si në kërkim të një strehe dhe gruaja e mbështillte në kraharor dhe e qetësonte megjithëse edhe ajo vetë kishte marrë ngjyrë blu nga frika, gjithë kohën mundohej ta mbulonte sa më shumë të ishte e mundur sikur krahët e saj nuk do t'i

lejonin plumbat ta preknin fëmijën. pastaj helikopteri lëshoi mes tyre një bombë 20 kilogramëshe një dritë e tmerrshme dhe barkën e përfshinë flakët. pastaj vazhdoi një pamje e mrekullueshme dora e një fëmije që ngjitej lart lart drejt lart në qiell pamje e marrë nga ndonjë helikopter me kamerën në turi dhe nga kolltuqet e partisë u dëgjuan duartrokitje të shumta por një grua në karriget e proleve nisi të bërtiste e sokëlliste se ai film nuk duhet të ishte shfaqur në sy të kalamajve nuk kishin të drejtë ta jepnin në sy të kalamajve derisa e nxorën e nxorën jashtë s'ma ha mendja se i bënë gjë askush nuk e çan kokën çfarë thonë prolet veprim tipik për prolet ata kurrë...

Uinstoni pushoi së shkruari, pjesërisht për arsye të ngërçit. Nuk e kuptonte se çfarë e detyroi të villte gjithë këtë lumë budallallëqesh. Ishte e çuditshme, por ndërsa shkruante iu shfaq një kujtim aq i gjallë saqë i dukej sikur ishte duke e hedhur në letër. Tashmë e kuptoi që kjo i ndodhte prej atij incidentit tjetër për shkak të të cilit kishte vendosur të kthehej në shtëpi dhe të niste ditarin.

Diçka që kishte ndodhur atë mëngjes në Ministri, nëse mund të përdoret folja ndodh për diçka kaq të pasigurt.

Në Departamentin e Arkivave, aty ku ai punonte, gati në orën njëmbëdhjetë fiks, njerëzit nxirrnin karriget nga kthinat dhe i vendosnin në qendër të hollit përballë tele-ekranit të madh, në përgatitje për Dy Minutat e Urrejtjes. Uinstoni po ulej në karrigen e vet në një nga radhët e mesit, kur dy persona që i njihte vetëm si fytyra por nuk u kishte folur kurrë, hynë papritmas në sallë. Një prej tyre qe një vajzë me të cilën qe shkëmbyer shpesh në korridore. Nuk ia dinte emrin, por e dinte që punonte në Drejtorinë e Trillimeve. Siç dukej – meqenëse e kishte parë disa herë me duar gjithë vaj dhe me një çelës dadosh – mund të ishte mirëmbajtëse e ndonjërës nga makinat që përdoreshin për të shkruar novelat. Ajo kishte një vështrim të guximshëm, rreth njëzet e shtatë vjeçe, me flokë të zinj të trashë, fytyrë pikaloshe dhe lëvizje atletike, të buta. Rreth belit, sipër kominosheve, shtrënguar mjaftueshëm që të nxirrte në pah trajtën e vitheve të saj, ajo kishte lidhur një

brez të kuq, emblemën e Organizatës së Rinisë Kundër Seksit. Uinstoni e kishte urryer atë vajzë qysh kur e kishte parë për herë të parë. E dinte arsyen. Urrejtja buronte nga atmosfera e hokejit, banjave të ftohta, marshimeve qytetare dhe mendjes përgjithësisht të kthjellët që ajo mbartte me vete kudo që shkonte. Ai kishte antipati për të gjitha gratë, sidomos për të rejat dhe të bukurat. Ngaqë gratë, veçanërisht ato më të rejat, ishin pasueset e lindura të Partisë, gëlltitëset e sllloganëve, spiunet amatore dhe nuhatëset e devijimeve. Por vajza në fjalë i dukej më e rrezikshmja nga të gjitha. Një herë, kur u shkëmbyen në korridor, vështrimi i saj me bisht të syrit e shpoi në trup si gjilpërë dhe për një çast i kalli datën. Madje i kishte shkuar në mendje që ajo mund të ishte agjente e Policisë së Mendimit. Diçka e pamundur, në fakt. Por, prapëseprapë, sa herë që e ndiente rrotull praninë e saj, vazhdonte të shqetësohej, një shqetësim ky prej frikës së përzier me armiqësi.

Personi tjetër ishte një burrë i quajtur O'Brajën, anëtar i Besnikëve të Partisë dhe mbajtës i një posti aq të rëndësishëm e të largët saqë Uinstoni kishte veç një ide të mjegullt për natyrën e tij. Kur panë që po afrohej një anëtar i Besnikëve të Partisë, me kominoshe të zeza, njerëzit rreth karrigeve i përfshiu një heshtje varri. O'Brajëni ishte burrë i bëshëm, truplidhur, qafë trashë, me fytyrë të ashpër, brutale dhe pak qesharake. Pavarësisht pamjes së frikshme, ai zotëronte njëfarë sjellje tërheqëse. E kishte zakon t'i rregullonte syzat me një lëvizje çarmatosëse – lëvizje e qytetëruar, por e vështirë të shprehej me fjalë. Një gjest që, në qoftë se dikush mendonte në këtë mënyrë, mund t'i kujtonte një fisnik të shekullit të nëntëmbëdhjetë i cili po të zgjaste kutinë e burnotit. Uinstoni e kishte parë nja dhjetë a dymbëdhjetë herë, në po kaq vjet. O'Brajëni e tërhoqi thellësisht, veç jo prej sjelljes qytetare dhe trupit të tij prej boksieri. Më së tepërmi, tërheqja buronte nga një bindje e fshehur – e ndoshta jo bindje, por vetëm shpresë – që O'Brajëni nuk e donte Partinë. Këtë e tregonte diçka në fytyrën e tij. Megjithëse, ndofta në atë fytyrë nuk ishte shkruar tradhtia, por thjesht inteligjenca. Sidoqoftë, ai kishte pamjen e një njeriu që mund t'i flisje nëse ishe jashtë rrezes së tele-ekranit dhe në qoftë se e gjeje vetëm. Uinstoni

nuk kishte bërë as përpjekjen më të vogël për të verifikuar këtë hamendje, ngaqë ishte e pamundur. Atë çast O'Brajëni vështroi orën e dorës, pa që ishte gati njëmbëdhjetë fiks dhe, në mënyrë të dukshme, vendosi të qëndronte në Drejtorinë e Arkivave derisa të mbaronin Dy Minutat e Urrejtjes. U ul në të njëjtën radhë me Uinstonin, dy karrige më tutje. Midis tyre qëndronte një vajzë me flokë të kuqërremtë e cila punonte në zyrën ngjitur me zyrën e Uinstonit. Vajza flokëzezë ndodhej në karrigen pas tij.

Pak më vonë, nga tele-ekrani në fund të dhomës shpërtheu një fjalim gërvishës, i neveritshëm, si zhurma e një makinerie të pavajosur. Një zhurmë që të acaronte nervat dhe të ngjethte mishin. Urrejtja kishte filluar.

Si zakonisht, në tele-ekran u shfaq fytyra e Emanuel Goldshteinit, Armikut të Popullit. Aty-këtu midis publikut u dëgjuan fishkëllima. Gruaja me flokë të kuqërremtë lëshoi një piskamë frike përzier me neveri. Goldshteini ishte renegati dhe bukëshkali që dikur, kohë më parë (askujt nuk i kujtohej me saktësi se kur), kishte qenë një nga udhëheqësit kryesorë të Partisë, pothuajse në një nivel me Vëllain e Madh, e mandej ishte përfshirë në veprimtari kundër-revolucionare, ishte dënuar me vdekje dhe, në mënyrë misterioze, ishte zhdukur. Programi i Dy Minutave të Urrejtjes ndryshonte vazhdimisht, por nuk kishte ditë që Goldshteini të mos ishte figura kryesore. Tradhëtari numër një, i pari person që ndoti pastërtinë e Partisë. Gjithë krimet e mëvonshme kundër saj, gjithë tradhtitë, aktet e sabotimit, herezitë, devijimet, buronin nga mësimet e tij. Ai ishte i gjallë, thurte komplote diku, ndoshta përtej detit, nën mbrojtjen e paguesve të huaj, e ndoshta – kështu flitej herë pas here – në ndonjë vend sekret në Oqeani.

Diafragma e Uinstonit u tendos. Sa herë që përballej me portretin e Goldshteinit provonte emocione të përziera. Kishte një fytyrë çifuti shëndetpakë, me një aureolë pushatake flokësh të bardhë dhe një mjekër të vogël majuce – fytyrë e zgjuar por që të ngjallte edhe urrejtje, me një lloj mendjelehtësie të moçme në hundën e gjatë e të hollë, afër fundit të së cilës qëndronin një palë syze. Ngjante me fytyrën e një deleje dhe, edhe zëri kishte

diçka prej deleje. Si zakonisht Goldshteini mbante fjalimin e helmatisur kundër doktrinave të Partisë – një sulm aq shumë i tepruar dhe pervers saqë edhe një fëmijë do ta kuptonte, e njëkohësisht i mjaftueshëm për të të alarmuar se të tjerë njerëz, jo me ndonjë nivel të lartë gjykimi, mund ta besonin. Fyente Vëllain e Madh, denonconte despotizmin e Partisë, kërkonte paqe të menjëhershme me Euroazinë, mbronte lirinë e shtypit, lirinë e tubimit, lirinë e mendimit, klithte me histerizëm për revolucionin e tradhtuar – dhe e gjithë kjo bëhej me një fjalim të rrufeshëm me fjalë shumërrokëshe, njëfarë parodie e stilit të zakonshëm të oratorëve të Partisë, madje përmbante edhe fjalë të Gjuhës së Re, shumë më shumë fjalë të saj seç përdorte në jetën e përditshme një anëtar i Partisë. Uinstoni nuk kishte dyshim për realitetin që bënte fjalë euforia e rreme e Goldshteinit, në sfondin mbrapa të cilit parakalonin kollonat e pafundme të ushtrisë euroaziatike – burra me pamje solide rresht pas rreshti, fytyra aziatike pa shprehje të cilat përmbytnin tele-ekranin dhe zhdukeshin, për t'u zëvendësuar me fytyra saktësisht të njëjta. Zhurma monotone e hapave të rëndë të këpucëve ushtarake shoqëronte blegërimat e Goldshteinit.

Pa kaluar as tridhjetë sekonda nga fillimi i Urrejtjes, gjysma e njerëzve në sallë lëshoi një lumë thirrjesh zemërimi të pakontrolluara. Fytyra prej deleje e vetëkënaqur dhe fuqia tmerruese e ushtrisë euroaziatike mbrapa saj, bëheshin ca si shumë për t'u duruar; përveç kësaj, vetëm shfaqja, ose thjesht sjellja ndërmend e fytyrës së Goldshteinit ngjallte frikë dhe zemërim në mënyrë automatike. Ai ishte objekt urrejtjeje më i qëndrueshëm se Euroazia dhe Azia Lindore, ngaqë, zakonisht, kur Oqeania ishte në luftë me njërën nga këto Fuqi, atëherë ishte në paqe me tjetrën. Por çudia qe se, megjithëse Goldshteini urrehej e përbuzej nga të gjithë, megjithëse çdo ditë, mijëra herë në ditë, në tribuna, tele-ekrane, gazeta dhe libra, teoritë e tij hidheshin poshtë, shkalafiteshin, përqesheshin, reklamoheshin në syrin e masave si gjepura që ishin – pavarësisht gjithë kësaj, influenca e tij nuk njihte tulatje. Përherë do të kishte leshko të rinj të gatshëm të josheshin prej Goldshteinit. S'kishte ditë

që Policia e Mendimit nuk zbulonte spiunë dhe sabotatorë të cilët vepronin sipas udhëzimeve të tij. Ai qe komandanti i një armate të madhe në hije, një rrjet bashkëpunëtorësh në ilegalitet të përkushtuar për rrëzimin e Shtetit. Emri i saj thuhej se ishte *Vëllazëria*. Gjithashtu, pëshpëriteshin fjalë për një libër të tmerrshëm që qarkullonte dorazi në ilegalitet, një përmbledhje e gjithë herezive, autori i të cilit ishte Goldshteini. Një libër pa titull. Kur e përmendnin, nëse e përmendnin, njerëzit e thërrisnin thjesht *libri*. Por gjithçka dihej veç nëpërmjet gojëdhënash të pasigurta. Edhe *Vëllazërinë* edhe *librin*, në qe e mundur të shmangeshin, nuk i zinte në gojë asnjë anëtar i Partisë.

Në minutën e dytë të saj Urrejtja u kthye në tërbim. Njerëzit kërcenin në ajër dhe bërtisnin me sa u hante fyti duke u përpjekur të sfumonin blegërimat trallisëse që vinin nga teleekrani. Gruaja trupvogël me flokët e kuqërremtë kishte marrë ngjyrë rozë të çelët, ndërsa goja e saj hapej dhe bërtiste si ajo e peshkut të nxjerrë në rërë. Madje edhe fytyra hijerëndë e O'Brajënit qe skuqur. Ai qëndronte drejt në karrige, gjoksi i fryhej e shfryhej sikur të përleshej me dallgët. Vajza flokëzezë, mbrapa Uinstonit, kishte nisur të ulërinte: "Ndyrësirë! Ndyrësirë! Ndyrësirë!" pastaj, papritur, rrëmbeu një fjalor të Gjuhës së Re dhe e flaku drejt teleekranit. Libri goditi Goldshteinin në hundë dhe ra përtokë, zëri vazhdoi pa luhatje. Në një moment kthjelltësie Uinstoni vuri se edhe ai vetë ulërinte së bashku me të tjerët dhe gjuante me takë këmbëzën e karriges. Gjëja më e keqe e Dy Minutave të Urrejtjes nuk ishte fakti që të gjithëve u duhej të tregoheshin aktivë, por fakti që nuk rrije dot pa u përfshirë. Brenda tridhjetë sekondave çdo shtirje ishte e tepërt. Ekstaza e shëmtuar e frikës dhe hakmarrjes, dëshira për të vrarë, për të torturuar, për të copëtuar fytyra me vare, përhapej mes grupit të njerëzve si rrymë elektrike, e kthente njeriun, edhe pa dëshirën e tij, në një të lajthitur që çirrej e ngërdheshej. E megjithatë, ky lloj zemërimi ishte një emocion abstrakt, i paorientuar, i cili mund të kalonte nga një objekt tek tjetri si luhatjet e flakës së llampës me vajguri. Kështu, për një çast urrejtja e Uinstonit nuk ishte e drejtuar kundër Golsdteinit, por

kundër Vëllait të Madh, Partisë dhe Policisë së Mendimit; dhe në çaste të tilla zemra e tij drithërohej për heretikun e tallur dhe të vetmuar në tele-ekran, i vetmi mbrojtës i së vërtetës dhe arsyes në një botë gënjeshtrash. E megjithatë, çaste më pas, edhe ai u bë pjesë e kësaj mase dhe gjithë çfarë thuheshin për Goldshteinin i dukeshin të vërteta. Në këto çaste, urrejtja e fshehtë për Vëllain e Madh shdërrohej në adhurim, ai lartësohej, i paepur, mbrojtës syshqiponjë, si një shkëmb përballë hordhive të Azisë, ndërsa Goldshteini, pavarësisht izolimit ku ndodhej, pafuqishmërisë dhe dyshimeve që rrethonin vetë ekzistencën e tij, dukej si një joshës djallëzor, i aftë të shkatërronte qytetërimin vetëm me anë të zërit.

Madje kishte momente që njeriu mund ta kalonte urrejtjen sa andej-këndej në mënyrë të vullnetshme. Befas, me rreptësisë që njeriu heq kokën nga jastëku i trembur nga një ëndërr e keqe, Uinstoni ia doli mbanë ta zhvendoste urrejtjen nga fytyra në tele-ekran tek vajza flokëzezë mbrapa tij. Haluçinacione të gjalla, të bukura, i shkrepëtinë në mendje. Do ta rrihte për vdekje me një shkop gome. Do ta lidhte pas një huri dhe do ta qëllonte me shigjeta si Shën Sebastianin. Do ta përdhunonte dhe do t'i priste gurmazin në çastin e orgazmës. Dhe e kuptoi *pse* e urrente më qartë se më parë. Sepse ajo ishte e re, e bukur dhe pa feminitet, sepse donte të shkonte në shtrat me të dhe nuk do t'ia arrinte kurrë, sepse rreth belit të saj elegant dhe të ëmbël, i cili të ftonte ta përfshije me krahë, gjendej vetëm brezi i kuq dhe i neveritshëm, simboli i dlirësisë.

Urrejtja arriti kulmin. Zëri i Goldshteinit ishte kthyer në blegërimin e deles së momentit, dhe për një çast fytyra e tij u shndërrua në fytyrë deleje. Mandej fytyrëdelja u transformua në figurën gjigante dhe të tmerrshme të një ushtari euroaziatik i cili përparonte me automatikun që uturinte ndërkohë që u duk sikur doli nga sipërfaqja e tele-ekranit dhe një pjesë e njerëzve në radhët e para u sprapsën. Por në të njëjtën kohë, fytyra armiqësore i bëri të pranishmit të merrnin frymë të çliruar sepse ajo u shkri në fytyrën e Vëllait të Madh, flokëzi, mustaqe të zeza, plot forcë e qetësi misterioze, dhe aq e madhe sa gati mbushi gjithë tele-ekranin. Askush nuk dëgjoi çfarë tha Vëllai i Madh. Një tufë fjalësh

inkurajuese, si puna e fjalëve që thuhen në poteren e betejave, rëndësia e të cilave qëndron vetëm tek fakti që po thuhet diçka. Pastaj fytyra e Vëllait të Madh u zhduk sërish dhe vendin e saj në tele-ekran e zunë shkronjat e mëdha e të theksuara të tre sllloganeve të Partisë:

LUFTA ËSHTË PAQE
LIRIA ËSHTË SKLLAVËRI
INJORANCA ËSHTË FUQI

Megjithatë fytyra e Vëllait të Madh dukej sikur nuk pranonte të largohej nga tele-ekrani, sikur përshtypja që kishte bërë në kokërdhokët e të pranishmëve ishte tejet e gjallë dhe nuk mund të fshihej aq shpejt. Gruaja me flokët e kuqërremtë qe përkulur sipër karriges para saj. Zgjati duart drejt tele-ekranit duke mërmëritur diçka drithëruese që tingëlloi si "Shpëtuesi im!". Pastaj zhyti kokën në pëllëmbët e veta. Po lutej.

Atë çast, gjithë grupi i njerëzve shpërtheu në brohoritje ritmike, të ngadalta dhe të thella: "V-M! ... V-M! ... V-M!" – disa herë rresht, shumë ngadalë, me një ndalesë të gjatë midis V-së dhe M-së – një tingull mërmëritës i rëndë, për çudi disi i egër, në sfondin e të cilit dëgjohej kërcitja e këmbëve të zbathura dhe rrahjet bum-bum. Kjo vazhdoi pothuajse për tridhjetë sekonda. Ishte një refren që dëgjohej në çaste të ngarkuara me emocione. Pjesërisht ishte një lloj himni për urtësinë e Vëllait të Madh, por edhe një veprim vetëhipnotizues, një humbje e qëllimshme e vetëdijes me anë të zhurmës ritmike. Uinstoni ndieu sërish boshllëkun në bark. Gjatë Dy Minutave të Urrejtjes nuk i rezistonte dot përfshirjes në delirin e përgjithshëm, por brohoritjet çnjerëzore "V-M! ... V-M!" i kallnin datën. Natyrisht që brohoriste bashkë me të tjerët, ishte e pamundur të bëje ndryshe. Fshehja e ndjenjave, kontrolli i shprehjes së fytyrës, bërja e asaj që bënin gjithë të tjerët qe një veprim instiktiv. Megjithatë pati një hapësirë prej dy-tre sekondash gjatë të cilës shprehja e syve mund ta kishte tradhtuar. Pikërisht në çastin që ndodhi diçka domethënëse – në qoftë se ndodhi vërtet.

Veç një grimë, sytë e tij ndeshën sytë e O'Brajënit. O'Brajëni ishte gritur në këmbë. Kishte hequr syzat dhe qe gati për t'i kthyer mbi hundë me gjestin e tij karakteristik. Por pati nje fraksion të sekondës ku vështrimet e tyre u puqën, dhe, për aq sa zgjati, Uinstoni e kuptoi – po, e kuptoi! – që O'Brajëni mendonte të njëjtën gjë. Ishte shkëmbyer një mesazh i pagabueshëm. Dukej sikur mendjet e tyre ishin hapur dhe mendimet kaluan nga njëri tek tjetër nëpërmjet syve. "Jam me ty, - dukej sikur thoshte O'Brajëni. – E kam shumë të qartë çfarë po ndien. Di gjithçka për përbuzjen, urrejtjen dhe neverinë tënde. Por mos u mërzit, jam me ty." Pastaj rrezja e inteligjencës u shua dhe fytyra e O'Brajënit u bë e padepërtueshme si gjithë të tjerat.

Kjo ishte e gjitha, prandaj Uinstonin e zuri menjëherë pasiguria nëse kishte ndodhur gjë apo jo. Incidente të tilla s'kishin patur kurrë vazhdim. Vetëm sa mbanin gjallë besimin, ose shpresën se Partia kishte edhe armiq të tjerë përveç tij. Ndoshta pëshpërimat për një komplot të fshehtë ishin të vërteta – ndoshta *Vëllazëria* ekzistonte vërtet! Pavarësisht arrestimeve, pranimit të fajit dhe ekzekutimeve, ishte e pamundur të mos besoje se *Vëllazëria* ishte veç një mit. Ai, herë besonte e herë jo. Nuk kishte fakte, vetëm ca vështrime fluturimthi që mund të thonin gjithçka ose asgjë: copa bisedash të kapura kalimthi, shkarravina të zbehta në mure nevojtoresh – madje, dikur, në takimin e dy të panjohurve, një lëvizje e lehtë e dorës e cila mund të ishte shenjë njohjeje. U tërhoq në kthinën e tij pa vështruar më nga O'Brajëni. Ideja për ta vazhduar më tej kontaktin as që i kishte shkuar në mendje. Do kishte qenë e rrezikshme edhe sikur të kishte ditur si ta bënte një gjë të tillë. Një shkëmbim vështrimesh të dykuptimta për një ose dy sekonda, kjo ishte e gjitha. Por në vetminë e madhe që njeriu ishte i detyruar të jetonte, edhe një ngjarje e tillë ishte mbresëlënëse.

Uinstoni u ngrit në këmbë dhe drejtoi trupin. Gromësiu. Xhini i erdhi në fyt.

Përqëndroi vështrimin mbi letër sërish. Vuri re se kishte vazhduar të shkruante në mënyrë automatike edhe gjatë kohës që rrinte ulur i pafuqishëm dhe mendohej. Shkrimi nuk ishte i

shtrembër dhe i palexueshëm si më parë. Pena kishte rrëshqitur gjithë qejf mbi letrën e lëmuar dhe kishte shkruar me gërma të mëdha dhe të qarta:

POSHTË VËLLAI I MADH
POSHTË VËLLAI I MADH
POSHTË VËLLAI I MADH
POSHTË VËLLAI I MADH
POSHTË VËLLAI I MADH

sërish e sërish, duke mbushur gjysmën e faqes.

Nuk e shmangu dot një ndjenjë paniku. Diçka që ishte vërtet absurde, sepse të shkruaje këto fjalë nuk qe më e rrezikshme se vetë hapja e ditarit, për një çast u tundua t'i griste faqet e shkarravitura dhe të hiqte dorë nga ajo punë.

Megjithatë nuk e bëri ngaqë e dinte se nuk ia vlente. Shkruante apo jo POSHTË VËLLAI I MADH, s'kishte rëndësi. Vazhdonte me ditarin apo jo, s'kishte rëndësi. Sidoqë të ndodhte Policia e Mendimit do ta kapte që do ta kapte. Ai kishte bërë – dhe sërish do ta kishte bërë edhe sikur të mos kishte prekur kurrë penë me dorë – krimin kryesor, i cili përmbante gjithë të tjerët. E quanin *krim i mendimit. Krimi i mendimit* nuk ishte diçka që mund të mbahej e fshehtë përjetësisht. Mund t'ia hidhje për njëfarë kohe, ndoshta me vite, por herët apo vonë do të të shtinin në dorë.

Përherë natën – arrestimet bëheshin vetëm në errësirë. Prishja e beftë e gjumit, një dorë e ashpër që të shkund nga supi, një dritë që të sulmon sytë, një rreth fytyrash të vrazhda rrotull krevatit. Në të shumtën e rasteve nuk bëhej gjyq, madje arrestimi nuk raportohej fare. Njerëzit thjesht zhdukeshin, përherë natën. Emri yt hiqej nga regjistrat, gjurmët e gjithçkaje që kishe bërë zhdukeshin, fillimisht ekzistenca jote e dikurshme mohohej, mandej harrohej. Thjesht zhdukeshe, asgjësoheshe: termi i zakonshëm ishte *avulloje*.

Për një çast e përfshiu njëfarë histerie. Nisi të shkruante me nxitim dhe rrëmujë:

do të më vrasin por nuk më plasi do të më qëllojnë mbrapa shpine por nuk më plasi poshtë vëllai i madh përherë të qëllojnë mbrapa shpine por nuk më plasi poshtë vëllai i madh...

U tërhoq mbrapa në karrige, i erdhi disi turp nga vetja, uli penën. Pas pak ia nisi sërish me rrëmbim. U dëgjuan trokitje në derë.

Kaq shpejt! Nuk bëri asnjë lëvizje, me shpresën e kotë se kushdo që të ishte do të largohej pas përpjekjes së parë. Por jo, trokitja u përsërit. Më e keqja e të gjithave do të ishte vonesa. Zemra i rrihte si daulle, por ndoshta fytyra nuk e tradhtonte për hir të zakonit. U ngrit dhe lëvizi me përtim drejt derës.

II

Kur preku dorezën pa që ditarin e kishte lënë hapur sipër tavolinës. Në të ishte shkruar gjithandej POSHTË VËLLAI I MADH, me shkronja aq të mëdha sa mund të lexohej qysh prej derës. Ky ishte gabimi më mendjelehtë dhe i papërfytyrueshëm që mund të bëhej. Por edhe mes panikut u kujtua që nuk e kishte mbyllur ngaqë s'kishte dashur ta njolloste letrën e butë me bojën ende të freskët.

U mbush me frymë dhe hapi derën. Menjëherë e përfshiu një ndjenjë e ngrohtë çlirimi. Përjashta qëndronte një grua me pamje të rrënuar, e dalëboje, me flokë të drejta dhe fytyrë gjithë rrudha.

- Oh, shok, - nisi ajo të kuiste mërzitshëm. – të ndieva kur u ktheve në shtëpi. Mund të më shikosh pak lavamanin e kuzhinës? Është bllokuar dhe...

Ishte zonja Parsons, gruaja e fqinjit në të njëjtin kat. ("Zonjë" ishte një fjalë jo fort e pëlqyer nga Partia – të gjithë duhet t'i thirrje "shok" ose "shoqe" – mirëpo me disa gra kjo fjalë të dilte në mënyrë instiktive.) Zonja Parsons ishte rreth të tridhjetave, por tregonte më e madhe. Rrudhat e fytyrës i kishte si të mbushura me pluhur. Uinstoni e ndoqi përgjatë korridorit. Këso riparime amatoreske qenë pothuajse acarim i përditshëm nervash. Blloku kishte pallate të vjetra të ndërtuara rreth viteve tridhjetë të cilat tashmë ishin gati të rrënuara. Suvaja binte nga muret dhe tavanet në mënyrë vazhdueshme, tubat çaheshin gjatë çdo ngrice, çatia pikonte sa herë që binte dëborë, sistemi i ngrohjes, në qoftë se nuk ishte i mbyllur për arsye ekonomike, zakonisht punonte me

gjysmën e kapacitetit. Ndërsa riparimet, me përjashtim të atyre që mund të bëje vetë, duhej të miratoheshin nga disa komitete të largëta të cilët e kishin natyrë ta vononin dy vjet edhe meremetimin e një parvazi.

- Meqënse Tomi nuk ndodhet në shtëpi, - tha gruaja e zënë ngushtë.

Apartamenti i Parsonsve ishte më i madh se i Uinstonit, por i pistë në një tjetër kuptim. Çdo gjë dukej e thyer dhe e shkelur, sikur sapo kishte dalë prej andej një kafshë gjigante e dhunshme. Lodra agresive – shkopinj hokeji, doreza boksi, një top i çarë futbolli, një palë të mbathura të kthyera së prapthi – hedhur aty këtu mbi dysheme, ndërsa mbi tavolinë kishte një stivë pjatash të palara dhe një libër ushtrimesh cepangrënë. Në mur vareshin banderolat e Organizatës së Rinisë dhe Spiunëve, si dhe një afishe e plotë e Vëllait të Madh. Ndihej era e lakrave të ziera, e zakonshme për gjithë pallatin, por në atë shtëpi ajo shoqërohej nga një kutërbim djerse që të shponte hundët, i cili kuptohej qysh me nuhatjen e parë se ishte kutërbimi i djersës së një personi që nuk ndodhej aty atë çast, megjithëse ai nuk qe në gjendje të thoshte si ia arrinte kesaj. Në dhomën tjetër dikush përpiqej që, me një krehër dhe një copë letër higjenike, të mbante ritmin me marshin ushtarak që vërshonte ende nga tele-ekrani.

- Janë fëmijët, - tha zonja Parsons e cila hodhi sytë nga dera disi e shqetësuar. – Sot nuk kanë dalë fare. Dhe natyrisht...

Ajo e kishte zakon t'i linte fjalitë në mes. Lavamani i kuzhinës ishte përplot me ujë të qelbur, disi jeshil, i cili kutërbonte ku e ku më tmerrshëm se lakrat. Uinstoni u ul në gjunjë dhe këqyri bërrylin e tubit. E kishte zët të përdorte duart dhe të ulej në gjunjë, sepse këto veprime i ngacmonin kollën. Zonja Parsons e vështroi e pafuqishme.

- Padyshim, po qe se Tomi do ishte në shtëpi do ta kishte rregulluar në çast, - tha. – Ai vdes për kësi gjërash. Ia zënë duart.

Tomi dhe Uinstoni ishin kolegë në Ministrinë e së Vërtetës. Tomi ishte një burrë disi i shëndoshë, një tip i gjallë që zotëronte një idiotësi paralizuese, një masë entuziazmi mendjelehtë – një nga ata naivët, të përkushtuarit e palodhur prej të cilëve varej,

madje më tepër sesa Policia e Mendimit, stabiliteti i Partisë. Në moshën tridhjetë e pesë vjeçare, ai sapo ishte larguar pa dëshirë nga Organizata e Rinisë dhe para se të pranohej në këtë organizatë, kishte arritur të militonte tek Spiunët edhe një vit më tepër nga ç'lejonte statuti. Në Ministri kishte një detyrë të dorës së dytë për të cilën nuk kërkohej inteligjencë, ndërkohë ishte figurë udhëheqëse e Komitetit Sportiv dhe në gjithë komitetet e tjera të angazhuara me organizimin e marshimeve popullore, manifestimeve spontane, fushatave të kursimit dhe gjithë aktiviteteve vullnetare në përgjithësi. Midis pufeve të llullës, me një krenari modeste, ai tregonte sesi gjatë katër viteve të fundit nuk kishte munguar në asnjë darkë në Vatrën e Kulturës së lagjes. Dhe ngado që shkonte, e ndiqte një kutërbim mbytës, njëfarë dëshmie e pavetëdijshme e jetës rraskapitëse e cila mbetej në ajër edhe pas largimit të tij.

- Keni ndonjë çelës? – tha Uinstoni, ndërsa përpiqej të lironte unazën në bërrylin e tubit.

- Çelës, - tha zonja Parsons e pasigurt. – Nuk e di, ndofta fëmijët...

Fëmijët ia behën në dhomën e pritjes, u dëgjua një kërcitje tjetër këpucësh dhe një tjetër shkulm ere nga krehëri. Zonja Parsons solli çelësin. Uinstoni zbrazi ujin dhe, duke shtrembëruar fytyrën nga pështirosja, nxori tufën e flokëve që kishte bllokuar tubin. Lau duart, aq sa mund të laheshin, me ujë të ftohtë nga çesma dhe u kthye në dhomën tjetër.

- Duart lart! – klithi një zë me egërsi.

Një bukurosh nëntë vjeçar që bënte të fortin kërceu nga mbrapa tavolinës dhe e kanosi me një pistoletë lodër, ndërsa e motra, rreth dy vjet më e vogël, bëri të njëjtin veprim me një copë dru. Të dy kishin veshur pantallona të shkurtra ngjyrë blu, këmisha gri dhe shalle pionieri të kuq, uniformat e Spiunëve. Uinstoni vendosi duart mbrapa kokës, por disi i shqetësuar ngaqë sjellja e djalit ishte e frikshme dhe loja nuk i dukej edhe aq si lojë.

- Ti je tradhtar! - bërtiti fëmija. – Kriminel mendimi! Spiun euroaziatik! Do të të vras, do të të avulloj, do të të dërgoj në minierat e kripës!

Befas fëmijët filluan t'i kërcenin rrotull duke këlthitur "Tradhëtar!" dhe "Kriminel mendimi", vogëlushja imitonte vëllain në çdo gjest. Qe e frikshme, si lodrimi i këlyshëve të tigrit që shumë shpejt do të kthehen në mishngrënës. Në sytë e djaloshit kishte një egërsi të llogaritur, një dëshirë të dukshme për ta grushtuar apo shkelmuar Uinstonin dhe një lloj ndërgjegjësimi se e kishte moshën për ta bërë diçka të tillë. Është fat që pistoleta nuk është e vërtetë, mendoi Uinstoni.

Sytë e zonjës Parsons kaluan të shqetësuar nga Uinstoni tek fëmijët dhe anasjelltas. Drita e dhomës ishte më e mirë dhe Uinstoni vuri re se në rrudhat e fytyrës së saj kishte rërë të vërtetë.

- Janë trazovaçë, - tha ajo. – U ka ngelur qejfi që nuk shkojnë të shikojnë varjen, prandaj bëjnë kështu. Unë s'i çoj dot sepse kam punë, ndërsa Tomi do vonohet.

- Pse të mos shkojmë të shohim varjen, - hungëroi djali me zërin e tij të trashë.

- Dua të shoh varjen! Dua të shoh varjen! – bërtiti vajza, ende duke kërcyer.

Uinstonit iu kujtua se atë mbrëmje do të vareshin disa robër euroaziatikë në Park, të akuzuar për krime lufte. Kjo ndodhte afërsisht një herë në muaj dhe qe kthyer në spektakël popullor. Fëmijët të luanin nga fiqiri po të mos i çoje. Ai u nda nga zonja Parsons dhe bëri për nga dera kryesore. Por, nuk kishte hedhur as gjashtë hapa në korridor, kur e goditi diçka mbrapa qafe, ishte një goditje therëse, sikur ta kishte djegur kush me hekur të skuqur. U kthye dhe pa zonjën Parsons tek dera duke hequr zvarrë të birin ndërkohë që ai futi në xhep hobenë.

- Goldshtein! – ulëriti djali ndërsa u mbyll dera. Megjithatë ajo që e shastisi Uinstonin ishte shprehja e pafuqishmërisë në fytyrën gri të gruas.

Kur hyri në shtëpi kaloi me shpejtësi para tele-ekranit dhe u ul rishtazi në tavolinë, ende duke fërkuar qafën. Muzika në tele-ekran kishte pushuar. Në vend të saj, një zë i shpejtë ushtarak, me një dëshirë brutale, po bënte një përshkrim të forcave të Kështjellës Pluskuese të Re të cilat porsa kishin ankoruar midis Islandës dhe Ishujve Faroe.

Me këta fëmijë, mendoi Uinstoni, besoj se gruaja e gjorë jeton e terrorizuar. Pas një apo dy vitesh ata do të fillonin të përgjonin edhe të ëmën se mos shfaqte shenja tradhtie. Në këto kohëra ishin bërë të tmerrshëm pothuajse gjithë fëmijët. Më e keqja e të gjithave ishte se në organizata si ajo e Spiunëve, fëmijët shdërroheshin sistematikisht në egërsira të pa fre, por pa kurrfarë prirjeje për t'u rebeluar kundër Partisë. Përkundrazi, Partinë dhe gjithçka lidhur me të e adhuronin. Këngët, parakalimet, parrullat, marshimet, qitjet me plumba mësimorë, sllloganet, adhurimi i Vëllait të Madh – për ata ishin një lloj loje madhështore. Gjithë egërsia e tyre ishte e drejtuar kundër armiqve të jashtëm, kundër të huajve, tradhtarëve, sabotatorëve dhe kriminelëve të mendimit. Për qytetarët mbi tridhjetë vjeç qe e natyrshme të trembeshin nga fëmijët e vet. Nuk kishte javë që gazeta *Times* të mos nxirrte, me shumë të drejtë, një paragraf që rrëfente për nuhuritësit e vegjël – "hero i vogël" ishte fraza standart e përdorur – që kishin pikasur ndonjë devijim dhe që kishin denoncuar prindërit e tyre te Policia e Mendimit.

Dhimbja e goditjes me hobe ishte zbutur. Penën e mori pa qejf ngaqë mendonte se nuk do të kishte gjë tjetër për të shkruar në ditar. Befas nisi të mendonte sërish për O'Brajënin.

Vite të shkuara – sa vite? patjetër shtatë – pa në ëndërr sikur ecte në një dhomë të errrët. Dikush që ishte ulur në njërën anë të dhomës, ndërsa Uinstoni kishte kaluar pranë, i kishte thënë: "Do të takohemi në një vend pa errësirë." Fjalë të thëna shumë qetë, pothuajse natyrshëm – deklarim, jo komandë. Uinstoni nuk ishte ndalur. Ajo që binte në sy ishte fakti që asokohe, në ëndërr, ato fjalë nuk i kishin lënë ndonjë mbresë. Vetëm më vonë dhe dalëngdalë, fjalët nisën të merrnin domethënie. Nuk i kujtohej nëse takimi i parë me O'Brajënin kishte ndodhur para apo pas ëndrrës, as koha kur kishte filluar ta dallonte zërin e tij nuk i kujtohej, megjithatë, aftësia për ta dalluar ekzistonte: njeriu që i kishte folur në errësirë kishte qenë O'Brajëni.

Uinstoni nuk kishte qenë kurrë i sigurt, edhe pas vështrimeve të shkëmbyera atë mëngjes e kishte të vështirë të

thoshte, çfarë e kishte O'Brajënin, aleat apo armik. Por edhe me kaq rëndësi nuk e shihte. Mirëkuptimi mes tyre ishte më i rëndësishëm se dashuria apo partizanllëku. "Do të takohemi në një vend pa errësirë," i kishte thënë ai. Uinstoni nuk e kishte kuptuar ç'donte të thoshte kjo, por e dinte që në një mënyrë apo në një tjetër ëndrra do të realizohej.

Zëri në tele-ekran pushoi. Në ajrin e qetë vërshoi një jehonë trompe, e pastër dhe e bukur. Zëri vazhdoi i çjerrë:

- Vini re! Ju lutem, vini re! Sapo kanë mbërritur lajme nga fronti i Malabarit. Forcat tona në Indinë e Jugut kanë arritur një fitore historike. Jam autorizuar të them se akti që jemi duke raportuar tregon që lufta do të mbarojë brenda një kohe shumë të shkurtër. Vijojmë me lajmet...

Lajme të këqija vijnë, mendoi Uinstoni. Dhe sikur ta dinte, pas përshkrimeve të përgjakshme të asgjësimit të ushtrisë euroaziatike, me shifra gargantuane të vrarësh dhe robërish, u dha lajmi që, jo më më larg se një javë më vonë, racioni i çokollatës do të ulej nga tridhjetë në njëzetë gramë.

Uinstoni gromësiu përsëri. Xhini po dilte duke i lënë një ndjesi fryrjeje. Tele-ekrani – ndoshta për të festuar fitoren, ndoshta për të larguar kujtimin e çokollatës së humbur – shpërtheu: "Oqeani, kjo është për ty". Në kësi çastesh duhet të përqëndroheshe. Megjithatë, në pozicionin e tanishëm ai nuk binte në sy.

"Oqeani, kjo është për ty" i hapi udhën një muzike më të lehtë. Me shpinë nga tele-ekrani, Uinstoni shkoi tek dritarja. Dita ishte ende e ftohtë dhe e kthjellët. Diku larg, me një hungërimë kumbuese dhe topitëse, shpërtheu një raketë. Asokohe, në Londër binin njëzetë apo tridhjetë të tilla në javë.

Poshtë në rrugë, era valëviste një afishe në të cilën fjala Anglosoc shfaqej e tëra pastaj zhdukej. Anglosoc. Parimet e shenjta të Anglosocit. Gjuha e Re, mendimi i dyfishtë, ndryshimet e të shkuarës. Unstoni u ndie sikur sorollatej në pyllin e funddetit, i humbur në një botë monstruoze ku monstra ishte vetë ai. Qe vetëm. E shkuara kishte vdekur, e ardhmja nuk mund të imagjinohej. Çfarë sigurie kishte që ai gëzonte përkrahjen qoftë

edhe të një krijese të vetme njerëzore? Dhe cila ishte rruga për të mësuar që dominimi i Partisë nuk do të zgjaste *përjetësisht*? Tre sloganet në fasadën e bardhë të Ministrisë të së Vërtetës u rikthyen si përgjigje:

LUFTA ËSHTË PAQE
LIRIA ËSHTË SKLLAVËRI
INJORANCA ËSHTË FORCË

Nxorri nga xhepi njëzetë e pesë cent. Të njëjtat sllogane qenë shkruar me shkronja të vogla e të qarta edhe në monedhë, ndërsa në anën tjetër të saj ishte koka e Vëllait të Madh. Në monedha, pulla poste, kopertina librash, flamuj, afishe dhe paketa cigaresh – kudo. Me sytë që të shikonin e zërin që të ndiqte ngado që shkoje. Zgjuar apo në gjumë, duke ngrënë apo duke punuar, në shtëpi apo jashtë saj, në dush apo në krevat – qe e pamundur t'i shmangeshe. Asgjë nuk ishte jotja veç atyre pak centimetrave kub brenda kafkës tënde.

Dielli kishte kaluar në anën tjetër dhe dritaret e panumërta të Ministrisë së të Vërtetës dukeshin të zymta si frëngji kështjelle ngaqë rrezet nuk shkëlqenin më në to. Përballë trajtës gjigante piramidale iu drodh zemra nga frika. Nuk mund të shpërthehej, ishte shumë e fortë. As një mijë raketa nuk do mjaftonin për ta shembur. Sërish pyeti veten se për kë e shkruante ditarin. Për të ardhmen, për të shkuarën – për një epokë imagjinare. Në vend të vdekjes, përballë i dilte asgjësimi. Ditari do të bëhej hi, ndërsa ai do të avullonte. Vetëm Policia e Mendimit do ta lexonte atë çfarë kishte shkruar, para se ta zhduknin nga faqja e dheut dhe nga kujtesa. Si mund t'i flisje të ardhmes kur nuk do të kishte qoftë edhe një gjurmë tënden, madje kur nuk do të mbijetonte fizikisht as një fjalë anonime e shkruar në letër?

Ora në tele-ekran ra dy e drekës. Për dhjetë minuta duhej të dilte. Pas gjysmë ore duhej të ndodhej në vendin e punës.

Çuditërisht, tingulli i orës dukej sikur i dha kurajo. Ai qe një fantazmë e cila shqiptonte një të vërtetë që kurrë nuk do ta dëgjonte kush. Por, përderisa e shqiptonte, vazhdimësia nuk ishte prishur.

Trashëgimia njerëzore përcillej duke ruajtur arsyen dhe jo duke ngritur zërin. U kthye tek tavolina, ngjeu penën dhe shkroi:

Për të ardhmen ose për të shkuarën, për një kohë ku mendimi është i lirë, ku njërëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe nuk jetojnë të vetëm – për një kohë ku e vërteta ekziston dhe ajo që bëhet nuk zhbëhet:

Përshëndetje – nga epoka e uniformitetit, nga epoka e vetmisë, nga epoka e Vëllait të Madh, nga epoka e mendimit të dyfishtë.

Tashmë jam pothuajse i vdekur, mendoi. Por vetëm tani, kur kishte filluar të ishte në gjendje të formulonte mendimet e veta, i dukej se kishte hedhur hapin vendimtar. Pasojat e çdo veprimi janë të përfshira tek vetë veprimi. Shkroi:

Krimi i mendimit nuk e përcjell vdekjen: krimi i mendimit është vdekje.

Tani që e pranoi veten si të vdekur u bind se duhet të jetonte sa më gjatë të qe e mundur. Dy gishta të dorës së djathtë ishin njollosur. Një nga ato lloj detajesh që mund të të tradhtonin. Ndonjë nuhuritës në Ministri (më e mundshme, ndonjë grua, dikush si puna e gruas me flokët e kuqërremtë apo vajza flokëzezë e Drejtorisë së Trillimeve) mund të habitej pse ai kishte shkruar gjatë pushimit të drekës, pse kishte përdorur penë të stilit të vjetër, *çfarë* kishte shkruar – e pastaj mund ta përcillte sinjalin në zyrën e duhur. Shkoi në banjë dhe, me sapunin ngjyrë kafe të errët e gjithë guriçka, i cili ngjasonte më tepër me letërzmeril përshtatur për këtë qëllim, lau bojën me kujdes.

Vendosi bllokun në sirtar. Ta fshihte ishte e kotë, por të paktën mund të linte një shenjë që ta kuptonte në qoftë se ishte zbuluar ose jo ekzistenca e tij. Po të vendoste një qime brenda faqeve binte në sy. Me mollëzën e gishtit mori një thërrmijë pluhuri të bardhë dhe e la në cep të kapakut, e cila, në qoftë se libri lëvizte, do të binte.

III

Uinstonit iu fanit nëna.

Kur ajo ishte zhdukur, mendoi, ai duhet të kishte qenë dhjetë ose njëmbëdhjetë vjeç. Ajo kishte qenë një grua shtatlartë, si statujë, e heshtur, me lëvizje të matura dhe flokë të verdhë të mrekullueshëm. Babain e kujtonte shumë më pak, zeshkan dhe të dobët, përherë të veshur këndshëm me të zeza (kujtonte veçanërisht lidhëset shumë të holla të këpucëve) dhe me syze. Patjetër, që të dy mund ishin hequr qafe nga ndonjëri prej spastrimeve të viteve pesëdhjetë.

Atë çast nëna qe ulur diku më poshtë, në thellësi, me motrën e vogël ndër krahë. Motra nuk i kujtohej fare, vetëm si një bebe delikate, e imët, vazhdimisht e heshtur, me sy të mëdhenj e kureshtarë. Të dyja vështronin nga ai. Ato ndodheshin në një vend të fshehtë – ndoshta në fundin e një pusi, ose në një varr shumë të thellë – sidoqoftë ishte një vend që, edhe pse goxha i thellë, vazhdonte të largohej edhe më në thellësi. Ndodheshin në sallonin e një anijeje që mbytej, duke vështruar Uinstonin përmes ujit që nxihej e nxihej. Në sallon kishte ende ajër, mund ta shihnin njëri tjetrin akoma, por ato fundoseshin gjatë gjithë kohës, poshtë në ujin jeshil që pas pak do t'ia hiqte nga vështrimi përgjithmonë. Ai qëndronte lart, tek drita, ndërsa ato fundoseshin drejt vdekjes, e ndodheshin aty poshtë *ngaqë* ai qëndronte lart. Ato e dinin dhe ai edhe e lexonte këtë nga fytyrat e tyre. Ato nuk mbartnin kurrfarë qortimi, as në fytyra as në zemra, vetëm faktin që e dinin se u duhej të vdisnin që ai të mbetej gjallë, dhe që kjo ishte pjesë e rregullit të pandryshueshëm të gjërave.

Nuk i kujtohej se çfarë kishte ndodhur, por ëndrra i kumtonte se në njëfarë mënyre jetët e nënës dhe motrës qenë sakrifikuar për të. Ishte një nga ato ëndrra të cilat, ndërsa ruajnë sfondin karakteristik të ëndrrave, janë vazhdimësi e jetës intelektuale të njeriut, gjatë së cilës ai zbulon fakte dhe ide që pas zgjimit i duken të reja dhe të çmuara. Ajo çfarë e preku befas atë çast ishte fakti që vdekja e nënës, gati tridhjetë vjet të shkuara, kishte qenë tragjike dhe e dhimbshme në një mënyrë që s'ndodhte më. E kuptoi që tragjedia i përkiste të shkuarës, kohës kur ekzistonte ende jeta private dhe miqësia dhe kur pjestarët e familjes i dilnin krah njëri-tjetrit pa qenë nevoja ta dinin arsyen. Vdekja e nënës ia copëtoi zemrën sepse dashuria e saj për të s'kishte shterur kurrë, ndërkohë që ai kishte qenë shumë i ri e narcizist për t'ia kthyer dashurinë, dhe ngaqë, si e qysh nuk i kujtohej, ajo ishte vetësakrifikuar në emër të një besnikërie të pandryshueshme. Kësi gjërash nuk ndodhnin më. E sotmja kishte frikë, urrejtje dhe dhimbje, por jo dinjitet të ndjenjës apo pikëllim të thellë e të ndërlikuar. Dukej se gjithë këtë e lexonte në sytë e mëdhenj të nënës dhe motrës të cilat e vështronin që poshtë, përmes ujit jeshil, ku ende fundoseshin.

Befas e pa veten të ulur mbi bar të shkurtër pranvere, në një natë behari ndërsa rrezet e pjerrta të diellit prarorin tokën. Pejsazhi që pa në ëndërr iu rishfaq aq shumë herë saqë nuk ishte më i sigurt të thoshte në e kishte parë në jetën reale apo jo. Në mendimet e tij pas zgjimit e quante Toka e Artë. Një kullotë e lashtë e shkelur nga lepujt, aty-këtu e përshkuar nga një udhë me fole urithësh. Degët e vidhave në gardhin përballë fushës fshikeshin lehtë prej flladit, gjethet, në masa të dendura, trazoheshin si flokë gruaje. Fare afër, megjithëse nuk dukej, rridhte shtruar një burim i kulluar, ndërsa në pellgjet poshtë shelgjeve notonin cironkat.

Vajza flokëzezë po vinte përmes fushës drejt tyre. Shqeu rrobat me një lëvizje të vetme dhe i flaku me përbuzje. Kishte trup të bardhë dhe të lëmuar, por atij nuk i ngjalli asnjë dëshirë dhe vërtet nuk ia hodhi sytë. Megjithatë gjesti me të cilin ajo kishte flakur teshat e mbushi me një ndjenjë admirimi për të. Hijeshia

dhe shpërkujdesja e atij veprimi kumtonte asgjësimin e plotë të një kulture, të një sistemi të tërë mendimi, sikur Vëllai i Madh, Partia dhe Policia e Mendimit të flakeshin në botën e hiçit vetëm me një lëvizje krahu. Edhe ai veprim i përkiste të shkuarës. Uinstoni u zgjua me fjalën "Shekspir" në buzë.

Tele-ekrani lëshonte një fishkëllimë që të çante timpanin e veshit dhe vazhdoi e tillë për tridhjetë sekonda. Ora shtatë e çerek, çasti i zgjimit për gjithë zyrtarët. Uinstoni u ngrit prej shtratit me përtesë – dhe lakuriq, një anëtar i thjeshtë i Partisë merrte vetëm 3000 triska për veshje në vit ndërsa pizhamat kushtonin 600 – rrëmbeu një bluzë të pistë dhe të mbathurat në karrige. Për tre minuta niste Kalitja Fizike. Befas e zuri një krizë kolle që gati i nxori rropullitë nga goja e cila e kapte menjëherë pas zgjimit, pothuajse çdo ditë. Kolla ia boshatiste mushkëritë deri në atë masë saqë për të rinisur frymëmarrjen i duhej të shtrihej në shpinë dhe të mbushej me frymë. Pas kollës, venat u frynë dhe malcimi kishte filluar të dhimbte.

- Grupi i tridhjetë-dyzet vjeçarëve! - u dëgjua një e lehur shpuese femërore. - Grupi i tridhjetë-dyzet vjeçarëve! Zini vendet, ju lutem. Tridhjetë-dyzet vjeçarët!

Uinstoni u përqëndrua tek tele-ekrani në të cilin tashmë kishte dalë një grua deri diku e re, thatanike po muskuloze, veshur me kanotierë dhe atlete.

- Hapja dhe mbyllja e krahëve! – foli prerë ajo. – Më ndiqni. *Një*, dy, tre, katër! *Një*, dy, tre, katër! Jepni, shokë, bëhuni pak më të gjallë! *Një*, dy, tre, katër! *Një*, dy, tre, katër!...

Dhimbja e shkaktuar nga kolla nuk kishte arritur t'ia hiqte nga mendja përshtypjet e ëndrrës, kurse lëvizjet ritmike të ushtrimeve sikur ia rikthyen disi. Ndërsa lëvizte krahët tutje-tëhu, duke u shtirur si i kënaqur për të rënë në sy të mirë gjatë Kalitjes Fizike, u përpoq që të arratisej në periudhën e mjegullt të fëmijërisë. Diçka jashtëzakonisht e vështirë. Përtej gjysmës së dytë të viteve pesëdhjetë nuk i kujtohej asgjë. Kur mungonin pikat e jashtme të referimit, edhe ravijëzimi i jetës tënde e humbiste mprehtësinë. Të kujtoheshin ngjarje të mëdha që edhe mund të mos kishin ndodhur, të kujtoheshin detaje

incidentesh pa qenë në gjendje të rrokje atmosferën e tyre, por kishte periudha tejet të gjata prej të cilave nuk mund të veçoje kurrgjë. Asokohe gjithçka kishte qenë tjetërsoj. Madje, kishin ndryshuar edhe emrat e shteteve dhe forma e tyre në hartë. Për shembull, Shiriti i Parë Ajror asokohe nuk quhej kështu: quhej Angli ose Britani, megjithëse, deri diku ndiehej i sigurt, Londra ishte quajtur gjithmonë Londër.

Uinstoni nuk ishte i sigurt nëse kishte patur apo jo ndonjë periudhë kohe kur vendi nuk kishte qenë në luftë, por në fëmijëri dukej qartë që kishte patur një ndërkohë modeste paqësore, sepse në një nga kujtimet e tij të hershme kishte patur një fushatë bombardimesh e cila i kishte zënë të gjithë në befasi. Ndoshta kur u hodh bomba atomike në Kolçester. Vetë bombardimet nuk i mbante mend, por i kujtohej dora e babait që shtrëngonte të tijën ndërsa vraponin tatëposhtë, poshtë, poshtë, diku ndën tokë, rreth e rrotull një shkalle spirale e cila kumbonte nga hapat dhe e lodhi aq shumë saqë ai nisi të rënkonte dhe kështu u ndalën të merrnin frymë. Me natyrën e saj ëndërrimtare dhe të ngadaltë, nëna i ndiqte në largësi. Në krahë mbante motrën e vogël – ose ndoshta një tufë batanijesh, nuk ishte i sigurt në motra kishte lindur ose ajo atëherë. Më në fund kishin ndalur në një vend të zhurmshëm përplot njerëz që ai e kishte njohur, një nga stacionet e metrosë.

Një pjesë e njerëzve ishin ulur në dyshemenë me pllaka guri, ndërsa disa të tjerë, ngjitur pas shoqi-shoqit, ishin ulur në krevate metalikë me kate. Uinstoni, nëna dhe babai gjetën një vend në dysheme ndërsa pranë tyre, ulur krahas njëri-tjetrit në krevat, ishte një çift pleqsh. Plaku kishte veshur një kostum të errët të mbajtur dhe një kapele pëlhure të shtyrë mbrapa, me flokët shumë të bardhë; fytyrën e kishte të kuqërremtë, sytë blu dhe në lotë. Kutërbonte xhin. Dukej sikur merrte frymë nga poret e lëkurës, dhe mund të thuhej fare mirë që lotët e tij ishin pika xhini. Por, megjithëse plaku qe pak i dehur, pikëllimi i tij ishte i sinqertë dhe i padurueshëm. Me intuitën e fëmijës, Uinstoni e pikasi që kishte ndodhur diçka e tmerrshme, diçka që nuk mund të falej apo shërohej kurrë. Gjithashtu e dinte përse bëhej fjalë. Ndonjë

nga të dashurit e plakut – ndoshta mbesa e tij – ishte vrarë. Çdo dy minuta përsëriste:

- Nuk duhet t'u kishim besuar. A nuk thashë, Ma? Kështu e pëson kur u beson atyre. S'më dëgjoi kush. Nuk duhet t'u kishim zënë besë maskarenjve.

Por, se kush kishin qenë maskarenjtë të cilëve ata nuk duhej t'u kishin zënë besë, Uinstonit nuk i kujtohej.

Qysh atëherë lufta kishte vazhduar, megjithëse, për hir të së vërtetës, duhet thënë që nuk kishte qenë e njëjta luftë gjithmonë. Gjatë fëmijërisë së tij edhe në rrugët e Londrës kishte patur luftime të turbullta, kujtimet e disa prej të cilave i kishte ende të gjalla. Por të gjurmoje historinë e gjithë asaj kohe, të gjeje cilat kishin qenë palët që luftonin, ishte krejt e pamundur, sepse nuk kishte gjë të shkruar dhe, veç çastit që ajo ndodhte, për luftën nuk thuhej më asnjë fjalë. Atë periudhë, për shembull, në 1984 (nëse ishte 1984), Oqeania ishte në luftë me Euroazinë dhe në aleancë me Azinë Lindore. Kurrë, në asnjë deklaratë publike apo private, nuk ishte pranuar që tri superfuqitë të kishin qenë ndonjëherë të rreshtuara kundër njëra-tjetrës. Në fakt, dhe Uinstoni e dinte, vetëm katër vite të shkuara Oqeania kishte qenë në luftë me Azinë Lindore e në aleancë me Euroazinë. Por ky ishte një informacion i fshehtë që ai e zotëronte rastësisht, vetëm ngaqë kishte kujtesë jo edhe aq të kontrolluar. Zyrtarisht ndryshimi i partnerëve nuk kishte ndodhur kurrë. Oqeania ishte në luftë me Euroazinë, për rrjedhojë Oqeania kishte qenë përherë në luftë me Euroazinë. Armiku i momentit gjithmonë përfaqësonte të keqen absolute, e kështu, çdo marrëveshje me të, e së shkauarës apo së ardhmes, ishte e pakonceptueshme.

Frika më e madhe, Uinstoni e shoshiti në mendje nja një mijë herë, ndërsa shtynte supet me dhimbje (me duart në mes, ishte radha e rrotullimit të trupit, një ushtrim që mendohej i mirë për muskujt e shpinës) – frika më e madhe ishte fakti që gjithçka mund të ishte e vërtetë. Në qoftë se Partia zgjaste dorën drejt së shkuarës dhe thoshte se ajo apo kjo ngjarje nuk *ka ndodhur kurrë* – natyrisht, kjo ishte më tmerrshme se torturat apo vdekja.

Partia thoshte që Oqeania s'kishte qenë kurrë në aleancë me Euroazinë. Por ai, Uinston Smithi, e dinte që jo më shumë

se katër vjet të shkuara ato kishin qenë aleate. Ku ekzistonte kjo dije? Vetëm në vetëdijen e tij dhe shumë shpejt duhet të asgjësohej me patjetër. Në qoftë se edhe të tjerët e pranonin rrenën e imponuar nga Partia – dhe në qoftë se burimet ofronin të njëjtën përrallë – atëherë rrena hynte në histori dhe bëhej e vërtetë. "Kush kontrollon të shkuarën," thoshte parrulla e Partisë, "kontrollon të shkuarën: kush kontrollon të tashmen kontrollon të shkuarën." Megjithatë, e shkuara nuk ishte ndryshuar kurrë edhe pse ishte e ndryshueshme. Çfarëdo e vërtetë e së tashmes ishte e tillë nga e përjetshmja tek e përjetshmja. Kjo ishte. Nevojitej veç një seri fitoresh mbi kujtesën personale. E quanin "kontroll të realitetit", ndërsa në Gjuhën e Re: "Mendimi i dyfishtë".

- Mjaft! – urdhëroi instruktorja, ca më përzemërsisht.

Uinstoni uli krahët dhe u mbush ngadalë me frymë. U zhyt në botën me labirinte të mendimit të dyfishtë. Të dije e të mos dije, ta njihje tërësisht të vërtetën ndërkohë që të thoje gënjeshtra të paramenduara, të kishe dy opinione që përjashtonin njëri-tjetrin, ta dije që ishin të kundërt dhe t'i besoje të dy; të përdorje logjikën kundër logjikës, të mohoje moralin ndërsa e kërkoje atë, të besoje që demokracia ishte e pamundur dhe që Partia ishte mbrojtëse e demokracisë; të harroje gjithçka që ishte e nevojshme të harrohej, ta riktheje në kujtesë në çastin e kërkuar, mandej ta harroje sërish, dhe mbi të gjitha, të njëjtin proces ta zbatoje gjatë vetë procesit. Ky ishte sekreti: të ngacmoje pavetëdijen me vetëdije, pastaj, sërish, të bëheshe i pavetëdijshëm për aktin hipnotik të sapo ushtruar. Madje, edhe për të kuptuar fjalën "mendim i dyfishtë", kërkohej të përdorje "mendim të dyfishtë".

Instruktorja u tërhoqi vëmendjen sërish.

- Dhe tani të shikojmë kush nga ne do të prekë gishtat e këmbëve! – tha ajo me entuziazëm. – Puquni me kofshët, shokë, ju lutem. Një-dy! Një-dy!...

Uinstoni e kishte inat këtë ushtrim sepse i jepte një dhimbje përcëlluese që nga thembrat deri në bel dhe shpesh i rikthente krizën e kollës. Kënaqësia e vogël e meditimit iu shua. E shkuara, mendoi, nuk ishte ndryshuar, por shkatërruar. Si mund

të vërtetoje edhe gjërat më të dukshme kur nuk kishte dëshmi tjetër veç kujtimeve të tua? U përpoq të kujtonte se në cilin vit kishte dëgjuar për herë të parë të flitej për Vëllain e Madh. Mund të kishte ndodhur diku aty nga vitet gjashtëdhjetë, mendoi, por ishte e pamundur të ishe i sigurt. Natyrisht, në librat e historisë Vëllai i Madh paraqitej si udhëheqës dhe mbrojtës i Revolucionit qysh prej fillimit. Pak nga pak, bëmat e tij ishin shtyrë mbrapa në kohë deri sa kishin mbërritur në botën mitike të viteve tridhjetë e dyzetë, kur kapitalistët vozitnin nëpër rrugët e Londrës me makinat e tyre vezulluese ose karrocat me anësore të xhamta dhe me kapelet e çuditshme cilindrike. Nuk dihej deri në ç'masë legjenda ishte e vërtetë dhe sa e shpikur. Uinstoni nuk kujtonte dot as datën e krijimit të Partisë. Nuk i besohej që ta kishte dëgjuar fjalën Anglosoc para 1960-ës, por ekzistonte mundësia që, në të folmen e vjetër, "Socializmi anglez" të kishte qenë në përdorim më herët. Gjithçka përpihej nga mjegulla. Mund të dalloje edhe ndonjë gënjeshtër, por më të rrallë ama. Për shembull, nuk ishte e vërtetë, siç pretendohej në librat e historisë se gjoja aeroplanin e kishte shpikur Partia. Aeroplanët ai i mbante mend qysh prej fëmijërisë më të hershme. Por nuk e vërtetoje dot. Mungonin faktet. Vetëm një herë në jetë i ndodhi të shtinte në dorë një dokument të pakundërshtueshëm për falsifikimin e fakteve historike dhe në atë rast...

- Smith! – ulëriti zëri shpues në tele-ekran. – 6079 Simth U.! Po, *ju*! Përkuluni më tepër, ju lutem! Keni mundësi për më shumë! Vetëm se nuk përpiqeni. Më poshtë, ju lutem! *Tashmë* po, shoku Smith! Tani, gjithë skuadra, qetësohu dhe shikoni mua.

Trupin e Uinstonit e mbuloi një djersë e ngrohtë dhe e beftë. Fytyrën e mbajti të padepërtueshme. Mos trego kurrë ankth! Kurrë zemërim. Edhe një përpëlitje e qepallave mund të të tradhtonte. Vështroi instruktoren ndërsa ngriti krahët dhe – nuk mund të thuhet "me hijeshi", por "me një elegancë dhe saktësi të admirueshme" – preku pjesën e poshtme të gishtave të këmbës.

- *Ja*, pra, shokë! *Kështu* dua që ta bëni edhe ju. Më ndiqni sërish. Unë jam tridhjetë e nëntë vjeçe dhe kam lindur katër fëmijë. Shikoni me kujdes. – U përkul sërish. – E shikoni, nuk i përkula

gjunjët. Po të doni edhe ju mund ta bëni, - shtoi, dhe drejtoi trupin. – Të gjithë ata ndën të dyzetepesat mund t'i kapin gishtat e këmbës. Jo të gjithë e kemi fatin të luftojmë në front, por formën fizike, ama, mund ta ruajmë. Kujtoni djemtë tanë në frontin e Malabarit! Si dhe marinarët në Kështjellën Pluskuese! Veç sillni ndërmend barrën e tyre. Tani provojeni sërish. Tani po, shoku Smith, *shumë* më mirë, - shtoi duke e inkurajuar, ndërsa Uinstoni, me mushkëritë të acaruara, ia doli mbanë të prekte gishtat pa i thyer gjunjët për herë të parë në shumë vite.

IV

Me një psherëtimë të thellë e të pavullnetshme, të cilën nuk mund ta ndalonte as afërsia me tele-ekranin, kur filloi dita e re punës, Uinstoni afroi nga vetja shkrimoren me zë, fryu pluhurin prej mikrofonit të saj dhe vendosi syzet. Pastaj çmbështolli dhe u shkoi një kapëse katër cilindrave prej letre që sapo kishin dalë nga tubi pneumatik në krahun e djathtë të tavolinës.

Në muret e kthinës së tij kishte tre vrima. Në të djathtë të shkrimores me zë kishte një tub të vogël për mesazhet me shkrim; në të majtë, një më i madh për gazetat; ndërsa në murin anësor, shumë afër Uinstonit, kishte një çarje të gjatë të mbrojtur nga një rrjetë teli. Çarje të tilla kishte me qindra e mijëra në të gjithë godinën, jo vetëm në çdo dhomë, por në korridore ishin edhe më të shpeshta, të cilat, kushedi për ç'arsye, quheshin vrimat e kujtesës. Kur duhej të shkatërrohej ndonjë dokument, ose edhe kur shikoje ndonjë copë letër në dysheme, ngritja e kapakut të vrimës së kujtesës më të afërt dhe flakja e letrës në të ishte një veprim automatik, ndërsa letra, me anën e ajrit të ngrohtë, përcillej tek furrat e mëdha të fshehura diku në skutat e godinës.

Uinstoni ekzaminoi katër fletushkat e sapo shpështjella. Secila prej tyre kishte një mesazh me dy apo tre rreshta, me zhargonin e shkurtuar – jo tërësisht në Gjuhë të Re, por përmbanin fjalë të saj – që përdorej për qëllime të brendshme në Ministri. Mesazhet ishin:

times 17.3.84 fjalim vm keqraportuar afrikë ndreq

times 19.12.83 parashikim pla3vjeç tremujor 4-ët 83
gabimshtypi verifikoj numër sotëm
times 14.2.84 minibollëk keqcitim çokollatë ndreq
times 3.12.83 raportim vm urdhërdite dyfishmbijomirë
lidhje joperson rishkruaj plotdije lartndën vetmbyll

Me një ndjenjë të lehtë kënaqësie, mesazhin e katër e hoqi mënjanë. Ngaqë ishte një çështje e rëndësishme dhe e koklavitur e la për në fund. Tri të tjerat ishin çështje rutinë, megjithëse e dyta ndoshta kishte të bënte me mbushjen e ca listave të mërzitshme në shifra.

Uinstoni formoi "numrat e vjetër" në tele-ekran dhe urdhëroi për numrat që i duheshin nga *Times*-i, të cilët, pas pak minutash, erdhën përmes tubit pneumatik. Mesazhet që kishte marrë u referoheshin artikujve ose paragrafeve të gazetës të cilat, për njëfarë arsyeje, qe parë e nevojshme të ndryshoheshin, ose, e thënë me termin zyrtar, të korrigjoheshin. Për shembull, në gazetën e shtatëmbëdhjetë marsit thuhej që Vëllai i Madh, në fjalimin e një dite më parë, kishte parashikuar që fronti i Indisë së Jugut nuk do të prekej dhe që së shpejti Euroazia do të sulmonte Afrikën e Veriut. Në fakt, Shtabi i Përgjithshëm i Euroazisë, në vend të Afrikës Veriore, kishte sulmuar Indinë e Jugut. Për pasojë, dilte e domosdoshme që një paragraf i fjalimit të Vëllait të Madh të rishkruhej sikur e kishte parashikuar atë që tashmë kishte ndodhur. Ose, sërish, gazeta *Times* e nëntëmbëdhjetë dhjetorit kishte botuar parashikimin e rendimentit për disa lloje mallrash konsumi për tremujorin e katërt të 1983-it, i cili ishte edhe tremujori i gjashtë i Planit të Nëntë Trevjeçar. Gazeta e ditës kishte shifrën e rendimentit të real, prej të cilit dukej që parashikimi ishte krejtësisht i gabuar në të gjithë zërat. Puna e Uinstonit ishte të korrigjonte figurat e kohëve të fundit dhe t'i barazonte me ato të parashikuarat. Ndërsa mesazhi i tretë, kishte të bënte me një gabim fare të thjeshtë i cili mund të rregullohej veç në pak minuta. Shkurtin e kaluar, Ministria e Bollëkut kishte premtuar ("ishte zotuar" thuhej në gjuhë zyrtare) se, gjatë 1984-ës, nuk do të kishte pakësim të çokollatës. Në fakt, Uinstoni e dinte që racioni

i çokollatës, në fund të asaj jave, do të ulej nga tridhjetë gramë në njëzetë. Ajo që kërkohej të bëhej ishte zëvendësimi i premtimit fillestar me një paralajmërim që ndoshta, diku gjatë muajit Prill, racioni do të zvogëlohej.

Me të mbaruar punë me të gjitha mesazhet, korrigjimet e bëra me shkrimoren me zë ua bashkangjiti kopjeve përkatëse të *Times*-it dhe i futi në tubin pneumatik. Pastaj, me një lëvizje që dukej gati e pavullnetshme, i zhubrosi mesazhet origjinale dhe shënimet që mund të kishte bërë vetë dhe i flaku në vrimat e memories të përpiheshin nga flakët.

Atë çfarë ndodhte në labirintin e padukshëm nëpër të cilin kalonte tubi pneumatik nuk e dinte me hollësi, por një ide të përgjithshme e kishte. Menjëherë pasi korrektimet e nevojshme në numrin e caktuar të *Times*-it ishin grumbulluar dhe krahasuar, ai numër do të ribotohej, kopja origjinale do të asgjësohej, ndërsa kopja e korrigjuar do të futej në dosje në vend të saj. Procesi i korrigjimeve të vazhdueshme zbatohej jo vetëm për gazetat, por edhe për librat, periodikët, pamfletet, afishet, broshurat, filmat, kolonat zanore, filmat vizatimorë, fotografitë – çdo lloj literature ose dokumenti që mund të kishte rëndësi politike apo ideologjike. E shkuara rifreskohej ditë për ditë, madje minutë për minutë. Në këtë mënyrë, çdo parashikim i bërë nga Partia mund të vërtetohej me dokumenta që kishte qenë i saktë; nuk lejohej të ekzistonte asnjë paragraf gazete apo kurrfarë opinioni që binte në kundërshtim me nevojat e çastit. Gjithë historia ishte kthyer në palimpsest, shuhej dhe rishkruhej sa herë që ishte e nevojshme. Kur korrigjimi mbaronte, nuk kishte asnjë mundësi për të zbuluar falsifikimin. Sektori më i madh i Drejtorisë së Arkivave, shumë më i madh nga ai në të cilin punonte Uinstoni, përbëhej nga persona detyra e të cilëve ishte të zbulonin dhe grumbullonin gjithë kopjet e librave, gazetave dhe dokumentave të tjerë që ishin zëvendësuar dhe duhej të asgjësoheshin. Një numër i *Times*-it, që për shkak të ndryshimeve në vijën politike ose profecive të gabuara të deklaruara nga Vëllai i Madh, mund të ishte rishkruar nja dhjetë-pesëmbëdhjetë herë, ndodhej në dosje me

datën origjinale dhe nuk ekzistonte asnjë kopje tjetër për ta kundërshtuar. Po kështu, librat ktheheshin për t'u shkruar disa herë me radhë dhe, në mënyrë të vazhdueshme, ribotoheshin pa shënimin më të vogël për ndryshimet e bëra. Madje, edhe urdhrat me shkrim që merrte Uinstoni, të cilat, i hiqte qafe me të mbaruar punë, kurrë nuk e përmendnin apo nënkuptonin që po kryhej një akt falsifikimi: përherë bëhej fjalë veç për pakujdesi, ngatërresa, gabime shtypi, apo citime të deformuara që duhej të korrigjoheshin për hir të saktësisë.

Në fakt, mendoi Uinstoni ndërsa korrigjonte shifrat e Ministrisë së Bollëkut, as falsifikim nuk mund të quhej. Ishte thjesht zëvendësim i një marrëzie me një marrëzi tjetër. Shumica e materialit me të cilin atyre u duhej të merreshin nuk kishte kurrfarë lidhje me të dhënat e botës reale, madje as nga ato lloj lidhjesh që gjenden në një gënjeshtër të kulluar. Statistikat qenë fantazi, si në versionin origjinal ashtu edhe në atë të korrigjuarin. Më të shumtën e kohës punonjësit qenë të detyruar që t'i sajonin nga mendja. Për shembull, Ministria e Bollëkut e kishte parashikuar numrin e çizmeve për tremujorin me 145 milonë palë. Shifra reale e prodhuar u dha gjashtëdhjetë e dy milionë. Megjithatë, kur e rishkroi parashikimin, Uinstoni e zbriti shifrën në pesëdhjetë e shtatë milionë, me qëllim që, si zakonisht, të synohej për tejkalim. Sidoqoftë, edhe shifra gjashtëdhjetë e dy edhe shifra pesëdhjetë e shtatë milionë ishin shumë larg të vërtetës. Mundësia më e madhe ishte që të mos qe prodhuar asnjë palë çizme. Dhe po kaq e mundshme, jo vetëm se nuk e dinte kush sa çizme qenë prodhuar, por edhe që askush s'çante kokë ta dinte. Ajo çfarë dihej me siguri ishte fakti që çdo tremujor, në letër, çizmet prodhoheshin në shifra astronomike, ndërkohë që ndoshta gjysma e popullsisë së Oqeanisë ecte këmbëzbathur. Dhe kështu ndodhte me çdo lloj të dhëne, sado e madhe apo e vogël të qe. Gjithçka zhdukej në errësirë, ku, në fund fare, as data nuk qe e sigurt.

Uinstoni vështroi përgjatë korridorit. Në kthinën përballë, një burrë trupvogël, mjekër zi, sqimatar, i quajtur Tillstën, me një gazetë të përthyer mbi gjunjë dhe gojën ngjitur tek mikrofoni i

shkrimores me zë, punonte i përqëndruar. Dukej sikur përpiqej ta mbante sekret mes vetes dhe tele-ekranit atë që thoshte. Ngriti kokën, syzet përcollën një vështrim armiqësor në drejtim të Uinstonit.

Uinstoni pothuajse nuk e njihte hiç Tillstënin dhe as që e kishte idenë se cila ishte detyra e tij. Nëpunësit e Drejtorisë së Arkivave nuk para flisnin për punën e tyre. Në korridorin e gjatë, pa dritare, me dy radhë kthinash, me kërcitje të pafundme letrash dhe me gumëzhimën e mërmëritjeve në mikrofonët e shkrimoreve, kishte rreth dhjetë-pesëmbëdhjetë vetë, të cilëve, Uinstoni nuk u dinte as emrat, edhe pse i shikonte përditë duke vrapuar tutje-tëhu në korridore apo duke lëvizur këmbë e duar gjatë Dy Minutave të Urrejtjes. Ndërsa e dinte që gruaja imcake me flokë të kuqërremtë në kthinën ngjitur robëtohej, ditë për ditë, për të gjetur, dhe pastaj shuar, në shtyp, emrat e njerëzve që qenë avulluar e mandej do të thuhej që nuk kishin ekzistuar kurrë. Kjo punë dukej e qëlluar për të meqë bashkëshorti i saj qe avulluar nja dy vite të shkuara. Kurse disa kthina më tutje, një krijesë ëndërrimtare, një butak i pasuksesshëm, i quajtur Ampëllforth, me veshë leshtorë dhe talent të habitshëm për të xhongluar me rimat dhe metrikën, prodhonte variante të gjymtuara – tekste përfundimtare, quheshin - të poemave me devijime ideologjike, të cilat, për arsye të panjohura, do të ruheshin në antologjira. Gjithë ky korridor me afërsisht pesëdhjetë punonjës, ishte vetëm një nënndarje, një qelizë e vetme në kompleksin e pashoq të Drejtorisë së Arkivave. Matanë, lart, poshtë, kishte të tjera mizëri punonjësish të përfshirë në një pafundësi punësh të paimagjinueshme. Shtypshkronjat gjigante me redaktorët, ekspertët tipografë me studiot e tyre të pajisura me gjithë instrumentat për të falsifikuar fotot. Sektori i teleprogrameve me inxhinierët, producentët dhe trupën e aktorëve të zgjedhur, sidomos për imitimin e zërave. Armata e nëpunësve të skedave, puna e të cilëve ishte përpilimi i listave me libra dhe periodikë për t'u korrigjuar. Magazinat e gjera ku ruheshin dokumentat e korrigjuara dhe furrat e fshehta ku

asgjësoheshin kopjet origjinale. Dhe diku, gati në anonimitet të plotë, ndodheshin mendjet drejtuese të cilat koordinonin gjithë lëvizjen dhe formulonin politikat që vendosnin se cili fragment i së shkuarës duhet të ruhej, cili të falsifikohej dhe cili të zhdukej nga faqja e dheut.

Por edhe vetë Drejtoria e Arkivave ishte thjesht një degë e Ministrisë së të Vërtetës, funksioni kryesor i të cilës nuk ishte rikrijimi i të shkuarës, por furnizimi i qytetarëve të Oqeanisë me gazeta, filma, libra shkollorë, programe televizive, drama, letërsi artistike – me gjithfarë informacioni të mundshëm, udhëzime, ose argëtim, nga statujat tek sllloganet, nga poemat lirike tek traktatet biologjike, nga abetarja tek fjalori i Gjuhës së Re. Ministria kishte për detyrë të plotësonte jo vetëm nevojat e shumëllojshme të Partisë, por ta përsëriste këtë proces edhe në nivele më të ulëta për të mirën e proleve. Kishte një zinxhir të tërë departamentesh që merreshin me literaturën, muzikën, dramat - në përgjithësi - argëtimin e proleve. Aty prodhoheshin gazeta paçavure që nuk kishin gjë tjetër veç sport, krim, astrologji, novela sensacionale pesë centë copa, filma me seks shqeto dhe këngë sentimentale të cilat kompozoheshin tërësisht në mënyrë mekanike, me një lloj kaleindoskopi të veçantë të quajtur vargëzues. Madje kishte një nënndarje të tërë – në Gjuhën e Re quhej *Pornosek* – që merrej me prodhimin e pornografisë së cilësisë së ulët, e cila postohej në pako të vulosura dhe nuk e shikonte asnjë anëtar tjetër Partie veç atyre që ishin bashkëpunëtorë në prodhimin e saj.

Ndërsa ishte duke punuar, nga tubi pneumatik kishin ardhur tre mesazhe të tjera, por ato ishin çështje të thjeshta që Uinstoni iu dha fund para se ta ndërprisnin Dy Minutat e Urrejtjes. Kur mbaroi Urrejtja ai u kthye në qoshen e vet, mori fjalorin e Gjuhës së Re nga rafti, shtyu mënjanë shkrimoren, fshiu syzet dhe ia nisi punës kryesore të mëngjesit.

Kënaqësia më e epërme për Uinstonin ishte ajo që përftonte nga puna. Pjesa më e madhe ishte rutinë bajate, por ajo përfshinte edhe gjëra aq të vështira dhe intriguese saqë mund të harroheshe pas saj si në një problem matematike – copëza delikate falsifikimi

ku të vetmit elementë orientimi ishin njohja që kishe për parimet e Anglosocit dhe llogaritja e asaj që Partia të kërkonte të thoshje. Uinstonit i jepej për kësi gjërash. Një herë i qe besuar edhe korrigjimi i artikujve kryesorë të *Times*-it, të cilët qenë shkruar tërësisht në Gjuhën e Re. Hapi mesazhin që kishte lënë mënjanë pak më parë. Mesazhi thoshte:

> times 3.12.83 raportim vm urdhërdite dyfishmbijomirë joperson rishkruaj plotdije lartndën vetmbyll

Në të folmen e vjetër (ose anglishten zyrtare) mund të përkthehej:

> Raporti i Vëllait të Madh, urdhri dite, në gazetën *Times* të 3 dhjetorit 1983, nuk është fare në lartësinë e duhur dhe përmend persona që nuk ekzistojnë. Rishkruajeni nga e para dhe dorëzojeni tek autoriteti epror para mbylljes së dosjeve.

Uinstoni lexoi artikullin fyes. Me ç'dukej, urdhri i ditës i Vëllait të Madh, në tërësi, lavdëronte punën e një organizate të quajtur FFCC e cila furnizonte me cigare dhe materiale të tjera marinarët e Kështjellës Pluskuese. Njëfarë shoku Uidhërs, anëtar i shquar i Besnikëve të Partisë, përmendej në mënyrë të veçantë dhe ishte dekoruar me Urdhërin për Merita të Spikatura, Klasi i Dytë.

Tre muaj më vonë, FFCC-ja ishte shpërbërë pa u dhënë ndonjë arsye. Nënkuptohej që tani Uidhërsi dhe shokët e tij duhet të ishin diskretituar, por nuk ishin përmendur as në Shtyp as në tele-ekran. Dhe ishte diçka që pritej, sepse nxjerrja në gjyq apo denoncimi publik i devijatorëve ishte diçka e rrallë. Spastrimet e mëdha ku përfshiheshin mijëra njerëz, me gjyqe publike për tradhtarët dhe *kriminelët e mendimit*, që i pranonin poshtërsisht krimet e tyre dhe mandej ekzekutoheshin, ishin shfaqje speciale që nuk ndodhnin më tepër se një herë në dy vjet. Më shpesh ndodhte që, njerëz të cilët shkaktonin qejfmbetje të Partisë, zhdukeshin dhe

nuk ziheshin më në gojë. Nuk ekzistonte asnjë lloj shenje mbi fatin e tyre. Në disa raste mund edhe të mos ishin ekzekutuar. Afërsisht tridhjetë persona që Uinstoni i kishte njohur, pa llogaritur prindërit e tij, ishin zhdukur kohë pas kohe.

Uinstoni fërkoi lehtë hundën me një kapse letrash. Në kthinën përballë shoku Tillstën vazhdonte punën pa rënë në sy, i kruspullosur sipër shkrimores me zë. Ngriti kokën një hop, sërish vështrimi ishte armiqësor. Ndoshta, u habit Uinstoni, edhe ai bënte të njëjtën punë. Kishte shumë mundësi. Një punë kaq delikate nuk mund t'i besohej kurrë vetëm një personi, ndërsa t'i jepej një komiteti do të thoshte që të pranohej hapur falsifikimi. Kishte rrezik që për versionet rivale të asaj që Vëllai i Madh kishte thënë faktikisht, punonin nja dhjetë a pesëmbëdhjetë vetë njëherazi. Ndërkohë, ndonjëra nga mendjet e Besnikëve të Partisë, do të përzgjidhte atë apo këtë version, do ta redaktonte dhe pastaj do të vinte në lëvizje gjithë procesin e kërkuar të citimeve, dhe në fund, rrena e aprovuar do të futej në arkiva e do të bëhej e vërtetë.

Uinstoni nuk e dinte përse ishte demaskuar Uidhërsi. Ndoshta për korrupsion ose paaftësi. Ndoshta Vëllai i Madh kishte hequr qafe një vartës të njohur pak si tepër. Ndoshta Uidhërsi ose dikush i afërt me të, kishte shfaqur tendenca armiqësore. Apo ndoshta – dhe më e mundshmja e të gjithave – gjithçka kishte ndodhur ngaqë spastrimet dhe zhdukjet ishin pjesë e domosdoshme e mekanizmave qeverisës. E vetmja shenjë domethënëse gjendej tek fjalët "për joperson", që do të thoshte se Uidhërsi kishte vdekur. Kjo nuk mund të thuhej për të gjitha rastet e arrestimeve. Shpeshherë të arrestuarit liroheshin dhe, para se të ekzekutoheshin, liheshin të lirë për një ose dy vjet. Shumë rrallë ndodhte që dikush të cilin e kishe menduar të vdekur prej kohësh mund të shfaqej si fantazmë në ndonjë gjyq publik ku, para se të zhdukej – këtë radhë përgjithmonë, dëshmonte dhe implikonte edhe nja njëqind të tjerë. Mirëpo, Uidhërsi ishte *joperson* qysh tani. Nuk ekzistonte, nuk kishte ekzistuar kurrë. Uinstoni i dha karar që nuk ishte e mjaftueshme të ndryshonte vetëm tendencën e fjalimit të Vëllait të Madh. Do të ishte më mirë që ta bënte sikur ai kishte trajtuar diçka pa lidhje fare me subjektin fillestar.

Mund ta kthente fjalimin në denoncim të zakonshëm të tradhtarëve dhe kriminelëve të mendimit, por kjo qe gjëja më lehtë që mund të bënte, ndërsa sajimi i ndonjë fitoreje në front, apo tejkalimi i prodhimit në ndonjë nga zërat e Planit të Nëntë Trevjeçar, mund të hapte shumë punë me të dhënat. Nevojitej veç fantazi e kulluar. Befas, iu shfaq i gatshëm në mendje imazhi i njëfarë shoku Ogilvi i cili kishte vdekur në betejë, në rrethana heroike. Në disa raste Vëllai i Madh ia kushtonte urdhrin e ditës përkujtimit të ndonjë anëtari të thjeshtë të Partisë jeta e të cilit lartësohej si model për t'u marrë shembull. Atë ditë do të përkujtonte shokun Ogilv. Natyrisht që nuk ekzistonte ndonjë person me këtë emër, por ca fjalë në gazetë dhe nja dy fotografi të falsifikuara mund ta sillnin fare lehtë në jetë.

Uinstoni u mendua një hop, pastaj tërhoqi pranë vetes shkrimoren me zë dhe filloi diktimin me stilin e njohur të Vëllait të Madh: stil ushtarak e pedantik dhe i lehtë për t'u imituar sepse ai e kishte zakon të bënte pyetje të cilave u përgjigjej po vetë ("Çfarë leksioni nxjerrim nga ky fakt, shokë? Mësimin – që është edhe një nga parimet themelore të Anglosocit – që...").

Në moshën tre vjeçare shoku Ogilv kishte refuzuar gjithë lodrat, me përjashtim të një daulleje, një automatiku dhe një helikopteri të vogël. Gjashtë vjeç – një vit më herët, duke përfituar nga një zbutje e rregullave – u bë anëtar i Spiunëve; nëntë vjeç ishte bërë komandant skuadre. Njëmbëdhjetë vjeç kishte denoncuar xhaxhain e vet në Policinë e Mendimit sepse kishte dëgjuar një bisedë e cila kishte patur tendenca armiqësore. Shtatëmbëdhjetë kishte qenë Sekretari i Parë Organizatës së Rinisë Kundër Seksit të një qarku. Nëntëmbëdhjetë kishte shpikur një granatë dore e cila ishte miratuar nga Ministria e Paqes dhe qysh në provën e saj të parë kishte vrarë tridhjetë e një robër euroaziatikë. Njëzet e tre vjeçar ishte zhdukur në betejë. I ndjekur nga avionet armike ndërsa fluturonte mbi Oqenin indian me materiale të rëndësishme, kishte lidhur pas trupit automatikun dhe ishte hedhur nga helikopteri në ujë me gjithë materialet e rëndësishme – një vdekje, kishte thënë Vëllai i Madh, të cilën nuk mund të mos e kujtoje pa e patur zili. Vëllai i Madh kishte shtuar edhe nja dy fjalë për pastërtinë dhe

vendosmërinë e shokut Ogilv. Nuk vinte alkool dhe duhan në buzë, i vetmi dëfrim i tij ishin orët në palestër, kishte hequr dorë nga seksi – ngaqë mendonte se martesa dhe kujdesi për familjen qenë pengesë për përkushtimin njëzet e katër orësh ndaj detyrës. Nuk dinte të fliste për gjë tjetër veç parimeve të Anglosocit dhe qëllim i vetëm i jetës së tij kishte qenë mposhtja e euroaziatikëve dhe zbulimi i spiunëve, sabotatorëve, kriminelëve të mendimit e gjithë tradhtarëve në përgjithësi.

Uinstoni debatoi me veten, t'ia jepte apo jo shokut Ogilv Urdhërin për Merita të Spikatura; në fund hoqi dorë, kjo do të hapte punë të madhe në përshtatjen e citimeve në shtyp.

Vështroi edhe një herë nga rivali i tij në kthinën përballë. Diçka e shtynte të ishte i sigurt që Tillstëni i palodhur bënte të njëjtën punë. Nuk kishte asnjë shans të dije se cili variant do të miratohej përfundimisht, por ai kishte bindjen e thellë që do të pranohej puna e tij. Shoku Ogilv, i paimagjinueshëm një orë më parë, tashmë ishte një fakt. E forta është, mendoi, se qenka më e lehtë të krijosh njerëz të vdekur sesa të gjallë. Shoku Ogilv, i cili nuk kishte patur kurrë të tashme, tashmë do të kishte të shkuar dhe, kur akti i falsifikimit të harrohej, do të ekzistonte në mënyrë autentike, mbështetur nga të njëjtat fakte me Karlin e Madh apo Jul Çezarin.

V

Në mensën me tavan të ulët, thellë ndën tokë, radha e punëtorëve çapitej e kërrusur. Ishte citë me njerëz dhe zhurmë shurdhuese. Avulli i çorbës në skarën afër banakut vërshoi drejt derës me një aromë thartire dhe metalike e cila, prapëseprapë, nuk i sfumoi dot avujt e Xhinit Fitorja. Në fund të dhomës ishte një bar i vogël, thjesht një vrimë në mur, ku shitej xhin për dhjetë cent një gllënjkë.

- Pikërisht njeriu që unë kërkoja, - tha një zë mbrapa Uinstonit.

Uinstoni u kthye. Pa mikun e tij, Sajmin, i cili punonte në Drejtorinë e Kërkimeve. Ndoshta "mik" nuk ishte fjala e duhur. Tashmë nuk kishe më miq, por vetëm shokë, veç kishte edhe ca shokë shoqëria e të cilëve ishte më e këndshme se e të tjerëve. Sajmi ishte filolog, specialist për Gjuhën e Re. Realisht ai qe njëri nga pjesëtarët e grupit të madh të ekspertëve të ngarkuar me përpilimin e Botimit të Njëmbëdhjetë të Fjalorit të Gjuhës së Re. Vinte më i imët se Uinstoni, me flokë të zeza, sy të mëdhenj e të fryrë, njëherazi të trishtuar dhe tallës, që e vëzhgonin nga afër fytyrën e bashkëbiseduesit.

- Desha të të pyes mos ke ndonjë brisk, - tha.

- Asnjë, - ia ktheu Uinstoni rrëmbimthi i nxitur nga ndjenja e fajit.

Brisqet qenë problem për të gjithë. Faktikisht, Uinstoni kishte dy brisqe të papërdorur, të hequr mënjanë. Muajt e fundit kishte qenë krizë brisqesh. Përherë do të kishte një artikull të domosdoshëm që nuk gjendej në dyqanet e Partisë. Herë

mungonin kopsat, herë peri, herë lidhëset e këpucëve dhe për momentin mungonin brisqet. Për t'i shtënë në dorë, nëse mund t'i shtije, duhet të pyesje vjedhurazi në tregun e "lirë".

- Kam gjashtë javë që rruhem me të njëjtin brisk, - u shtir Sajmi.

Radha përparoi edhe një çap. Kur ndaluan u kthye sërish nga Sajmi. Morën nga një tabaka mbi një stivë me tabaka ende të lyrosura sipër tavolinës.

- E pe varjen e të burgosurve dje? – pyeti Sajmi.

- Isha në punë, - tha Uinstoni me indiferencë. – Besoj se do ta shikoj në kinema.

- Nuk është e njëjta gjë, - tha Sajmi.

Sytë e tij tallës u endën mbi fytyrën e Uinstonit. "E kam të qartë, - dukej sikur thoshnin. – Të shikoj në brendësi. Dhe e di shumë mirë pse nuk shkove të shikoje varjen e të burgosurve." Sajmi qe konservator i helmët, por në një mënyrë intelektuale. Fliste me një kënaqësi pasionante dhe të neveritshme për bombardimet e helikopterëve mbi fshatrat armike, për gjyqet dhe rrëfimet e kriminelëve të mendimit, për ekzekutimet në qelitë e Ministrisë së Dashurisë. Të bisedoje me të duhej që ta largoje nga tema të tilla dhe, nëse qe e mundur, ta kridhje në çështjet teknike të Gjuhës së Re, aty ku ishte autoritar dhe i këndshëm. Uinstoni mënjanoi kokën një grimë për të shmangur zhbirimin e syve të zinj e të mëdhenj.

- Nuk shkoi keq, - tha Sajmi si t'i kujtohej diçka. – Kur ua lidhin këmbët sikur e prishin disi. Qejfi im janë përpëlitjet sa andej këndej. Dhe mbi të gjitha, fundi, gjuha e varur përjashta dhe ngjyra e saj blu – një blu e hapët. Ky është detaji më pikant për mua.

- Tjetri, ju lutem, - bërtiti një prole me përparëse të bardhë dhe garuzhde në dorë.

Uinstoni dhe Sajmi shtynë tabakatë poshtë skarës. Në të dyja u vendos me delikatesë dreka e zakonshme – një tas metalik me çorbë ngjyrë rozë e gri, një copë bukë, një copë djathë, një filxhan Kafe Fitorja pa qumësht dhe një tabletë sakarinë.

- Poshtë tele-ekranit është një tavolinë e lirë, - tha Sajmi. – Gjatë rrugës marrim nga një xhin.

Xhinin ua hodhën në gota porcelani pa bisht. Çanë përmes dhomës së tejmbushur dhe vendosën ushqimet mbi tavolinën me suprinë metalike, në cepin e së cilës dikush kishte lënë një pellg me çorbë, një lëng i pistë që dukej si e vjellë. Uinstoni ngriti gotën me xhin dhe para se të gëlltiste lëngun me shije vaji, ndali një hop të mblidhte veten. Pasi largoi lotët me rrahjen e qepallave, befas kuptoi që kishte uri. Çorba që nisi të gëlltiste ishte disi e ujshme, por kishte edhe ca topa ngjyrë rozë që ndoshta ishin përgatitur me mish. Derisa mbaruan së ngrëni çorbën nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Nga tavolina në të majtë të Uinstonit, pak më mbrapa tij, dikush fliste me shpejtësi dhe papushim, një mërmëritje e vrazhdë e ngjashme me gagaritje rosash, e cila dilte mbi gjithë zhurmën e dhomës.

- Si shkojnë punët me Fjalorin? - tha Uinstoni, duke e ngritur zërin që të dëgjohej.

- Pak ngadalë, - tha Sajmi. – Po merrem me mbiemrat. Janë mahnitës.

Me t'u përmendur Gjuha e Re, Sajmi u çel në fytyrë. Lëvizi tasin mënjanë, mori bukën me delikatesë, djathin në dorën tjetrën dhe u përkul sipër tavolinës për të biseduar me zë të ulët.

- Botimi i Njëmbëdhjetë është botimi përfundimtar, - tha. – Gjuha po merr trajtën e plotë – trajtën që do të ketë kur nuk do të flitet gjuhë tjetër veç saj. Kur ta mbarojmë, njerëzve si puna jote do t'u duhet ta mësojnë nga e para. Ti mendon, po hamendësoj, që puna jonë kryesore është të shpikim fjalë të reja. Në asnjë mënyrë. Ne po shkatërrojmë fjalë – me dhjetra e me qindra, përditë. Po bëjmë krasitje serioze të gjuhës. Botimi i Njëmbëdhjetë nuk do të ketë asnjë fjalë që do të dalë nga përdorimi para vitit 2050.

Sulmoi i uritur bukën, kafshoi nja dy-tre herë, pastaj vazhdoi të fliste me pasionin e një pedanti. Fytyra e hollë dhe e zymtë u gjallërua, sytë tallës u bënë ëndërrues.

- Shkatërrimi i fjalëve është gjë e mrekullueshme. Natyrisht, pjesa më e madhe që do të asgjësohet janë folje dhe mbiemra, por ka edhe qindra emra që duhet t'i heqim qafe. Jo vetëm sinonimet, por edhe antonimet. Tek e fundit, si mund të justifikohet një fjalë

që është thjesht e kundërta e një fjale tjetër? Fjala e ka brenda vetes të kundërtën e saj. Le të marrim fjalën "mirë", për shembull. Në qoftë se kemi fjalën "mirë", ç'kuptim ka të kemi fjalën "keq"? "Jomirë" mund të shkojë po aq mirë, madje edhe më mirë, pasi ndryshe nga tjera krijon të kundërtën e saktë të fjalës "mirë". Pastaj, në qoftë se dëshiron një version më të fortë të fjalës "mirë", ç'kuptim ka të kesh një varg fjalësh të padobishme dhe të vagullta si "përsosur", "shkëlqyer" dhe gjithë tjerat? "Mbimirë" i jep shumë mirë ato kuptime, apo, në qoftë se dëshiron një fjalë akoma më të fortë kemi "dyfishmbimirë". Natyrisht, ne i përdorim ato fjalë tashmë, por pas versionit përfundimtar të Gjuhës së Re nuk do të ketë version tjetër. Në fund konceptet e "të mirës" dhe "të keqes" do të përmbushen vetëm nga gjashtë fjalë – në fakt, në realitet do të jetë vetëm një fjalë. E shikon sa e bukur është, Uinston? Natyrisht, fillimisht ishte ideja e Vëllait të Madh, - shtoi ai një mendim të vonuar.

Me përmendjen e Vëllait të Madh fytyrën e Uinstonit e përfshiu një kënaqësi e madhe. Prapëseprapë, Sajmi e pikasi menjëherë mungesën e entuziazmit.

- Ti, Uinston, nuk e ke aq qejf Gjuhën e Re, - tha ai pothuajse me trishtim. – Kur shkruan, ti mendon ende në të folmen e vjetër. Kam lexuar ca nga artikujt që boton herë pas here tek *Times*-i. S'janë keq, por janë përkthime. Në shpirt je për të folmen e vjetër, me gjithë paqartësinë dhe pavleshmërinë e hijeve të kuptimeve të saj. Ti nuk e njeh kënaqësinë e shkatërrimit të fjalëve. A e di që Gjuha e Re është e vetmja gjuhë fjalori i së cilës zvogëlohet nga viti në vit?

Natyrisht, Uinstoni nuk e dinte. Ai buzëqeshi, duke shpresuar të dukej dashamirës, ngaqë s'kishte besim tek fjalët. Sajmi mori edhe një kafshatë nga buka e zezë, e përtypi pak dhe vazhdoi:

- Nuk e shikon se qëllimi kryesor i saj është të ngushtojë hapësirën e mendimit? Do të vijë një ditë që krimi i mendimit do të zhduket krejt, sepse nuk do të ketë fjalë me të cilat mund të shprehet. Çdo koncept që do të jetë i nevojshëm, do të shprehet vetëm me *një* fjalë, me kuptimin e saj të përkufizuar me fanatizëm

ndërsa gjithë kuptimet dytësore jenë shuar dhe flakur në harrim. Me Botimin e Njëmbëdhjetë jemi shumë afër kësaj pike. Megjithatë procesi do të vazhdojë edhe shumë kohë pas vdekjes tonë. Çdo vit do të ketë gjithnjë e më pak fjalë dhe hapësira e vetëdijes do të jetë përherë e më e vogël. Natyrisht, edhe sot nuk ka asgjë që e justifikon krimin e mendimit. Është thjesht çështje vetëdisipline, aftësi për të kontrolluar realitetin. Por një ditë nuk do të ketë nevojë as për këtë. Revolucioni do të kompletohet kur gjuha të jetë e përsosur. Gjuha e Re është Anglosoci dhe Anglosoci është Gjuha e Re, - shtoi ai me një kënaqësi të fshehtë. – Uinston, të ka shkuar ndonjëherë në mendje se, më së shumti, deri në vitin 2050, nuk do të ketë asnjë qenie njerëzore që mund ta kuptojë këtë bisedë që ne po bëjmë sot?

- Përveç... - nisi Uinstoni me dyshim dhe pushoi.

E kishte në majë të gjuhës të thoshte "Përveç proleve", por u vetpërmbajt, ngaqë pati frikë se ato fjalë nuk tregonin partishmëri.

- Punëtorët nuk janë qenie njerëzore, - tha i shkujdesur ai. – Deri në 2050 – ndoshta më herët – gjithë dija e vërtetë e Gjuhës së Vjetër do të jetë zhdukur. Gjithë letërsia e të shkuarës do të jetë shkatërruar. Çoseri, Shekspiri, Miltoni, Bajroni – do të ekzistojnë vetëm me versione në Gjuhën e Re, jo thjesht të kthyer në diçka tjetër, por të shndërruar në diçka të kundërt me atë që kanë qenë. Bile edhe letërsia e Partisë do të ndryshojë. Si mund të ketë një parrullë të tillë "Liria është skllavëri", kur koncepti i lirisë do të jetë hequr? Gjithë mjedisi mendor do të jetë krejt ndryshe. Në fakt, nuk do të ketë fare mendim në kuptimin e sotëm të kësaj fjale. Partishmëri do të thotë të mos mendosh – mungesë e nevojës që të mendosh. Partishmëri është pavetëdija.

Një ditë, mendoi Uinstoni plotësisht i bindur, Sajmi do të eleminohet. Është shumë inteligjent. Shikon shumë qartë dhe flet shumë hapur. Partia nuk i pëlqen njerëz të tillë. Një ditë ai do të zhduket. E ka të shkruar në ballë.

Uinstoni e kishte mbaruar bukën dhe djathin. U kthye pak anash në karrige të pinte kafen. Në tavolinën në të majtë të tij, njeriu me zërin e çjerrë vazhdonte të fliste pa pikën e

mëshirës. Një vajzë, ndoshta sekretaria e tij, e ulur me shpinë nga Uinstoni, e dëgjonte dhe dukej se miratonte gjithë dëshirë gjithçka që ai thoshte. Herë pas here Uinstoni dëgjonte gjëra të tilla si "Unë mendoj se ke të drejtë, jam plotësisht dakord me ty", të thëna nga zëri vajzëror dhe mendjelehtë. Por zëri tjetër nuk pushoi asnjë çast, edhe kur fliste vajza. Uinstoni e njihte burrin si fytyrë, megjithatë, përveç faktit që ai kishte një post të rëndësishëm në Drejtorinë e Trillimeve, nuk dinte gjë tjetër. Ishte një burrë rreth të tridhjetave, me një fyt muskuloz dhe gojë të mëdhe e të shkathët. Me kokën të hedhur disi mbrapa, për shkak të pozicionit në të cilin qëndronte, syzat ishin në dritë dhe në vend të syve Uinstoni pa dy disqe bosh. Më i bezdisshëm qe fakti se ishte e pamundur të kapje qoftë edhe një fjalë të vetme nga lumi i fjalëve që i vërshonte nga goja. Vetëm njëherë, Uinstoni, kapi një frazë – "eleminimi i plotë dhe përfundimtar i Goldshteinit" – e nxjerrë me shpejtësi, shabllon dhe, me sa dukej, e hedhur me qëllim. Prapëseprapë, edhe pse mund të mos e dëgjoje çfarë thoshte, nuk kishe dyshime për natyrën e tij në përgjithësi. Ai mund të fliste kundër Golsteinit, mund të kërkonte masa më të forta kundër kriminelëve të mendimit, mund të bubullonte kundër mizorisë së ushtrisë euroaziatike, mund të thurte lavde për Vëllain e Madh dhe heronjtë në frontin e Malabarit – megjithatë këto nuk ndryshonin asgjë. Çfarëdo që ai thoshte, ti ishe i sigurt që qe fanatizëm i pastër, Anglosoc i kulluar. Ndërsa shikonte fytyrën pa sy dhe nofullën që lëvizte rrëmbimthi, Uinstoni kishte përshtypjen se ai nuk ishte qenie njerëzore e vërtetë, por një lloj manekini. Atij njeriu nuk i fliste mendja, por laringu. Nga goja nxirrte fjalë, por jo në kuptimin e ligjërimit të vërtetë, veç një zë prodhuar nga pavetëdija, si gagaritjet e rosës.

Sajmi ishte zhytur në heshtje dhe bënte vija me bisht të lugës në pellgun e çorbës. Zëri në tavolinën tjetër vazhdonte të gagariste me rrëmbim, lehtë i dëgjueshëm, pavarësisht poteres përqark.

- Në Gjuhën e Re ka një fjalë, - tha Sajmi, - nuk di në e di ti apo jo, *rosëfolme*, të gagarisësh si rosë. Është një nga ato fjalët interesante që ka dy kuptime të kundërta. Kur e përdor

për armikun, është fyerje, kur e përdor për dikë me të cilin të përputhen mendimet, është lavdërim.

Padyshim që Sajmi do të avullohet, mendoi sërish Uinstoni. E mendoi me njëfarë trishtimi, edhe pse e dinte që Sajmi e përbuzte, e shikonte me antipati, dhe, me t'ju dhënë mundësia, ishte gati ta denoncote si kriminel mendimi. Diçka nuk shkonte me Sajmin. Diç i mungonte: maturia, ftohtësia, një lloj idiotësie shpëtimtare. Nuk mund të thoje që i mungonte partishmëria. Ai i besonte parimet e Anglosocit, e nderonte Vëllain e Madh, lumturohej pas fitoreve, i urrente tradhtarët, jo vetëm sinqerisht por edhe me një lloj entuziazmi, dhe qe në korent me informacionit më të fundit, diçka jo e zakonshme për një anëtar të rëndomtë të Partisë. Megjithatë shihej me dyshim. Thoshte gjëra që do të ishte më mirë të mos thuheshin, kishte lexuar shumë libra, frekuentonte kafe *Gështenjën*, vend i piktorëve dhe muzikantëve. Nuk kishte asnjë ligj, as të pashkruar bile, kundër frekuentimit të kafe *Gështenjës*, megjithatë ai vend qe shenjë e keqe. Aty mblidheshin para se të eleminoheshin gjithë udhëheqësit e vjetër të rënë nga vakti. Thuhej se vite e dekada të shkuara aty ishte parë edhe Goldshteini. Nuk ishte e vështirë ta parashikoje fatin e Sajmit. Megjithatë, sikur Sajmi ta nuhaste se çfarë qe duke menduar Uinstoni, do ta kishte denoncuar tek Policia e Mendimit pa humbur kohë. Ç'është e vërteta kështu do bënin të gjithë, por Sajmi më tepër nga të tjerët. Dëshira nuk mjaftonte. Partishmëri qe pavetëdija.

Sajmi ngriti kokën.

- Po vjen Parsonsi, - tha.

Diçka në tonin e zërit të tij dukej sikur shtonte "ai budallai i dreqit". Parsonsi, fqinji i Uinstonit tek Blloku i Fitores, ishte duke çarë rrugën përmes dhomës – llafazan, shtatmesatar, flokë verdhë, me fytyrë bretkose. Qysh tridhjetë e pesë vjeç po dhjamosej keqas, qafë e bel, por lëvizjet i kishte të shpejta dhe djaloshare. Dukej si një fëmijë i vëllimshëm që kishte veshur kominoshet për të fshehur përmasat, ishte e pamundur të mos e përfytyroje me pantallona të shkurtra ngjyrë blu, këmishë gri, dhe shallin e Spiunëve. Në qoftë se e

sillje ndëmend figurën e tij gjithmonë do të shikoje gjunjët me gropëza dhe mëngët e llërëve rrondokope të shpërveshura. Dhe vërtet, Parsonsi u kthehej pantallonave të shkurtra kur kishte ndonjë marshim apo çdo lloj aktiviteti fizik që e pranonte një veshje të tillë. I përshëndeti të dy me një "Ç'kemi!" gazmore dhe u ul në tavolinë duke kundërmuar djersë. Fytyra rozë qe mbushur me pikëla lagështire. Aftësia e tij për të djersitur qe e jashtëzakonshme. Në Vatrën e Kulturës mund ta kuptoje që kishte luajtur pingpong nga doreza e pistë e raketës. Sajmi kishte nxjerrë një shirit letre në të cilin kishte shkruar një kollonë të gjatë fjalësh dhe e studionte me një laps të kuq mes gishtave.

- Shikoje, punon në kohën e drekës, - tha Parsonsi, duke e prekur lehtë Uinstonin, - i përkushtuar, ë? Plako, ç'është ajo që ke në dorë? Diçka të vështirë për mendjen time, besoj. Smith, ma merr mendja që e di pse po të gjurmoj. Ke harruar të më japësh kontrat.

- Çfarë kontrash? – tha Uinstoni, e ndieu menjeherë që bëhej fjalë për para. Afërsisht një e katërta e rrogës duhej të rezervohej për kontributet vullnetare të cilat qenë aq shumë saqë ishte e vështirë t'i kujtoje të gjitha.

- Për Javën e Urrejtjes. Ti e di, fondet e çdo familjeje. Jam përgjegjës për bllokun tonë. I jemi futur me vendosmëri – do të organizojmë një shfaqje të madhe. Ja ku po ta them, nuk do të jetë faji im në qoftë se rrugët e Bllokut të Fitores nuk do të kenë numrin më të madh të flamujve. Më premtove dy dollarë.

Uinstoni gjeti dhe dorëzoi dy kartëmonedha të pista e të zhubrosura, të cilat Parsonsi i futi mes një blloku të vogël, me një shkrim elegant analfabeti.

- Plako, meqë ra fjala, - tha, - dëgjova se dje ai maskarai im të kishte qëlluar me hobe. E bëra rezil. Në fakt e paralajmërova se do t'ia heq hobenë në qoftë se e bën sërish.

- Më duket se qe i mërzitur që nuk shkoi të shihte ekzekutimin, - tha Uinstoni.

- Ah, shiko – ajo që doja të thoja i thotë vetë të gjitha, apo jo? Të dy janë mistrecë, por plot me entuziazëm! E kanë mendjen vetëm te Spiunët dhe, natyrisht, lufta. E di ç'bëri ime bijë të

shtunën, kur skuadra e saj shkoi në marshim në Berkhamsted? Bashkë me dy shoqe u përvodhën nga marshimi dhe e harxhuan gjithë mbasditen duke përgjuar një të panjohur. Iu qepën këmba këmbës për orë të tëra, edhe mes pyllit, pastaj kur mbërritën në Amërsham, e dorëzuan në polici.

- E përse e bënë këtë? – tha Uinstoni, disi i habitur. Parsoni vazhdoi me entuziazëm:

- Ime bijë u bind që ai ishte diversant – për shembull, mund të ishte hedhur me parashutë. Por kjo është çështja, shok i dashur. E kishte kuptuar nga këpucët e tij të çuditshme, tha, nuk kishte parë askënd me këpucë të tilla më parë. Kështu që mundësia më e madhe qe që ai të ishte i huaj. Për një shtatvjeçare është mrekulli, apo jo?

- Ç'u bë me atë burrin? – tha Uinstoni.

- Oh, të them të drejtën nuk e di. Por nuk do të çuditesha sikur... - Parsonsi bëri sikur qëlloi me pushkë, dhe kërciti gjuhën për të imituar krismën.

- Bukur, - tha Sajmi i përhumbur, pa i ngritur sytë nga shiriti i letrës.

- Natyrisht, nuk mund të rrezikojmë, - aprovoi me gatishmëri Uinstoni.

- E kisha fjalën që jemi në luftë, - tha Parsonsi.

Sikur ta konfirmonte këtë, nga tele-ekrani sipër kokave të tyre u dëgjua një thirrje borie. Megjithatë, këtë radhë nuk u shpall ndonjë fitore, por bëri një njoftim Ministria e Bollëkut.

- Shokë, - klithi një zë i padurueshëm rinor. – Shokë, vini re! Lajme të shkëlqyera. Beteja me prodhimin është fituar. Bilancet e sapo përfunduara të planit tregojnë se vitin e shkuar standarti i mirëqenies është rritur jo më pak se 20 për qind në të gjitha zërat. Sot në mëngjes, në gjithë Oqeaninë, në demonstrime spontane të shfrenuara, punëtorët lanë fabrikat e zyrat dhe marshuan në rrugë me pankarta në mirënjohje të Vëllait të Madh për jetën e re dhe të lumtur që na ka falur udhëheqja e tij. Ja disa nga të dhënat. Ushqime...

Fraza "jeta jonë e re dhe e lumtur" u dëgjua disa herë rresht. Asokohe ajo ishte fraza më e pëlqyer e Ministrisë së

Bollëkut. I alarmuar nga boria Parsonsi dëgjonte me një solemnitet të habitshëm dhe njëfarë mërzie të kalitur. Nga shifrat s'merrte vesh, por e kuptonte që ishin një arsye për t'u lumturuar. Kishte nxjerrë një llullë të madhe e të pistë e cila ishte gjysmë e mbushur me duhan të djegur qysh në xhep. Me racionin e duhanit veç 100 gramë në javë, rrallë mund ta mbushje gjithë llullën. Uinstoni kishte ndezur një Cigare Fitorja të cilën e mbante me kujdes në pozicion horizontal. Racionin e ri i binte ta merrte të nesërmen, ndërsa i kishin mbetur veç katër cigare. Për momentin e kishte larguar mendjen nga çdo zhurmë e largët dhe dëgjonte vetëm atë çfarë vërshonte prej tele-ekranit. Vuri re që ishin organizuar edhe demonstrime për të falënderuar Vëllain e Madh për shtimin e racionit të çokollatës në 20 gramë. Ndërkohë u kujtua që vetëm një ditë më parë ishte dhënë njoftimi që racioni do të *ulej* në 20 gramë në javë. Si ishte e mundur që ta gëlltisnin të kundërtën vetëm dyzetë e tetë orë më vonë? Po, shumë e mundur. Parsonsi e gëlltiti sade fare, si të qe kafshë. Krijesa pa sy në anën tjetër e gëlltiti si i tërbuar, gjithë pasion, me dëshirën e marrë të ndiqte, denonconte dhe zhdukte nga faqja e dheut këdo që do të thoshte se një javë më parë racioni kishte qenë tridhjetë gramë. Edhe Sajmi – në mënyrë më të ndërlikuar, duke përdorur mendimin e dyfishtë - e hëngri. Atëherë, mos vallë ai ishte i *vetmi* që kishte kujtesë?

Nga tele-ekrani vërshonte lumi i statistikave përrallore. Krahasuar me një vit më parë, atë vit kishte më tepër ushqime, veshje, shtëpi, mobilje, sahanë, karburant – gjithçka ishte shtuar, përveç sëmundjeve, krimit dhe çmendurisë. Vit pas viti e minutë pas minuti, gjithkush e gjithçka përparonte me shpejtësinë e dritës. Uinstoni, ashtu si Sajmi pak më herët, mori lugën dhe llapashiti në lëngun e mishit derdhur mbi tavolinë, fillimisht bëri një vizë e pastaj vazhdoi me figurina. Meditonte i trishtuar mbi natyrën fizike të jetës. Kështu kishte qenë gjithmonë? Këtë shije kishte patur ushqimi përherë? Hodhi një sy nëpër mensë. Një dhomë me tavan të ulët, plot e përplot, muret të nxirë nga trupat e fërkuar pas tyre; tavolina dhe karrige metalike të shtypura, ngjitur me njëra tjetrën saqë njerëzit uleshin bërryl më bërryl; lugë të përthyera, tabaka buzëthyera, gota të bardha

avdalle; gjithë sipërfaqet me yndyrë dhe blozë në çdo të çarë; një përzierje mbytëse xhini dhe kafeje të keqe, çorba metalike dhe rroba të pista. Përherë stomaku dhe lëkura protestonin, një ndjesi sikur të të kishin privuar nga diçka që ishte e drejta jote. Ishte shumë e vërtetë që kujtimet s'kishin ndonjë ndryshim të madh. Në çdo kohë nuk kishte patur ushqim me bollëk, nuk kishte patur çorape pa vrima, mobiljet kishin qenë të shqyera e të ronitura, dhomat të ftohta, trenat e metrosë të citosur, shtëpitë të rrënuara, buka e zezë, çaji me pakicë, kafeja me shije të qelbët, cigaret të pa mjaftueshme – asgjë çmimlirë dhe me bollëk, përveç xhinit sintetik. Natyrisht, me plakjen e trupit gjërat përkeqësoheshin, a *nuk* ishte kjo një shenjë që nuk ishte ky rendi i gjërave: përderisa zemra dëmtohej nga mungesa e rehatisë, pisllëku dhe fukarallëku, dimrat e pafund, kutërbimi i çorapeve, ashensorët përherë të prishur, uji i ftohtë, sapuni i ashpër, cigaret që thërrmoheshin, ushqimi me shijen e keqe? Mirëpo, pse duhej të dukej diçka e patolerueshme përderisa nuk kishe kujtime që dikur gjërat kishin qenë ndryshe?

Vërdalli sytë nëpër mensë sërish. Pothuajse të gjithë ishin të shëmtuar, dhe kështu do të kishin qenë edhe sikur në vend të kominosheve blu të kishin veshur diçka tjetër. Në një tavolinë në fund të dhomës, një burrë trupvogël, me pamje brumbulli, pinte kafe ndërsa vështronte me dyshim nga cepi në cep. Sa e lehtë që ishte, në qoftë se nuk shikoje përreth vetes, mendoi Uinstoni, të besoje që njeriu i ri ndërtuar nga Partia - djem muskulozë, shtatlartë dhe vajza leshverdha e gjoksderdhura, ngjyrë çokallatë dhe të shkujdesura – jo vetëm ekzistonte, por qe shumicë. Në fakt, me sa gjykonte ai, pjesa më e madhe e popullsisë së Shiritit të Parë Ajror, ishin të shkurtër, zeshkanë dhe të shëmtuar. Mënyra sesi shtoheshin në Ministri tipat me pamje brumbulli ishte e çuditshme: shtatpakë e të shëmtuar, të rënduar qysh herët, me këmbë të shkurtra, lëvizje të shpejta dhe fytyra të dhjamosura, enigmatike dhe me sy të vegjël. Ky ishte tipi që dukej se lulëzonte nën dominimin e Partisë.

Njoftimi i Ministrisë së Bollëkut mbaroi me një oshtimë tjetër të borisë që i hapi rrugën një muzike metalike. Me

entuziazmin e turbullt të trazuar nga shifrat, Parsonsi hoqi llullën nga goja.

- Ministria e Bollëkut ka bërë me të vërtetë një punë për t'u lavdëruar këtë vit, - tha duke tundur kokën, me sigurinë që merrte vesh nga këto punë. – Me që ra fjala, plako, Smith mos ke të më japësh ndonjë brisk?

- As edhe një, - tha Uinstoni. – Kam gjashtë javë që rruhem me të njëjtin brisk.

- Oh, në rregull – thjesht, thashë të pyesja njëherë.

- Më vjen keq, - tha Uinstoni.

Zëri gagaritës në tavolinën ngjitur, përkohësisht i heshtur gjatë njoftimit të Ministrisë së Bollëkut, kishte filluar sërish më i zhurmshëm se kurrë. Pa e ditur pse, Uinstoni e kapi veten duke menduar për zonjën Parsons, me flokët e saj të lëshuar dhe rrudhat mbushur me pluhur. Brenda dy vjetësh ata fëmijë do ta denonconin në Policinë e Mendimit. Zonja Parsons mund të avullohej. Sajmi mund të avullohej. Uinstoni mund të avullohej. Parsonsi nuk do të avullohej. Krijesa pa sy dhe me zërin gagaritës nuk do të avullohej kurrë. As burrat shtatpakët me pamje brumbulli që lëviznin me shpejtësi në labirintin e korridoreve të Ministrisë nuk do të avulloheshin kurrë. As vajza flokëzezë, vajza e Drejtorisë së Trillimeve, nuk do të zhdukej kurrë. Uinstoni pati përshtypjen se e dinte kush do të mbijetonte dhe kush do të fshihej nga faqja e dheut, megjithëse nuk e kishte të lehtë të thoshte se cilat qenë arsyet e mbijetesës.

Atë çast, një kthim i rrufeshëm e nxori prej përhumbjes. Vajza në tavolinën ngjitur u kthye përgjysmë dhe po e vështronte. Ishte vajza flokëzezë. E vështronte disi brinjazi, por me një ngulm të çuditshëm. Në sekondën që vështrimet e tyre u ndeshën ajo shmangu sytë.

Uinstoni ndieu t'i djersitej shtylla kurrizore. Trupin ia përshkoi një rrufe terrori. Alarmi pothuajse u zhduk në çast, por duke lënë një shqetësim sëmbues mbrapa. Për se e vështroi ajo vajzë? Përse e ndiqte? Për fat të keq nuk i kujtohej në kishte qenë ajo në tavolinë kur kishte ardhur ai, apo në kishte ardhur më vonë. Por dje, gjatë Dy Minutave të Urrejtjes, ajo ishte ulur pikërisht

mbrapa tij, ndërsa nuk qe e nevojshme ta bënte këtë. Kishte shumë mundësi që detyra e saj të qe të dëgjonte Uinstonin dhe të sigurohej që britmat e tij ishin në lartësinë e duhur.

Mendimi i mëparshëm iu kthye sërish, mbase ajo nuk qe fare anëtare e Policisë së Mendimit, prandaj rreziku më i madh ishin spiunët amatorë. Nuk e kishte idenë për sa kohë ajo e kishte vështruar, mbase edhe pesë minuta, ndërkohë që tiparet e tij mund të mos kishin qenë tërësisht të kontrolluara. T'u jepje liri të plotë mendimeve, në një vend publik ose brenda fokusit të tele-ekranit, do të thoshte të luaje me zjarrin. Edhe gjëja më e vogël mund të të tradhtonte. Një tik nervor, një ankth i pavetëdijshëm, zakoni i të folurit me vete – çdo gjë që tregonte anormalitet apo që kumtonte se po fshihje diçka. Sidoqoftë, të merrje një shprehje të papërshtatshme në fytyrë (për shembull, një vështrim mosbesues gjatë njoftimeve të fitoreve) ishte një akt i dënueshëm. Madje në Gjuhën e Re, për këtë kishte edhe një fjalë: *fytyrëkrim*.

Vajza i kishte kthyer shpinën sërish. Tek e fundit ajo mund të mos ishte duke e ndjekur, ndoshta kishte qenë ratësi që u ul pranë tij dy ditë rresht. Cigarja qe fikur, e vuri me kujdes në buzë të tavolinës. Po qe se nuk i shkundej duhani, do ta pinte pas punës. Vajza në tavolinën ngjitur mund të ishte spiune e Policisë së Mendimit, brenda tre ditëve ai mund të përfundonte në qelitë e Ministrisë së Dashurisë, sidoqoftë bishti i cigares nuk duhej shpërdoruar. Sajmi e kishte mbështjellë rripin e letrës dhe e futi në xhep. Parsonsi kishte nisur të fliste.

- Plako, të kam treguar, - tha ai, duke iu shmangur shtëllungës së tymit të llullës së vet, - për rastin kur ata mistrecat e mi të vegjël i vunë zjarrin fustanit të asaj shitëses plakë të dyqanit e cila kishte mbështjellë salçiçet me një afishe të V.M-së? Iu avitën nga mbrapa dhe e ndezën me shkrepse. E dogjën keq. Trazovaçë, ë? Por të shkathët! Ky është trajnim i shkallës më të lartë që bëjnë sot tek Spiunët – madje, më i mirë se në kohën time. E gjen dot çfarë u kanë dhënë së fundi? Bori veshi për të dëgjuar nga vrimat e çelësit. Pak ditë më parë ime bijë e solli në shtëpi – e provoi në derën e dhomës së ndenjjes dhe tha që mund të dëgjonte dy herë

më shumë se duke vënë veshin në vrimë të çelësit. Shyqyr që është veç lodër. Sidoqoftë është ideja e qëlluar, apo jo?

Atë çast tele-ekrani lëshoi një fishkëllimë shpuese. Ishte sinjali për t'u kthyer në punë. Gjithë punonjësit u ngritën në këmbë dhe filluan betejën për të hipur në ashensorë, duhani i cigares së Uinstonit ra në dysheme.

VI

Uinstoni shkruante në ditar:

Ndodhi tre vjet më vonë. Një mbrëmje e errët pus, në një rrugë anësore pranë njërit nga stacionet e mëdha të trenit. Ajo qëndronte në hyrje, poshtë një llampe të rrugës që pothuajse nuk ndriçonte hiç. Kishte fytyrë rinore, lyer shumë trashë. Ajo çfarë më tërhoqi ishte lyerja, e bardha e saj, si një maskë dhe buzët me ngjyrë të kuqe të çelur. Anëtarët e Partisë nuk e lyejnë kurrë fytyrën. Në rrugë nuk kishte njeri, as tele-ekran. Dy dollarë, tha. Unë...

Për momentin qe e vështirë të vazhdonte. Mbylli sytë dhe shtypi gishtat sipër tyre, u përpoq të largonte imazhin që shfaqej e rishfaqej. E përfshiu një dëshirë e madhe të lëshonte një breshëri fjalësh të pista me sa i hante fyti. Ose të përplaste kokën për muri, apo të qëllonte tavolinën me shkelm, ose të flakte shishen e bojës nga dritarja – të bënte një veprim të dhunshëm apo të zhurmshëm, ose diçka që dhimbte dhe largonte kujtimin që se linte rehat.

Armiku më i rrezikshëm, mendoi, është sistemi yt nervor. Tensioni brenda teje mund të shndërrohej në simptoma të padukshme në çdo moment. Solli në mendje një burrë me të cilin qe shkëmbyer në rrugë ca javë të shkuara, një burrë me pamje të zakonshme, një anëtar Partie, tridhjetë e pesë-dyzet vjeç, shtatlartë e i hollë, me një valixhe. Kur ishin thuajse njëzet metra larg, befas ana e majtë e fytyrës së burrit pësoi njëfarë spazme. Ndërsa u afruan kjo ndodhi sërish, një tërheqje e lehtë, një dridhje si flash

aparati fotografik dhe dukej hapur se ishte zakon. Iu kujtua ajo që mendoi atë ditë: shëmtaraqi i gjorë ka marrë fund. Ajo që e trembi ishte fakti që veprimi mund të ishte i pavetëdijshëm. Por rreziku më i madh ishte të folurit në gjumë. Me sa dinte ai, nuk kishte asnjë mundësi të ruheshe.

U mbush me frymë dhe vazhdoi të shkruante:

E ndoqa, përmes një dere dolëm në kopshtin e pasmë dhe u futëm në një kuzhinë në bodrum. Ngjitur me murin ndodhej një krevat dhe në tavolinë një llampë, me flakën shumë të ulët. Ajo...

Shtrëngoi dhëmbët. I vinte për të pështyrë. Kishte menduar njëkohësisht, për gruan e bodrumit dhe për Katerinën, bashkëshorten. Uinstoni ishte i martuar – në fakt, kishte qenë i martuar: e ndoshta ishte ende, për sa kohë që e dinte se ajo jetonte. Iu duk sikur thithi sërish aromën e rëndë të bodrumit, aromë e përbërë nga insekte, veshje të pista dhe parfume çmimlira dhe aromë mbytëse, por sidoqoftë tërheqëse sepse asnjë anëtare partie nuk përdorte, apo imagjinohej të përdorte, parfum. Atë e përdornin vetëm prolet. Në mendjen e tij, era e parfumit ishte e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me kurvërimin.

Kur kishte shkuar me atë gruan, ishte shkarja e parë në dy vjet, a diç e tillë. Natyrisht, shoqërimi me prostitutat ishte i ndaluar, por ishte një nga ato rregullat që me raste mund ta shkelje. Ishte e rrezikshme, por jo çështje për jetë a vdekje. Të kapeshe me një prostitutë, e shumta do të thoshte pesë vjet punë e detyruar, vetëm kaq, në s'kishe bërë shkelje tjetër të ligjit. Madje në qoftë se nuk kapeshe gjatë aktit, dënoheshe edhe më pak. Në zonat e varfra të banimit, i gjeje me bollëk gratë që shiteshin. Disa mund të jepeshin edhe për një shishe xhin, që proleve nuk u lejohej ta pinin. Madje Partia ishte e prirur të mbyllte njërin sy për prostuticionin, si një mënyrë për çliruar instiktet që nuk mund të shtypeshin tërësisht. Shthurja nuk qe dhe aq e rëndësishme për sa kohë që mbetej e fshehtë, pa ndjenjë dhe përfshinte vetëm gratë e një klase të shtypur dhe të përbuzur. Përzierjet midis anëtarëve të Partisë qenë krim i pafalshëm. Por – edhe pse, gjatë spastrimeve të mëdha,

ky ishte krimi që të akuzuarit pranonin – ishte e pamundur që ta imagjinoje se një gjë e tillë ndodhte vërtet.

Synimi i Partisë nuk ishte thjesht të ndalonte gratë dhe burrat të krijonin lidhje të cilat mund të ishte e vështirë t'i kontrollonte. Qëllimi i vërtetë, i padeklaruar, ishte ta zhvishte aktin seksual nga kënaqësia. Armiku më i madh ishte erotizmi dhe jo dashuria, brenda dhe jashtë martesës. Të gjitha martesat midis anëtarëve të Partisë duhet të aprovoheshin nga një komitet i ngritur për këtë qëllim dhe – megjithëse një parim i padeklaruar kurrë – leja refuzohej në qoftë se midis çifitit në fjalë vihej re joshje fizike. Qëllimi i vetëm i martesës ishte lindja e fëmijëve që do t'i shërbenin Partisë. Penetrimi seksual duhej të shikohej si një veprim disi i neveritshëm dhe i dorës së dytë, si bërja e klizmës, për shembull. Edhe kjo nuk u tha kurrë hapur, por tërthorazi ishte ngulitur tek çdo anëtar i Partisë qysh në lindje. Madje kishte edhe organizata, si Organizata e Rinisë Kundër Seksit, që përkrahnin beqarinë e plotë për të dyja sekset. Gjithë fëmijët do të lindnin me anë të shtatëzanisë artificiale (*shtatart* quhej në Gjuhën e Re) dhe do të rriteshin në institucione publike. Uinstoni ishte i ndërgjegjshëm që kjo nuk trajtohej seriozisht, por i shkonte për shtat ideologjisë së Partisë. Partia përpiqej ta vriste instiktin seksual ose, në qoftë se nuk e vriste dot, të paktën ta shpërfytyronte dhe ta ndynte. Ai nuk e kuptonte pse duhej bërë një gjë e tillë, por i dukej e drejtë që të bëhej. Dhe në lidhje me grate, përpjekjet e Partisë kishin qenë të suksesshme.

E çoi sërish mendjen tek Katerina. Mund të bëheshin nëntë, dhjetë – afërsisht njëmbëdhjetë vjetë qysh kur ishin ndarë. Ishte e çuditshme që mendonte aq pak për të. Bile kishte ditë të tëra që harronte se kishte qenë i martuar. Bashkë kishin qëndruar afërsisht pesëmbëdhjetë muaj. Partia nuk e lejonte shkurorëzimin, por në rastet pa fëmijë e stimulonte ndarjen.

Katerina ishte flokëverdhë, shtatëlartë, elegante, me lëvizje dehëse. Kishte fytyrë të guximshme, syshqiponjë, një fytyrë që mund ta quaje fisnike, deri kur zbuloje se mbrapa saj nuk kishte asgjë. Ai e kishte kuptuar qysh në fillimet e jetës bashkëshortore – ndoshta ngaqë e njihte në mënyrë më intime

seç njihte shumicën e njerëzve – se ajo, pa asnjë dyshim, kishte qenë gruaja më mendjelehtë, më vulgare dhe më tyryfyçkë që ai kishte njohur. Mendimet e saj ishin vetëm sllogane dhe ajo mund të gëlltiste gjithë budallallëqet, absolutisht të gjitha, që i ofronte Partia. Në mendjen e tij e quante "Kolona zanore njerëzore". Megjithatë, do ta kishte duruar sikur mos të ishte shfaqur një pengesë – seksi.

Sa e prekte ajo niste të ngjethej e mpihej. Ishte më mirë të përqafoje një copë dru sesa atë. Dhe më e çuditshmja ishte se, kur ajo e shtrëgonte pranë vetes, atij i dukej sikur e shtynte në të kundërt me gjithë forcën e vet. Ashpërsia e muskujve të saj këtë përshtypje i linte. Ajo qëndronte shtrirë me sytë mbyllur, as rezistonte as bashkëpunonte, por *dorëzohej*. Në fillim ishte gjendje hutuese dhe, pas njëfarë kohe, e neveritshme. Por edhe atëherë, ai sërish do ta kishte duruar jetën me të, në qoftë se do të kishin rënë dakord të bashkëjetonin pa seks. Çudia qe se Katerina ishte ajo që nuk pranonte. Duhet ta provonin që të bënin një fëmijë në qe e mundur, thoshte. Kështu që akti vazhdoi të kryhej një herë në javë, rregullisht, me përjashtim të rasteve kur s'kishin mundësi. Madje shpesh, ajo e kujtonte për seksin në mëngjes, si për diçka që duhej të bëhej atë darkë dhe që s'duhej harruar. Ajo e thërriste me dy emra. Njëri "lindja e një fëmije" dhe tjetri "detyra jonë ndaj Partisë" (po, pikërisht këtë frazë përdorte). Shumë shpejt ai filloi të përjetonte ankth kur u afrua dita e caktuar. Por fatmirësisht, fëmija nuk u shfaq dhe ajo ra dakord të mos e provonin më, pastaj, shumë shpejt u ndanë.

Uinstoni psherëtiu lehtë. Mori penën dhe nisi të shkruante sërish:

Ajo u shtri në krevat, dhe menjëherë, pa asnjë parapërgatitje, në mënyrën më të shëmtuar, më të neveritshme, siç mund ta imagjinoni, ngriti fustanin. Unë...

E pa veten duke qëndruar atje në mugëtirë, me kundërmim insektesh dhe parfumi çmimlirë në majë të hundës, ndërsa në zemër kishte ndjenjën e humbësit dhe lëndimit që edhe atë

çast ishin të ngatërruara me imazhin e trupit të bardhë të Katerinës, i ngrirë përgjithmonë nga fuqia e Partisë. Pse duhej të ndodhte kështu përherë? Pse, në vend të këtyre përleshjeve të pista sporadike nëpër vite, të mos kishte një grua të vetën? Mirëpo aventurat e dashurisë qenë pothuajse të pamundura. Ndershmëria ishte e ngulitur tek gratë njësoj si dashuria për Partinë. Prej kujdesit të treguar herët, prej ujit të ftohtë dhe lojërave, prej broçkullave të përsëritura e ripërsëritura në shkollë, tek Spiunët, në Organizatën e Rinisë, në leksione, parada, këngë, sllogane dhe muzika rreshtore: i kishin zhveshur nga ndjenjat natyrale. Arsyeja i thoshte që kishte edhe përjashtime, por atij nuk i besohej. Ato qenë të papushtueshme, ashtu si Partia i donte të ishin. Ai donte ta thyente atë mur virtytesh, qoftë edhe një herë të vetme në jetën e tij dhe jo sepse donte të ishte i dashuruar. Akti seksual i bërë me sukses qe rebelim. Dëshira ishte krim mendor. Madje edhe të zgjonte Katerinën, në qoftë se ia arrinte ta zgjonte, diçka e tillë do të konsiderohej joshje edhe pse ajo ishte gruaja e vet.

Duhej të shkruhej pjesa tjetër e ngjarjes. Shkroi:

Ngrita flakën e llampës. Kur e pashë në dritë...

Pas errësirës, drita e vakët e llampës me parafinë i qe dukur shumë e çelët. Për herë të parë e pa gruan siç duhej. Hodhi një hap drejt saj dhe ndali, gjithë epsh dhe tmerr. E njihte rrezikun që kishte marrë përsipër qysh kur ishte nisur për aty. Ishte gati i sigurt se në kthim do ta kapnin patrullat, madje kush e dinte që atë çast nuk po e prisnin jashtë. Në qoftë se largohej pa e bërë, atëherë përse kishte ardhur aty...!

Duhej shkruar, duhej pranuar. Papritur në dritën e llampës kishte zbuluar që gruaja ishte e moshuar. Boja ishte suvatuar aq trashë në fytyrën e saj saqë të linte përshtypjen se do të plasaritej si maskë kartoni. Flokët i kishte me rruvija të bardha; por detaji më neveritshëm u shfaq kur goja e saj u hap lehtë dhe ai pa vetëm një zgavër të errët. Gruaja nuk kishte dhëmbë.

Kur e pashë në dritë, vura re që qe e moshuar, të paktën pesëdhjetë vjeçe. Megjithatë unë vazhdova, e bëra që e bëra.

Shtypi gishtat sipër qepallave sërish. Më në fund e shkroi, megjithëse nuk ndjeu asnjë ndryshim. Terapia nuk kishte dhënë sukses. Dëshirën për të sharë me fjalët më të pista e kishte më të zjarrtë se kurrë.

VII

Në qoftë se shpresa ekziston, shkroi Uinstoni, *ajo gjendet te prolet.*

Në qoftë se shpresa ekzistonte, atëherë patjetër që ndodhej te prolet, sepse vetëm ata, ajo masë e panumërt dhe e mospërfillur, 85 për qind e popullsisë së Oqeanisë, ishte në gjendje të prodhonte fuqinë e nevojshme për të shkatërruar Partinë. Ajo nuk mund të përmbysej nga brenda. Armiqtë e Partisë, nëse kishte, nuk kishin mundësi as ta njihnin njëri-tjetrin. Edhe nëse *Vëllazëria* legjendare ekzistonte, gjë që edhe mundet, anëtarët e saj nuk lëviznin dot në grupe më të mëdha se dy apo tre vetë. Për këtë arsye, rebelim do të thoshte një vështrim, një ndryshim zëri, e shumta, më të rrallë, ndonjë mërmërimë. Ndërsa ndërgjegjësimi i proleve për fuqinë e tyre e bënte të panevojshëm organizimin e komploteve. Mjaftonte të ngriheshin në këmbë dhe të tundeshin si një kalë që shkund mizat. Mjaftonte të merrnin vendimin se të nesërmen do të hidhnin Partinë në erë. Sigurisht, herët apo vonë edhe kjo do t'u shkonte në mendje. E megjithatë...!

Iu kujtua dita kur ecte përgjatë një rruge të mbushur me njerëz, ndërsa një bërtimë e tmerrshme, qindra-mijëra zëra – zëra grash, shpërtheu nga një rrugë dytësore, pak përpara tij. Ishte një klithmë e fuqishme zemërimi dhe dëshpërimi, një "Oh-o-o-o-oh!" që u zgjat si kumbim kambane. Zemra iu hodh përpjetë. Po fillon! mendoi. Rebelimi. Më në fund prolet po shpërthejnë! Kur mbërriti në vendin e ngjarjes, pa një turmë rrotull tezgave të tregut në atë rrugicë, dyqind a treqind gra me fytyra tragjike,

si të ishin pasagjerë në një anije që mbytej. Atë çast dëshpërimi kolektiv u shpërbë në një pafundësi zënkash individuale. Siç u mor vesh, një nga tezgat shiste tenxhere të kallajisura. Tenxheret ishin të shtypura dhe të cekëta, por në këto kohëra ishte e vështirë të gjeje enë gatimi. Papritur ato kishin mbaruar. Gratë fatlume, të shtyra e të shtypura nga pjesa tjetër, përpiqeshin të largoheshin me tenxheret në duar, ndërsa një duzinë grash të tjera gumëzhinin rreth tezgës, akuzonin shitësin për hatëre dhe se gjoja ai kishte hequr mënjanë të tjera tenxhere. Pati një shpërthim të ri britmash. Dy gra të bëshme, njëra me flokë të lëshuar, kishin shtënë në dorë të njëjtën tenxhere. Për një çast ato e tërhoqën enën të dyja njëkohësisht dhe kështu u mbetën në duar vetëm dorezat e tenxheres. Uinstoni i vështroi me neveri. Mirëpo për një çast, vetëm nga ato pak qindra gurmaze kishte dalë një klithmë me fuqi të frikshme! Ç'dreqin kishin që nuk bërtisnin po ashtu për gjëra me rëndësi?

Uinstoni shkroi:

Pa u ndërgjegjësuar prolet nuk do të ngrihen, ndërsa ndërgjegjësimi arrihet vetëm pas rebelimit.

Këto fjalë, mendoi, nuk kanë asnjë dallim nga ato çfarë thoshin tekstet shkollore të Partisë. Natyrisht, Partia pretendonte që i kishte çliruar prolet nga skllavëria. Para Revolucionit prolet ishin shtypur nga kapitalistët, ishin fshikulluar dhe varfëruar, gratë ishin detyruar të punonin në minierat e qymyrit (në fakt, ato punonin ende), fëmijët ishin shitur në fabrika qysh gjashtë vjeç. Në të njëjtën kohë, në sajë të parimeve të mendimit të dyfishtë, Partia mendonte se prolet ishin inferiorë të lindur të cilët, me anë të ca ligjeve të thjeshta, duhet të mbaheshin të nënshtruar si kafshë. Në realitet për prolet dihej shumë pak. Nuk ishte e nevojshme të dihej shumë. Për sa kohë që ata punonin e shumoheshin, aktivitetet e tjera të tyre s'kishin rëndësi. Duke i lënë me njeri tjetrin, si lopët të lëshuara në savanat e Argjentinës, prolet ishin përshtatur me një stil jete i cili u dukej normal, njëfarë riti i lashtë. Lindnin, rriteshin rrugëve, fillonin punën dymbëdhjetë vjeç, përjetonin një

lulëzim të bukurisë dhe dëshirave seksuale, martoheshin njëzet vjeç, arrinin moshën mesatare në tridhjetë dhe, në të shumtën e rasteve, vdisnin gjashtëdhjetë vjeç. Puna e rëndë fizike, punët e shtëpisë dhe rritja e fëmijëve, grindjet e vogla me fqinjët, filmat, futbolli, birra dhe mbi të gjitha, kumari, përbënin gjithë botën e tyre. Nuk qe e vështirë t'i mbaje nën kontroll. Midis tyre do të gjendeshin përherë një tufë agjentësh të Policisë së Mendimit, të cilët përhapnin fjalë të rreme, që veçonin dhe eleminonin ata pakë individë që shiheshin si të aftë për t'u bërë të rrezikshëm; por nuk ishin bërë përpjekje për t'i indoktrinuar të gjithë me ideologjinë e Partisë. Ndjenjat e forta politike të punëtorëve nuk ishin të dëshiruara. Gjithë ajo që kërkohej prej tyre ishte njëfarë patriotizmi primitiv i cili mund të shfrytëzohej sa herë që dilte e nevojshme për t'i bërë ata të pranonin orë më të gjata pune dhe shkurtimin e racioneve. Por edhe kur prolet qenë të pakënaqur, gjë që edhe ndodhte, pakënaqësia e tyre ishte pa rrugëdalje, sepse, duke mos pasur ide të përgjithshme, ata përqëndroheshin vetëm në gjëra të vogla. Të këqijat e mëdha nuk i vinin re kurrë. Në shtëpitë e shumicës së proleve nuk kishte as tele-ekran. Edhe policia civile nuk merrej shumë me ta. Shkalla e krimit në Londër ishte e madhe, një botë brenda botës së hajdutëve, banditëve, prostitutave, shitësve të drogës dhe dallaveraxhinjve të çdo lloji, por meqenëse këto ndodhnin mes vetë proleve nuk u jepej rëndësi. Në gjithë çështjet morale atyre u qe lejuar të ndiqnin traditën e paraardhësve. Pastërtia seksuale e Partisë nuk u ishte imponuar. Tradhëtia nuk dënohej, divorci ishte i lejuar. Ç'është e vërteta, në qoftë se prolet do të kishin dhënë shenjë që kishin nevojë apo e donin fenë edhe ajo do të ishte lejuar. Prolet nuk dyshoheshin. E thoshte edhe parrulla e Partisë: "Prolet dhe kafshët janë të lira."

Uinstoni u përkul dhe fërkoi nyellin e malcuar. Plaga kishte nisur t'i kruhej përsëri. Ajo që mund të shqetësonte njeriun vazhdimisht ishte pamundësia për të mësuar sesi kishte qenë jeta para Revolucionit. Nxori nga sirtari një tekst historie që e kishte marrë tek zonja Parsons dhe nisi të kopjonte një pasazh në ditar:

Në të shkuarën (thuhej), para Revolucionit të lavdishëm, Londra nuk ishte qyteti i bukur që ne njohim sot. Ajo ishte një vend i errët, i pistë, mizerje, ku pothuaj askush nuk e ngopte barkun me bukë, ku qindra e mijëra njerëz ecnin zbathur ose flinin në qiell të hapur. Fëmijët në moshën tuaj detyroheshin të punonin dymbëdhjetë orë në ditë për punëdhënës të pashpirt, të cilët i fshikullonin në qoftë se ata punonin ngadalë ndërsa për të ngrënë u jepnin veç thërrime buke dhe ujë. Por midis kësaj varfërie ekstreme kishte një pakicë shtëpish të mëdha dhe të bukura në të cilat jetonin të pasurit, me shërbëtorë numri i të cilëve mund të shkonte edhe tridhjetë. Të pasurit quheshin kapitalistë. Ata ishin të shëndoshë, të shëmtuar, me fytyra djallëzore, si ato në fotot në faqen tjetër. Siç e shikoni ai ka veshur një pallto të madhe e cila quhet rendigotë dhe një kapele të çuditshme, me shkëlqim dhe në formën tubi-sobe, e cila quhej cilindër. Kjo ishte uniforma e kapitalistëve dhe nuk lejohej ta vishte kush tjetër. Kapitalistët zotëronin gjithçka në botë, pjesa tjetër e njerëzve ishin skllevër të tyre. Ata kishin në zotërim gjithë tokën, shtëpitë, fabrikat dhe paratë. Kush nuk ju bindej kapitalistëve futej në burg, ose flakej nga puna dhe lihej të vdiste urie. Kur një njeri i thjeshtë i fliste një kapitalisti, duhej t'i fliste me përulje, të përkulej, të hiqte kapelen dhe ta thërriste "Zotëri". Shefi i gjithë kapitalistëve quhej Mbret, dhe...

Uinstoni e dinte vazhdimin. Do të flitej për priftërinjtë me mëngë të gjera, për gjykatësit me veshje hermeline, për shtyllën e turpit, vargonjtë, rrotën, kamxhikun, banketet e Kryetarit të Bashkisë dhe për ritin e puthjes së gishtit të këmbës së Papës. Kishte edhe diçka që quhej *jus primae noctis*, që ndoshta nuk përmendej në libra fëmijësh. Ky ishte ligji sipas të cilit çdo kapitalist kishte të drejtë të flinte me çdo grua që punonte në një nga fabrikat e tij.

Si mund ta kuptoje se cilat nga këto ishin gënjeshtra? *Ndoshta* ishte e vërtetë që njeriu i thjeshtë jetonte më mirë tani sesa para revolucionit. E vetmja dëshmi për të kundërtën ishte protesta memece e trupit tënd, ndjenja instiktive se kushtet në të cilat jetoje ishin të patolerueshme dhe që dikur kishin qenë ndryshe. U habit kur mendoi se tipari kryesor i jetës moderne

nuk ishte egërsia dhe pasiguria, por durimi, zymtësia dhe apatia. Në qoftë se vështroje rrotull, jeta nuk ngjante fare jo vetëm me gënjeshtrat që vërshonin nga tele-ekrani, por as me synimet që Partia përpiqej të arrinte. Edhe pjesa më e madhe e jetës së një anëtari të Partisë ishte asnjanëse, jo politike, rropatje në punë të mërzitshme, luftë për të gjetur një vend në metro, arnimi i rrobave të tejlodhura, lypja e një tablete sakarinë, kursimi i bishtave të cigares. Qëllimi i Partisë ishte diçka gjigante, e jashtëzakonshme, rrëzëllitëse – një botë çeliku, me makineri monstruoze dhe armë të frikshme – një komb ushtarësh dhe fanatikësh, që marshonin në unitet të përsosur, të gjithë duke menduar të njëjtën gjë dhe duke bërtitur të njëjtat sllogane, punë, luftë, fitore, persekutim i përjetshëm – treqind milionë njerëz me të njëjtën pamje. Realiteti kishte marrë tatëpjetën, qytete të zymta ku njerëz të ushqyer keq ecnin me këpucë të grisura që jetonin në shtëpi të shekullit të nëntëmbëdhjetë të mballosura me dërrasa, të cilat mbanin erë lakre dhe nevojtoresh. Përfytyrimi i tij për Londrën dukej se ishte një qytet i pafundmë me gërmadha, me miliona kosha plehërash dhe i shkrirë në pamjen e zonjës Parsons, një grua me fytyrën e rrudhosur dhe flokë të drejta që rrekej më kot të rregullonte tubin e bllokuar të lavamanit.

U përkul sërish të përkonte nyellin. Ditë e natë tele-ekrani të lodhte veshët me statistika që tregonin se sot njerëzit kishin më shumë ushqim, më shumë veshje, shtëpi më të mira, më tepër argëtim, - se jetonin më gjatë, punonin më pak orë, ishin më të mëdhenj, më të shëndetshëm, më të fortë, më të gëzuar, më inteligjentë dhe më të shkolluar se pesëdhjetë vjetë më parë. Asnjë fakt nuk mund të vërtetohej apo kundërshtohej. Për shembull, Partia pretendonte se 40 për qind e popullsisë dinin shkrim e këndim, ndërsa përpara Revolucionit, thuhej, kjo shifër kishte qenë 15 për qind. Partia pretendonte se shkalla e vdekshmërisë foshnjore ishte 160 për një mijë, ndërsa para Revolucionit kishte qenë 300 – e kështu me radhë. Një ekuacion me dy të panjohura. Mund të ishte shumë e vërtetë që çdo fjalë në librat e historisë të ishte fantazi e kulluar. Me sa merrte vesh ai, nuk kishte mundësi që të kishte pasur një ligj si *jus primae noctis*, ose krijesa të quajtura kapitalistë, apo kapele cilindrike.

Gjithçka humbte në mjegull. E shkuara ishte fshirë, fshirja qe harruar, gënjeshtra ishte bërë e vërtetë. Vetëm një herë në jetën e tij kishte zotëruar – *pas* ngjarjes, kjo kishte rëndësi – një fakt konkret, të pakundërshtueshëm, për një akt falsifikimi. E kishte mbajtur në dorë për disa sekonda. Duhet të kishte qenë viti 1973 – sidoqoftë, kishte qenë periudha kur ishte ndarë me Katerinën. Por data me të cilën kishte lidhje ky fakt i përkiste shtatë ose tetë viteve të shkuara.

Ngjarja zinte fill nga mesi i viteve gjashtëdhjetë, periudha e spastrimeve të mëdha, gjatë të cilave u zhdukën një herë e përgjithmonë gjithë udhëheqësit kryesorë të Revolucionit. Asnjëri prej tyre nuk e arriti 1970-ën, përveç Vëllait të Madh. Deri atë kohë shumica e tyre qenë demaskuar si tradhtarë dhe kundërrevolucionarë. Goldshteini ishte arratisur dhe askush nuk e dinte ku fshihej, ndërsa të tjerët, një pakicë u zhdukën pa lënë gjurmë, ndërsa shumica, pas gjyqesh spektakolare në publik ku ata pranuan gjithë krimet, u ekzekutuan. Midis të mbijetuarve të fundit ishin tre persona të quajtur, Xhon, Aronson dhe Radhërford. Duhet të ishin arrestuar aty nga viti 1965 dhe, siç ndodhte shpesh, për një vit a më shumë, ata u zhdukën dhe askush nuk dinte të thoshte në ishin gjallë apo në kishin vdekur, kur befas u nxorën në dritë të inkriminonin veten si zakonisht. Ata kishin pranuar bashkëpunimin me armikun (asokohe Euroazia), shpërdorimin e fondeve publike, vrasjen e disa anëtarëve të besuar të Partisë, intrigat kundër Vëllait të Madh të cilat zinin fill para se të niste Revolucioni dhe aktet e sabotimit me pasojë vdekjen e qindra mijëra njerëzve. Pas pranimit të këtyre gjërave u falën, u rikthyen në Parti dhe iu dhanë poste sa për të marrë rrogën, por që tingëllonin si detyra të rëndësishme. Të tre shkruan artikuj të gjatë e të neveritshëm në gazetën *Times* ku pranonin arsyet e devijimit dhe premtonin që do të përmirësoheshin.

Në fakt, pak kohë pasi ata u liruan, Uinstoni i pa te kafe *Gështenja*. E mbante mend mirë magjepsjen e frikshme me të cilën i pati kundruar me bisht të syrit. Ata ishin shumë më të vjetër se ai, relike të një bote të lashtë, pothuajse figurat e fundit

të mbetura nga ditët heroike të fillimit të Partisë. Mbështjellë me hijen e zbehtë të magjisë së luftës ilegale dhe asaj civile. Pavarësisht se faktet dhe datat po zbeheshin, ai kishte ndjesinë se i kishte dëgjuar emrat e tyre shumë vite më përpara se emrin e Vëllait të Madh. Në të njëjtën kohë ata ishin të demaskuar, të përbaltur, armiq, të destinuar për t'u zhdukur brenda një apo dy vjetësh. Nga të gjithë ata që kishin rënë në duart e Policisë së Mendimit nuk kishte shpëtuar asnjëri. Pra, ishin kufoma që prisnin të përcilleshin në varr.

Në tavolinat pranë tyre nuk ulej njeri. Gjëja më e mirë ishte që as në lagje të mos shfaqeshe pranë këtyre njerëzve. Rrinin ulur pranë gotave të xhinit me karafil, një specialitet i lokalit. Nga të tre, Uinstonit i kishte bërë më shumë përshtypje Radhërfordi. Dikur, Radhërfodi kishte qenë një karikaturist i famshëm, karikaturat e pamëshirshme të të cilit kishin ndihmuar për të ndikuar opinionin publik, para e pas Revolucionit. Edhe tani, veç me ndërkohë disi të gjata, *Times*-i botonte karikatura të tij. Imitime të stilit të vet të mëparshëm, por çuditërisht pa jetë dhe jo fort bindëse. Një përzierje temash të përhershme – shtëpi të vjetra me qera, fëmijë të uritur, luftë nëpër rrugë, kapitalistë me kapele cilindrike – madje edhe në barrikada kapitalistët dukej se nuk hiqnin dorë prej tyre – një përpjekje e pafund dhe e pafuqishme për t'u kthyer në të shkuarën. Pamja e Radhërfordit të kallte datën, një kreshtë flokësh gri të lyrosur, një fytyrë plot rrudha e qeska, buzë të trasha afrikanësh. Dikur duhet të kishte qenë i fuqishëm, ndërsa tani trupi i tij ishte lëshuar, kërrusur, mbufatur, kishte degraduar në çdo drejtim.

Kishte qenë ora tre e mbasdites. Atë çast Uinstonit nuk i kujtohej arsyeja pse kishte shkuar në kafene në një orë të tillë. Prej tele-ekranit vinte një muzikë e shplarë. Tre burrat u ulën në qoshen e tyre pothuajse pa shprehje, nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Kamarieri ua rimbushte gotat me xhin pa i thënë kush. Në tavolinën përkrah tyre ndodhej një kuti shahu, me gurët gati, por nuk luante kush. Mandej, ndoshta tridhjetë sekonda më vonë, ndodhi diçka. Muzika që jepej në tele-ekran ndryshoi njëkohësisht melodinë dhe tonin. Diçka po ndodhte – diçka e vështirë të përshkruhej e

cila u shoqërua me një ulëritje të veçantë, të ashpër dhe shpotitëse që, në mendjen e tij, Uinstoni e quante ton i verdhë. Dhe një zë që ia nisi këngës:

Ndën gështenjën degëgjerë
Ti shite mua unë shita ty:
Ne prehemi këtu, ata aty
Ndën gështenjën degëgjerë.

Ata nuk lëvizën qerpik. Megjithatë, kur Uinstoni e pa sërish fytyrën e rrënuar të Radhërfordit, pikasi sytë e mbushur me lotë. Për herë të parë, shoqëruar nga një dridhmë e brendshme, pa e kuptuar pse u drodh, vuri re që Arosoni dhe Radhërfordi kishin hundë të shtypur.

Nuk kaloi shumë kohë dhe ata u arrestuan. Me sa u mor vesh, ishin përfshirë sërish në punë armiqësore qysh prej momentit të lirimit. Krahas një zinxhiri krimesh të reja, në gjyqin e dytë pranuan nga e para gjithë krimet e vjetra. Ata u ekzekutuan dhe si paralajmërim për pasardhësit emrat e tyre u futën në historinë e Partisë. Afërsisht pesë vjet më vonë, në 1973-in, Uinstoni po çmbështillte një tufë dokumentash të cilat sapo i kishte sjellë mbi tavolinë tubi pneumatik, kur mori një copë gazetë e cila dukej që ishte futur mes të tjerave dhe pastaj ishte harruar. E kuptoi rëndësinë e saj qysh në çastin që e hapi. Ishte një gjysmë faqe e ngrisur nga gazeta *Times*, rreth dhjetë vite të shkuara – gjysma e sipërme e gazetës, me datën në të – e cila kishte fotografinë e një delegacioni me disa funksionarë të Partisë të cilët ndodheshin në Nju Jork. Në mes të grupit binin në sy Xhoni, Arosoni dhe Radhërfordi. S'kishte asnjë mundësi të gaboheshe, emrat e tyre ishin shkruar në diçiturën shoqëruese.

Çështja ishte se ata e kishin pranuar vetë, në të dy gjyqet, që në atë datë kishin qenë në Euroazi. Nga një aeroport sekret në Kanada kishin fluturuar drejt Siberisë për t'u takuar me zyrtarë të lartë të Euroazisë të cilëve u kishin dhënë informacione të rëndësishme ushtarake. Data ishte ngulitur në kujtesën e Uinstonit sepse rastisi me solsticin e verës; sidoqoftë, ngjarja e

plotë duhet të ishte regjistruar edhe në shumë vende të tjera. Pra, kishte veç një konkluzion: krimet e pranuara kishin qenë gënjeshtra.

Natyrisht, ky nuk ishte ndonjë zbulim. Uinstoni nuk kishte besuar qysh atëkohë që njerëzit e zhdukur gjatë spastrimeve të mëdha i kishin bërë vërtet krimet për të cilat akuzoheshin. Vetëm se kjo ishte dëshmi konkrete, një fragment nga e shkuara e nxjerrë jashtë ligjit, si fosilet e gabuara që shfaqen në vendin e papërshtatshëm dhe prishin një teori gjeologjike të tërë. Në qoftë se një ditë ajo foto botohej dhe i bëhej e njohur botës, kjo mund ta hidhte Partinë në erë.

Ai i qe kthyer menjëherë punës. Menjëherë sa kishte parë foton, dhe pasi kuptoi domethënien e saj, e kishte mbuluar rrëmbimthi me një fletë formati. Fatmirësisht, kur e kishte çmbështjellë, gazeta kishte qenë kokëposhtë po ta shikoje nga tele-ekrani.

Shtyu karrigen mbrapa dhe vendosi bllokun e shënimeve mbi gju, me qëllim të largohej prej tele-ekranit sa më tepër të qe e mundur. Nuk ishte e vështirë ta mbaje fytyrën të palëvizshme, madje, me përpjekje, edhe frymëmarrja mund të kontrollohej, por të bëje zap rrahjet e zemrës ishte e pamundur dhe tele-ekrani ishte aq i ndjeshëm sa mund ta pikaste edhe këtë gjë. Për njëfarë kohe, që atij iu duk se zgjati dhjetë minuta, nuk bëri asgjë, ishte përfshirë nga paniku mos ndodhte ndonjë e papritur – për shembull, mos kalonte ndonjë valë ajri sipër tavolinës – e cila do ta tradhtonte. Mandej, sërish pa e zbuluar, e futi fotografinë në vrimën e kujtesës së bashku me ca letra të tjera. Brenda një minute duhet të ishte kthyer në hi.

Kjo kishte ndodhur dhjetë-njëmbëdhjetë vite të shkuara. Ndërsa sot mund ta kishte mbajtur atë fotografi. Çudia ishte se fakti që e kishte prekur me dorë atë foto, i dukej sikur edhe tani përbënte një ndryshim, kur në fakt, edhe fotua edhe vetë ngjarja ishin thjesht një kujtim. Mos vallë, u çudit, për shkak të një dëshmie të vogël që nuk ekzistonte më, por që *kishte* ekzistuar *dikur*, kontrolli i Partisë mbi të shkuarën ishte dobësuar?

Por, edhe sikur fotografia të sillej sërish në jetë, në ditët e sotme ajo mund të mos përdorej dot as si dëshmi. Asokohe,

në kohën që ai bëri zbulimin, Oqeania nuk ishte më në luftë me Euroazinë, prandaj do të duhej që agjentët me të cilët kishin bashkëpunuar tre të vrarët të ishin agjentë të Azisë Lindore. Qysh atëherë qenë shtuar akuza të tjera – një, dy, tre, nuk i kujtohej sa. Ishte shumë e mundshme që rrëfimet e tyre të ishin shkruar e rishkruar derisa faktet dhe datat origjinale ta kishin humbur krejt domethënien e tyre. E shkuara nuk ndryshonte, ajo ishte në ndryshim të përhershëm. Ajo çfarë atij i qe kthyer në një ëndërr të keqe ishte fakti që pse duhej shpikur gjithë ky mashtrim. Përparësitë fillestare për falsifikimin e së shkuarës ishin të dukshme, por motivi përfundimtar mbetej mister. Mori penën dhe shkroi sërish:

E kuptoj SI: nuk kuptoj PSE

Pyeti veten, ashtu si e kishte pyetur shumë herë të tjera, se mos ishte gjë i çmendur. Ndoshta kishte vetëm një të çmendur. Dikur quhej çmenduri të besoje që toka rrotullohej rreth diellit, ndërsa sot të besosh që e shkuara është e pandryshueshme. Ai mund të ishte i *vetmi* që mendonte kështu, dhe në qoftë se kjo ishte e vërtetë, atëherë ishte i çmendur. Por mendimi se mund të ishte i çmendur nuk e shqetësoi, ajo çfarë i kallte datën ishte fakti që mund të ishte gabim.

Mori në dorë tekstin e historisë për fëmijë dhe kundroi fotografinë e Vëllait të Madh në faqe të parë. Sytë hipnotizues e vështruan në sy. Ishte njëlloj si të të shtypte një forcë vigane – diçka që të futej poshtë kafkës – të përplasej pas trurit, të kallte datën për mendimet e tua, në përpjekje për të të bindur të mohoje faktet që ofronin shqisat. Një ditë Partia do të thoshte se dy edhe dy bëjnë pesë dhe ti do të ishe i detyruar ta besoje. Herët apo vonë një pretendim i tillë do të ishte i pashmangshëm, kjo ishte logjika e logjikës së tyre. Në mënyrë të heshtur, kjo filozofi mohonte jo vetëm përvojën e vlefshme, por edhe ekzistencën e realitetit të jashtëm. Herezia e herezive ishte mendimi i shëndoshë. Fakti që mund të të vrisnin vetëm pse mendoje ndryshe nuk ishte aq i frikshëm sa dyshimi që Partia mund të kishte të drejtë. Tek e

fundit, nga e dimë ne që dy edhe dy bëjnë katër? Ose: që forca e gravitetit eksiston? Apo, që e shkuara është e pandryshueshme? Çfarë mund të thuhet në qoftë se e shkuara dhe realiteti përreth ekzistojnë vetëm në mendje, ndërkohë që mendja mund të jetë e kontrollueshme?

Jo! Kurajua e tij zvetënohej pa dashje. Pa ndonjë lidhje të dukshme, mendimet ia pushtonte fytyra e O'Brajënit. E dinte, ishte më i sigurt se kurrë, që O'Brajëni ishte në anën e tij. Ditarin e shkruante për O'Brajënin – *për* O'Brajënin, ishte si një letër e fshehtë që nuk do ta lexonte kush, por që i drejtohej një personi të caktuar dhe ky ishte fakti që i diktonte formën.

Partia thoshte që duhej flakur çdo dëshmi e syve dhe veshëve. Urdhëri më i epërm dhe përfundimtar i saj. Kur mendoi për një fuqi vigane të drejtuar kundër tij, me të cilën mund ta mposhtte në debat çdo intelektual i Partisë dhe për argumentet mendjeholla që ai as nuk do t'i kuptonte pa le t'u kundërvihej, e lanë fuqitë. Megjithatë kishte të drejtë! Partia ishte gabim dhe ai kishte të drejtë. E dukshmja, e pafajshmja dhe e vërteta duhet të mbroheshin. Klishetë janë të vërteta, mos e harroni! Bota konkrete ekziston, ligjet e saj nuk ndryshojnë. Gurët janë të fortë, uji është i lëngët, objektet e lira bien drejt qendrës së tokës. Me parandjenjën se po i shkruante O'Brajënit dhe i bindur që po krijonte një aksiomë, shkroi:

Liri është liria të thuash që dy edhe dy bëjnë katër. Kur kjo merret e mirëqenë, të tjerat e ndjekin.

VIII

Aroma e kafes së pjekur – kafe e vërtetë, jo Kafe Fitorja – erdhi prej diku nga fundi i korridorit dhe vërshoi në rrugë. Uinstoni ndaloi në mënyrë të pavullnetshme. Pas dy sekondash u rikthye sërish në botën e fëmijërisë së tij gjysmë të harruar. Pastaj kërciti një derë e cila e ndërpreu aromën sikur të kishte qenë tingull.

Kishte përshkruar disa kilometra trotuar dhe plaga në këmbë rrihte me rrëmbim. Kjo ishte hera e dytë në tri javë që nuk shkonte në Vatrën e Kulturës dhe ky ishte një veprim mendjelehtësie, sepse dihej që në Vatër verifikohej me kujdes pjesëmarrja e gjithsecilit. Në parim, një anëtar Partie nuk kishte kohë të lirë dhe nuk rrinte kurrë vetëm, me përjashtim të kohës kur ishte në krevat. Në qoftë se nuk ishte duke punuar, duke ngrënë apo në gjumë, hamendësohej ta merrte pjesë në ndonjë lloj argëtimi të përbashkët; të bënte diçka që kumtonte dëshirë për vetmi, qoftë edhe një shëtitje vetëm, ishte një rrezik i përhershëm. Gjuha e Re kishte fjalën e vet për këtë dukuri: *jetëntënde*, që nënkuptonte individualitet dhe eksentrizëm. Por atë mbrëmje, ndërsa doli nga Ministria, Uinstonin e kishte joshur butësia e freskut të prillit. Qielli kishte marrë një ngjyrë blu të ngrohtë që s'ishte parë gjatë gjithë vitit, dhe krejt papritur, mbrëmja e zhurshme dhe e pafund në Vatër, lojërat, leksionet e mërzitshme dhe rraskapitëse, shoqëria e shtirur vajisur me xhin, i dukeshin të padurueshme. U largua nga stacioni i autobusit në mënyrë instiktive dhe brodhi nëpër labirintet e Londrës, së pari drejt jugut, pastaj në drejtim të lindjes, u kthye drejt veriut,

duke u harruar nëpër rrugë të panjohura pa e vrarë mendjen për drejtimin që merrte.

"Në qoftë se shpresa ekziston – kishte shkruar në ditar - ajo gjendet tek prolet." Këto fjalë, deklarim e një të vërtete mistike dhe një absurditeti të qartë, vazhdonin t'i ktheheshin në mendje. Ndodhej diku në periferitë ngjyrë kafe e të ngatërruara të veriut dhe të lindjes, në vendin që dikur quhej stacioni i Shën Pankrasit. Ecte përgjatë një rruge me kalldrëm, me dyer të mballosura të cilat binin drejt e në trotuar dhe nuk ndryshonin shumë nga vrimat e minjve. Aty-këtu në kalldrëm kishte pellgje me ujë të qelbur. Nga dyert e errëta dhe rrugicat e ngushta që degëzoheshin në të dyja e anët e rrugës, njerëzit vërshonin në trumba të mahnitshme – vajza në lulëzim të plotë, me buzë të lyera pa shije, djelmosha që ndiqnin vajzat, gra mufka me ecje patash që rrëfenin sesi do të bëheshin vajzat pas njëzet vjetësh, krijesa të moshuara e të kërrusura që shtyheshin të çapëlyera, dhe fëmijë të leckosur e këmbëzbathur që luanin në pellgje, të cilët shpërhapeshin nga klithmat e zemëruara të nënave. Afërsisht një e katërta e xhamave të dritareve me pamje nga rruga ishin të mballosur me dërrasa. Shumica e njerëzve nuk i kushtuan vëmendje; një pakicë e kqyrën me kuriozitet të rezervuar. Dy gra të shëndosha, me krahët të kryqëzuar mbi futë, llafoseshin tek pragu. Ndërsa u afrua, Uinstoni kapi copëza të bisedës:

- Po moj, i thashë, ke të drejtë. Por, po të kishe qenë në vendin tim, do kishe bërë të njëjtën gjë. Të kritikosh është e thjeshtë, ti nuk ke problemet e mia.

- Ah, - tha tjetra, - kjo është e gjitha. Ashtu duhet.

Zërat e çjerrë pushuan njëherësh. Ndërsa Uinstoni kaloi, gratë e kqyrën me një heshtje armiqësore. Megjithëse nuk bëhej fjalë për armiqësi sade, por njëfarë ngurimi i thjeshtë, një mpirje e çastit, sikur t'u kishte kaluar pranë një kafshë e panjohur. Njërëzit e veshur me kominoshet blu të Partisë nuk t'i kapte syri shpesh në kësi rrugësh. Vetëm një anëtar mendjelehtë mund të merrte guximin të shkonte në vende të tilla pa ndonjë arsye pune. Në rast se të shikonin patrullat kishin të drejtë të të ndalonin. "A mund të shikojmë pak dokumentat, shok. Çfarë bëni këtu? Kjo është

rruga juaj e përditshme për në shtëpi?" – e kështu me radhë. Nuk kishte ndonjë ligj që të ndalonte të shkoje në shtëpi nga një rrugë jo e zakonshme, por, nëse Policia e Mendimit e merrte vesh, kjo mjaftonte t'i tërhiqte vëmendjen.

Befas rrugën e përfshiu rrëmuja. Nga të gjitha anët vinin thirrje paralajmëruese. Njerëzit u lëshuan drejt dyerve si lepuj. Një vajzë doli nga një derë pak para Uinstonit, rrëmbeu një fëmijë që luante në një pellg, i hodhi futën krahëve dhe u kthye sërish në shtëpi, gjithçka u bë me një frymë. Në të njëjtën kohë, një burrë i veshur me kostum të zi si për koncert, i cili doli nga një rrugicë, vrapoi drejt Uinstonit duke ia bërë me gisht nga qielli:

- Avullorja, - bërtiti. – Kujdes, shef! Bum nga qielli! Shtrihu, shpejt!

"Avullorja" ishte emri me të cilin, për kushedi ç'arsye, prolet thërrisnin raketat. Në përgjithësi, kur bënin paralajmërime të tilla, prolet ishin të saktë. Dukej sikur ata kishin një lloj instikti që i paralajmëronte disa sekonda para se të binin raketat, megjithëse mendohet që raketat udhëtojnë më shpejt se zëri. Uinstoni mbuloi kokën me duar. Një gjëmim e bëri trotuarin të dridhej, një shi sendesh të lehta i kërcitën mbi shpinë. Kur u ngrit në këmbë pa që ishte mbuluar me copa nga xhamat e dritares më të afërt.

Vazhdoi rrugën. Raketa kishte shkatërruar një grup shtëpish 200 metra më tutje. Një re e zezë tymi varej në qiell, ndërsa poshtë saj, rrotull gërmadhave, ngrihej një shtëllungë me pluhur suvaje e shkaktuar nga turma. Në trotuar, pak përpara tij ishte një tog me copa suvaje, në mes të togut një vijë e kuqe e çelur. Kur u ngrit pa një dorë njeriu të prerë në kyç. Me përjashtim të pjesës së përgjakur, pjesa tjetër e dorës ishte zbardhur tej mase, sikur donte t'u ngjante hedhurinave të suvasë.

E shkelmoi krahun drejt kanalit dhe mandej, që t'i shmangej turmës, mori një rrugë dytësore djathtas. Pas tre ose katër minutash u gjend jashtë zonës së goditur nga raketa, aty jeta gumëzhitëse e rrugëve të pista vazhdonte sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ishte afërsisht ora tetë e mbrëmjes dhe pijetoret e proleve (që quheshin *pub*-e) ishin citë më citë me klientë. Nga dyert e nxirosura që hidheshin valle, hapu

e mbyllu papushim, vinte një erë urine, tallazhi dhe birre të thartë. Në një kënd, të formuar nga ballina e një shtëpie pak më të dalë, pa tre burra kokë më kokë, ai që rrinte në mes mbante një gazetë të palosur të cilën dy të tjerët e këqyrnin që sipër supeve të tij. Edhe pse jo aq afër sa t'u lexonte shprehjen në fytyra, Uinstoni e dallonte që ajo çfarë lexonin i kishte përpirë. Patjetër që duhet të bëhej fjalë për ndonjë lajm me rëndësi. Kur mbërriti veç pak hapa larg tyre, grupi u shpërbë dhe dy prej burrave nisën të grindeshin. Për një çast iu duk sikur ata ishin gati të qëlloheshin.

- A nuk më dëgjon ç'dreqin të them? Ka katërmbëdhjetë muaj që s'ka fituar asnjë numër që mbaron me shtatë!

- Po, ka fituar!

- Jo, s'ka fituar! Unë i kam gjithë numrat të shënuar në një copë letër në shtëpi. S'kam lajthitur numër. Dëgjomë, asnjë numër që mbaron...

- Po, një shtatë ka fituar! Jam gati të ta them atë mut numri. Mbaronte me 407 dhe ishte shkurt – java e dytë e shkurtit.

- Shkurti i sat ëme! Unë e kam shkruar të bardhë mbi të zezë. Dhe të garantoj që s'ka fituar asnjë numër me shtatë...

- Oh, mjaft tani – tha burri i tretë.

Bisedonin për llotarinë. Kur u largua nja tridhjetë metra, Uinstoni ktheu kokën. Ata vazhdonin të diskutonin gjithë pasion. Me një shifër të përjavshme marramendëse, llotaria ishte e vetmja ngjarje publike që tërhiqte vëmendjen e proleve. Prolet për të cilët llotaria ishte parimi, në mos motivi, i vetëm për të jetuar, mund të ishin miliona. Kënaqësia, marrëzia, qetësuesi, nxitësi i tyre intelektual. Kur vinte puna për llotarinë, edhe njerëz analfabetë shfaqnin aftësi të mahnitshme për të bërë llogari të vështira dhe një kujtesë të habitshme. Ekzistonte një tribë e tërë njerëzish që e nxirrnin bukën duke shitur kombinime, parashikime dhe hajmali me fat. Uinstoni nuk kishte të bënte me llotarinë e cila organizohej nga Ministria e Bollëkut, por e dinte (në fakt, të gjithë anëtarët e Partisë e dinin) që në të shumtën e rasteve çmimet ishin të simuluara. Jepeshin vetëm shuma të vogla, ndërsa çmimet e mëdha i merrnin persona që

nuk ekzistonin. Duke mos patur komunikim të brendshëm midis pjesëve të veçanta të Oqeanisë, nuk ishte e vështirë që këto gjëra të stiseshin.

Në qoftë se shpresa ekzistonte, ajo gjendej tek prolet. Kjo nuk duhet shqitur nga mendja. Kur e thoshje me fjalë dukej e arsyeshme, por vetëm kur shikoje krijesat njerëzore që të kalonin pranë në trotuar, ajo kthehej në akt besimi. Rruga ku ai u kthye merrte tatëposhtë. Pati ndjesinë që kishte qenë në këtë lagje edhe më parë dhe që diku, jo shumë larg, gjendej një rrugë kryesore. Nga diku më tutje, u dëgjua një potere. Rruga pësonte një kthesë të fortë dhe mbaronte me shkallë të cilat prinin drejt një rrugice ku shiteshin perime të vyshkura në tezga. Atë çast Uinstonit i ra ndërmend se ku ndodhej. Rrrugica të nxirrte në rrugën kryesore dhe në kthesën tjetër, jo më larg se pesë minuta, ndodhej dyqani i vjeturinave ku kishte blerë bllokun në të cilin tashmë mbante ditarin. Ndërsa në një dyqan kancelarish pak më poshtë, kishte blerë bishtin e penës dhe shishen me bojë.

Në krye të shkallëve u mbush me frymë. Përballë ndodhej një birrari e vogël dhe e zymtë dritaret e së cilës dukeshin të mbuluara nga bryma; në fakt, qenë të veshura me pluhur. Një plak i kërrusur por energjik, me mustaqe të bardha e të kreshpëruara si karkalec deti, shtyu derën që kolovitej dhe hyri brenda. Ndërsa Uinstoni e këqyrte, mendoi se plaku, që së paku qe tetëdhjetë vjeç, duhet të kishte qenë mesoburrë gjatë kohës së revolucionit. Ai dhe pak të tjerë si puna e tij ishin lidhja e fundit që ekzistonte me botën e përmbysur të kapitalizmit. Në Parti nuk kishin mbetur shumë vetë idetë e të cilëve ishin formuar para Revolucionit. Brezi i vjetër ishte zhdukur pothuajse krejt në spastrimet e mëdha të viteve pesëdhjetë e gjashtëdhjetë, ndërsa ata pak që mbetën kishin kohë që ishin trembur dhe dorëzuar intelektualisht. Në qoftë se kishte ndonjë person që mund të të bënte një pasqyrë reale të jetës së fillimshekullit, ai gjendej midis proleve. Uinstoni solli sërish në mendje fragmentin e lexuar në tektin e historisë dhe befas e kapi një krizë marrëzie. Do të shkonte në birrari, do të njihej me plakun dhe do ta pyeste. Do t'i thoshte: "Më trego për jetën gjatë fëmijërisë tënde. Si ishin gjërat asokohe? Më mirë apo më keq se sot?"

Duke mos i lënë vetes kohë të pendohej nga frika, zbriti shkallët me nxitim dhe kaloi në anën tjetër të rrugicës së ngushtë. Si përherë, nuk kishte ndonjë ligj që të ndalonte të frekuentoje birraritë e proleve, por rrallë ndodhte të shkoje pa rënë në sy. Në qoftë se shfaqej patrulla, mendoi të shtirej sikur i kishte rënë të fikët, megjithëse ishte e vështirë që ata ta hanin atë kokërr ulliri. Shtyu derën dhe era e rëndë e birrës së thartë i shpoi hundët. Ndërsa hyri, poteria në sallë u ul në gjysmë volumi. Në shpinë ndjeu sytë e të pranishmëve mbi kominoshet e tij. Loja me shigjeta që zhvillohej në fund të sallës u ndërpre brenda tridhjetë sekondash. Plaku që ai kishte ndjekur rrinte tek banaku, po fjalosej me banakierin, një djalosh i bëshëm, i fuqishëm, hundëshkabë dhe llërë gjigantë. Një rreth njerëzish që rrinin në këmbë me gotat në duar, ndiqnin debatin.

- Unë të pyeta si njeri, apo jo? – tha plaku duke drejtuar supet gati për të qëlluar. – Ndërsa ti më thua se në gjithë këtë pijetore të shkërdhyer nuk mund të gjendet një pintë[1]?

- Çfarë dreqin quan pintë ti? – tha banakieri duke u përkulur përpara, me majat e gishtave mbështetur sipër banakut.

- Shikojeni! E quan veten banakier dhe nuk di se çfarë është pinta. Pinta është gjysma e një quarti[2] dhe katër quarte bëjnë një gallon[3]. M'u dashka të të mësoj edhe abc-në tani.

- Hera e parë që i dëgjoj, - tha banakieri shkurt. – Ne shërbejmë vetëm gota litërshe dhe gjysmë litërshe. Gotat janë në raftin përballë teje.

- Mua më pëlqen pinta, - këmbënguli plaku. – S'më heq dot qafe aq lehtë. Kur qeshë i ri s'kishte nga këto mut litrash.

- Kur ke qenë ti i ri njerëzit jetonin nëpër pemë, - tha banakieri dhe hodhi sytë nga klientët e tjerë.

Sallën e përfshiu një e qeshur që e largoi disi ndrydhjen e shkaktuar nga ardhja e Uinstonit. Fytyra e bardhë mjekërshkurtër e plakut mori ngjyrë rozë. Ndërsa u largua duke folur nëpër dhëmbë, u ndesh me Uinstonin. Uinstoni e kapi lehtë nga krahu.

---

1 - njësi matëse = 0,568 litra.
2 - njësi matëse = 1, 14 litra.
3 - njësi matëse = 4,56 litra.

- Mund të të ofroj diçka për të pirë? – e pyeti.

- Ti je zotëri i vërtetë, - tha plaku, duke drejtuar sërish supet. Dukej që s'i kishte vënë re kominoshet e Uinstonit. – Pintë! – i bërtiti banakierit. – Një pintë birrë.

Banakieri hodhi një birrë ngjyrë kafe në dy gota të trasha gjysmëlitërshe të cilat i kishte shpëlarë poshtë banakut. Birra ishte e vetmja pije që gjeje në lokalet e proleve. Mendohej që ata nuk pinin xhin, megjithëse mund ta shtinin lehtë në dorë. Loja me shigjeta kishte nisur sërish, ndërsa grupi rreth banakut bisedonte për biletat e llotarisë. Për një çast prania e Uinstonit u harrua. Poshtë dritares ishte një tavolinë prej druri ku ai dhe plaku mund të kuvendonin pa frikën se mund t'i dëgjonte kush. Rreziku ishte tejet i madh, por në sallë nuk kishte tele-ekran, një detaj për të cilin ai u kujdes ta verifikonte qysh kur hyri.

- Duhet të më kishte dhënë pintë, - tha plaku, ndërsa u ul pranë gotës. – Gjysmë litër nuk mjafton. S'më kënaq. Ndërsa një litër është shumë. Më nguc fshikëzën e urinës. E pastaj çmimi.

- Duhet të kesh parë shumë ndryshime qysh nga koha e djalërisë, - tha Uinstoni me qëllim.

Plaku i kaloi sytë ngjyrë blu të hapur nga tabela e shigjetave tek banaku dhe nga banaku tek dera e banjës së burrave, sikur ndryshimet për të cilat pyeste Uinstoni të kishin ndodhur në birrari.

- Birra ishte më e mirë, - tha më në fund plaku. – Dhe më e lirë! Kur qeshë i ri, birra e butë – që e thërrisnim *frushkullim* – ishte katër pensë një pintë. Natyrisht, përpara luftës.

- Cila luftë? – tha Uinstoni.

- Gjithë luftërat, - tha plaku i paqartë. – Ngriti gotën dhe drejtoi trupin sërish. – Për shëndetin tënd!

Molla majëprehtë e Adamit, lëvizi poshtë e lart me shpejtësi në grykën e dobët të plakut dhe birra u zhduk. Uinstoni shkoi tek banaku dhe u kthye me dy gjysmëlitërshe të tjera. Plaku dukej se nuk e çante më kokën për fshikëzën e urinës.

- Ti je shumë më i moshuar se unë, - tha Uinstoni. – Duhet të kesh qenë goxha në moshë qysh para se të lindja unë. Besoj që e mban mend jetën e asaj kohe, para Revolucionit. Moshatarët e mi nuk dinë asgjë nga ajo periudhë. Ne mund të lexojmë për atë

kohë në libra, por çfarë thuhet në libra mund të mos jetë e vërtetë. Më pëlqen të dëgjoj mendimin tënd. Librat e historisë thonë se jeta para Revolucionit ishte krejt ndryshe nga jeta e ditëve tona. Asokohe ekzistonte shtypja, padrejtësia dhe varfëria më e madhe – diçka përtej imagjinatës. Londinezët lindnin dhe vdisnin pa e mbushur kurrë barkun me bukë. Gjysma e tyre nuk kishin as këpucë. Punonin dymbëdhjetë orë në ditë, braktisnin shkollën qysh nëntë vjeç, flinin nga dhjetë veta në dhomë. Ndërkohë që kishte një pakicë, veç disa mijëra – kapitalistë, quheshin – që ishin të pasur dhe me pushtet. Pronarë të gjithçkaje që mund të pronësohej. Jetonin në vila luksoze, kishin nga tridhjetë shërbëtorë, lëviznin në makina ose karroca me katër kuaj, pinin shampanjë, mbanin kapele cilindrike...

Befas plaku u çel në fytyrë.

- Kapele cilindrike! – tha. – E çuditshme që i përmende. Nuk e di pse, por edhe unë i kujtova dje. Ka vite që s'kam parë kapele cilindrike, thashë me vete. Kanë humbur fare. Hera e fundit që kam përdorur kapele të tillë ka qenë funerali i kunatës. Dhe kjo ndodhi – ë, nuk mund të them datën e saktë, por, ma ha mendja, nja pesëdhjetë vjetë më parë. Natyrisht, e kisha marrë me qera për atë rast, të kuptohemi.

- Nuk e kam fjalën vetëm tek kapelet, - tha Uinstoni. - Çështja është që këta kapitalistët – si dhe avokatët e priftërinjtë që ata mbanin me para – ishin të zotët e vendit. Gjithçka ishte në shërbim të tyre. Ju – njerëzit e thjeshtë, punëtorët – qetë skllevër. Ata mund të bënin me ju çfarë të donin. Mund t'ju degdisnin në Kanada me traget si dele. Mund të flinin me bijat tuaja po t'u shkrepte në kokë. Mund të urdhëronin që ju të fshikulloheshit me kamxhik. Kur i ndeshnit në rrugë duhet të hiqnit kapelen. Çdo kapitalist bridhte me një bandë lakejsh që...

Plaku u çel sërish.

- Lakej! – tha. – Ja një fjalë tjetër që s'mbahet mend kur e kam dëgjuar për herë të fundit. Lakej! Oh, kjo më çon në ato vite. Më kujtohet – oh, vite e vite të shkuara – dilja ndonjëherë të dielave mbasdite nga Hajd Parku të dëgjoja fjalimet e çunave. Armata e Shpëtimit, katolikë, çifutë, indianë – nga të gjitha llojet.

Por njëri prej tyre – emri s'më kujtohet, e kishte gjuhën brisk. S'të falte! "Lakej," thoshte, "lakej të borgjezisë! Shërbëtorë të klasës sunduese!" Parazitë – kjo është një fjalë tjetër që përdori ai. Hiena – s'ka dyshim që i quajti hiena. Natyrisht që e kishte fjalën për Partinë Laburiste, më kupton.

Uinstoni pati përshtypjen se po flisnin për gjëra krejt të kundërta.

- Ajo që doja të dija ishte kjo, - tha. – Mendon që sot je më i lirë se në ato kohëra? Trajtohesh më mirë si qenie njerëzore? Në të shkuarën, njerëzit e pasur, ata në krye...

- Dhoma e Lordëve, - ndërhyri plaku sikur iu kujtua diçka.

- Dakord, Dhoma e Lordëve. Por pyetja ishte: A u shihnin me përbuzje këta njerëz vetëm pse ata qenë të pasur dhe ju të varfër? Është e vërtetë, për shembull, që ju duhet t'i thërrisnit "zotëri" dhe të hiqnit kapelen kur ju kalonin pranë?

Plaku dukej i zhytur në mendime. Para se të përgjigjej rrëkelleu gati një të katërtën e gotës.

- Po, - tha. – U pëlqente të prekje kapelen. Tregonte respekt. Unë vetë s'qeshë dakord, por e kam bërë shumë herë. Siç thuhet, qeshë i detyruar.

- Ndodhte shpesh – vetëm po citoj atë që kam lexuar në tekstin e historisë – ndodhte shpesh që këta njerëz dhe shërbëtorët e tyre ju shtynin nga trotuari në kanal?

- Një herë më shtynë edhe mua, - tha plaku. – Më kujtohet si të ketë ndodhur dje. Ishte nata e Garave me Varka – natën e Garave me Varka njerëzit bëheshin çakmaqe – dhe ndodhi që u ndesha me një djalosh në shëtitoren Sheiftsbëri. Alamet zotnie ishte – këmishë me papijon, kapele cilindrike, pallto të zezë. Ecte me zigzage në trotuar dhe u përplasëm si padashje. "Ku i ke sytë?" më tha. Unë thashë: "Mos kujton se e ke tëndin këtë trotuar të shkërdhyer?" Ai tha: "Mos e kruaj me mua se ta përdredh qafën." Unë ia prita: "Ti je tapë. Gjysmë minuti më duhet të të hekuros." Dhe ke parë ti, më hodhi duart në gjoks, më shtyu dhe desh më flaku në rrota të autobusit. Eh, asokohe qeshë i ri, u bëra gati t'ia rrasja, vetëm se...

Uinstoni u ndie i pafuqishëm. Kujtesa e plakut ishte veç një kapicë vogëlsirash. Mund ta pyesje gjithë ditën e s'merrje vesh

asnjëlloj informacioni të saktë. Ndoshta historitë e Partisë qenë të vërteta, madje mund të ishin tërësisht të tilla. Uinstoni bëri përpjekjen e fundit.

- Ndoshta nuk u shpreha qartë, - tha. – Ajo çfarë doja të thoja është: ti je gjallë prej një kohe të gjatë, gjysmën e jetës e ke jetuar para Revolucionit. Në 1925-ën, për shembull, ke qenë goxha i rritur. Me sa mban mend, a mund të thuash që jeta në 1925-ën ishte më e mirë nga sot, ose më e keqe? Po të të jepej mundësia, do zgjidhje të shkuarën apo të tashmen?

Plaku kundroi dërrasën e ku nguleshin shigjetat. Ktheu birrën me fund, por kësaj radhe më ngadalë. Foli më shtruar dhe me një hije filozofi, sikur birra ta kishte zbutur.

- E kuptoj ç'pret të them, - tha. – Pret të them se më pëlqen të rinohem. Po t'i pyesësh, shumica e njerëzve do të pranonin të ishin të rinj përsëri. Kur je i ri je i shëndetshëm e i fortë. Në moshën time diç do dhembë. Me këmbët kam një problem të çuditshëm dhe fshikëza e urinës është e tmerrshme. Gjashtë shtatë herë në natë më çon nga shtrati. Nga ana tjetër, edhe pleqëria ka të mirat e saj. Nuk ke më të njëjtat shqetësime. S'ke punë me femrat, një e mirë që s'ka të paguar. Në më bëson, s'kam prekur grua për gati tridhjetë vjet. E për më tepër, s'kam patur dëshirë.

Uinstoni u mbështet pas pezulit të dritares. S'ia vlente të vazhdonte. Po bëhej gati të shkonte për të marrë birrat e tjera kur plaku u ngrit dhe bëri drejt banjës kutërbuese të lokalit. Gjysmëlitërshja e tepërt kishte nisur punën në trupin e tij. Uinstoni kundroi gotën bosh për nja dy minuta dhe as që e kuptoi sesi mundën këmbët ta nxirrnin në rrugë. Pas njëzet vjetësh, mendoi, pyetja e madhe dhe e thjeshtë: "A ishte jeta më e mirë para apo pas Revolucionit?", nuk do të merrte më përgjigje. Madje edhe tani s'kishte kush t'i përgjigjej, përderisa të mbijetuarit e kohëve të vjetra nuk qenë në gjendje të krahasonin dy periudha të ndryshme. Ata mbanin mend një milionë çikërrima të padobishme, një zënkë me shokun e punës, telashet për të gjetur pompën e humbur të biçikletës, shprehjen në fytyrën e motrës së vdekur, shtjellat e pluhurit në një mëngjes me erë shtatëdhjetë vjetë të shkuara, ndërsa gjithë faktet në

lidhje me çështjen kishin mbetur jashtë përfytyrimit të tyre. Ishin katandisur si thnegëlat, të cilat shikojnë vetëm objektet e vogla. E kështu, kur kujtesa të mos punonte më dhe kur dëshmitë e shkruara të falsifikoheshin – kur të ndodhte kjo, pretendimi i Partisë se ajo kishte përmirësuar kushtet e jetës së njeriut do të pranohej, sepse nuk do të ekzistonte, dhe nuk do të ekzistonte kurrë, një standart tjetër me të cilin të krahasohej.

Befas zinxhiri i mendimeve iu këput. Ndaloi dhe ngriti kokën. Ndodhej në një rrugicë me një grusht dyqanesh të vogla shpërndarë aty këtu midis shtëpive. Mu sipër kokës së tij vareshin tre rrumbuj metalikë të pangjyrë që kumtonin se dikur kishin qenë të praruar. Një vend që e njihte. Natyrisht! Ndodhej para dyqanit të vjeturinave ku kishte blerë ditarin.

Një valë frike e përshkoi së brendshmi. Blerja e bllokut kishte qenë një hap i nxituar dhe ishte betuar që të mos kthehej më tek ai vend. E megjithatë, sapo i la këmbët të lira ta çonin ku të donin ato e sollën aty. Kishte shpresuar se duke nisur ditarin do të ruhej nga incidente të tilla vetëvrasëse. Njëkohësisht vuri re që, edhe pse ishte ora nëntë e mbrëmjes, dyqani ishte ende hapur. Hyri me parandjenjën se po të futej brenda do të binte më pak në sy sesa po të vëradollesej jashtë. Në rast se e pyeste kush do të shtirej sikur kërkonte brisqe.

Pronari sapo kishte ndezur një llapë me vajguri që shpërndante një aromë të qelbët, por të tërheqëse. Qe një burrë tek të gjashtëdhjetat, i dobët dhe i kërrusur, me hundë të gjatë dashamirëse dhe sy të butë të shfytyruar nga syzat e trasha. Flokët pothuajse të bardha, ndërsa vetullat të trasha dhe ende të zeza. Syzat, lëvizjet e ngadalta e të kujdesshme, dhe fakti që mbante një xhaketë kadife të lodhur, e mbështillnin me një hije intelektuali, si shkrimtar ose muzikant. Kishte zë të shtruar, sikur shuhej, dhe fliste me theks shumë më afër standartit sesa shumica e proleve.

- Ju njoha qysh në trotuar, - tha ai menjëherë. – Ju jeni zotëria që bleu albumin e një zonjushe. Kishte letër të mrekullueshme. E kremuar, quhej dikur. Ka pesëdhjetë vjet ndoshta, që s'prodhohet më letër e tillë. – Vështroi qysh sipër syzave: - Mund të t'ju ndihmoj

me ndonjë gjë të veçantë? Apo thjesht deshët të hidhnit një sy rrotull.

- Jo, më ra rruga, - tha Uinstoni turbull. – Thjesht hyra. Nuk vështroj për gjësend.

- Akoma më mirë, - tha tjetri, - sepse nuk besoj se do t'jua plotësoja dëshirën. – Bëri një gjest shfajësimi me dorë: – Ju e shikoni si është; bosh, mund të thuhet. Ta themi midis nesh, tregëtia e antikuareve ka marrë fund. S'ka kërkesë, por s'ka as mall. Mobiljet, porcelanet, qelqurinat – janë thyer kohë pas kohe. E natyrisht, gjërat metalike janë shkrirë. Bëhen vite që nuk kam parë një mbajtëse qirinjsh prej tunxhi.

Në fakt, dyqani i vogël ishte përplot sende, por gati të gjitha pa pikën e vlerës. Hapësirat në dysheme ishin shumë të ngushta, sepse rreth e rrotull mureve ishin stivosur korniza fotografish të panumërta të mbuluara nga pluhuri. Në dritare ndodheshin tabaka filxhanësh, bullona, dalta të ndryshkura, biçakë tehthyer, orë të shkalafitura që as nuk shtireshin sikur punonin rregullisht dhe gjithfarë plehurinash. Vetëm mbi një tavolinë në qoshe kishte një kapicë mbetjesh – kuti burnoti të lyera me varak, karfica agate e kësi gjërash – që mund të kishin njëfarë vlere. Ndërsa u çapit drejt tavolinës, Uinstonit i zuri syri një send të rrumbullt, të lëmuar që shkëlqente butë prej dritës së llampës; e mori në duar.

Ishte një poç xhami, sferik në një anë dhe i sheshtë nga tjetra. Të dyja, ngjyra dhe përbërja e xhamit, kishin një butësi të veçantë, si të krijuar prej shiut. Në qendër të tij, e zmadhuar prej sipërfaqeses së sferike, kishte një objekt të përdredhur, të çuditshëm, rozë që të kujtonte një trëndafil apo një taçe.

- Çfarë është kjo? – pyeti Uinstoni i mahnitur.

- Koral, - tha plaku. – Duhet të ketë ardhur nga Oqeani Indian. Ata i ngjitnin në xham. Më i vjetër se njëqind vjetë është. Pamja flet vetë.

- Shumë i bukur, – tha Uinstoni.

- Është vërtet i bukur, - tha tjetri i kënaqur. – Por njerëzit që mund ta thonë këtë janë rralluar. – U kollit. – Në qoftë se ndodh ta bleni, tani do t'ju kushtojë katër dollarë. Më kujtohet se dikur të bleje një mall të tillë duheshin tetë paund – ë, unë s'e bëj

dot llogari, por qenë tërë ato para. Po kush e çan kokën tani për antikuaret – as për këto pak që kanë mbetur.

Uinstoni pagoi katër dollarët rrëmbimthi dhe e futi sendin e lakmuar në xhep. Ajo çfarë e joshi tek ai send, më tepër se bukuria, ishte ideja që i përkiste një periudhe tjetër, shumë të ndryshme nga e sotmja. Xhami ujor i butë nuk ngjante me asnjë nga xhamat që ai kishte parë në jetën e tij. Padobishmëria e pamjes e bënte atë dyfish tërheqës, megjithëse Uinstoni e mori me mend që dikur ai send ishte përdorur si letërmbajtëse. Në xhep rëndonte, por fatmirësisht nuk krijonte mbufatje. Po të gjendej në zotërimin e një anëtari të Partisë konsiderohej send i çuditshëm, pse jo kompromentues. Përherë çdo gjë e vjetër, aq më tepër edhe e bukur, ishte e dyshimtë. Me të marrë katër dollarët, plaku u bë më gazmor. Uinstoni e kuptoi që ai do të kishte pranuar edhe për tre, madje edhe për dy.

- Në katin e dytë ka një dhomë tjetër që mund t'ju interesojë t'i hedhni një sy, - tha. – S'ka shumë gjëra. Fare pak çipurina. Do sjell llampën e vajgurit nëse shkojmë.

Plaku ndezi një tjetër llampë dhe, me shpinën të kërrusur, priu shkallëve të pjerrëta e të vjetra, mandej përmes një kalimi të ngushtë, dolën në një dhomë nga dritaret e së cilës nuk shihej rruga, por një oborr shtruar me kalldrëm dhe një pyll oxhaqesh. Uinstoni vuri re që mobiljet ishin rregulluar sikur parashikohej që aty të jetonte dikush. Në dysheme qe shtruar një rrugore, nja dy foto në mur, dhe një kolltuk të thellë, të lerosur ngjitur me oxhakun. Në buhar tik-takej një orë e vjetër me të dymbëdhjetë numrat në fushë. Poshtë dritares, duke zënë gati çerekun e dhomës, qe një krevat i madh me dyshekun ende në të.

- Këtu jetuam derisa vdiq ime shoqe, - tha plaku me një ndjenjë shfajësimi. – Pak e nga pak, po i shes mobiljet. Ai është një krevat i mrekullueshëm mogani, ose bëhet po t'i shkunden insektet. Por ju paralajmëroj që është pak i rëndë.

Plaku e ngrinte llampën sikur rrekej të ndriçonte gjithë dhomën, dhe çuditërisht vendi dukej ftues në dritën e vakët. Në qoftë se je i gatshëm të marrësh parasysh rrezikun, mendoi Uinstoni fluturimthi, këtë dhomë mund ta shtish në dorë veç për pak dollarë në javë. Ishte një ide fluturake e parealizueshme të cilën

e braktisi po me nxitim, por dhoma e bëri nostalgjik, i zgjoi njëfarë kujtimi stërgjyshor. I dukej sikur e dinte se çfarë do të ndiente po të jetonte në një dhomë si ajo, ulur në kolltukun pranë oxhakut, me thembrat buzë vatrës dhe çajnikun në zjarr, krejt i vetëm, tërësisht i sigurt, pa e vëzhguar askush, pa zëra që ta ndiqnin, pa tingull tjetër veç këngës së çajnikut dhe tik-takeve miqësore të orës.

- Nuk ka tele-ekran! – mërmëriti pa dashje.

- Ah, - bëri plaku, - s'kam patur kurrë kësi sendi. Shumë i shtrenjtë. Në fakt s'më është dashur hiç. Tej në qoshe është një tavolinë e palosshme. Padyshim, në qoftë se do të përdoren krahët duhet ta pajisni me mentesha të reja.

Në qoshen tjetër kishte një raft librash, Uinstoni ishte drejtuar për aty. Në të kishte vetëm mbeturina. Edhe në banesat e proleve, gjurmimi dhe shkatërrimi i librave ishte bërë me të njëjtin përshkushtim si gjithandej. Kishte shumë mundësi që në gjithë Oqeaninë të mos kishte asnjë libër të botuar para vitit 1960. Ende me llampë në dorë, plaku qëndronte para një gravure me kornizë prej trëndafili që varej në anën tjetër të oxhakut, përballë krevatit.

- Shikoni, në qoftë se jeni i interesuar për botime të vjetra... - nisi plaku me delikatesë.

Uinstoni u afrua të shikonte gravurën me kujdes. Një ndërtesë ovale, me dritare kënddrejta dhe një kullë në pjesën e përparme, gdhendur në çelik. Rrotull godinës dridhej një parmak, në anën e pasme kishte diçka të ngjashme me një statujë. Uinstoni e kundroi për disa çaste. Edhe pse statujën nuk e mbante mend, ndërtesa i dukej e njohur.

- Korniza është e mbërthyer në mur, - tha plaku, - por mund ta heq pa problem.

- Atë ndërtesë e mbaj mend, - tha Uinstoni. – Tani është kthyer në gërmadhë. Ndodhet në rrugës për tek Pallati i Drejtësisë.

- E saktë. Afër Gjykatave. U bombardua... oh, shumë vite më parë. Dikur kishte qenë kishë. Kisha e Shën Klement Dejnsit quhej. – Si të qe i ndërgjegjshëm që po thoshte diçka qesharake, plaku qeshi shfajësueshëm dhe shtoi: - Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat e Shën Klementit.

- Çfarë është kjo? – pyeti Uinstoni.

- Oh – "Portokallet dhe limonat, thërrasin kambanat e shën Klementit." Një vjershë që e këndonim të vegjël. S'më kujtohet si vazhdon, por fundin ia mbaj mend. "Po vjen qiriri të të prijë drejt shtrojës, po vjen hanxhari të të heqë kokën." Ishte një lloj kërcimi. Fëmijët shtrinin duart që të kaloje poshtë dhe kur mbërrinin tek vargu "po vjen hanxhari të të heqë kokën", të kapnin nga qafa. Plot me emra kishash ishte. Gjithë kishat e Londrës përmendeshin – më kryesoret, në fakt.

Uinstoni vrau mendjen më kot të gjente se cilit shekull i përkisnin kishat. Të përcaktoje moshën e ndërtesave të Londrës qe e pamundur. Ndërtesat që ishin të bukura, të mëdha dhe disi të reja në dukje, pretendohej që ishin ndërtuar pas Revolucionit, ndërsa ato, vjetërsia e të cilave nuk mund të fshihej, i atribuoheshin një periudhe të vagullt të quajtur Mesjetë. Për periudhën e kapitalizmit thuhej që nuk ishte ndërtuar asgjë me vlerë. Ashtu si librat, edhe artitektura nuk të ndihte për të mësuar historinë. Statujat, mbishkrimet, gurët përkujtimorë, emrat e rrugëve – gjithçka që mund të hidhte dritë mbi të shkuarën ishte ndryshuar.

- Kurrë s'e kam ditur që ka qenë kishë, - tha Uinstoni.

- Faktikisht, ka shumë të tilla, - tha plaku, - megjithëse ua kanë ndryshuar funksionin. Si vazhdonte vjersha? Ah! E gjeta!

Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat
e Shën Klementit,
Më keni borxh tre groshë, thërrasin kambanat
e Shën Martinit...

kjo është gjithë ç'më kujtohet. Një grosh ishte një monedhë e vogël e ngjashme me një cent.

- Ku është kisha e *Shën Martinit*? – pyeti Uinstoni.

- *Shën Martinit*? Nuk është prishur. Tek *Sheshi i Fitores*, përkrah galerisë së fotografisë. Një ndërtesë me një portik trekëndor, kollona ballore dhe ca shkallë të mëdha.

Uinstoni e njihte shumë mirë atë vend. Ishte një muzeum që përdorej për lloje të ndryshme propagandash – modele raketash në

miniaturë, Kështjella Pluskuese, tablo dylli që ilustronin mizoritë e armikut, e kësi gjërash.

- Dikur quhej *Shën Martini në Fushë*, - plotësoi plaku, - megjithëse kurrë s'më ka zënë syri ndonjë fushë asaj ane.

Uinstoni nuk e bleu gravurën. Ajo do të kishte qenë një send edhe më i çuditshëm se letërmbajtsja e xhamit dhe e vështirë të mbartej pa u hequr nga korniza. Por qëndroi edhe disa minuta duke biseduar me plakun, mbiemri i të cilit, siç e zbuloi, nuk ishte Uiks – diçka që mund ta mendoje nëse i referoheshe emrit të lokalit – por Karrington. Zoti Karrington ishte i ve, gjashtëdhjetë e tre vjeç dhe jetonte në atë dyqan qysh prej tridhjetë vjetësh. Përherë kishte dashur ta ndërronte atë emër, por asnjëherë nuk i ishte bërë e mbarë. Gjatë kohës që flisnin Uinstonit nuk i hiqej nga mendja vjersha gjysmake. Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat e Shën Klementit, më keni borxh tre groshë, thërrasin kambanat e Shën Martinit... Ishte e çuditshme, por kur e thoje me vete, kishe ndjesinë se dëgjoje kambana, kambanat e Londrës së përhumbur e cila ende ekzistonte diku, e fshehur dhe e harruar. I dukej se kumbimet e kambanoreve të përhitura i mbërrinin në vesh njëra pas tjetrës. Mirëpo, me sa mbante mend, nuk i kujtohej të kishte dëgjuar kurrë kambana në jetën reale.

U nda nga plaku dhe i zbriti shkallët vetëm, nuk donte që ai ta shikonte tek zgjaste kokën për të kontrolluar rrugën para se të dilte. Dhe ende pa dalë e kishte vendosur që pas një ndërkohe të mjaftueshme – një muaj, të themi – do të rrezikonte për ta vizituar atë dyqan sërish. Ndoshta një veprim i tillë nuk ishte më i rrezikshëm se mungesa atë mbrëmje në Vatrën e Kulturës. Rikthimi pas blerjes së ditarit, pa e ditur në dyqanxhiu ishte njeri i besueshëm apo jo, kishte qenë marrëzi. Megjithatë...!

Po, mendoi sërish, do të kthehej. Do të blinte të tjera mbetje të bukura. Do ta blinte gravurën e Shën Klement Dejnsit, do ta hiqte nga korniza dhe do ta çonte në shtëpi të fshehur poshtë xhaketës. Do ta shkulte nga kujtesa e zotit Karrington pjesën tjetër të poemës. Madje edhe plani çmendurak për të marrë me qera dhomën e katit të dytë i vetëtiu një çast në mendje. Këto pesë sekonda ekzaltuese e bënë të pakujdesshëm dhe zbriti në trotuar

pa e vëzhguar mirë nga dritarja. Madje kishte nisur të mërmëriste një melodi të përatyshme...

Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat
e Shën Klementit,
Më keni borxh tre groshë, thërrasin kë...

Befas i ngriu gjaku dhe i llokoçitën zorrët. Jo më shumë se dhjetë metra larg, në trotuar vinte drejt tij një person me kominoshe. Ishte vajza e Drejtorisë së Trillimit, vajza flokëzezë. Drita ishte e zbehtë, por nuk e pati të vështirë ta njihte. Ajo e vështroi drejt e në fytyrë dhe pastaj eci me të shpejtë sikur nuk e kishte vënë re.

Për disa sekonda Uinstoni u ndie si i paralizuar. Pastaj u kthye djathtas dhe eci me hapa të rëndë, pa e vënë re që mori drejtimin e gabuar. Sidoqoftë, një gjë ishte sqaruar. Nuk kishte më dyshim që vajza e përgjonte. Patjetër që e kishte ndjekur, ishte e pamundur që ta quaje vetëm rastësi kalimin e saj në të njëjtën natë dhe në të njëjtën rrugë të harruar, kilometra të tëra larg nga vendbanimi i anëtarëve të Partisë. Ishte diçka përtej rastësisë. Fakti nëse vajza ishte agjente e Policisë së Mendimit apo spiune amatore e nxitur nga detyra zyrtare, nuk kishte rëndësi. Mjaft që ajo e mbikëqyrte. Ndoshta e kishte parë edhe kur ai kishte hyrë në birrari.

Ecte me vështirësi. Xhunga e xhamit në xhep i përplasej pas kofshës në çdo hap, ndaj u mëdysh, ta flakte apo ta mbante. Më e keqja ishte dhimbja e barkut. Për disa minuta pati ndjesinë se do të vdiste në qoftë se nuk gjente një banjë sa më shpejt. Por në vende të tilla nuk kishte banja publike. Mandej spazma kaloi duke lënë një dhimbje topitëse.

Doli që rrugica ishte pa krye. Uinstoni u ndal, u mendua një çast se çfarë të bënte, mandej u kthye dhe vazhdoi nga kishte ardhur. Kur u kthye u kujtua që me vajzën ishte shkëmbyer veç tre minuta më herët dhe po të vraponte mund ta arrinte. Do ta ndiqte deri sa të mbërrinin në ndonjë vend të qetë e pastaj do t'ia shkallmonte kafkën me gurët e kalldrëmit. Në fakt, edhe

copa e xhamit në xhep do të mjaftonte. Por e braktisi atë mendim menjëherë, edhe mendimi i ushtrimit të dhunës fizike ishte i padurueshëm. Nuk mundej të vraponte, nuk mundej të godiste. Pastaj, ajo ishte e re dhe epshore dhe mund të mbrohej. E shkoi në mend edhe mundësinë që të nxitonte për t'u kthyer në Vatër të Kulturës dhe të qëndronte derisa ajo të mbyllej që të krijonte një alibi për mbrëmjen. Por edhe kjo ishte e pamundur. Kishte rënë në kthetrat e plogështisë. E vetmja gjë që dëshironte ishte të kthehej në shtëpi sa më shpejt, të ulej dhe të rrinte i qetë.

Në shtëpi mbërriti në orën dhjetë e gjysmë. Në njëmëdhjetë e gjysmë do të fikeshin dritat. Shkoi në guzhinë dhe gëlltiti pothuaj një filxhan çaji me xhin Fitorja. Pastaj shkoi tek tavolina afër kamares, u ul dhe nxori bllokun nga sirtari. Nuk e hapi. Në teleekran një vajzë sokëllinte një këngë patriotike. Kundroi një copë herë kapakun e mermertë të bllokut, në përpjekjen e dështuar t'i mbante sokëllimat jashtë vetëdijes së vet.

Ata vinin natën, përherë natën. Ishte më mirë të vrisje veten pa rënë në dorë të tyre. Padyshim që një pjesë kështu bënin. Në fakt, shumica e të zhdukurve bënin vetëvrasje. Por që të vrisje veten në një botë ku armët e zjarrit, ose çdo helm me veprim të shpejtë, nuk shtiheshin lehtë në dorë, kërkohej dëshpërim i thellë. Me një lloj habie solli ndërmend kotësinë biologjike të dhimbjes dhe frikës, tradhtinë e trupit njerëzor që menjëherë ngrin për inerci pikërisht në momentin që duhet një përpjekje e veçantë. Po të qe treguar pak i shkathët, mund t'ia kishte qepur gojën vajzës flokëzezë, por ngaqë një veprim i tillë ishte shumë i rrezikshëm Uinstoni nuk pati kurajo ta bënte realitet dëshirën. U çudit kur mendoi që në çaste krize njeriu nuk lufton kundër ndonjë armiku të jashtëm, por kundër trupit të tij. Madje edhe tani, pavarësisht xhinit, dhimbja topitëse në bark ia bëri vijimin e mendimeve të pamundur. Dhe e njëtja gjë ndodh, mendoi, edhe në situatat heroike apo tragjike. Në fushën e betejës, në qelitë e torturës, në anijen që mbytet, përherë çështjet për të cilat ti lufton harrohen, sepse trupi mbufatet derisa mbush universin, edhe kur nuk je i paralizuar nga frika apo duke bërtitur me dhimbje, lufta është betejë e përhershme

kundër urisë, të ftohtit, pagjumësisë, dhimbjes së stomakut apo therjeve të dhëmbit.

Hapi ditarin. Ishte e rëndësishme që të shënonte diçka. Gruaja në tele-ekran kishte filluar një këngë të re. Zëri i saj i ngjitej në tru si thërrime xhami. U përpoq të përfytyronte O'Brajënin, për të cilin e shkruante ditarin, por mendja i shkonte tek ato çfarë mund t'i ndodhnin kur të binte në duart e Policisë së Mendimit. Kur të vrisnin pa humbur kohë nuk ishte kushedi çfarë. Vdekjen e prisje. Por para se të vdisje (të gjithë i dinin gjëra të tilla, dhe askush nuk i zinte në gojë) duhet të kaloje në procesin e rrëfimit: përpëlitjet në dysheme dhe thirrjet për mëshirë, e krisuara e kockave të thyera, dhëmbët e copëtuar dhe tufat e flokëve të përgjakur. Përse duhet ta përjetoje një gjë të tillë, kur fundi ishte përherë i njëjtë? Përse nuk t'i shkurtonin ca ditë apo javë nga jeta? Asnjë nuk ndodhi të arratisej nga qelitë dhe të gjithë pranonin të rrëfeheshin. Me t'ju dorëzuar krimit mendor, ishe i sigurt që një ditë do të vdisje. Atëherë pse ishte i nevojshëm përjetimi i asaj llahtare e cila nuk ndryshonte asgjë në të ardhmen?

Pas përpjekjesh, ia doli mbanë të formonte një imazh pak më të plotë se më parë për O'Brajënin. "Do të takohemi në një vend pa errësirë," i kishte thënë O'Brajëni. E dinte, ose mendonte se e dinte, ku e kishte fjalën. Vendi pa errësirë ishte e ardhmja imagjinare, e cila nuk mund të shihej, por me anë të largpamësisë, në mënyrë mistike, mund të qëllonte e përbashkët. Mirëpo me goditjet e zërit të tele-ekranit në vesh, e pati të pamundur të ndiqte mendimet. Vuri një cigare në buzë. Gjysma e duhanit iu shkund vrik në gjuhë, një lloj pluhuri i vështirë për t'u larguar duke pështyrë. Fytyra e e Vëllait të madh i pushtoi imagjinatën dhe zuri vendin e O'Brajënit. Ashtu siç kishte bërë edhe ditë më parë, nxori një monedhë nga xhepi dhe e këqyri. Edhe fytyra e këqyri atë, e rëndë, e qetë, mbrojtëse; çfarë buzëqeshjeje fshihej pas mustaqeve të trasha? Si një ogur i zi iu rishfaqën fjalët:

LUFTA ËSHTË PAQE
LIRIA ËSHTË SKLLAVËRI
INJORANCA ËSHTË FUQI

PJESA E DYTË

I

Kishte kaluar gjysma e paradites, Uinstoni doli nga kthina e vet të shkonte në banjë.

Nga ana tjetër e korridorit të gjatë dhe të ndriçuar po afrohej një figurë njeriu e vetmuar. Ishte vajza flokëzezë. Qysh kur e kishte parë afër dyqanit të rrangullinave, kishin kaluar katër ditë. Ndërsa afroheshin drejt njëri-tjetrit, ai vuri re krahun e saj të fashuar i cili nga larg nuk binte ngaqë fashua kishte të njëjtën ngjyrë me kominoshet. Ndoshta ndërsa vinte vërdallë ishte përplasur me ndonjë nga kaleindeskopët e mëdhenj në të cilët "u jepej dora e parë" novelave. Në Drejtorinë e Trillimit ky ishte një aksident i rëndomtë.

Kur ishin gati katër metra larg, vajza u pengua dhe u plandos pothuajse me fytyrë në dysheme. U dëgjua një klithmë e mprehtë dhimbjeje. Patjetër që ajo kishte rënë mbi krahun e dëmtuar. Uinstoni ndaloi i hutuar. Ndërkohë vajza u ngrit. Fytyra e saj kishte marrë ngjyrë kulloshtre ndërsa buzët i ishin bërë më të kuqe se kurrë. Sytë i kishte fiksuar në sytë e Uinstonit, me një shprehje lutëse që dukej se buronte më tepër prej frikës sesa dhimbjes.

Uinstoni përjetoi një ndjenjë të çuditshme trazimi. Para tij ndodhej armiku që përpiqej ta vriste dhe një krijesë njerëzore në të njëjtën kohë, e cila vuante dhe ndoshta kishte thyer ndonjë eshtër. Ai u nis në mënyrë instiktive që ta ndihmonte. Kur e kishte parë të binte mbi krahun e fashuar, iu duk sikur ndieu dhimbje në trupin e vet.

- U vrave? - e pyeti.

- Oh, jo. Pak krahun. Do të kalojë shpejt.

Vajza fliste sikur i fluturonte zemra. Ama, ishte zbehur keq.

- Mos ke thyer gjë?

- Jo, jo, asgjë. Dhemb pak tani, por do shkojë.

Ajo i shtriu dorën, ai e ndihmoi të ngrihej. Ngjyra e fytyrës i qe kthyer disi, dukej shumë më e lehtësuar.

- S'kam gjë, - përsëriti pak më vonë. – Përplasa pak kyçin e dorës. Faleminderit, shok.

Dhe pas këtyre fjalëve mori drejtimin për ku qe nisur, me një gjallëri sikur vërtetë të mos kishte ndodhur asgjë. Gjithë incidenti nuk zgjati më shumë se gjysmë minuti. Fshehtësia me të cilën njeriu përpiqej të fshihte ndjenjat kishte fituar stausin e instiktit, e për më tepër, ngjarja kishte ndodhur përballë një tele-ekrani. Prapëseprapë, ishte e pamundur që ai ta fshihte një habi të rrufeshme sepse gjatë dy-tre sekondave që e ndihmoi vajzën të ngrihej ajo i rrëshqiti diçka në dorë. S'kishte asnjë dyshim që e kishte bërë me qëllim. Diçka e vogël dhe e sheshtë. Ndërsa u fut në derën e banjës e kaloi sendin nga dora në xhep dhe e preku me mollëzat e gishtave. Ishte një copë letër e palosur.

Ndërsa rrinte tek urinorja e shpalosi me majën e gishtave përsëri. Padyshim që në të duhet të ishte shkruar njëfarë mesazhi. Për një çast mendoi të futej në banjë dhe ta lexonte. Por e dinte shumë mirë që një gjë e tillë ishte marrëzi. Kamerat e banjave shikoheshin me vëmendje më të madhe se kamerat e gjithë vendeve të tjera.

U kthye në kthinën e vet, u ul, hodhi copën e letrës midis të tjerave me shkujdesje, vuri syzat dhe drejtoi nga vetja mikrofonin e shkrimores. "Pesë minuta, - i tha vetes, - të paktën pesë minuta!" Zemra i rrihte me një hov të frikshëm. Për fat, puna që kishte në dorë ishte diçka rutinë, korrigjimi i një liste me shifra, s'donte ndonjë vëmendje kushedi.

Çfarëdo gjëje që ishte shkruar në letër, patjetër që duhet të kishte njëfarë kumti politik. Me sa mund të hamendësonte ai, kishte dy mundësi. E para, më e mundshmja, dhe ajo çka

ai kishte dyshuar: vajza ishte agjente e Policisë së Mendimit. Megjithatë nuk e kuptonte pse Policia e Mendimit duhej t'i dërgonte mesazhet në atë mënyrë, megjithëse ndoshta kishin arsyet e tyre. Mesazhi në letër mund të ishte kërcënim, thirrje, urdhër të vriste veten, pra, njëfarë kurthi. Por kishte edhe një mundësi tjetër e cila fitonte terren në mendjen e tij në mënyrë të frikshme megjithëse ai përpiqej ta ndrydhte: që mesazhi nuk kishte të bënte fare me Policinë e Mendimit, por vinte nga ndonjë organizatë ilegale. Ndoshta *Vëllazëria* ekzistonte vërtet! Ndoshta vajza ishte anëtare e saj! Padyshim që kjo ide ishte absurde, por ai e kishte shkuar në mendje qysh në çastin që ndieu letrën në pëllëmbë. Vetëm nja dy minuta më vonë i ra ndërmend varianti tjetër dhe më i mundshmi. Madje edhe tani, megjithëse logjika i thoshte që mesazhi përcillte vdekje – ai besonte tek tjetra, shpresa çmendurake këmbëngulte, zemra godiste dhe, ndërsa mërmëriste shifrat në mikrofon, përpiqej me vështirësi të shmangte dridhjet e zërit.

Mbështolli gjithë dengun e letrave dhe e flaku në tubin pneumatik. Kishin kaluar tetë minuta. Rregulloi syzat sipër hundës, psherëtiu dhe afroi pranë vetes dengun tjetër me copën e letrës përsipër. E sheshoi. Me një shkrim dore të madh dhe të shtrembër, ishte shkruar:

Të dua.

Uinstoni ishte aq i hutuar saqë nuk e hodhi sendin inkriminues në tubin e kujtesës menjëherë. Dhe, megjithëse e njihte shumë mirë rrezikun e shfaqjes së interesit të tepruar, para se ta hidhte, nuk e mposhti dot tundimin të sigurohej që ato fjalë ishin vërtet në letër.

Pjesën tjetër të paradites e pati të vështirë të punonte. Kishte gjithë ato çikërrima për të bërë, por më e keqja e të këqijave ishte kujdesi që duhej treguar për t'i fshehur shqetësimet nga telekrani. Uinstoni pati ndjesinë se po i merrte zjarr barku. Dreka në mensën e nxehtë, gjithë zhurmë dhe citë me njerëz, ishte torturë. Kishte shpresuar që gjatë drekës të rrinte pak vetëm, por kur të

vinë të ligat hapu derën: Parsons çyryku, djersa e të cilit e mposhti aromën e pakët të çorbës, i mbiu përkrah dhe broçkulliti papushim rreth përgatitjeve për Javën e Urrejtjes. Ai ishte veçanërisht i entuziazmuar për një skulpturë me brumë letre të portretit të Vëllait Madh, dy metër e gjerë, e cila po përgatitej me këtë rast nga skuadra e Spiunëve anëtare e së cilës ishte edhe vajza e tij. Uinstonin e acaronte fakti që nuk i kapte fjalët e Parsonsit dhe që i duhej të kërkonte vazhdimisht që ai t'i përsëriste gjërat. Për një çast i zuri syri vajzën e cila ndodhej me dy vajza të tjera në një tavolinë në anën tjetër të dhomës. Iu duk se ajo nuk e kishte parë, nuk e ktheu më kokën në atë drejtim.

Mbasditja ishte më e pranueshme. Menjëherë pas drekës i erdhi një punë e vështirë dhe delikate e cila kërkonte orë të tëra dhe lënien mënjanë të gjithçkaje tjetër. Kjo punë kërkonte që të falsifikoheshin një sërë raportesh prodhimi të dy vjetëve të shkuar me qëllim që të diskretitohej një anëtar i shquar i Besnikëve të Partisë, të cilit po i afrohej shtrëngata. Kjo detyrë ishte një nga gjërat për të cilat Uinstoni ishte mjeshtër, pothuajse ia doli mbanë ta hiqte tërësisht mendjen nga vajza për dy orë rresht. Kur mbaroi iu rikthye kujtimi i saj dhe bashkë me të edhe dëshira për të ndenjur vetëm. Derisa të mbetej vetëm do ta kishte të pamundur të mendonte për zhvillime të reja. Atë darkë ishte një nga mbrëmjet që duhej të dukej në Vatrën e Kulturës. Hëngri si i babëzitur një tjetër vakt pa shije në mensë, vrapoi për në Vatër, mori pjesë në një budallallëk solemn të quajtur "diskutim në grup", luajti dy sete pinpong, gëlltiti ca gota xhin dhe ndoqi për gjysmë ore një leksion të titulluar "Lidhja e Anglosocit me shahun". Shpirti i tij përpëlitej nga mërzia, por këtë radhë nuk kishte ngacmimin t'i bishtnonte mbrëmjes në Vatër. Me shfaqjen e fjalëve *të dua* i gëlonte dëshira për të jetuar dhe, krejt papritur, rrezikimet e vogla i dukeshin marrëzi. Ora s'kishte shkuar ende njëmbëdhjetë kur, në të errët, u shtri në krevat, vendi më i mbrojtur nga tele-ekrani nëse rrije në heshtje dhe ku mund të mendoje pa ndërprerje.

Megjithatë kishte një problem fizik që duhej zgjidhur: si të kontaktonte me vajzën për të rregulluar një takim. Idenë

se ajo mund t'i përgatiste ndonjë kurth e fshiu nga mendja. Në shqetësimin e saj të pagabueshëm, kur ajo i kishte dhënë letrën, kishte lexuar faktin se diçka e tillë s'do të ndodhte kurrë. Padyshim që vajzën e kishte pushtuar frika dhe ishte krejt e natyrshme. As mendimin për ta refuzuar përparimin e saj nuk e kishte çuar në mendje. Vetëm para pesë netësh kishte menduar t'ia shkallmonte kafkën me gur, por tashmë kjo s'kishte rëndësi. E përfytyroi lakuriq, trup vajzëror, siç e kishte parë në ëndrra. Ai e kishte kujtuar tyryfyçkë si të tjerat, me mendjen deng me gënjeshtra dhe urrejtje, ndërsa barkun përplot akull. Kur mendoi se mund ta humbiste, që trupi vajzëror mund të zhdukej, e zunë ethet. Dhe ajo që e trembte më shumë ishte fakti se, në qoftë se nuk binin në kontakt shumë shpejt, ajo mund të ndërronte mendje. Por mundësitë për t'u takuar ishin shumë të pakta. Ishte njëlloj si të kërkoje një lëvizje të mëtejshme në një lojë shahu ndërkohë që ishe mat. Ngado që të kthesheshe përballeshe me tele-ekranin. Në fakt, gjithë mundësitë e komunikimit me vajzën iu shfaqën brenda pesë minutave pasi lexoi letrën; por tani, kur kishte kohë për t'u menduar, i kaloi në mendje një nga një, si të rreshtonte një sërë veglash sipër tavolinës.

Sigurisht, ai lloj takimi që kishte ndodhur atë mëngjes nuk duhej të përsëritej. Në qoftë se ajo do të punonte në Drejtorinë e Arkivave do të kishte qenë disi e lehtë, por ai i njihte shumë pak hyrje-daljet e Drejtorisë së Trillimeve dhe nuk kishte pretekst për të shkuar aty. Po ta dinte se ku jetonte dhe në ç'orë e linte ajo punën, do të ishte përpjekur ta takonte gjatë rrugës për në shtëpi; megjithëse ta ndiqte nuk kishte siguri, kjo do të thoshte sorrollatje larg Ministrisë, diçka që patjetër do të binte në sy. Ndërsa t'i dërgonte letër me postë, as që bëhej fjalë. Hapja e letrave ishte një rutinë që nuk mbahej më as s'i sekret. Në fakt, shumë pak njerëz shkruanin letra. Në rastet që duhet të dërgoje mesazhe, shtypeshin kartolina me fraza të gjata dhe kur lexoheshin u hiqeshin fjalët e tepërta. Pastaj ai nuk dinte as emrin e vajzës, e le më adresën e saj. Në fund vendosi që vendi më i sigurt për t'u takuar ishte mensa. Në qoftë se e gjente në një tavolinë vetëm, diku në mes të dhomës, jo shumë afër tele-

ekranit dhe me gumëzhitje të mjaftueshme bisedash rrotull - në qoftë se këto kushte zgjasnin, të themi tridhjetë sekonda, atëherë mund të shkëmbenin ndonjë fjalë.

Një javë më vonë jeta ishte si një ëndërr e trazuar. Të nesërmen ajo erdhi në mensë në kohën që zilja kishte rënë dhe ai po kthehej në vendin e punës. Me sa dukej ajo kishte kaluar në ndonjë nga turnet e vonshme. U shkëmbyen pa u parë fare. Një ditë pas kësaj ajo erdhi për drekë në orarin e zakonshëm, por së bashku me tri vajzat e tjera dhe ishin ulur ngjitur me tele-ekranin. Mandej kaluan tri ditë të tmerrshme sepse ajo nuk u shfaq hiç. Dukej se gjithë mendja dhe trupi i tij vuanin nga një ndjeshmëri e papërballueshme, me një lloj trasparence që e kthente në agoni çdo lëvizje, çdo tingull, çdo kontakt, çdo fjalë që atij i duhet të shqiptonte apo dëgjonte. As në gjumë nuk i shmangej dot imazhit të saj. Ato ditë nuk e preku ditarin. Në gjente një grimë qetësi, kjo ndodhte në punë, gjatë së cilës arrinte ta harronte vajzën, të paktën për dhjetë minuta. As që e kishte idenë se çfarë mund t'i kishte ndodhur asaj. S'kishte asnjë mundësi hetimi. Mund të ishte zhdukur, mund të kishte vrarë veten, mund të ishte transferuar në një cep tjetër të Oqeanisë ose, më e keqja dhe më e mundshmja e të gjithave: mund të kishte ndërruar mendje dhe i shmangej.

Një ditë më vonë ajo u shfaq sërish. Krahun e kishte hequr nga fashua, ndërsa kyçin e dorës e kishte ende në allçi. Gëzimi i tij që e shikonte përsëri ishte aq i madh sa nuk e përmbajti dot veten dhe e kundroi për disa sekonda. Të nesërmen për pak ia arriti t'i fliste. Kur hyri në mensë ajo ishte ulur në një tavolinë goxha larg murit dhe ishte vetëm. Ishte herët, në mensë nuk kishte shumë vetë. Radha u shty përpara derisa Uinstoni pothuajse arriti në banak, pastaj u vonuan nja dy minuta ngaqë dikush në krye ankohej se nuk i kishin dhënë tabletën e sakarinës. Vajza ishte ende vetëm kur Uinstoni mori tabakanë dhe u nis drejt tavolinës së saj. Ecte i shkujdesur dhe kërkonte me sy një tavolinë përtej asaj të vajzës. Ndoshta vetëm tre metra i ndanin. Një zë mbrapa Uinstonit thirri: "Smith!" Bëri sikur nuk e dëgjoi. "Smith!" - u përsërit thirrja, më e lartë. S'kishte çfarë të bënte. U kthye. Një djalosh leshverdhë me pamje budallai, i quajtur Uilsher, të

cilin Uinstoni gati nuk e njihte, e ftoi buzagaz në vendin e lirë në tavolinën e tij. Ta refuzoje ishte me rrezik. Tashmë që ishte njohur, nuk mund të shkonte të ulej në tavolinën e një vajze të pashoqëruar. Binte shumë në sy. U ul duke buzëqeshur miqësisht. Fytyra e torollakut flokëverdhë shkëlqeu. Uinstoni përfytyroi veten duke ngulur një sopatë mes për mes saj. Pak më vonë tavolina e vajzës u mbush.

Ndoshta ajo e kishte pikasur kur u nis drejt saj dhe e kishte marrë sinjalin. Të nesërmen ai u kujdes të mbërrinte në mensë më herët. Për fat, ajo ishte ulur pothuajse në të njëjtën tavolinë dhe përsëri vetëm. Personi para tij në radhë ishte një burrë trupvogël, i ngadaltë, si buburrec, me fytyrë të sheshtë dhe sy të vegjël dyshues. Ndërsa Uinstoni u largua nga banaku vuri re se burri trupvogël bëri për nga tavolina e vajzës. Shpresat iu shuan sërish. Një tavolinë më tutje kishte një vend bosh, por diçka në fytyrën e burrit trup vogël sugjeronte se do të ishte në të mirën e tij që të ulej në tavolinën bosh. Uinstoni e ndoqi me zemër të ngrirë. Po të mos ulej në tavolinën e vajzës mundimi ishte i kotë. Atë çast u dëgjua një përplasje e zhurmshme. Burri trup vogël u plandos përdhe, tabakaja fluturoi, ndërsa përgjatë dyshemesë rrodhën dy rrëke: njëra me supë, tjetra me kafe. Burri u ngrit duke e vështruar Uinstonin me ligësi dhe bindjen se ai e kishte penguar. S'prishte punë. Me zemrën që rrihte si e çmendur, pesë minuta më vonë ai ishte ulur në tavolinë me vajzën.

U ul pa e vështruar fare. Hapi ushqimin dhe nisi të hante pa humbur kohë. E mira ishte të fliste sa më shpejt, para se të vinte dikush tjetër, por tani e kishte kapluar frika të gjithin. Qysh nga takimi i parë kishte kaluar një javë. Duhet të kishte ndërruar mendje, patjetër që duhet të kishte ndërruar mendje! Ishte e pamundur që kjo lidhje të përfundonte me sukses; kësi gjërash nuk ndodhnin në jetën reale. Ai mund edhe të kishte hequr dorë nga biseda sikur atë çast të mos kishte parë Ampëlforthin, poeti me veshët leshtorë që vinte vërdallë duke çaluar me tabaka në duar, në kërkim të një vendi për t'u ulur. Në mënyrën e tij të paqartë, Ampëlforthi ishte i lidhur me Uinstonin dhe sigurisht që do të ulej në tavolinën e tij po ta shihte. Kishte vetëm një minutë për

vepruar. Uinstoni dhe vajza hanin qetësisht. Gjella ishte një çorbë e ujshme, supë në fakt, me fasule. Uinstoni nisi të fliste, gati me mërmërimë. Asnjëri nuk e ngriti kokën; gjerbinin ritmikisht gjellën e ujshme dhe shkëmbyen pak fjalë të nevojshme midis hurbave, me një zë të ulët monoton.

- Kur e mbaron punën?
- Në gjashtë e gjysmë.
- Ku mund të takohemi?
- Në Sheshin e Fitores, pranë monumentit.
- Është plot me tele-ekrane.
- Në qoftë se sheshi është i mbushur me njerëz s'ka problem.
- Ndonjë sinjal?
- Jo. Mos u afro derisa të më shikosh mes turmës. Dhe mos më shiko. Qëndro diku afër meje.
- Në ç'orë?
- Shtatë.
- Në rregull.

Ampëlforthi nuk e pa dhe u ul në një tavolinë tjetër. Nuk folën më dhe, aq sa ishte e mundshme për dy njerëz ulur përballë njëri-tjetrit, nuk shkëmbyen vështrime. Vajza mbaroi drekën me nxitim dhe doli, ndërsa ai ndenji dhe ndezi një cigare.

Uinstoni mbërriti në Sheshin e Fitores më herët. Erdhi rrotull bazamentit të një kollone gjigante me hulliza sipër së cilës qëndronte statuja e Vëllait të Madh, me vështrimin nga juglindja drejt qiejve ku ai kishte mundur avionët euroaziatikë (një vit më parë kishin qenë avionët aziatiko-lindorë) në Betejën e Shiritit të Parë Ajror. Në rrugën përballë tij ishte statuja e një kalorësi që duhet të ishte Oliver Kromuelli. Vajza nuk po shfaqej as në shtatë e pesë. Uinstonin e kapi sërish frika e tmershme. Nuk do të vinte, kishte ndërruar mendje! Eci ngadalë drejt anës veriore të sheshit dhe ndieu një kënaqësi të vakët kur dalloi kishën e Shën Martinit, kambanat – kur kishte patur kambana – e së cilës kishin kumbuar: "Më keni borxh tre groshë." Pastaj pa vajzën tek bazamenti monumentit, e cila lexonte, ose shtirej sikur lexonte, një afishe të vendosur në mënyrë spirale përgjatë

kolonës. Nuk ishte mirë t'i afrohej derisa të grumbulloheshin edhe ca njerëz të tjerë. Ballina e kolonës ishte e mbushur me tele-ekrane. Por atë çast, prej diku nga e majta vinin thirrje dhe gumëzhitje automjetesh të rënda. Befas të gjithë në shesh nisën të vraponin. Vajza lëvizi me shpejtësi rrotull luanëve në bazament dhe iu bashkua turmës që vraponte. Uinstoni e ndoqi. Ndërsa vraponte, prej britmave përreth e kuptoi që po kalonte një karvan robërish euroaziatikë.

Tashmë, një masë e madhe njerëzish po bllokonte krahun jugor të sheshit. Uinstoni, që zakonisht pëlqente të rrinte sa më larg çdo lloj klithme, çau drejt zemrës së turmës me këmbë e me duar. Shumë shpejt u ndodh një shtrirje krahu larg vajzës, por rruga qe bllokuar nga një prole gjigant dhe një grua, ndoshta bashkëshortja e tij, po aq e vëllimshme, të cilët kishin ndërtuar një mur mishi të pakalueshëm. Uinstoni u kthye përanash dhe me një shtytje të fuqishme ia doli mbanë të fuste supet midis tyre. Një çast pati ndjesinë se të brendshmet do t'i shtrydheshin midis dy kofshëve gjigante, mandej arriti të çante, pak i djersitur. Ndodhej pranë vajzës. Sup më sup, të dy me vështrimet fiksuar përpara.

Në rrugë po kalonte një varg i gjatë kamionësh, me rojet fytyrëngrirë të armatosur me automatikë në çdo cep. Njerëzit fytyrëverdhë me uniforma të vjetra ngjyrë jeshile brenda kamionëve rrinin galiç, ngjeshur pas njëri-tjetrit. Fytyrat mongoliane të trishtura vështronin jashtë makinës pa pikën e kureshtjes. Herë pas here, kur tronditej ndonjë makinë, dëgjoheshin trokëllitje metali, gjithë të burgosurit i kishin këmbët të prangosura. Kamionët kalonin njëri pas tjetrit, përplot fytyra të vuajtura. Uinstoni e dinte që i kishte para syve, por i shikonte me ndërprerje. Supi i vajzës dhe krahu i saj deri në bërryl qenë puthitur pas tij. Mollëza e saj ishte aq afër saqë ndiehej ngrohtësia e saj. Ashtu siç kishte bërë edhe në mensë, ajo ishte në zotërim të situatës. Nisi të fliste me të njëjtin zë monoton si edhe më parë, gati pa i luajtur buzët, një mërmërimë e lehtë që mbytej nga sokëllimat dhe uturima e makinave.

- Më dëgjon?
- Po.

- E merr dot pushim të shtunën?

- Po.

- Atëherë, dëgjo me kujdes. Duhet ta mbash mend. Shko tek Sheshi Pandigton...

Ajo e përshkroi rrugën që ai duhet të merrte me një saktësi ushtarake që e hutoi Uinstonin. Gjysmë ore udhëtim me tren; jashtë stacionit merr majtas; dy kilometra përgjatë rrugës; një portë pa qemer; një udhë përmes një fushe; një rrugicë me bar; një kamion midis shkurreve; një pemë e tharë dhe me myshk. Sikur ta kishte hartën në kokë.

- I mban dot mend të gjitha? – mërmëriti në fund.

- Po.

- Kthehu majtas, pastaj djathtas, pastaj majtas sërish. Porta nuk ka qemer. Je i sigurt që do t'i mbash mend?

- Po.

- Atëherë largohu shpejt.

Këtë s'qe nevoja t'ia thoshte ajo. Por për momentin nuk dilnin dot nga turma. Kamionët kalonin e kalonin ndërsa mizëria e njerëzve vazhdonte të ishte gojëhapur. Në fillim pati ca britma e fishkëllima, të cilat i lëshonin vetëm anëtarët e Partisë, por pushuan shpejt. Emocioni më i epërm ishte kureshtja. Të huajt, qoftë nga Euroazia qoftë nga Azia Lindore, shikoheshin si kafshë të çuditshme. Mundësia e vetme e qytetarëve për t'i parë ishin robërit e luftës, edhe ata vetëm kalimthi. Nuk e merrnin vesh kurrë se cili ishte fati i mëtejshëm i tyre, përveç disave që vareshin si kriminelë lufte, të tjerët thjesht zhdukeshin, ndoshta i çonin në kampe me punë të detyruar. Fytyrat e rrumbullta mongole qenë zëvendësuar nga fytyrat e pista, të parruara dhe të rraskapitura të tipit europian. Sipër mollëzave të thara, sytë e tyre vështronin sytë e Uinstonit, shpeshherë me një ngulm të çuditshëm, dhe zhdukeshin sërish. Karvani po mbaronte. Në kamionin e fundit pa një burrë të moshuar me fytyrën mbuluar nga thinjat, që rrinte në këmbë dhe krahët të kryqëzuar, sikur të ishte mësuar duke i pasur të lidhur. Kishte ardhur koha që Uinstoni dhe vajza të ndaheshin. Por në çastin e fundit, kur turma ende po i ngjeshte, dora e saj kërkoji të tijën dhe e shtrëngoi.

S'kishin kaluar as dhjetë sekonda, megjithatë dukej sikur duart shtrëngoheshin prej një kohe të gjatë. Uinstoni pati kohë të mësonte çdo detaj të asaj dore. Eksploroi gishtërinjtë e gjatë, thonjtë me formë, pëllëmbën e ashpër me kallot e shumta, mishin e butë poshtë kyçit. Nëse e ndeshte herë tjetër mund ta njihte vetëm me të prekur. Atë çast u kujtua që nuk e dinte se ç'ngjyrë kishin sytë e saj. Ndoshta ngjyrë kafe, megjithatë ndodhte që tipat flokëzinj të kishin sy të kaltër. Të kthente kokën për t'i parë sytë qe marrëzi. Zënë për dore, të padukshëm mes shtypjes së trupave, vështronin të përqëndruar përpara dhe në vend të syve të vajzës, Uinstonin e kundruan me trishtim sytë e të burgosurit.

II

Uinstoni u ngjit përgjatë rrugicës me lara drite dhe hijesh, duke shkelur mbi pellgje të artë sa herë që degët hapeshin. Poshtë pemëve në të majtë, toka kishte mjegull dhe zymbylë. Kur ajri të prekte lëkurën ngjante si puthje. Ishte dita e dytë e Majit. Prej thellësive të pyllit dëgjohej kënga e kumrisë.

Ishte pak herët. Rrugës nuk kishte patur probleme, ndërsa dukej sheshit që vajza ishte me aq përvojë saqë Uinstoni nuk ndiehej aq i frikësuar sa mund të ndiehej zakonisht. Ndofta asaj duhej t'i besohej për të gjetur një strehë të sigurt. Përgjithësisht nuk mund të mendoje se ishe më i sigurt në fshat sesa në Londër. Në fshat nuk kishte tele-ekrane, por ekzistonte rreziku i përhershëm i mikrofonave të fshehtë; pastaj, nuk kishte siguri që të udhëtoje pa rënë në sy. Për largësi më të vogla se 100 kilometra nuk ishte e nevojshme të mbaje letërnjoftim, por shpeshherë në stacione shfaqeshin patrullat të cilat u kontrollonin dokumentat anëtarëve të Partisë që ndeshnin përpara dhe u bënin pyetje provokuese. Megjithatë, ai nuk kishte parë ndonjë patrullë dhe gjatë rrugës që nga stacioni ishte siguruar që nuk ndiqej me kthime të kujdesshme të kokës. Treni kishte qenë citë me prole që për shkak të kohës bisedonin sikur shkonin me pushime. Vagoni me ndenjëse druri me të cilin udhëtoi ishte mbushur nga një familje e vetme gjigante e cila fillonte që nga gjyshja pa dhëmbë dhe mbaronte me një fëmijë një muajsh; shkonin për të kaluar një mbasdite me krushqit dhe, siç ia shpjeguan Uinstonit pa teklif, të gjenin pak gjalpë në tregun e zi.

Rrugica erdhi duke u zgjeruar dhe brenda një minute Uinstoni gjeti udhën që ajo i kishte treguar, një kalim i zakonshëm

lopësh i kredhur midis shkurreve. Ai nuk kishte orë, por ende s'kishte shkuar tre. Zymbylët ishin aq të dendur sa ishte e pamundur të mos i shkelje. U ul dhe nisi t'i mblidhte, ca për të vrarë kohën e ca ngaqë donte t'i dhuronte lule vajzës kur ta takonte. Kishte mbledhur një goxha tufë dhe po nuhaste aromën e vakët që të shkaktonte të vjella, kur një zë mbrapa shpine, kërcitja e pagabueshme e shkarpave poshtë këmbës, e la pa frymë. Vazhdoi të mblidhte zymbylë. Kjo ishte gjëja më e mirë që mund të bënte. Mund të ishte vajza, por edhe mund ta kishin ndjekur. Kthimi i kokës do të thoshte fajësi. Këputi lule njëra pas tjetrës. Një dorë e preku lehtë në sup.

Ngriti sytë. Pa vajzën. Ajo tundi kokën për t'i thënë se nuk duhet të bënte zhurmë, pastaj çau degët dhe priu në shtegun e ngushtë drejt pyllit. Padyshim që ajo kishte qenë aty edhe më parë, u shmangej fare natyrshëm ligatinave. Uinstoni e ndiqte me tufën e luleve ende në dorë. Fillimisht u çlirua, por ndërsa shikonte trupin e fortë dhe elegant që lëviste para tij, me brezin e kuq të shtrënguar mjaftueshëm të rrëfente kurbën e vitheve, ndjenja e inferioritetit të tij ishte goxha e rëndë. Edhe tani dyshonte se ajo mund të kthehej dhe mund të hiqte dorë kur të shikonte atë. Ëmbëlsia e ajrit dhe gjelbërimi i gjetheve e shkurajonte. Qysh gjatë rrugës nga stacioni i trenit, dielli i majit e kishte bërë të ndiehej i ndotur dhe i tretur, krijesë shtëpiake, me poret e lëkurës mbushur me blozën e Londrës. Ndërkohë i ra ndërmend që vajza nuk e kishte parë kurrë në dritën e diellit, në natyrë. Mbërritën tek pema e rrëzuar që ajo kishte përmendur. Vajza kërceu para dhe çau shkurret, ndërsa ai nuk shikonte shteg. Kur Uinstoni e ndoqi, u gjendën në një çeltinë, një bregore me bar të hollë e mbyllur tërësisht nga fidanët e lartë. Vajza ndaloi dhe u kthye.

- Pra, arritëm, - tha.

Ai e shikonte nga një largësi disa metërshe. E megjithatë nuk guxoi të afrohej.

- Në rrugicë nuk fola, - vazhdoi ajo, - nga frika e mikrofonëve të fshehtë. S'besoj se ka, por kushedi. Ekziston mundësia që ndonjë nga ata maskarenjtë të na i njohë zërat. Këtu jemi të sigurt.

Ai s'kishte ende kurajo t'i afrohej.

Këtu jemi të sigurt? – përsëriti i hutuar.

- Po. Shiko pemët. - Ahe të vegjël që dikur ishin prerë dhe sythët kishin shpërthyer në një pyll shtyllash, asnjëra nuk e kalonte trashësinë e llërit. – Asnjëri nuk është aq i trashë sa të mbajë mikrofonin pa rënë sy. Pastaj, unë kam qenë edhe herë tjetër.

Vetëm bisedonin. Tashmë ai ishte afruar pak më tepër. Ajo qëndronte para tij si lastonjë, me një buzëqeshje që dukej disi ironike, sikur të habitej me ngurimin e tij për të vepruar. Zymbylët kishin rënë përtokë. Dukej se kishin rënë vetë. Uinstoni e kapi nga dora.

- Të besohet, - tha, - se deri në këtë çast nuk dija çfarë ngjyre kishin sytë e tu? – Vuri re që ishin ngjyrë kafe, kafe e hapët, me qerpikë të zinj. – Po tani që më pe sesi jam, mund ta honepsësh këtë pamje?

- Po, me lehtësi.

- Jam tridhjetë e nëntë vjeç. Kam një bashkëshorte që s'e heq dot qafe. Kam një këmbë përherë të malcuar dhe pesë dhëmbë të rremë.

- As që më shqetësojnë.

Më pas qe e vështirë të thoje e kujt ishte inisiativa që ajo përfundoi në krahët e tij. Fillimisht ai nuk ndiente asgjë veç mosbesimit. Trupi vajzëror i ngjishej pas trupit ndërsa masa e flokëve të zinj pas fytyrës dhe, atij gati nuk i besohej, ajo kishte ngritur kokën dhe ai po puthte buzët e plota e të kuqe. Duart e saj ishin kapur pas qafës së tij, ajo e thërriste, shpirt, i shtrenjti im, i dashuri im. Ai e shtriu përtokë, ajo nuk kundërshtonte fare, mund të bënte me të çfarë të donte. Por e vërteta ishte se ai nuk kishte ndjesi fizike, veç atij kontakti të thjeshtë. Gjithë ç'ndiente ishte mosbesimi dhe krenaria. Ishte i lumtur për atë që ndodhte, por nuk kishte dëshirë fizike. Ishte shumë herët, vajzëria dhe bukuria e saj e kishin trembur, kishte jetuar shumë kohë pa një grua – nuk e dinte arsyen. Vajza mblodhi veten dhe largoi një zymbyl nga flokët e saj. U mbështet pas tij, i hodhi krahun për mesi.

- Mos u mërzit, shpirt. S'ka pse ngutemi. Kemi gjithë mbasditen përpara. Strehëza është fantastike. E zbulova gjatë një marshimi. Sikur të vinte njeri do të dëgjohej qysh njëqind metra larg.

- Si e ke emrin? - pyeti Uinstoni.

- Xhulia. Unë e di emrin tënd. Uinston – Uinston Smith.

- Si e mësove?

- Kam përshtypjen se jam më e prerë se ty për zbulim, shpirt. Më thuaj, ç'mendim kishe për mua para ditës që të dhashë letrën?

Ai nuk pati as tundimin më të vogël për ta gënjyer. Madje, duke treguar më të keqen, shfaqte shenja dashurie.

- S'doja të ta shihja fytyrën, - tha. – Doja të të përdhunoja e pastaj të të vrisja. Dy javë më parë mendova seriozisht të të thyeja kafkën me gurët e kalldrëmit. Në do të dish të vërtetën, kujtoja se kishe të bëje me Policinë e Mendimit.

Vajza qeshi e kënaqur, dukej që këtë e merrte si kompliment për përsosmërinë e maskimit të saj.

- Policinë e Mendimit! Mos më thuaj që e mendove sinqerisht?

- Shiko, ndoshta jo. Por nga pamja jote e përgjithshme – ti je e re dhe shëndetshme, më kupton – mendova se mos ndoshta...

- Kujtoje se isha anëtare partie e përkushtuar. E kulluar, me fjalë e me vepra. Pankarta, parakalime, sllogane, lojëra, marshime – e kësilloj gjërash. Dhe të shkonte në mendje që në qoftë se më jepej mundësia më e vogël do të të denoncoja si kriminel mendimi që të vriteshe?

- Po, diçka e tillë. Ka shumë vajza të tilla, prandaj.

- Ky dreq brezi e ka fajin, apo jo? – tha ajo, ndërsa hoqi brezin e kuqërremtë të Organizatës së Rinisë Kundër Seksit dhe e flaku sipër degëve. Mandej, sikur prekja e belit të saj ta kishte kujtuar për diçka, Xhulia rrahu xhepat e kominosheve të veta dhe nxori një copë të vogël çokollate. E theu më dysh dhe njërën pjesë ia zgjati Uinstonit. Ende pa e marrë pjesën, Uinstoni e kuptoi që çokallata nuk ishte çokallatë e zakonshme. Ishte e errët, me shkëlqim dhe e mbështjellë me letër alumini. Zakonisht, çokollata

Ai s'kishte ende kurajo t'i afrohej.

Këtu jemi të sigurt? – përsëriti i hutuar.

- Po. Shiko pemët. - Ahe të vegjël që dikur ishin prerë dhe sythët kishin shpërthyer në një pyll shtyllash, asnjëra nuk e kalonte trashësinë e llërit. – Asnjëri nuk është aq i trashë sa të mbajë mikrofonin pa rënë sy. Pastaj, unë kam qenë edhe herë tjetër.

Vetëm bisedonin. Tashmë ai ishte afruar pak më tepër. Ajo qëndronte para tij si lastonjë, me një buzëqeshje që dukej disi ironike, sikur të habitej me ngurimin e tij për të vepruar. Zymbylët kishin rënë përtokë. Dukej se kishin rënë vetë. Uinstoni e kapi nga dora.

- Të besohet, - tha, - se deri në këtë çast nuk dija çfarë ngjyre kishin sytë e tu? – Vuri re që ishin ngjyrë kafe, kafe e hapët, me qerpikë të zinj. – Po tani që më pe sesi jam, mund ta honepsësh këtë pamje?

- Po, me lehtësi.

- Jam tridhjetë e nëntë vjeç. Kam një bashkëshorte që s'e heq dot qafe. Kam një këmbë përherë të malcuar dhe pesë dhëmbë të rremë.

- As që më shqetësojnë.

Më pas qe e vështirë të thoje e kujt ishte inisiativa që ajo përfundoi në krahët e tij. Fillimisht ai nuk ndiente asgjë veç mosbesimit. Trupi vajzëror i ngjishej pas trupit ndërsa masa e flokëve të zinj pas fytyrës dhe, atij gati nuk i besohej, ajo kishte ngritur kokën dhe ai po puthte buzët e plota e të kuqe. Duart e saj ishin kapur pas qafës së tij, ajo e thërriste, shpirt, i shtrenjti im, i dashuri im. Ai e shtriu përtokë, ajo nuk kundërshtonte fare, mund të bënte me të çfarë të donte. Por e vërteta ishte se ai nuk kishte ndjesi fizike, veç atij kontakti të thjeshtë. Gjithë ç'ndiente ishte mosbesimi dhe krenaria. Ishte i lumtur për atë që ndodhte, por nuk kishte dëshirë fizike. Ishte shumë herët, vajzëria dhe bukuria e saj e kishin trembur, kishte jetuar shumë kohë pa një grua – nuk e dinte arsyen. Vajza mblodhi veten dhe largoi një zymbyl nga flokët e saj. U mbështet pas tij, i hodhi krahun për mesi.

- Mos u mërzit, shpirt. S'ka pse ngutemi. Kemi gjithë mbasditen përpara. Strehëza është fantastike. E zbulova gjatë një marshimi. Sikur të vinte njeri do të dëgjohej qysh njëqind metra larg.

- Si e ke emrin? - pyeti Uinstoni.

- Xhulia. Unë e di emrin tënd. Uinston – Uinston Smith.

- Si e mësove?

- Kam përshtypjen se jam më e prerë se ty për zbulim, shpirt. Më thuaj, ç'mendim kishe për mua para ditës që të dhashë letrën?

Ai nuk pati as tundimin më të vogël për ta gënjyer. Madje, duke treguar më të keqen, shfaqte shenja dashurie.

- S'doja të ta shihja fytyrën, - tha. – Doja të të përdhunoja e pastaj të të vrisja. Dy javë më parë mendova seriozisht të të thyeja kafkën me gurët e kalldrëmit. Në do të dish të vërtetën, kujtoja se kishe të bëje me Policinë e Mendimit.

Vajza qeshi e kënaqur, dukej që këtë e merrte si kompliment për përsosmërinë e maskimit të saj.

- Policinë e Mendimit! Mos më thuaj që e mendove sinqerisht?

- Shiko, ndoshta jo. Por nga pamja jote e përgjithshme – ti je e re dhe shëndetshme, më kupton – mendova se mos ndoshta...

- Kujtoje se isha anëtare partie e përkushtuar. E kulluar, me fjalë e me vepra. Pankarta, parakalime, sllogane, lojëra, marshime – e kësilloj gjërash. Dhe të shkonte në mendje që në qoftë se më jepej mundësia më e vogël do të të denoncoja si kriminel mendimi që të vriteshe?

- Po, diçka e tillë. Ka shumë vajza të tilla, prandaj.

- Ky dreq brezi e ka fajin, apo jo? – tha ajo, ndërsa hoqi brezin e kuqërremtë të Organizatës së Rinisë Kundër Seksit dhe e flaku sipër degëve. Mandej, sikur prekja e belit të saj ta kishte kujtuar për diçka, Xhulia rrahu xhepat e kominosheve të veta dhe nxori një copë të vogël çokollate. E theu më dysh dhe njërën pjesë ia zgjati Uinstonit. Ende pa e marrë pjesën, Uinstoni e kuptoi që çokallata nuk ishte çokallatë e zakonshme. Ishte e errët, me shkëlqim dhe e mbështjellë me letër alumini. Zakonisht, çokollata

kishte ngjyrë kafe të shpëlarë dhe thërrmohej me shije – aq sa mund të përshkruhet – si tymi i një zjarri plehërash. Herë pas here, kishte patur rast ta provonte çokallatën që sapo i dha Xhulia. Duhma e parë e aromës i trazoi kujtesën, por pa i rënë në të, një ngacmim i fuqishëm dhe shqetësues.

- Ku e ke marrë? – pyeti.

- Në tregun të zi, - u gjegj ajo me indiferencë. – Në fakt, mua më jepet të shikoj për kësi gjërash. Tek Spiunët kam qenë komandante skuadre. Tre netë në javë punoj vullnetarisht për Organizatën e Rinisë Kundër Seksit. Kam harxhuar orë të tëra për të ngjitur afishet e tyre të shpifura nëpër Londër. Në parakalime më gjen përherë duke mbajtur ndonjë pankartë nga njëri cep. Shfaqem shpesh e gëzuar dhe nuk i bëj bisht asnjë aktiviteti. Mbaje mirë me turmën, kjo është motoja ime. E vetmja mënyrë për t'u mbrojtur.

Në gjuhën e Uinstonit kishte shkrirë copa e parë e çokollatës. Shija ishte e mrekullueshme. Mirëpo kujtimi që e ngucte vazhdonte të endej në kufijtë e vetëdijes, diçka që e ndiente fuqishëm, por pa arritur t'ia rrokte formën, si një objekt vendosur jashtë rrezes së syrit. E largoi mendjen prej tij, i ndërgjegjshëm që ishte kujtimi i një veprimi të cilin dëshironte ta zhbënte, por nuk mundej.

- Ti je e re, - i tha. – Dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet më e re se unë. Çfarë mund të të joshë tek një burrë si puna ime.

- Diçka në fytyrën tënde. Do ta provoj, thashë. Jam mjeshtre të dalloj njerëz pa përkatësi. Qysh kur të pashë, e kuptova që ishe kundër *atyre*.

Atyre, dukej që e kishte fjalën për Partinë, veçanërisht për Besnikët e saj, për të cilët ajo fliste me një urrejtje therëse saqë e trazoi Uinstonin, edhe pse ai e dinte se në kishte një vend të mbrojtur, ai vend ishte vendi ku ndodheshin. Ndërsa sharjet në gjuhën e saj e lanë pa mend. Anëtarët e Partisë nuk duhej të shanin, vetë Uinstoni shante shumë rrallë, të paktën, jo me zë të lartë. Ndërkohë që Xhulia dukej e paaftë ta përmendte Partinë pa përdorur fjalë nga ato që i gjeje të shkarravitura nëpër muret e periferisë. Ai nuk ishte kundër. Qe thjesht një shenjë e revoltës

kundër Partisë dhe gjithë mekanizmave të saj e cila në njëfarë mënyre të bënte mirë për shëndetin, si teshtima e kalit që nuhurit zahire të mykur. E kishin lënë vendin e zhveshur dhe po ecnin ndën hijen lara-lara dhe, aty ku kishte hapësirë për të ecur përkrah, me krahët rreth mesit të njërit-tjetrit. Kur ajo hoqi brezin, ai ndieu butësinë e belit të saj. Flisnin vetëm me pëshpërima. Jashtë çeltinës, tha Xhulia, është më mirë të ecim në qetësi. Tashmë kishin arritur buzë pyllit të vogël. Ajo e ndali.

- Mos dil në vendin e zhveshur. Mund të ketë ndonjë spiun. Është më mirë sikur të ecim fshehur pas degëve.

Po qëndronin në hijen e një lajthie. Drita e diellit, e cila depërtonte midis gjetheve të panumërta, nuk kishte rënë ende në fytyrat e tyre. Uinstoni vështroi drejt fushës përballë dhe e kapi një turbullim i çuditshëm njohjeje. E njihte atë vend. Një livadh i vjetër, i ngrënë, me një udhë përmes dhe fole urithësh aty-këtu. Në anën e ashpër përballë, degët e vidhave tundeshin lehtë nga filladi, ndërsa masa e dendur e gjetheve trazohej si flokë gruaje. Me siguri që diku afër, në një vend që s'e kapte syri, ndodhej një burim me pellgje të gjelbërta me cironka.

- Mos ka një burim diku afër? – përshpëriti.

- Po, është. Në cepin e fushës tjetër. Ka edhe peshq, të mëdhenj. Mund t'i soditësh tek valëvitin bishtin në pellgjet poshtë shelgjeve.

- Toka e Artë, - tha ai gati me mërmërimë.

- Toka e Artë?

- Asgjë, asgjë. Një peizazh që e kam parë herë pas here në ëndërr.

- Shiko, - pëshpëriti Xhulia.

Në një degë vetëm pesë metra larg, pothuajse në nivelin e fytyrave të tyre, u shfaq një tushë. Ndoshta nuk i kishte parë. Zogu ishte në diell, ata në hije. Hapi krahët, i mbylli sërish me kujdes, përkuli kokën për një çast, pothuaj sikur përshëndeste diellin me përulje, e mandej ia nisi këngës. Në qetësinë e mbasdites, volumi i zërit ishte i habitshëm. Uinstoni dhe Xhulia u shtrënguan, të magjepsur. Kënga vazhdoi e vazhdoi, minutë pas minuti, me variacione të çuditshme, pa e përsëritur kurrë veten, sikur zogu

e bënte me qëllim për të treguar virtuozitetin e vet. Dikur ndaloi për pak sekonda, hapi krahët dhe i mblodhi sërish, fryu gjoksin me pikla dhe ia nisi edhe njëherë këngës. Uinstoni e kundronte me një lloj nderimi të turbullt. Për kë dhe përse këndonte zogu? Nuk e shikonte as e dashura dhe as rivalët. Çfarë e shtynte që ta derdhte këngën në zbrazëti në skaj të pyllit të vetmuar? Ndoshta, mendoi Uinstoni, diku rrotull kishte ndonjë mikrofon të fshehtë. Ai dhe Xhulia kishin folur me pëshpërima, por kënga e tushës mund të inçizohej. Ndoshta në anën tjetër të instrumentit, ndonjë njeri me pamje brumbulli ishte duke dëgjuar me vëmendje – dëgjonte *këngën*. Por kënga ia largoi gjithë dyshimet nga mendja. Sikur dikush t'i derdhte njëfarë lëngu që binte sipër tij e trazohej me dritën e diellit që depërtonte nëpër gjethe. Pushoi së menduari dhe gati nuk ndiente asgjë. Beli i vajzës në dorën e tij ishte i butë dhe i ngrohtë. E rrotulloi dhe u kthyen gjoks më gjoks; trupi i saj shkrihej me trupin e tij. Kudo që preknin duart gjenin një masë të epshme si uji. Buzët e tyre u bashkuan; diçka ndryshe nga puthjet e forta që kishin shkëmbyer më herët. Kur i larguan fytyrat sërish, dihatën gjatë. Zogu u tremb dhe u largua me një përplasje të krahëve.

Uinstoni e puthi sërish.

- Tani - pëshpëriti.

- Jo këtu, - ia ktheu ajo, po me pëshpërimë.

Rrëmbimthi, të shoqëruar nga kërcitje të herëpashershme degësh, gjarpëruan përsëri drejt çeltinës. Kur u gjendën brenda unazës së njomëzave, ajo u kthye përballë tij. Të dy merrnin frymë me nxitim, por në fytyrën e saj ishte rishfaqur buzëqeshja. Për një çast ajo vështroi Uinstonin, pastaj kërkoi zinxhirin e kominosheve të veta dhe ndodhi vërtet siç ai e kishte parë në ëndërr: po aq butë sa e kishte përfyturuar, ajo grisi rrobat dhe, kur i flaku mënjanë, e bëri këtë me të njëjtin gjest të mrekullueshëm që e fshinte një çast gjithë qytetërimin nga faqja e dheut. Bardhësia e trupit ndriti nga dielli. Por për një çast sytë e tij nuk vështruan trupin, u hutuan nga buzëqeshja e gjerë dhe e zbehtë në fytyrën pikaloshe. Ai u përkul në gjunjë para saj dhe i mori dorën ndër duar.

- E ke bërë më përpara?

- Patjetër. Me qindra herë – jo, më saktë, me dhjetra.

- Me anëtarë partie.

- Po, përherë me anëtarë partie.

- Me anëtarë të Besnikëve të Partisë?

- Jo, jo, me ndyrësirat. Megjithëse ka shumë prej tyre që s'do ta falnin po t'u jepej rasti. Nuk janë aq shenjtorë sa shiten.

Zemra i rrahu me forcë. Ajo e kishte bërë me dhjetra herë; ai do dëshironte që ajo ta kishte bërë me qindra herë, madje me mijëra. Çdo nojmë korrupsioni e mbushte me një shpresë të fuqishme. Ku i dihej, ndofta në thellësi Partia ishte e kalbur, kulti i saj për punë dhe vetmohim mund të ishte shtirje për të mbuluar poshtërsinë. Eh, sikur ta kishte infektuar gjithë racën e tyre me lebrozë ose sifiliz, sa me kënaqësi do ta kishte bërë! Gjithçka që mund t'i shthurte, dobësonte, sabotonte! E uli Xhulian në gjunjë, për të qenë fytyrë më fytyrë.

- Dëgjo. Sa më shumë burra që ke patur, aq më shumë të dua. Më kupton?

- Po, qartë.

- E urrej puritanizmin, e urrej mirësinë! Nuk dua që të ekzistojë asnjë virtyt, gjithandej. Dua që çdo qelizë e tyre të shthuret.

- Qartë atëherë, unë të vij për shtat, i dashur. Gjithë qelizat e mia janë të shthurura.

- Të pëlqen ta bësh? Nuk e kam fjalën thjesht me mua, por veprimin.

- E adhuroj.

Tek e fundit, kjo ishte ajo që ai donte të dëgjonte. Jo thjesht dashuria e një personi të vetëm, por instikti i kafshës, dëshira e pandryshueshme dhe pa ndërlikime, forca që do ta shkatërronte Partinë. Tashmë ngritjet dhe uljet e kraharorëve të tyre kapën shpejtësinë normale, u ndanë me një pafuqishmëri të mbushur me kënaqësi. Dielli ishte nxehur edhe më. Të dy ishin përgjumësh. Ai kërkoi kominoshet dhe mbuloi vajzën pjesërisht. Dhe pothuajse menjëherë i zuri gjumi, fjetën rreth gjysmë ore.

Uinstoni u zgjua i pari. U ngrit përgjysmë dhe kundroi fytyrën pikaloshe, ende qetësisht në gjumë, me pëllëmbën e saj si

nënkresë. Goja bënte përjashtim, nuk mund të quhej e bukur. Po ta vështroje me vëmendje, poshtë syve kishte nja dy vija. Flokët e zinj dhe të shkurtër ishin jashtëzakonisht të trashë dhe të butë. U kujtua që nuk e dinte ende mbiemrin e saj, apo ku banonte.

Kurmi i fortë vajzëror në gjumë, tashmë i pafuqishëm, ngjalli tek ai një ndjenjë keqardhjeje dhe mbrojtjeje. Por dhembshuria e dalldisur që ndieu poshtë lajthisë, kur këndonte tusha, sikur nuk ishte rikthyer. Largoi kominoshet dhe kundroi ijen e saj të bardhë e të butë. Në të shkuarën, mendoi, kur vështronte trupin e gruas dhe e dëshironte, kjo ishte e gjitha. Por në kohën e sotme nuk ka dashuri apo epsh të kulluar. Nuk kishte emocione të pastra, sepse gjithçka ishte e mpleksur me frikën dhe urrejtjen. Përqafimi i tyre kishte qenë një betejë, ndërsa orgazma fitore. Kjo qe një gotitje kundër Partisë. Ishte akt politik.

III

- Këtu mund të vijmë sërish, - tha Xhulia. – Në përgjithësi, një bazë mund të përdoret deri në dy herë. Natyrisht, jo për një apo dy muaj.

Pasi u ngrit prej gjumit sjellja e saj ndryshoi. U alarmua dhe mori pamje serioze, u vesh, lidhi brezin e kuqërremtë për mesi, pastaj nisi të planifikonte detajet e kthimit në shtëpi. Këtë e bënte natyrshëm. Padyshim, ajo kishte një lloj dinakërie që Uinstonit i mungonte, dhe dukej që orientohej në mënyrë të shkëlqyer në peizazhin rrotull Londrës, të ruajtur me kujdes gjatë marshimeve. Rruga që ajo i tregoi ishte krejt e ndryshme nga ajo që ai kishte ardhur dhe e nxori në një tjetër stacion treni. Dhe sikur po shpallte një parim të rëndësishëm, ajo tha: "Kurrë mos u kthe në shtëpi nga e njëjta rrugë." Ajo do të largohej e para, ndërsa Uinstoni do të priste gjysmë ore.

Ajo i tregoi një vend ku mund të takoheshin pas punës katër ditë më vonë. Ishte një rrugë në lagjet e varfra, pranë një tregu të hapur i cili zakonisht ishte i populluar dhe i zhurmshëm. Ajo do të vërdallej nga tezga në tezgë duke u shtirur sikur kërkonte lidhëse këpucësh ose pe. Në qoftë se e shikonte që rrethanat ishin të favorshme do të shfrynte hundët që Uinstoni të afrohej, përndryshe ai duhej t'i kalonte pranë sikur nuk e njihte. Por, nëse ishin me fat, mund të bisedonin pa problem ndonjë çerek ore mes turmës dhe të linin një takim tjetër.

- Dhe tani më duhet të largohem, - tha, sapo ai nguliti në mendje udhëzimet. – Më duhet të kthehem në shtatë e gjysmë. Do punoj nja dy orë për Organizatën e Rinisë Kundër Seksit, do

shpërndaj traktate dhe ca gjëra të kësaj natyre. Nuk të duket e tmerrshme? Më rregullon pak flokët? Mos kam ndonjë cifël në flokë? Atëherë, mirupafshim, i dashur, mirupafshim!

U lëshua në krahët e tij, e puthi me vrull, pastaj çau nëpër njomëza dhe u zhduk në pyll pa u ndjerë. Ai nuk e kishte mësuar ende mbiemrin apo adresën e saj. Por s'kishte rëndësi sepse ishte e paimagjinueshme që ata të mund të takoheshin ndonjëherë në shtëpi apo të shkëmbenin letra.

Siç rrodhën ngjarjet ata nuk u takuan më në pyll. Faktikisht, gjatë muajit maj vetëm një herë ia dolën mbanë të bënin dashuri. Kjo ndodhi në një tjetër vend të fshehtë që e dinte Xhulia, kambanorja e një kishe të rrënuar në një vend malor, pothuajse të shkretuar, ku tridhjetë vjetë më parë kishte rënë një bombë atomike. Kur mbërrije vendi qe i sigurt, por rruga që të çonte aty ishte e rrezikshme. Herët e tjera takoheshin vetëm në rrugë, çdo darkë në një vend të ndryshëm dhe jo më shumë se një gjysmë ore për çdo radhë. Në rrugë ishte më e lehtë të flisje. Ndërsa lëviznin përgjatë turmës në trotuare, jo shumë ballazi dhe pa shikuar nga njëri-tjetri, bënin një bisedë të çuditshme me ndërprerje e cila ndizej e shuhej si drita e një fari dhe që pushonte papritmas kur afrohej ndonjë uniformë e Partisë apo kur gjendeshin pranë ndonjë tele-ekrani, për të rifilluar minuta më vonë në mes të fjalisë dhe për t'u lënë në mes tek pika e rënë dakord për t'u ndarë, që të riniste ditën tjetër, pa asnjëlloj hyrjeje, pikërisht aty ku kishte mbetur. Xhulia dukej se ishte mësuar me kësilloj bisedimi të cilin e quante "të folur me këste". Çuditërisht ajo ishte mësuar të fliste pa i lëvizur buzët. Përgjatë gati një muaji arritën të shkëmbenin vetëm një puthje. Po ecnin të heshtur në një rrugë anësore (Xhulia nuk fliste kurrë kur ishin larg rrugëve kryesore) ndërsa dëgjohej një potere shurdhuese, toka gufonte, darka po binte dhe Uinstoni e pa veten në tokë, i mavijosur e i tmerruar. Duhet të kishte rënë ndonjë raketë diku rrotull. Papritur pa fytyrën e Xhulias pak centimetra më tutje të tijës, me bardhësinë e vdekjes, bërë shkumës e bardhë. Edhe buzët i kishte të bardha. Kishte vdekur! E shtrëngoi në gji dhe vuri re se po puthte një fytyrë të ngrohtë dhe të gjallë. Me një lloj pudre në buzë. Buzët e të dyve kishin një veshje të trashë suvaje.

Për shkak të ndonjë patrulle aty pranë apo helikopterit që ndodhej vërdallë sipër kokave, kishte mbrëmje që kur dilnin shëtitje shkëmbeheshin pa bërë asnjë shenjë. Takimi do të kishte qenë i vështirë edhe sikur rreziku të ishte më i vogël. Uinstoni punonte gjashtëdhjetë orë në javë, ndërsa Xhulia edhe më shumë, ndërsa ditët e pushimit të të dyve nuk përputheshin. Sidoqoftë, ndodhte shumë rrallë që Xhulia të kishte ndonjë mbrëmje të lirë. Ajo harxhonte shumë kohë nëpër leksione dhe demonstrata, duke shpërndarë traktate për Organizatën e Rinisë Kundër Seksit, për të përgatitur flamujt e Javës së Urrejtjes, duke bërë koleksione për javën e kursimit dhe kësi aktivitetesh. Barrë që ia vlente qeranë, thoshte ajo: ishte mënyrë maskimi. Në qoftë se respektoje ligjet e vogla, mund të thyeje të rëndësishmit. Madje ishte ajo që e nxiti Uinstonin të punonte me kohë të pjesshme edhe një mbrëmje tjetër në javë në prodhimin e municionit, i cili bëhej në mënyrë vullnetare nga anëtarët e zellshëm të Partisë. Kështu, një mbrëmje për çdo javë, Uinstoni kalonte katër orë në mërzi paralizuese në një magazinë të hapur, të ndriçuar keq, ku përplasjet e çekiçëve përziheshin në mënyrë acaruese me muzikën e tele-ekranit, ku montonte copa metali që ndoshta ishin pjesë të shkrehësit të një bombe.

Kur u takuan në kambanoren e kishës, hapësirat në bisedat e tyre fragmentare ishin mbushur. Qe nje mbasdite përvëluese. Ajri në dhomën e vogël sipër kambanave ishte i ngrohtë dhe i palëvizshëm, të mbyste me erën e glasës së pëllumbave. Të ulur në dyshemenë me pluhur e mbeturina ata folën për orë të tëra ndërsa here pas here njëri ngrihej për të hedhur një sy nga frëngjitë, me frikën mos vinte kush.

Xhulia ishte njëzet e gjashtë vjeçe. Jetonte në një konvikt bashkë me tridhjetë vajza të tjera ("Përherë në pisllëkun e grave! Oh, sa i urrej gratë!" tha si parantezë) dhe, siç Uinstoni e kishte marrë me mend, punonte te makinat që shkruanin romane në Drejtorinë e Trillimit. Puna e saj ishte përdorimi dhe mirëmbajtja e një motori elektrik të fuqishëm, por disi të koklavitur, një punë që e pëlqente. Nuk "ia priste shumë", por i pëlqente të përdorte duart dhe e njihte mirë makinerinë. Ajo ishte në gjendje të

përshkruante gjithë procesin e ndërtimit të një romani, qysh nga direktivat e përgjithshme të lëshuara nga Komiteti i Planit deri tek korrigjimet përfundimtare të Skuadrës së Rishkrimit. Ndërsa kopja përfundimtare nuk i interesonte. "Nuk e vras shumë mendjen për të lexuar," – thoshte. Librat ishin një artikull që duhej të prodhohej, si reçeli apo lidhëset e kallçinave.

Xhulias nuk i kujtohej asgjë nga periudha para viteve gjashtëdhjetë dhe i vetmi person që kishte njohur dhe që i kishte folur vazhdimisht për kohën para Revolucionit kishte qenë gjyshi saj i cili ishte zhdukur kur ajo kishte qenë tetë vjeç. Në shkollë kishte qenë kapitene e ekipit të hokejit dhe kishte fituar kupën e gjimnastikës për dy vjet rresht. Kishte qenë komandante skuadre tek Spiunët dhe, para se të kalonte tek Organizata e Rinisë Kundër Seksit, kishte qenë sekretare e një dege të Organizatës së Rinisë. Gjithonë kishte patur një karakter të mrekullueshëm. Madje ishte zgjedhur (një shenjë e pavdekshme reputacioni të mirë) që të punonte në Pornosek, nëndarje e Drejtorisë së Trillimit, e cila bënte pornografi të cilësisë së ulët për t'ua shpërndarë proleve. Punëtorët e Pornosekut e thërrisnin me nofkën Shtëpia e Ndyrë, tha ajo. Aty kishte qëndruar rreth një vit, kishte punuar në prodhimin e broshurave mbështjellë me plastmas të cilat mbanin tituj si *Histori të Forta* apo *Një Natë në Shkollën e Vajzave* dhe që bliheshin me etje nga të rinjtë proletarë të cilët kujtonin se po blenin diçka ilegale.

- Ç'lloj librash janë këto? – pyeti Uinstoni me kureshtje.

- Oh, tërësisht plehra. Vërtetë të mërzitshëm. Vetëm gjashtë fibula qarkullojnë, por që modifikohen pak. Natyrisht, unë qeshë tek kaleidoskopët. Nuk qeshë kurrë në Skuadrën e Rishkrimit. S'më jepet për letërsi, i dashur.

Uinstoni u çudit kur mësoi se punëtorët e Pornosekut, me përjashtim të shefave të departamenteve, ishin vajza. Kjo shpjegohej me faktin se burrat, instiktet e të cilëve janë më pak të kontrolluara se ato të grave, kishte rrezik të shthureshin nën ndikimin e pisllëqeve me të cilat do të punonin.

- Madje aty nuk pëlqehen as gratë e martuara, - shtoi Xhulia. – Vajzat mendohen të jenë të pastra. Sidoqoftë, ti je me një që nuk është.

Marrëdhënien e parë të dashurisë e pati kur ishte gjashtëmbëdhjetë vjeçe, me një anëtar partie gjashtëdhjetë vjeçar që më vonë u vetvra për t'u shmangur arrestimit. "Dhe ishte gjëja më e mirë, - tha Xhulia, - përdryshe gjatë rrëfimeve të tij do të kishte dalë edhe emri im." Qysh atëherë kishte patur shumë lidhje të tjera. Sipas saj jeta ishte e thjeshtë. Njeriu do që të kënaqet; "ata", Partia e kishte fjalën, mundoheshin të të privonin nga kjo; ndërsa ti përpiqeshe t'i shkelje ligjet deri sa të shkonte. Për atë ishte e natyrshme që "ata" të kërkonin të të vidhnin kënaqësinë, ashtu si edhe përpjekjen tënde për të mos u kapur. Xhulia e urrente Partinë, e thoshte këtë me fjalët më të hidhura, por nuk e kritikonte. Përveç rasteve kur kishte të bënte me jetën e saj, asaj nuk i interesonte doktrina e Partisë. Uinstoni vuri re se ajo nuk e përdorte Gjuhën e Re, me përjashtim të atyre fjalëve që kishin hyrë në përdorimin e përditshëm. Nuk kishte dëgjuar kurrë për *Vëllazërinë* dhe nuk besonte në ekzistencën e saj. Çdo lloj revolte kundër Partisë asaj i dukej budallallëk sepse ishin të paracaktuara të dështonin. Zgjuarsi ishte që edhe të shkelje ligjet edhe të mbeteshe gjallë. Uinstoni vriste mendjen sesa vetë si puna e saj mund të gjendeshin në brezin e ri, të rritur në botën e Revolucionit, që s'njihnin gjë tjetër, që e pranonin Partinë si diçka të pandryshueshme, si qiellin për shembull, dhe që nuk rebeloheshin kundër autoritetit të saj, por thjesht i shmangeshin si lepuri qenit.

Mundësinë e martesës nuk e zunë në gojë. Ajo ishte diçka e largët edhe për t'u menduar. Nuk kishte komitet që do të lejonte një martesë të tillë edhe në qoftë se Katerina, gruaja e Uinstonit, të kishte hequr dorë. Nuk ia vlente as si ëndërr me sy hapur.

- Çfarë njeriu ishte jot shoqe? – pyeti Xhulia.

- E ke dëgjuarën fjalën e Gjuhës së Re *mirëmendueshëm*? Pikërisht ashtu ishte: partishmëri e gjallë, e paaftë të kishte qoftë edhe një mendim të keq.

- Jo, atë fjalë nuk e dija, por tani e kam parasysh atë lloj personi.

Uinstoni nisi t'i tregonte për jetën e tij gjatë martesës, por, çuditërisht, ajo i dinte pjesët më të rëndësishme. Ajo nisi t'i

përshkruante mpirjen e trupit të Katerinës sikur ta kishte parë ose ndjerë vetë, mënyrën sesi e shtynte me gjithë fuqinë e saj, madje edhe kur krahët ishin të lidhur rreth trupit të tij. Me Xhulian nuk e kishte vështirë të fliste për gjëra të tilla, pastaj, Katerina kishte pushuar së qeni diçka që dhembte, madje ishte kthyer në një kujtim bezdisës.

- Nuk mund ta duroja më vetëm për një arsye, - tha Uinstoni. I tregoi për ritualin e vogël e të ftohtë që Katerina e kishte detyruar të respektonte një herë në javë. – Ajo e urrente, por nuk kishte zot ta ndalonte për ta bërë. E quante... e merr dot me mend?

- Detyra jonë ndaj Partisë, - tha Xhulia menjëherë.

- Nga e di ti?

- E kam mësuar në shkollë, i dashur. Bisedë për seksin, një herë në javë, për moshat mbi gjashtëmbëdhjetë. Më vonë, në Lëvizjen e Rinisë. Ta ngulitin në kokë përgjatë viteve. Dhe mund të them se në shumicën e rasteve jep rezultat. Natyrisht, nuk mund të jesh e sigurt, njerëzit janë hipokritë të mëdhenj.

Xhulia nisi të thellohej mbi këtë temë. Për të gjithçka sillej rrotull seksualitetit të saj. Kur binte fjala për kësi gjërash ishte shumë e mprehtë. Ndryshe nga Uinstoni, ajo e kishte rrokur kuptimin e puritanizmit të Partisë. Çështja nuk qe se instikti seksual krijonte një botë të vetën jashtë kontrollit të Partisë dhe për rrjedhojë duhej shkatërruar. Më i rëndësishëm ishte fakti që privimi seksual nxiste histerizmin, diçka që ishte e dëshirueshme sepse mund të transformohej në ethe luftarake dhe adhurim të udhëheqësit. Ja si e shpjegoi ajo:

- Kur bëjnë dashuri njerëzit harxhojnë energji, pas aktit lumturohen dhe nuk duan t'ia dinë për asgjë. Partia nuk e duron dot këtë ndjenjë. Ajo do që njeriu të jetë i mbushur me energji gjithë kohës. Tërë këto parakalime poshtë e lart, brohoritjet dhe valëvitjet e flamujve janë seks i pa konsumuar. Në qoftë se njeriu është i lumtur brenda vetes pse duhet të eksitohet për Vëllain e Madh, Planet Tre-Vjeçare, Dy Minutat e Urrejtjes apo gjithë kalbëzimin e saj të mallkuar?

Kjo ishte e vërtetë, mendoi Uinstoni. Midis dlirësisë dhe partishmërisë kishte një lidhje të drejtpërdrejtë. Përndryshe si do

të qe e mundur që frika, urrejtja dhe mendjelehtësia çmendurake e nevojshme në anëtarët e saj, të mbahej në korsinë e duhur, në qoftë se instikti i fuqishëm nuk ndrydhej për t'u përdorur si energji? Impulset seksuale qenë të rrezikshme për Partinë dhe ajo e kishte llogaritur këtë. Edhe me instiktin prindëror Partia kishte punuar të njëjtën marifet. Familja nuk mund të nxirrej jashtë ligjit dhe, faktikisht, njerëzit inkurajoheshin që t'i donin fëmijët e tyre pothuajse si familjet tradicionale. Ndërsa fëmijët mësoheshin në mënyrë sistematike që të ishin kundër prindërve, t'i përgjonin dhe raportonin devijimet e tyre. Si pasojë familja ishte kthyer në një levë të Policisë së Mendimit. Kjo ishte një strategji që të gjithë të ishin të rrethuar nga informatorë të cilët e njihnin objektivin nga afër.

Befas mendimet iu kthyen tek Katerina. Padyshim që ajo do ta kishte denoncuar tek Policia e Mendimit në qoftë se nuk do të kishte qenë aq e trashë saqë nuk e vuri re mungesën e partishmërisë në mendimet e tij. Por ajo që ia ktheu në mendje Katerinën ishte nxehtësia e padurueshme e mbasdites e cila ia kishte mbushur ballin me bulëza djerse. Nisi t'i tregonte Xhulias për diçka që kishte ndodhur, ose që nuk ndodhi, një mbasdite tjetër me zagushi, njëmbëdhjetë vjet të shkuara.

Nuk kishin më shumë se tre ose katër muaj të martuar. Diku në Kent, gjatë një marshimi kishin humbur rrugën. Kishin mbetur veç nja dy minuta larg shokëve, por u futën në një kthesë të gabuar dhe e panë veten buzë një guroreje të vjetër. Një gropë dhjetë apo njëzet metra me fundin gjithë popla. Rrotull nuk kishte frymë njeriu për ta pyetur. Me të kuptuar që kishin ngatërruar rrugën Katerina nisi të shqetësohej. Largimi nga turma e marshuesve, qoftë edhe për një çast, për atë do të thoshte shkelje. Ajo donte që ktheheshin me vrap nga kishin ardhur dhe të kërkonin një drejtim tjetër. Por atë çast Uinstonit i kapi syri ca xhufka bar gjergji, mbirë në të çarat e greminës poshtë tyre. Njëra xhufkë ishte dyngjyrëshe, purpur e errët dhe e kuqe tulle, të dyja dilnin nga e njëjta rrënjë. Uinstoni nuk kishte parë kurrë më parë diçka të tillë dhe thirri edhe Katerinën ta shikonte.

- Katerinë, shiko! Shiko ato lulet atje. Atë tufën afër fundit. E shikon që ka dy ngjyra të ndryshme?

Tashmë ajo kishte nisur të largohej, por u kthye një çast, mjaft e zemëruar. Madje u përkul sipër greminës të shikonte aty ku tregonte gishti i tij. Uinstoni qëndronte pak prapa dhe e kapi për mesi që ta mbante. Atë çast e kuptoi që ishin vetëm. Asnjë frymë njeriu rrotull, asnjë fëshfërimë gjethesh, madje asnjë zog i zgjuar. Rreziku që në vende të tilla të kishte mikrofonë të fshehtë ishte shumë i vogël dhe, edhe nëse kishte, do të kapte vetëm zhurma. Ishte ora më e nxehtë dhe e përgjumur e mbasdites. Mandej mbi ta ranë rrezet e diellit, në fytyrën e Uinstonit shpërtheu djersa. Dhe i lindi një mendim...

- Pse nuk e shtyve? – pyeti Xhulia. – Unë s'do kisha nguruar.

- E di, e dashur, që do ta bëje. Edhe unë do ta bëja po të kisha qenë personi që jam tani. Ndoshta do ta bëja – nuk jam i sigurt.

- Të vjen keq që nuk e bëre?

- Po. Shumicën e kohës, po.

Qenë ulur krah njëri-tjetrit në dyshemenë gjithë pluhur. Ai e shtrëngoi nga vetja. Koka e saj u mbështet në supin e tij, aroma e mrekullueshme e flokëve mposhtte erën e glasave të pëllumbave. Kjo është shumë e re, mendoi, ende kërkon diçka nga jeta, nuk e kupton se të hedhësh në humnerë një person që s'të pëlqen nuk zgjidh asgjë.

- Faktikisht ai veprim nuk do kishte ndryshuar gjë.

- Atëherë pse të vjen keq që nuk e bëre?

- Vetëm ngaqë unë pëlqej pozitiven dhe jo negativen. Nuk mund ta fitojmë këtë ndeshje që po luajmë. Disa dështime janë më të mira se ca të tjera.

Uinstoni e ndieu nga dridhja e supit të saj që ajo mendonte ndryshe. Sa herë që ai thoshte diçka të tillë ajo e kundërshtonte. Nuk e pranonte se është ligj natyror që individi humbet gjithmonë. Në njëfarë mënyre e kuptonte që edhe ajo vetë ishte e humbur, që herët apo vonë Policia e Mendimit do ta kapte dhe do ta vriste, por një pjesë tjetër të trurit të saj besonte që ishte e mundur të krijoje një botë të fshehtë ku mund të jetoje siç të pëlqente. Nevojitej veç fat, dhelpëri dhe guxim. Nuk e kuptonte që lumturia nuk ekzistonte, që fitorja i përkiste të ardhmes, shumë vonë pas vdekjes tënde

dhe se qysh nga momenti që i shpallje luftë Partisë ishte e mira ta mendoje veten si kufomë.

- Ne jemi të vdekurit, - tha Uinstoni.

- S'kemi vdekur akoma, - tha Xhulia me ton prozaik.

- Jo fizikisht. Për gjashtë muaj, një vit – pesë vjet, ma ha mendja. E kam frikë vdekjen. Ti je e re, besoj se duhet të trembesh më shumë se unë. Natyrisht do t'i shmangemi sa të mundemi. Por nuk është ndonjë ndryshim kushedi. Për aq kohë sa qeniet njerëzore mbeten qenie njerëzore, vdekja dhe jeta janë e njëjta gjë.

- Oh, gjepura! Me kë do të flesh në të ardhmen, me mua apo me një skelet? Nuk të pëlqen që je gjallë? Nuk të pëlqen të ndjesh: ky jam unë, kjo është dora ime, kjo është këmba ime, jam i vërtetë, jam solid, jam gjallë! Të pëlqen *kjo*?

Xhulia u përdrodh për trupi dhe ngjeshi kraharorin pas tij. Ai ndieu gjinjtë e saj të pjekur dhe të fortë, që sipër kominosheve. Trupi i saj i dhuronte trupit të tij rini dhe energji.

- Po, më pëlqen, - tha.

- Atëherë, mos fol për vdekjen. Dhe tani dëgjo, i dashur, duhet të planifikojmë takimin tjetër. Fare mirë mund të kthehemi tek ai vendi në pyll. Boll e kemi lënë të çlodhet. Veçse t'i duhet të vish nga rrugë tjetër. E kam planifikuar gjithçka. Hip në tren – shiko, po e vizatoj.

Dhe me natyrën e saj praktike mblodhi ca pluhur ndërsa me një fije kashtë nga një fole pëllumbi nisi të vizatonte në dysheme një hartë.

IV

Uinstoni hodhi një sy rrotull dhomës së vjetër sipër dyqanit të zotit Karrington. Krevati i madh pranë dritares ishte rregulluar, me batanije të vjetra dhe nënkresë pa këllëf. Në buhar punonte ora e modës së vjetër me të dymbëdhjetë numrat në fushë. Në cep, sipër tavolinës së palosshme, mbajtësja e letrave që kishte blerë një javë më parë shndrinte lehtë në gjysmë errësirë.

Në parmakun e oxhakut ndodhej soba me vajguri, një xhezve, dy filxhanë që ia kishte dhënë zoti Karrington. Uinstoni ndezi fitilin dhe vendosi tiganin me ujë të ngrohej. Akrepat e orës tregonin shtatë e njëzet, faktikisht, nëntëmbëdhjetë e njëzetë. Xhulia do të vinte në shtatë e gjysmë.

Marrëzi, marrëzi, thoshte zemra, marrëzi e ndërgjegjshme dhe e pavend. Nga gjithë krimet që mund të bënte një anëtar i Partisë, ky është një nga ata që nuk e fshihje dot. Në fakt, fillimisht ideja i kishte lindur në formën e një imazhi, mbajtësja e letrave prej xhami e pasqyruar në sipërfaqen e tavolinës së palosshme. Siç e kishte parashikuar, zoti Karrington nuk kishte sjellë pengesa për marrjen e dhomës me qera. Sigurisht që ishte i gëzuar për ato pak dollarë që do të fitonte. Dhe as nuk u trondit apo u acarua kur Uinstoni e sqaroi që dhomën e donte për një lidhje dashurie. Përkundrazi, vështroi në gjysmë largësi dhe foli për gjëra të përgjithshme, me një delikatesë të tillë që të linte përshtypjen sikur ishte i padukshëm. Intimiteti, tha, është gjë shumë e çmuar. Të gjithëve u pëlqente të kishin nga një vend për të qëndruar vetëm në raste të veçanta. Dhe kur e siguronin një vend të tillë, ruajtja e sekretit ishte thjesht gjest i natyrshëm për këdo që e dinte.

Me pamjen e një njeriu që do të zhdukej nga ekzistenca, shtoi se shtëpia kishte dy hyrje, njëra prej tyre nga kopshti mbrapa, e cila dilte në rrugicë.

Dikush po këndonte poshtë dritares. Uinstoni vështroi jashtë vjedhurazi i mbrojtur nga perdja prej muslini. Dielli i qershorit ishte ende shumë larg perëndimit, ndërsa poshtë, në oborrin e përmbytur nga rrezet, një grua e stërmadhe, e fortë si një kolonë normane, me llërët ngjyrë kafe në të kuqe dhe një futë liri lidhur për mesi, çapitej vajtje-ardhje midis një magjeje dhe telit të rrobave, duke hapur në tel ca lecka katrore e të bardha të cilat Uinstoni i mori për pelena foshnje. Sa herë që nuk e kishte gojën të zënë me kapëse rrobash, gruaja këndonte me kontra-alto të fuqishme:

Qe veç joshje e pashpresë
Që u shua si ngjyrë prilli
Por vështrimi, fjala dhe ëndrrat që trazuan!
E bënë të vetën zemrën time!

Javën e fundit ajo këngë dëgjohej në çdo cep të Londrës. Ishte një nga këngët e panumërta të prodhuara për prolet nga një nëndarje e Drejtorisë së Muzikës. Teksti i këngës ishte krijuar pa asnjë ndërhyrje njerëzore, vetëm me një instrument që quhej vjershator. Megjithatë gruaja e këndonte me shumë ëndje, sikur donte ta kthente këngën e tmerrshme në një melodi të pëlqyeshme. Uinstoni dëgjonte këngën dhe zvarritjen e këpucëve të saj në pllaka, dëgjonte thirrjet e fëmijëve në rrugë e diku më në largësi një gërhitje të zbehtë trafiku, ndërsa çuditërisht, falë mungesës së tele-ekranit, dhoma i dukej e qetë.

Marrëzi, marrëzi, marrëzi! Mendoi sërish. Nuk mund të imagjinohej që ata ta përdornin këtë vend më shumë se dy-tre javë e të mos kapeshin. Por të dy kishin patur tundimin e fuqishëm për të patur një strehë vërtet të vetën, shtëpi banimi dhe diku afër. Për ca kohë pas takimit në kambanoren e kishës e kishin patur të vështirë të linin takim tjetër. Orët e punës ishin shtuar në mënyrë drastike me rastin e afrimit të Javës së Urrejtjes. Java ishte edhe një

muaj larg, por përgatitjet e gjithëfarshme e të pafundme kërkonin një punë të jashtëzakonshme prej të gjithëve. Më në fund arritën të siguronin një mbasdite të lirë në të njëjtën ditë. Një natë më parë ishin takuar shkarazi në rrugë. Si përherë, Uinstoni pothuajse nuk e vështroi fare Xhulian, por, ndërsa u zhytën mes turmës, nga një vështrim i shpejtë e kuptoi që ajo ishte më e zbehtë se zakonisht.

- U anullua, - mërmëriti ajo, sapo e pa të arsyeshme që nuk e dëgjonte kush. – Për nesër, e kam fjalën.

- Çfarë?

- Nuk vij dot nesër mbasdite.

- Pse?

- Oh, e njëjta arsye. Këtë radhë filloi më herët.

Uinstonit i hipi gjaku në kokë një çast. Gjatë atij muaji që e kishte njohur, natyra e dëshirës së tij për të kishte ndryshuar. Fillimisht në dëshirën e tij kishte patur shumë pak epsh. Hera e parë që kishin bërë dashuri kishte qenë shtysë e vullnetit. Por pas herës së dytë gjërat kishin ndryshuar. Aroma e flokëve, shija e gojës, butësia e lëkurës së saj, duket se kishin depërtuar brenda, ose, të paktën, në ajrin rrotull tij. Takimi ishte kthyer në një nevojë fizike, të cilën ai jo vetëm që e dëshironte, por e shikonte edhe si të drejtën e vet. Kur ajo tha që nuk do të vij, ai pati ndjesinë që e tradhtonte. Por atë çast turma u ngjesh dhe duart e tyre u takuan rastësisht. Xhulia i shtrëngoi majat e gishtave në një mënyrë që tregonte jo dëshirë, por dhembshuri. U kujtua që kur burri jeton me një grua, ky lloj zhgënjimi duhet të jetë një gjendje normale që rishfaqet dhe e përfshiu një lloj ndjeshmërie që nuk e kishte ndier më parë. Dëshiroi të kishin qenë çift i martuar prej dhjetë vjetësh; dëshiroi të shëtiste me të në rrugë ashtu siç bënin atë çast, por hapur dhe pa frikë, duke folur për gjëra të thjeshta e duke blerë vogëlsira për shtëpinë; dhe mbi të gjitha dëshiroi të kishin një shtëpi ku të jetonin vetëm pa detyrimin që të bënin dashuri sa herë që takoheshin. Faktikisht, ideja për të marrë me qera dhomën e zotit Karrington i lindi të nesërmen. Kur ia bëri sugjerimin Xhulias, ajo pranoi me një gatishmëri të paparashikuar. Të dy e dinin që ai veprim ishte çmenduri. Kjo

do të thoshte të shkonin me dëshirë drejt vdekjes. Ndërsa ishte duke pritur në buzë të krevatit, shkoi sërish në mendje qelitë e Ministrisë së Dashurisë. Ai habitej me mënyrën që ky tmerr i paracaktuar shfaqej e zhdukej në mendimet e njeriut. Ishte aty, në të ardhmen, pararendës i vdekjes, si 99-ta vjen para 100-ës. Ishte i pashmangshëm, por mund të vonohej; megjithatë, herë pas here, me kokëfortësi dhe ndërgjegje, njerëzit parapëlqenin ta shkurtonin ndërkohën para se të shfaqej tmerri.

Atë çast u dëgjuan hapa të shpejtë nëpër shkallë. Xhulia hyri me vrull. Në duar kishte një çantë veglash prej kanavace ngjyrë kafe të pistë, si ajo që e kishte parë të mbante kur kalonte poshtë e lart në Ministri. Ai u lëshua drejt saj për ta përqafuar, por ajo u tërhoq me nxitim, pjesërisht ngaqë ende se kishte hequr çantën e veglave.

- Prit një minutë, - i tha. – Më lër të të tregoj çfarë kam sjellë. Mos gjete gjë Kafe Fitorja? Mendova se do kishe sjellë. Lëre mënjanë, sepse nuk do na duhet. Shiko!

Ajo u ul në gjunjë, hapi çantën dhe nxori çelësat e dadove e kaçavidat që ndodheshin në pjesën e sipërme të saj. Poshtë veglave kishte një numër paketash letre të pastër. Paketa e parë ishte ajo që Uinstonit iu duk e njohur. Ishte e mbushur me diçka të rëndë, në trajtë rëre, e cila rrëshqiste kudo që e prekje.

- S'besoj se është sheqer? – tha Uinstoni.

- Sheqer i vërtetë. Jo sakarinë, po sheqer. Ja edhe një bukë – dhe jo buka jonë e qelbur, por bukë e bardhë – dhe një vazo e vogël me reçel. Kjo është një kanaçe qumësht – por shiko! M'u desh ta mbështillja me pëlhurë sepse…

S'qe nevoja të tregonte pse e kishte mbështjellë. Aroma e saj mbushi dhomën, një aromë e fortë që dukej sikur vinte prej fëmijërisë së tij të hershme, të cilën edhe tani mund ta ndeshje tek shpërhapej në ndonjë korridor para se të mbyllej dera, apo që shfaqej në mënyrë misterioze në një rrugë të populluar, një nuhatje e shpejtë dhe zhdukej.

- Kafe, - mërmëriti ai, - kafe e vërtetë.

- Kafe nga ajo që përdorin Besnikët e Partisë. Një kile, - tha ajo.

- Si i gjete gjithë këto gjëra?

- Gjithçka është nga ato që përdorin Besnikët. Atyre maskarenjve nuk u mungon asgjë. Sigurisht që kamarierët, shërbëtorët dhe njerëzit në tërësi, vjedhin – shiko, kam sjellë edhe një pako çaj.

Uinstoni ishte ulur në bisht anash saj. Grisi cepin e paketës.

- Çaj i vërtetë. Jo gjethe manaferre.

- Kohët e fundit çaji ka qenë me bollëk. Nuk e di që kanë pushtuar Indinë? - tha ajo e paqartë. – Por dëgjo, i dashur. Dua që të kthehesh me shpinë nga unë për nja dy minuta. Shko ulu në anën tjetër të krevatit. Mos iu afro dritares. Dhe mos u kthe pa të thënë unë.

Uinstoni vështroi i hutuar përmes perdes prej muslini. Në kopsht gruaja me krahët e kuq vazhdonte të bënte hap rreshtor nga magjja tek teli i rrobave. Nxori dy kapëse të tjera nga goja dhe vazhdoi këngën gjithë pasion:

Thonë se koha i zbut dhimbjet
Thonë se mund të harrosh
Por buzëqeshjet dhe lotët përgjatë viteve
M'i prekin akoma telat e zemrës!

Me sa dukej i dinte përmendësh gjithë pallavrat që thoshte. Zëri i saj melodioz, i ngarkuar me një melankoli të hareshme, ngrihej lart bashkë me ajrin e ëmbël të verës. Të krijohej përshtypja sikur gruaja do të kishte qenë plotësisht e lumtur, sikur ajo mbrëmje qershori të kishte qenë e përjetshme dhe teshat të pafundme, të qëndronte aty për njëmijë vjet, duke nderur pelena e duke kënduar broçkulla. U çudit kur u kujtua që nuk kishte dëgjuar kurrë një anëtar partie të këndonte vetëm dhe në mënyrë spontane. Bile kjo mund të merrej si mungesë partishmërie, eksentrizëm i rrezikshëm, njëlloj si të flisje me vete. Ndoshta njerëzit kishin diçka për të kënduar vetëm kur jetonin në nivele urie.

- Tani mund të kthehesh, - tha Xhulia.

Ai u rrotullua dhe për një çast gati nuk e njohu. E shumta kishte përfytyruar ta shikonte gollomesh. Ndryshimi që kishte ndodhur ishte hutues, madje më shumë se kaq: Xhulia kishte bërë tualet.

Sendet e tualetit i kishte blerë në ndonjë dyqan prolesh. Buzët i kishte ngjyrë vishnjë, mollëzat të kuqe, hundën të pudrosur, madje edhe pjesën poshtë syve e kishte çelur pak. Tualeti nuk ishte bërë me mjeshtëri, por në kësi çështjesh standartet e Uinstonit ishin të ulëta. Kurrë më parë nuk kishte parë apo imagjinuar një anëtare partie me fytyrën të lyer. Përmirësimi i pamjes së saj ishte goditës. Vetëm me ca njolla vendosur në vendet e duhura dhe ajo jo vetëm që ishte bërë më e bukur, por, mbi të gjitha, më femërore. Flokët e shkurtra dhe kominoshet mashkullore e lezetonin edhe më. Ndërsa e rroku në përqafim, një valë violetash sintetike i përmbyti hundën. Iu kujtua gjysmë errësira e kuzhinës së një bodrumi dhe zgavra pa dhëmbë e një gruaje. Edhe ajo kishte përdorur të njëjtin parfum, por atë çast nuk e shqetësonte.

- Edhe parfum! – tha.

- Po, i dashur, edhe parfum. E di çdo të bëj tjetër? Do gjej një fustan të vërtetë dhe do ta vesh në vend të këtyre pantallonave të shëmtuara. Do vesh rroba silku dhe këpucë me taka. Në këtë dhomë do të jem grua dhe jo anëtare partie.

Hoqën rrobat rrëmbimthi dhe u shtrinë në krevatin prej mogani. Për Uinstonin ishte hera e parë që zhvishej lakuriq në sy të saj. Deri më tash atij i kishte ardhur turp për trupin e tij të zbehtë dhe thatanik, me venat e mavijosura në pulpa dhe pjesën e pangjyrë sipër kyçit të këmbës. Nuk kishin çarçafë, por batanija sipër të cilës u shtrinë qe zbutur nga përdorimi i tepërt, ndërsa madhësia dhe elasticiteti i krevatit i çuditi të dy. "Do jetë mbushur me tartabiqe, por kush e çan kokën," – tha Xhulia. Asokohe nuk të zinte syri krevat dopjo, përveçse në shtëpitë e proleve. Uinstoni kishte fjetur në një të tillë kur kishte qenë fëmijë, ndërsa Xhulia, me sa i kujtohej asaj, kurrë.

Fjetën një copë herë. Kur u zgjua Uinstoni, ora kishte shkuar afërsisht nëntë. Nuk lëvizi sepse Xhulia flinte me kokën të mbështetur mbi krahun e tij. Shumica e tualetit të saj kishte kaluar

në fytyrën e tij ose në jastëk, por një e kuqe e lehtë vazhdonte ta lezetonte mollëzën e saj. Një rreze e verdhë e diellit në perëndim ra në fund të krevatit dhe ndriçoi oxhakun ku vlonte xhezveja. Gruaja në kopsht kishte pushuar, ndërsa britmat e zbehta të fëmijëve në rrugë mbërrinin deri në dhomë. Ai vriste mendjen i përhumbur, në kishte qenë normale apo jo një përvojë e tillë në të shkuarën e ndaluar, të shtriheshe në krevat në një mbrëmje të freskët vere, një burrë dhe një grua gollomesh, që bënin dashuri kur u mbushej, që flisnin për çfarë u pëlqente, pa qenë të detyruar të ngriheshin, thjesht qëndronin shtrirë duke dëgjuar tingujt e paqtë të botës jashtë. Kishte patur vërtet një kohë kur kësi gjërash ishin diçka e zakonshme? Xhulia u zgjua, fërkoi sytë, u ngrit në bërryl dhe vështroi nga soba me vajguri.

- Gjysma e ujit ka avulluar, - tha. – Pak më vonë do bëj kafet. Kemi edhe një orë. Kur priten dritat në zonën tuaj?

- Në njëmbëdhjetë e gjysmë.

- Në konvikt fiken në njëmbëdhjetë. Ndërsa dera mbyllet më herët se kaq, sepse... hej! Dil jashtë, ti pisanjos!

Befas ajo u përkul jashtë krevatit, mori një këpucë në dysheme dhe e flaku në cep të dhomës me një zhdërvjelltësi djaloshare, njësoj ashtu siç ai e kishte parë të fërfëllonte fjalorin në fytyrën e Goldshteinit gjatë Dy Minutave të Urrejtjes.

- Çfarë ishte? – pyeti Uinstoni i befasuar.

- Një mi. E pashë që nxori turirin e shpifur te dërrasat. Aty ka një të çarë. Sidoqoftë, ia kalla datën.

- Minj! – mërmëriti Uinstoni. – Në këtë dhomë!

- E ku nuk ka minj, - tha Xhulia me indiferencë ndërsa u shtri sërish. – Në konvikt i gjen edhe në kuzhinë. Ca pjesë të Londrës janë përplot. E di që minjtë sulmojnë fëmijët? Po, po. Në ca nga këto rrugë gratë nuk guxojnë ta lënë fëmijën vetëm as për dhjetë minuta. Minjtë e kafejtë, atë të mëdhenjtë, janë të rrezikshëm. Dhe më e keqja është se kafshët...

- *Mos vazhdo më tej!* – tha Uinstoni me sytë të mbyllur.

- I shtrenjti im! Ti u zbehe krejt. Çfarë ke kështu? Ta shpifin?

- Miu – shkaktari i gjithë tmerreve të botës!

Xhulia u ngjesh pas tij dhe e përfshiu ndër krahë, si të përpiqej ta mbronte me ngohtësinë e kurmit të saj. Uinstoni vazhdoi t'i mbante sytë mbyllur. Për një kohë të gjatë pati ndjesinë se po shikonte një ëndërr të keqe që ishte rishfaqur në jetën e tij here pas here. Pothuajse gjithmonë e njëjta ëndërr. Ai qëndronte përballë një muri prej errësire, ndërsa në anën tjetër të murit gjendej diçka e padurueshme, diçka e tmerrshme për t'u përballur. Ndjenja më e thellë në ëndërr ishte vetëmashtrimi, ngaqë, faktikisht, nuk e dinte se çfarë fshihej mbrapa atij muri prej errësire. Me një përpjekje të stërmundimshme, si të shkulte një gozhdë nga truri i vet, mund ta kishte nxjerrë në dritë atë shqetësim. Përherë zgjohej pa e marrë vesh çfarë ishte, por në njëfarë mënyre, kishte lidhje me atë çfarë Xhulia kishte thënë kur ai e ndaloi.

- Më fal, - i tha, - s'ka asgjë. S'më pëlqejnë minjtë, kjo është e gjitha.

- Mos u mërzit i dashur, nuk do t'i lëmë ato kafshë të ndyra të hyjnë këtu. Para se të ikim do ta shtupoj të çarën me një copë leckë. Ndërsa herës tjetër që të vijmë do sjell ca allçi dhe do ta izoloj tërësisht.

Tashmë çasti i panikut ishte gjysmë i harruar. Me një ndjenjë turpi për çka ndodhi, Uinstoni u ngrit dhe u mbështet pas kokës së krevatit. Xhulia zbriti nga krevati, veshi kominoshet dhe bëri kafen. Aroma që erdhi nga xhezveja ishte aq e fuqishme dhe eksituese saqë ata mbyllën dritaren për të mos ngjallur kureshtjen e kalimtarëve në rrugë. Ajo që e bënte edhe më të mirë ishte ngjyra e mëndafshtë që i jepte sheqeri, diçka që, pas kaq vitesh përdorim të sakarinës, Uinstoni e kishte harruar krejt. Me njërën dorë në xhep dhe një copë bukë me reçel në tjetrën, Xhulia vinte vërdallë nëpër dhomë, vështronte me indiferencë raftin e librave, deklamonte mënyrën më të mirë për të riparuar një tavolinë të palosshme, plandosej në kolltukun e vjetër për të parë në ishte i rehatshëm, dhe kundronte me një lloj habie të këndshme orën absurde me të dymbëdhjetë numrat në fushë. Mandej çoi letërmbajtësen prej qelqi pranë krevatit për ta parë në dritë më të mirë. Uinstoni ia mori nga dora, i mrekulluar si gjithmonë, si me pikat e shiut në dritare.

- Çfarë mendon se është? – pyeti Xhulia.

- S'mendoj se është ndonjë gjë, e kam fjalën që s'besoj se është përdorur ndonjëherë për diçka. Dhe pikërisht për këtë më pëlqen. Është një copë histori që kanë harruar ta ndryshojnë. Një mesazh qysh prej njëqind vjetësh, kuptohet, nëse di ta lexosh.

- Po ajo piktura atje – Xhulia bëri me kokë nga gravura në murin përballë – thua të jetë njëqind vjeçare?

- Më tepër. Ndoshta dyqind, megjithëse është e vështirë ta thuash. Tani është e pamundur të dallosh moshën e diçkaje.

Xhulia u afrua ta këqyrte gravurën nga afër.

- Këtu e nxori kokën brejtësi, - duke shkelmuar jelekun poshtë gravurës. – Ç'është ky vend? Diku e kam parë.

- Kishë, ose ka qenë e tillë. Quhej kisha e Shën Klement Dajnit. – Uinstonit iu kujtua vjersha që i kishte mësuar zoti Karrington dhe, disi me nostalgji, shtoi: Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat e Shën Klementit!

Ajo vazhdoi vjershën duke e lënë gojë hapur:

Më keni borxh tre groshë, thërrasin kambanat
e Shën Martinit,
Kur do të m'i ktheni, pyesin kambanat
e Bejlit të Vjetër...

- S'më kujtohet si vazhdon më tej. Sidoqoftë, vargjet e fundit s'i kam harruar: - Po vjen qiriri të të prijë drejt shtrojës, po vjen hanxhari të të heqë kokën.

Si dy gjysma të një kundërparrulle. Por pas kambanave të " Bejlit të Vjetër" duhet të kishte vargje të tjera. Ndofta mund të nxirrej nga kujtesa e zotit Karrington, në qoftë se frymëzohej me takt.

- Kush ta ka mësuar, - e pyeti ai.

- Gjyshi. E këndonte për mua kur qeshë shumë e vogël. Ai u avullua kur isha tetë vjeçe – ose, le të themi, u zhduk. Habitem se çfarë ka qenë limoni, - shtoi ajo e dyzuar. – Portokalle kam parë. Një frut i rrumbullaktë me gjyrë të verdhë dhe lëkurë të trashë.

- Unë i mbaj mend limonat, - tha Uinstoni. – Në vitet pesëdhjetë ishin sheshit. Një frut i thartë që ta shtrembëronte fytyrën edhe kur i merrje erë.

- Vë bast që gravura ka tartabiqe nga mbrapa, - tha Xhulia. – ndonjë ditë do ta heq për ta pastruar. Besoj se është koha të dalim. Duhet ta heq këtë bojë nga fytyra. Oh, ç'bezdi! Mandej do fshij buzëkuqin nga fytyra jote.

Uinstoni qëndroi shtrirë edhe për pak minuta. Dhoma po errësohej. U kthye drejt dritës dhe kundroi letërmbajtësen prej qelqi. Gjëja më interesante nuk qe pjesa e koralit, por brendësia e vet qelqit. Ishte goxha i thellë, e sërish ishte transparent gati sa ajri. Sikur sipërfaqja e qelqit të ishte qemer i qiellit, një botë e vogël dhe me tërë atmosferën e saj brenda tij. Uinstoni pati parandjenjën se mund të futej brenda atij qelqi dhe u fut vërtet, së bashku me krevatin prej mogani, tavolinën e palosshme, orën, gravurën prej çeliku, dhe vetë letërmbajtësen prej qelqi. Letërmbajtësja ishte dhoma ku ai ndodhej, ndërsa korali qe jeta e tij dhe e Xhulias, të fiksuara në një lloj përjetësie në zemër të koralit.

V

Sajmi ishte zhdukur. Një mëngjes nuk u shfaq në punë; mungesën e tij e komentuan një grusht njerëzish mendjelehtë. Të nesërmen nuk e përmendi kush. Ditën e tretë Uinstoni shkoi në korridorin e Drejtorisë së Arkivave të shikonte tabelën e njoftimeve. Një nga lajmërimet kishte listën e anëtarëve të Komitetit të Shahut, pjesëtar i të cilit kishte qenë edhe Sajmi. Lista dukej e njëjtë me të mëparshmen – asnjë kryq skualifikimi – por kishte një emër më pak. Kaq mjaftonte. Sajmi kishte pushuar së ekzistuari, nuk kishte ekzistuar kurrë.

Dielli të piqte. Në labirintet pa dritare të Ministrisë, kondicionerët në dhoma e mbanin temperaturën normale, por jashtë trotuaret të përzhitnin këmbët, ndërsa ajri i metrosë në orët e ngarkuara ishte lemeri e vërtetë. Përgatitjet për Javën e Urrejtjes ishin në kulmin e tyre, stafet e gjithë ministrive punonin jashtë orarit. Parakalime, takime, parada ushtarake, leksione, shfaqje punësh në dyll, filma, programe për tele-ekranin, gjithçka që kërkonte organizim; duheshin ngritur tribunat, bërë portretet, shkruar parrullat, kompozuar këngët, qarkulluar pëshpëshet, falsifikuar fotot. Sektori i Xhulias në Drejtorinë e Trillimit e kishte lënë mënjanë prodhimin e novelave dhe po nxirrte një seri pamfletesh për mizoritë. Çdo ditë, përveç kohës së punës Uinstoni harxhonte orë të tëra duke kaluar në dorë arkivat e *Times*-it për të ndryshuar e zbukuruar lajme që do të citoheshin në fjalime. Natën vonë, kur turmat e potershme të proleve lëshoheshin në rrugë, qytetin e përfshinte një gjallëri e pa parë. Raketat binin pa pushim, madje shpesh, në largësi dëgjoheshin shpërthime gjigante

që askush nuk dinte ç'qenë ndërkohë që qarkullonin pëshpëshet më të çuditshme.

Melodia e re që do të ishte edhe hymni i Javës së Urrejtjes (Kënga e Urrejtjes, quhej) ishte kompozuar dhe transmetohej pafundësisht në tele-ekrane. Himni kishte një ritëm të vrazhdë, si lehje qeni, që nuk mund të quhej muzikë, por i ngjante rrahjeve të një daulleje. E shoqëruar nga ulërimat e qindra gurmazëve dhe me ritmin e hapit rreshtor të tyre, himni bëhej i llahtarshëm. Prolet e kishin pëlqyer këngën dhe rrugëve në mesnatë ajo konkuronte me këngën ende popullore: *Qe veç një joshje e pashpresë*. Fëmijët e Parsonsve e luanin natë e ditë, në mënyrë të padurueshme, me një krehër dhe një copë letër higjenike. Mbrëmjet e Uinstonit qenë më të ngarkuara se kurrë. Të organizuara nga Parsonsi, skuadrat e vullnetarëve merreshin me zbukurimin e rrugës për Javën e Urrejtjes, ngjitnin flamuj, lyenin afishet, vendosnin shtiza flamujsh mbi çatira, lidhnin, duke rrezikuar të thyenin qafën, banderolat nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Parsonsi mburrej se vetëm Blloku i Fitores do të ekspozonte katërqind metër pëlhurë për flamurë. Elementi i krenarisë së tij, vendaliu i lumtur si laureshë. Vapa dhe puna fizike e shtynin Parsonsin që të vishej me pantallona të shkurtra dhe këmishë të hapur edhe në mbrëmje. Ku nuk e gjeje, shtynte, tërhiqte, qepte, i binte kudhrës, improvizonte, i gjendur me këshilla shoqërore për këdo që takonte, ndërsa trupi i tij vazhdonte të ishte burim i pashterur djerse me aromë djegëse.

Befas, në tërë Londrën ishte shfaqur një afishe e re. Një figurë e llahtarshme e ushtrisë euroaziatike, tre-katër metra e lartë, fytyrë mongoliane pa shprehje, me çizme të mëdha, hapin të shtrirë dhe automatikun krahqafë. Nga çdo pikë që ta shikoje afishen, gryka e automatikut, zmadhuar nga prerja, drejtohej ballazi nga ty. Ishte ngjitur në çdo hapësirë boshe të mureve, madje ua kalonte në numër edhe portreteve të Vëllait të Madh. Prolet që zakonisht ishin apatikë kur binte fjala për luftë, patën periudhën e tërbimit patriotik. Si për të qenë në harmoni me frymën e përgjithshme, raketat kishin vrarë më shumë njerëz se zakonisht. Njëra ra në kinemanë e Stepnit plot me njerëz dhe varrosi qindra syresh poshtë gërmadhave. Gjithë banorët e lagjes dolën në një

funeral të pafundmë i cili vazhdoi me orë të tëra dhe në realitet ishte protestë për të shprehur zemërimin. Një raketë tjetër ra në një djerrinë që përdorej si fushë sporti, copëtoi me dhjetra fëmijë. Pati të tjera demonstrime të acaruara, u dogj portreti i Goldshteinit, me qindra afishe të ushtarit euroaziatik u grisën e u flakën në zjarr dhe në rrëmujë e sipër u vodhën një sërë dyqanesh; pastaj u hap fjala se spiunët i drejtonin raketat me telekomandë, dhe një çifti të moshuarish, për të cilët dyshohej që kishin lidhje gjaku jashtë shtetit, iu dogj shtëpia, ndërsa vetë ata vdiqën nga asfiksia.

Kur shkonin në dhomën sipër dyqanit të zotit Karrington, Xhulia dhe Uinstoni shtriheshin krah njëri-tjetrit të zbuluar, zhveshur cullak nga vapa. Miu nuk ishte dukur më, ndërsa tartabiqet qenë shtuar jashtëzakonisht prej të nxehtit. E pistë apo e pastër, dhoma ishte parajsë. Me të hyrë brenda e spërkatnin çdo gjë me piper të blerë në tregun e zi, flaknin rrobat dhe bënin dashuri me trupat e djersitur, mandej binin për gjumë dhe kur të çoheshin i gjenin tratabiqet të mbledhura gati për kundërsulm.

Katër, pesë, gjashtë – shtatë herë u takuan gjatë qershorit. Uinstoni e kishte lënë xhinin. I qe shuar dëshira për pije. Ishte shëndoshur, malcimi qe zbutur - duke lënë veç një njollë kafe sipër kyçit, krizat e kollës së mëngjesit kishin pushuar. Jeta nuk ishte më e padurueshme si më parë, nevoja për t'u shtirur para kamerës nuk ekzistonte dhe i ishte shuar dëshira për të klithur vetëm fjalë të pista me sa i hante fyti. Tani që kishin gjetur një bazë të fshehtë, e cila u dukej si shtëpia e tyre, nuk i bezdiste as fakti që u duhej të takoheshin në mënyrë të çrregullt e veç dy orë për çdo herë. Ekzistenca e dhomës sipër dyqanit të vjeturinave ishte e ajo që u interesonte. Fakti që dhoma ishte e paprekshme ishte njësoj si të gjendeshin në të. Dhoma ishte planet, një xhep i së shkuarës në të cilën mund të lëviznin edhe kafshët e zhdukura. Zoti Karrington, mendonte Uinstoni, ishte një tjetër kafshë e zhdukur. Zakonisht gjatë rrugës për në katin e dytë, Uinstoni ndalej për të ndërruar ndonjë llaf me zotin Karrington. Plaku dukej se dilte shumë rrallë ose nuk dilte hiç prej dyqanit dhe gati nuk kishte klientë fare. Pothuajse bënte jetën e një fantazme, midis dyqanit të vogël e të errët dhe një kuzhine edhe më të vogël në anën e pasme, ku

gatuante dhe midis të tjerash, në të gjendej një gramafon i lashtë me bori gjigante. Plaku dukej i lumtur që i jepej rasti të bisedonte me dikë. Duke i ardhur vërdallë mallit që s'bënte një grosh, me hundën e gjatë, syzat e trasha dhe supet e kërrusura poshtë xhaketës kadife, ngjante më tepër si koleksionist sesa tregtar. Me një lloj entuziazmi të shuar, vinte në dukje këtë apo atë vjetërsirë – një tapë porcelani të filetuar, kapakun e pikturuar të një kutie të thyer burnoti, një medalion të rremë në të cilin ruhej një fije floku e një foshnje vdekur prej kohësh – pa kërkuar kurrë që Uinstoni t'i blinte, thjesht t'i admironte. Të bisedoje me plakun ishte njësoj si të dëgjoje tingullin e lodhur të një harmonike. Ai kishte nxjerrë nga gollat e kujtesës ca vjersha të tjera. Njëra bënte fjalë për njëzet e katër mëllenja, një tjetër për një lopë me bririn e thyer dhe një tjetër për vdekjen e *Gushkuqit të Gjorë*. "Mendova se mund të të interesojnë," – thoshte me një buzëqeshje me nxitim sa herë që kujtonte një fragment të ri. Por nuk kujtonte më shumë se dy tre vargje nga secila vjershë.

Të dy e dinin – në fakt, nuk u qe shqitur kurrë nga mendja – se ajo që po ndodhte nuk do të zgjaste shumë. Kishte momente kur vdekja dukej po aq e prekshme sa krevati në të cilin qenë shtrirë dhe shtrëngoheshin fort pas njëri-tjetrit me një lloj sensualiteti dëshpërues, si një i dënuar me vdekje që kërkonte të rrokte kafshatën e fundit të kënaqësisë, ndërsa ora donte edhe pesë minuta të binte. Megjithëse kishte edhe momente që ata jo vetëm ndieheshin të sigurt, por ushqenin edhe iluzionin e qëndrueshmërisë. Në fakt, për sa kohë që ndodheshin në atë dhomë, të dy e ndienin që nuk do t'u qasej e keqe. Mbërritja në dhomë ishte e vështirë dhe e rrezikshme, por vetë dhoma ishte vend i shenjtë. Qe si atëherë kur Uinstoni këqyri në thellësi të letërmbajtëses prej xhami, me ndjesinë që ishte e mundur të futeshe në atë botë të qelqtë, dhe pasi të futeshe mund ta kapje kohën. Shpesh përhumbeshin në ëndrra me sy hapur. Sikur fati nuk do të soste kurrë dhe ata do të vazhdonin mashtrimin, thjesht fare, deri ditën e fundit të jetës. Ose Katerina mund të vdiste dhe Uinstoni e Xhulia do martoheshin. Ose do vetëvriteshin së bashku. Ose do të zhdukeshin, do të transformoheshin që të mos i njihte

kush, do të mësonin të flisnin me theksin e proleve, do të gjenin punë në fabrikë dhe do të jetonin periferive. Të dy e dinin që të gjitha këto ishin të kota. Faktikisht nuk kishte rrugëdalje. Ata s'kishin ndërmend të zbatonin as planin më praktik, vetëvrasjen. Të duronin ditë pas dite dhe javë pas jave, të jetonin një jetë pa të ardhme, dukej një instikt i pamposhtshëm, një lloj si mushkëritë që do vazhdojnë të mbushen për sa kohë që do të ketë ajër.

Shpeshherë mendonin që të merrnin pjesë aktive në rebelimin kundër Partisë, por pa e patur idenë se cili ishte hapi i parë. Edhe nëse e famshmja *Vëllazëri* qe reale, ishte e vështirë për të vendosur lidhjet. Ai i tregoi Xhulias për sekretin që ekzistonte, ose që dukej se ekzistonte, mes tij dhe O'Brajënit, shtysën që e përfshinte shpeshherë, t'i afrohej O'Brajënit, t'i deklaronte se ishte armik i Partisë dhe të kërkonte ndihmën e tij. Çuditërisht, ajo nuk e pa këtë si një veprim të nxituar. Xhulia qe mësuar t'i gjykonte njerëzit nga shprehja e fytyrës dhe iu duk normale që Uinstoni mund t'i besonte O'Brajënit vetëm me një shkëmbim vështrimesh. Për më tepër, ajo besonte se të gjithë, ose pothuajse të gjithë, fshehtazi, e urrenin Partinë dhe nuk do nguronin t'i shkelnin ligjet nëse do qenë të mbrojtur. Por ajo nuk pranoi kurrsesi që ekzistonte apo mund të ekzistonte një opozitë e përgjithshme e organizuar. Përrallat rreth Goldshteinit dhe ushtrisë së tij ilegale, tha ajo, ishin veç gjepura të shpikura nga Partia për qëllimet e saj e që duhet t'i besoje. Mitingjet e Partisë apo demonstratat spontane, ku Xhulia kishte bërtitur me sa i hante zëri emrat e njerëzve që s'kishte dëgjuar kurrë dhe që nuk besonte se krimet e tyre qenë të vërteta, nuk mund të numëroheshin. Ndërsa gjatë gjyqeve publike zinte vendin veçmas Organizatës së Rinisë që rrethonte gjykatat nga mëngjesi në darkë, duke thirrur gjatë pushimeve "Vdekje tradhtarëve!" Gjatë Dy Minutave të Urrejtjes, përherë sharjet e saj kundër Goldshteinit dëgjoheshin mbi të tjerët. Megjithatë Xhulia kishte vetëm një ide të mjegullt se kush ishte Goldshteini dhe çfarë doktrine përfaqësonte ai. Ajo ishte rritur pas revolucionit dhe ishte shumë e re për të mbajtur mend betejat ideologjike të viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë. Ajo as nuk mund t'i përfytyronte gjërat si puna e lëvizjes politike të pavarur, e tek e fundit, Partia

ishte e pathyeshme. Partia qe e përjetshme, e pandryshueshme. I vetmi rebelim që mund të bëje ishin shkeljet e fshehta ose, e shumta, akte të izoluara dhune, për shembull, të vrisje dikë apo të hidhje diçka në erë.

Në njëfarë mënyre Xhulia ishte më e kujdeshme se Uinstoni dhe më pak e dyshuar nga Partia. Një herë, kur e solli rasti të përmendej lufta me Euroazinë, Xhulia e habiti Uinstonin me mendimin e saj të thënë krejt natyrshëm se kishte rrezik që lufta të mos bëhej fare. Dhe që kishte shumë mundësi që raketat që binin përditë në Londër të hidheshin nga vetë qevria e Oqeanisë, "për të mbajtur njerëzit të frikësuar". Uinstonit, kjo nuk i kishte shkuar në mendje. Madje ajo e bëri të ndiehej xheloz kur i tha se problemi më i madh i saj gjatë Dy Minutave të Urrejtjes ishte frenimi i të qeshurës. Por ajo i vinte në dyshim mësimet e Partisë vetëm kur ato kishin të bënin me jetën e saj. Shpeshherë ishte e gatshme ta pranonte legjendën zyrtare, vetëm pse dallimi midis të vërtetës dhe gënjeshtrës nuk i dukej i rëndësishëm. Për shembull, ajo besonte - diçka që e kishte mësuar në shkollë - se aeroplanët i kishte shpikur Partia. (Uinstoni u kujtua se kur ai kishte qenë në shkollë, fundi i viteve pesëdhjetë, Partia pretendonte se kishte shpikur vetëm helikopterët; një dekadë më vonë, kur ishte në shkollë Xhulia, Partia pretendonte shpikjen e aeroplanëve; pas një dekade tjetër do pretendonte shpikjen e motorit me avull.) Dhe kur i tha Xhulias që aeroplanët kishin ekzistuar para se të lindte ai, madje shumë kohë para Revolucionit, ajo nuk u habit. Tek e fundit, ç'rëndësi kishte kush e kishte shpikur aeroplanin? Mirëpo ajo që e trallisi Uinstonin ishte fakti, dhe e zbuloi nga një pohim i rastësishëm, se asaj nuk i kujtohej që katër vjetë më parë Oqeania kishte qenë në luftë me Azinë Lindore dhe në paqe me Euroazinë. Ishte shumë e vërtetë që ajo e konsideronte gjithë luftën veç një rrenë, por me sa dukej nuk e kishte vënë re që emri i armikut kishte ndryshuar. "Unë kujtoja se ne kemi qenë në luftë vetëm me Euroazinë," – tha ajo e pasigurt. Kjo e trembi disi Uinstonin. Shpikja e aeroplanit ishte bërë shumë kohë para se të lindte ajo, por ndërrimi i armikut kishte ndodhur

para katër vjetësh, kur ajo ishte vajzë e rritur. Për këtë u grindën rreth një çerek ore. Më në fund ai ia doli mbanë ta detyronte që ajo të kujtohej se dikur armiku kishte qenë Azia Lindore dhe jo Euroazia. Por kjo ishte një çështje që asaj nuk i dukej e rëndësishme.

- Kush e çan kokën? - tha e acaruar. – Luftërat ndjekin njëra-tjetrën, pastaj dihet që lajmet janë gënjeshtra.

Nganjëherë ai i fliste për Drejtorinë e Arkivave dhe për falsifikimet e paturpshme që bëheshin. Xhulias nuk i bënin përshtypje këto fakte. Ajo nuk e shikonte humnerën që, me kthimin e gënjeshtrave në të vërteta, hapej para këmbëve të saj. Uinstoni i tregoi për Xhonsin, Aronsonin, Radhërfordin dhe copën e rëndësishme të gazetës që dikur e kishte prekur me duart e tij. Xhulia reagoi me indiferencë. Madje në fillim nuk pikasi as kuptimin e historisë.

- I kishe shokë? – e pyeti.

- Jo, as nuk i njihja. Ata qenë anëtarë të Besnikëve të Partisë. Pastaj, ishin shumë më të mëdhenj në moshë. Qenë dora e vjetër, para Revolucionit. As si fytyra nuk i njihja mirë.

- Atëherë pse e çan kokën? Gjithë kohën vritet dikush, apo jo?

Ai u mundua ta bënte të kuptonte:

- Ky ishte një rast i veçantë. Nuk ishte çështja se po vritej dikush. A e kupton që e shkuara, duke filluar qysh dje, është nxjerrë jashtë ligjit? Në qoftë se ajo mbijeton diku, atëherë këto janë objekte pa mbishkrime sipër, si puna e xhamit atje. Tashmë ne pothuajse nuk dimë asgjë rreth Revolucionit dhe viteve para tij. Çdo e dhënë është shkatërruar ose falsifikuar, çdo libër është rishkruar, çdo pikturë është ripikturuar, çdo statujë, rrugë dhe godinë është riemëruar, çdo datë është ndryshuar. Dhe procesi vazhdon ditë për ditë, minutë për minutë. Nuk ekziston asgjë veç të tashmes së pafundme ku Partia është e pagabueshme. Natyrisht që unë *e di* se e shkuara është falsifikuar, por nuk do të jem kurrë në gjendje ta vërtetoj, madje as kur e kam bërë vetë falsifikimin. Kur falsifikimi mbaron, dëshmitë zhduken. Të vetmet dëshmi që ekzistojnë gjenden në mendjen time dhe nuk

jam i sigurt në ka njeri tjetër që ka të njëjtat kujtime. Gjatë gjithë jetës time, vetëm në atë rast më ra në dorë dëshmi konkrete *pas* një ngjarjeje – vite më vonë.

- E për çfarë të hyri në punë?

- Për asgjë, sepse e flaka pak minuta më vonë. Por në qoftë se më ndodh sot diçka e tillë, do ta ruaj.

- Unë nuk do ta bëja, - tha Xhulia. – Unë jam e gatshme të rrezikoj, por për diçka që ia vlen, jo për copa gazetash të vjetra. Edhe sikur ta kishe ruajtur, çfarë do bëje me të?

- Ndoshta jo ndonjë gjë të madhe, por ishte dëshmi. Në qoftë se do t'ia kisha treguar kujt, mund të kishte ngjallur ca dyshime. Unë nuk mendoj se mund të përmbysim gjithçka gjatë jetës sonë. Por mund të realizohen vatra rezistence të herëpashershme – grupe të vogëla njerëzish të bashkuar, që rriten vazhdimisht, që lënë mbrapa ca gjurmë prej nga duhet të vazhdojë më tej brezi pasardhës.

- Mua s'më intereson brezi tjetër, i dashur. Unë jam e interesuar veç për ne të dy.

- Ti je rebele vetëm nga mesi e poshtë, - i tha ai.

Xhulias kjo iu duk shumë e mençur dhe e mbështolli me krahë e lumturuar.

Ajo nuk e kishte hiç idenë për degëzimet e doktrinës së Partisë. Sa herë që ai niste t'i fliste për parimet e Anglosocit, *mendimin e dyfishtë*, ndryshimin e të shkuarës, mohimin e realitetit objektiv, ose kur përdorte fjalë të Gjuhës së Re, ajo lodhej e turbullohej dhe thoshte se nuk u kushtonte vëmendje gjërave të tilla. Kur e dije që këto ishin pallavra, përse duhet që ta vrisje mendjen? Ajo dinte kur të brohoriste dhe kur të shante dhe kaq i mjaftonte. Në qoftë se ai këmbëngulte të fliste për gjëra të tilla, Xhulian e zinte gjumi. Ajo ishte nga ata njerëz që i zë gjumi në çdo orë e në çdo pozicion. Duke biseduar me të, Uinstoni e kuptoi sesa e lehtë ishte të shtireshe si besnik i Partisë, ndërkohë që nuk kishe as idenë më të vogël se çfarë ishte besnikëria. Në njëfarë mënyre, pikëpamjet e Partisë u imponoheshin më mirë njerëzve që nuk i kuptonin ato. Ata mund të mashtroheshin të pranonin dhunimin më flagrant të realitetit, sepse ata nuk e

kuptonin poshtërsinë e asaj që kërkohej prej tyre dhe nuk qenë të interesuar për ngjarjet publike që mund vinin re se çfarë ndodhte. Mungesa e aftësisë për të kuptuar i shmangte nga çmendja. Ata gëlltisnin çdo gjë dhe ajo që gëlltisnin nuk i dëmtonte, sepse nuk linte gjë mbrapa, njëlloj si një kokërr misri që kalon pa u tretur në trupin e një zogu.

VI

Më në fund ndodhi. Mesazhi i shumëpritur erdhi. Uinstonit i dukej se gjithë jetën kishte pritur që të ndodhte pikërisht kjo.

Po ecte përgjatë korridorit të Ministrisë dhe ishte pothuajse te vendi ku Xhulia i kishte dhënë copën e letrës, kur ndieu se dikush, më i bëshëm se ai, po ecte mbrapa tij. Ky njeri, cilido që ishte, para se të fliste u kollit lehtë si për ta paralajmëruar. Uinstoni u ndal në mënyrë të beftë dhe u kthye. Ishte O'Brajëni.

Më në fund ishin përballë njëri-tjetrit dhe e vetmja dëshirë që Uinstoni pati ishte t'ia mbathte vrapit. Zemra i rrihte me forcë. Nuk do të ishte në gjendje të fliste. Megjithatë, O'Brajëni vazhdoi të ecte me të njëjtin ritëm, e kapi Uinstonin miqësisht nga krahu dhe kështu ecën përkrah njëri-tjetrit. Ai nisi të fliste me një mirësjellje të veçantë, serioz, gjë që e dallonte nga pjesa më e madhe e Besnikëve të Partisë.

- Shpresoja të gjeja një rast për të biseduar me ty, - tha. – Para ca ditësh lexova një nga artikujt e tu mbi Gjuhën e Re në *Times*. Më duket se ke një interes të veçantë prej studiuesi për Gjuhën e Re?

Uinstoni e mblodhi veten.

- Jo prej studiuesi, - tha. Unë jam veç amator. Nuk është fusha ime. S'kam patur ndonjëherë të bëj me konstruksionin e sotëm të gjuhës.

- Por e shkruan me shumë elegancë, - tha O'Brajëni. – Ky nuk është vetëm opinioni im. Para pak kohësh po bisedoja me shokun tënd i cili padyshim që është ekspert. Për momentin emri i tij nuk më kujtohet.

Sërish zemra e Uinstonit rrahu deri në dhimbje. S'pati asnjë dyshim që e kishte fjalën për Sajmin. Mirëpo Sajmi jo vetëm që kishte vdekur, por qe fshirë, qe kthyer në *joperson*. Ta përmendje atë hapur qe me shumë rrezik. Padyshim që nënkuptimi i O'Brajënit kishte qenë një sinjal, fjalëkalimi. Duke përdorur pak krim mendor O'Brajëni i ktheu të dy në bashkëfajtorë. Vazhduan të ecnin përgjatë korridorit dhe O'Brajëni u ndal për një çast. Me ngrohtësinë e tij të çuditshme dhe çarmatosëse që përcillte me anë të gjesteve, rregulloi syzat sipër hundës. Pastaj vazhdoi:

- Ajo që desha të thoshja është se në artikullin tënd vura re që kishe përdorur dy fjalë të cilat kanë dalë jashtë përdorimit. Por që kanë dalë tani vonë. E ke parë botimin e dhjetë të Fjalorit të Gjuhës së Re?

- Jo, - tha Uinstoni. – Nuk e dija që është botuar. Në Drejtorinë e Arkivave ne vazhdojmë të përdorim botimin e nëntë.

- Ma ha mendja që botimi i dhjetë do edhe pak muaj të dalë. Por ca nga kopjet e para kanë filluar të qarkullojnë. Njërën e kam unë. Ndoshta do të të interesonte t'i hidhje një sy?

- Padyshim, - tha Uinstoni, duke e kuptuar se ku ishte synimi.

- Disa nga ndryshimet e reja janë vërtet të gjetura. Pakësimi i numrit të foljeve – besoj se kjo është pika që do të të pëlqejë më shumë. Shiko, të të dërgoj një mesazh së bashku me fjalorin? Por kam frikë se jam harraq i pandreqshëm për kësi gjërash. Ndoshta mund të vish ta marrësh vetë në shtëpinë time, kur ta shikosh të arsyeshme? Prit. Të të jap adresën.

Ndodheshin përballë tele-ekranit. O'Brajëni, pak me shkujdesje, kërkoi xhepat nga jashtë me duar dhe nxori një bllok shënimesh të vogël me kapak lëkure dhe një stilograf prej ari. Mu poshtë tele-ekranit, në një pozicion të tillë që kushdo që të ishte në anën tjetër të instrumentit mund ta lexonte atë që ai shkruante, O'Brajëni shkarraviti një adresë dhe ia zgjati letrën Uinstonit.

- Zakonisht në shtëpi jam darkave, - tha. – Nëse jo, atëherë fjalorin do të ta japë shërbëtori im.

Dhe u zhduk, duke e lënë Uinstonin me letër në dorë, e cila këtë radhë nuk kishte nevojë të fshihej. Prapëseprapë, e mësoi

përmendësh me kujdes përmbajtjen e saj dhe më vonë e hodhi në vrimën e kujtesës së bashku me letrat e tjera.

Biseda zgjati jo më shumë se dy minuta. Gjithë episodi kishte veç një kuptim të mundshëm. Gjithçka ishte sajuar që Uinstoni të mësonte adresën e O'Brajënit. Kjo ishte e domosdoshme, sepse ishte e pamundur të zbuloje adresën e dikujt pa bërë një hetim të drejtpërdrejtë. Nuk ekzistonte asnjë lloj zyre adresash. "Në qoftë se do të më duash, ja ku më gjen," kjo ishte çfarë O'Brajëni kishte dashur të thoshte. Ndoshta diku në fjalor mund të fshihej ndonjë mesazh. Por sidoqoftë, konspiracioni që kishte ëndërruar ekzistonte dhe tashmë kishte nxjerrë kokën.

E dinte që herët a vonë do t'i duhej t'u bindej urdhrave të O'Brajënit. Ndoshta të nesërmen, ndoshta shumë më vonë – nuk ishte i sigurt. Ajo që po ndodhte ishte vazhdimi i një procesi që kishte filluar vite të shkuara. Hapi i parë kishte qenë një mendim i fshehtë, i pavullnetshëm, hapi i dytë do të ishte hapja e fjalorit. Kishte kaluar nga mendimet tek fjalët dhe nga fjalët tek veprimet. Hapi i fundit ishte diçka që do të ndodhte në Ministrinë e Dashurisë. Diçka që ai e kishte marrë parasysh. Fundi ishte shkruar bashkë me fillimin. Por qe e frikshme, ose më saktë, ishte shija e parë e vdekjes, hapi i parë drejt saj. Edhe kur po bisedonte me O'Brajënin, kur e rroku kuptimin e fjalëve, një drithërimë e akullt i kishtë përfshirë trupin. Pati ndjesinë sikur futej në ftohtësinë e një varri dhe fakti që e kishte ditur se ai varr e kishte pritur, nuk i lehtësonte gjërat.

Uinstoni u zgjua me sytë mbushur me lotë. Xhulia u rrotullua përgjumësh duke u fërkuar pas trupit të tij e duke mërmëritur diçka si:

- Çfarë ke?

- Pashë në ëndërr... - nisi ai, dhe ndaloi. Ishte diçka e vështirë për t'u shprehur me fjalë. Nuk ishte vetëm ëndrra, por edhe një kujtim i lidhur me këtë ëndërr që i vërshoi në mendje sapo u zgjua.

Uinstoni ndenji shtrirë me sytë të mbyllur, ende i njomur nga atmosfera e ëndrrës. Një ëndërr e madhe plot dritë në të cilin i dilte para syve gjithë jeta e tij, si peizazhi në një mbrëmje vere pas shiut. Gjithçka ishte shfaqur brenda letërmbajtëses prej qelqi, por sipërfaqja e xhamit ishte kupa e qiellit dhe gjithçka brenda kupës që e larë nga drita e butë falë së cilës dalloheshin qartë largësi të pafundme. Ëndrra kishte qenë e lexueshme, gjithë-gjithë përbëhej nga një lëvizje e dorës së nënës së tij, e përsëritur sërish tridhjetë vjet më vonë nga një grua çifute që e kishte parë në lajme, e cila përpiqej të mbronte një djalë të vogël nga plumbat, para se të dy së bashku të sharroheshin nga breshëritë e helikopterëve.

- A e di, - tha ai, - që deri këtë çast besoja që nënën time e kisha vrarë unë.

- Pse e vrave? – pyeti Xhulia përgjumësh.

- Nuk e vrava fizikisht.

Në ëndërr i qe kujtuar pamja e fundit e nënës dhe shumë shpejt pas zgjimit iu rikthyen gjithë hollësitë e tjera. Ishte një kujtim që e kishte shmangur qëllimisht nga vetëdija e tij. Për datën nuk

ishte i sigurt, por besonte se në kohën e ngjarjes nuk kishte qenë më i madh se dhjetë ose dymbëdhjetë vjeç.

Babai ishte zhdukur kohë më përpara; nuk i kujtohej me saktësi. Ajo çfarë mbante mend më mirë ishte situata e trazuar dhe rrëmuja e asaj kohe: paniku i përhershëm i bombardimeve ajrore dhe strehimi në stacionet e metrosë, grumbujt e rrënojave gjithandej, shpalljet e pakuptueshme ngjitur nëpër kthesa rrugësh, bandat e të rinjve – të gjithë veshur me këmisha të së njëjtës ngjyrë, radhët e pafundme tek furrat, breshëritë e herëpashershme të automatikëve – dhe mbi të gjitha, fakti që ushqimi ishte i pamjaftueshëm. I kujtoheshin mbasditet e gjata që, bashkë me moshatarët e tjerë, kalonte rreth kazanëve dhe togjeve me mbeturina, duke mbledhur kërcenjtë e gjetheve të lulelakrës, lëkurat e patateve, herë-herë edhe kore buke të cilat i pastronin me kujdes nga zgjyra; dhe pritja e kamionëve që thuhej se transportonin ushqim për lopët dhe që kalonin nga një rrugë e caktuar në pjesët delikate të së cilës shkëpusnin thela asfalti nga trondítjet.

Kur u zhduk babai, nëna nuk shfaqi habi apo pikëllim të skajshëm, veçse e përfshiu një ndryshim i papritur. Dhe e lanë fuqitë krejt. Edhe Uinstoni e kuptonte që ajo ishte duke pritur që do të ndodhte diçka. Ajo bëri gjithçka që ishte e nevojshme – gatoi, lau, pastroi, rregulloi krevatin, fshiu dyshemenë, fshiu pluhurat e buharit – përherë me ngadalë dhe çuditërisht pa lëvizje të tepërta, si një model artisti që lëvizte pas qejfit. Trupi i saj i bëshëm rikthehej natyrshëm në pasivitet. Mund të rrinte pa lëvizur në krevat me orë të tëra, duke u kujdesur për të bijën, e imët, e sëmurë dhe shumë e qetë, dy ose tre vjeçe, bërë kockë e lëkurë. Më të rrallë e merrte Uinstonin ndër krahë dhe e shtrëngonte në gji pa thënë asnjë fjalë për një kohë të gjatë. Pavarësisht moshës dhe moskokëçarjes së tij, ai e shikonte që kjo gjendje ishte në njëfarë mënyre e lidhur me atë që do të ndodhte dhe që nuk u përmend kurrë.

Kujtoi shtëpinë në të cilën jetonin, një dhomë e errët dhe gati kutërbuese gjysmën e së cilës e zinte një krevat me mbulesë të bardhë. Në parmakun e oxhakut kishte një furnelë me gaz dhe një raft ushqimesh, ndërsa kur zbrisje jashtë kishte një lavaman

balte ngjyrë kafe, i përbashkët për të gjitha dhomat. Kujtoi trupin si statujë të nënës ndërsa përkulej tek furnela për të trazuar diçka në tenxhere. Dhe mbi të gjitha kujtoi urinë e tij të vazhdueshme, betejat e turpshme dhe të ashpra gjatë kohës së ngrënies. Pastaj kujtoi sesi e lodhte nënën duke i kërkuar papushim të dinte pse nuk kishte ushqim, sesi i bërtiste dhe i gërthiste (madje i kujtohej edhe toni i zërit të tij, që kishte filluar të trashej para kohe e nganjëherë gjëmonte në një mënyrë të veçantë), ose sesi ulerinte gjithë patos në përjekje për të marrë më shumë se racioni i vet. Nëna e merrte të mirëqenë që ai, "djali", duhet të merrte pjesën më të madhe, por ai vazhdimisht kërkonte edhe më pavarësisht pjesës që i jepej. Për çdo vakt ajo i lutej që të mos bëhej egoist dhe të kujtohej se motra ishte e sëmurë që edhe ajo kishte nevojë për ushqim, por më kot. Kur nëna nuk i hidhte më ushqim ai ulërinte, përpiqej ta mbushte lugën në tenxhere me forcë, ose e rrëmbente nga pjata e motrës. E dinte që në këtë mënyrë po i linte ato pa ushqim, por nuk e përmbante dot veten, madje kishte ndjesinë që ishte e drejta e tij të bënte një veprim të tillë. Dukej se uria tekanjoze e stomakut e justifikonte sjelljen e tij. Në kohën ndërmjet vakteve, në qoftë se nëna nuk vigjëlonte, ai përpiqej vazhdimisht të vidhte ushqimet e pakta në raft.

Një ditë morën racionin e çokollatës. Kishte javë ose muaj që nuk kishin marrë asgjë. E kujtonte fare qartë atë kafshatë të vogël dhe të çmuar çokollate. Për të tre racioni ishte një pllakë dy ons[1] (onsi përdorej ende). S'donte mend që duhej ndarë në tre pjesë. Por befas, sikur po dëgjonte dikë tjetër, Uinstoni dëgjoi veten tek kërkonte me një zë të lartë kumbues që t'i jepej atij gjithë çokollata. Nëna e qortoi të mos tregohej i babëzitur. Pati një grindje të gjatë e prekëse, me britma, ulërima, lotë, ankime, e pazarllëqe. Motra imcake, që mbahej me të dy duart pas të ëmës, pa asnjë dallim nga këlyshët e majmunëve, e vështronte qysh sipër supeve të nënës, me sy të mëdhenj e të trishtuar. Nëna theu tre të katërtat e çokollatës dhe ia dha Uinstonit ndërsa pjesën tjetër ia dha motrës. Vajza e mori çokollatën dhe e këqyrte me vëmendje, ndoshta nuk e dinte

1 - Njësi matëse 1 ons = 28.3 gr (shën. i përkth.)

çfarë ishte. Uinstoni vështroi motrën për një çast. Mandej, me një shpërthim të beftë, ia rrëmbeu çokollatën nga duart dhe u lëshua me vrik drejt derës.

- Uinston! Uinston! – thirri nëna ndërsa e ndiqte. – Kthehu! Jepja çokollatën motrës!

Uinstoni ndaloi, por nuk u kthye. Sytë e shqetësuar të nënës u fiksuan në fytyrën e tij. Edhe tani mendonte për atë që ishte gati të ndodhte dhe ai nuk e dinte. Ndërsa motra, e vetëdijshme që i qe vjedhur diçka, shpërtheu në një të qarë të mekët. Nëna e mbështolli me krahë dhe e shtrëngoi në kraharor. Diçka tek ky veprim i kumtoi Uinstonit se motra po vdiste. U rrotullua dhe vrapoi nëpër shkallë, me çokollatën që i ngjitej nëpër duar.

Qysh atëherë Uinstoni nuk e pa më nënën. Pasi e përlau çokallatën, pati njëfarë ndjesie turpi nga vetja dhe u vërdallos rrugëve për një kohë të gjatë, derisa uria e ktheu në shtëpi. Asgjë nuk kishte lëvizur nga dhoma, përveç nënës dhe motrës. Ato nuk kishin marrë asnjë rrobë, bile as pallton e nënës. Kurrë nuk e mësoi me siguri që nëna kishte vdekur. Kishte shumë mundësi që të ishte dërguar në kamp me punë të detyruar. Ndërsa motrën, ashtu si vetë atë, mund ta kishin dërguar në ndonjë nga kolonitë e fëmijëve të pastrehë (që quheshin Qendrat e Rehabilitimit) të cilat, për pasojë të luftës civile, ishin shtuar; ose mund të ishte dërguar bashkë me nënën në kampin me punë të detyruar, ose thjesht e kishin lënë të vdiste diku.

Ëndërra ishte ende e freskët në mendjen e tij, sidomos lëvizja mbrojtëse e krahut në të cilën dukej se fshihej gjithë kuptimi i saj. E kaloi mendjen tek një ëndërr e dy muajve të shkuar. Pikërisht ashtu siç nëna ishte ulur në krevatin me mbulesë të bardhë e të pistë, me fëmijën mbërthyer pas saj, po ashtu, gjithnjë me sytë nga ai, ishte ulur në anijen që mbytej poshtë tij, që zhytej çast pas çasti, në ujin që errësohej.

Uinstoni i tregoi Xhulias historinë e zhdukjes së nënës. Pa i hapur sytë, ajo u rrotullua dhe gjeti një pozicion më të rehatshëm.

- Besoj se asokohe ke qenë bishë e ndyrë, - tha ajo pa e vrarë mendjen. – Gjithë fëmijët janë ndyrësira.

- Dakord. Por gjithë thelbi i ngjarjes...

Nga frymarrja e saj dukej që Xhulian po e zinte gjumi sërish. Uinstoni do kishte pëlqyer të vazhdonte të fliste për nënën e vet. Nga ato çfarë mbante mend, kishte mendimin se nëna nuk kishte qenë ndonjë grua e jashtëzakonshme, apo inteligjente, mirëpo kishte zotëruar njëfarë fisnikërie, një lloj pastërtie, thjesht ngaqë rregullave të cilave ajo u bindej ishin personale. Ndjenjat e saj qenë të sajat dhe nuk mund të ndryshoheshin nga jashtë. Asaj nuk do t'i kishte shkuar kurrë në mendje që veprimet e pafrytshme ishin të pakuptimta. Në qoftë se e do dikë atëherë ti jep dashuri dhe kur nuk ke gjë tjetër për t'i dhënë, vazhdon t'i japësh dashuri. Kur kishte mbaruar copa e fundit e çokollatës, nëna e kishte marrë vajzën ndër krahë. Ishte një gjest i panevojshëm, që nuk ndryshonte asgjë, që nuk prodhonte çokallatë, që nuk e shmangte dot vdekjen e fëmijës apo të saj, por ishte një veprim që bëhej natyrshëm. Edhe gruaja refugjate në varkë e kishte mbështjellë djalin e vogël në krahë, me një gjest që përballë plumbave nuk ndihmonte më shumë se një fletë letre. Më e tmerrshmja gjë që Partia kishte bërë – ndërsa vidhte realitetin material - ishte përpjekja për të rrënjosur idenë që ndjenjat dhe impulset s'kishin asnjë vlerë. Me të rënë në kthetrat e Partisë, ajo që ndieje apo ajo që nuk ndieje, ajo që bëje apo që nuk bëje, nuk ndryshonte asgjë. Sidoqë vinte puna zhdukeshe, nuk mbetej gjurmë, as jotja as e veprimeve të tua. Fshiheshe tërësisht nga faqja e historisë. E megjithatë, para dy brezash kjo nuk do të kishte patur ndonjë rëndësi themelore, sepse asokohe nuk përpiqej kush të ndryshonte historinë. Njerëzit qeveriseshin nga vlera private që nuk viheshin në diskutim. Marrëdhëniet personale qenë gjithçka, një veprim tërësisht i pafuqishëm, një përqafim, një pikë loti, një fjalë për dikë që jep shpirt, kishin vlerë në vetvete. Befas i ra ndërmend që prolet i kishin ruajtur ato zakone. Ata nuk qenë besnikë ndaj ndonjë partie, kombi apo ideje, ata qenë besnikë ndaj njëri-tjetrit. Për herë të parë në jetën e tij nuk i pa prolet me përbuzje, apo nuk i mendoi thjesht si një forcë e plogët që një ditë do të gjallërohej e do të shpëtonte botën. Prolet kishin mbetur njerëzorë. Nuk ishin ashpërsuar në shpirt. Ata kishin ruajtuar ndjenjat primitive që atij iu desh t'i rimësonte

me përpjekje të vetëdijshme. Ndërsa mendonte pikërisht këtë, pa ndonjë lidhje të dukshme, iu kujtua që pak kohë më parë kishte parë në trotuar një krah të masakruar dhe e kishte gjuajtur me shkelm si të kishte qenë kërcell lulelakre.

- Prolet janë njerëz, - tha me zë të lartë. – Ndërsa ne jo.

- Pse jo? – tha Xhulia që u zgjua sërish.

Uinstoni u mendua një hop.

- Të ka shkuar ndonjëherë në mendje, - tha, - se gjëja më e mirë që mund të bëjmë është të dalim që këtu para se të jetë vonë dhe të mos shihemi më kurrë?

- Po, i dashur, e kam menduar tërë ato herë e megjithatë s'kam për ta bërë diçka të tillë.

- Deri tani na ka ecur, - tha Uinstoni, - por nuk ka për të zgjatur shumë. Ti je e re, dukesh qytetare normale dhe e pafajshme. Në qoftë se qëndron larg njerëzve si puna ime mund të jetosh edhe pesëdhjetë vite të tjera.

- Jo. E kam menduar edhe këtë. Do të bëj atë që do të bësh edhe ti. Mos ma ki frikën. E njoh mirë artin e të jetuarit.

- Bashkë mund të rrimë edhe gjashtë muaj, ndoshta një vit, por është e sigurt që në fund na pret ndarja. E ke llogaritur sesa të vetmuar do të jemi atëherë? Kur të na kapin nuk do të jemi në gjendje të bëjmë asgjë për njëri-tjetrin, asgjë. E pranoj unë apo jo lidhjen tonë, kjo nuk do të ketë rëndësi, ata do të të heqin që do të të heqin qafe. Heshtja apo bashkëpunimi im, nuk do të jetë në gjendje ta shtyjë vdekjen tënde qoftë edhe pesë minuta. Asnjëri prej nesh nuk do ta dijë nëse tjetri është gjallë apo ka vdekur. Nuk do të kemi asnjë lloj fuqie. E rëndësishme është që të mos tradhtojmë njëri-tjetrin, megjithëse edhe kjo nuk do të ndryshojë gjë.

- Në qoftë se e ke fjalën për të pranuar fajin, - tha Xhulia, - duhet ta bëjmë menjëherë. Të gjithë e pranojnë. Nuk reziston dot. Të torturojnë.

- Nuk e kam fjalën për pranimin e fajit. Ajo nuk është tradhti. Nuk ka rëndësi çfarë thua apo nuk thua, rëndësi kanë vetëm ndjenjat. Vetëm në qoftë se më detyrojnë mos të të dua më – kjo është tradhtia e vërtetë.

Xhulia u zhyt në mendime.

- Është e pamundur ta bëjnë një gjë të tillë, - tha më në fund. – E vetmja gjë që nuk e bëjnë dot. Mund të detyrojnë të thuash çdo gjë – *çdo gjë* – por nuk të detyrojnë dot të besosh në të. Ata nuk hyjnë dot brenda teje.

- E drejtë, - tha Uinstoni disi më optimist, - kjo është e vërtetë. Nuk futen dot në zemrën e tjetrit. Në qoftë se e ndiejmë që ia vlen të mbetemi njerëzorë, madje edhe kur kjo nuk sjell asnjë përfitim, atëherë kemi triumfuar ndaj tyre.

Uinstoni solli në mendje tele-ekranin me veshët gjithmonë të ngrehur. Mund të përgjoheshe natë e ditë, por në qoftë se fytyra nuk të tradhtonte ua kishe hedhur. Pavarësisht zgjuarsisë së saj, Partia ende s'kishte arritur të zbulonte se çfarë mendonte qytetari. Ndoshta, kur ishe në duart e tyre, kjo nuk ishte edhe aq e vërtetë. Nuk dihej se çfarë ndodhte brenda Ministrisë së Dashurisë, por mund të hamendësohej: tortura, injeksione, instrumenta të ndjeshme që të regjistronin veprimtarinë nervore, lodhje shkallë-shkallë me anë të pagjumësisë, vetmisë dhe pyetjeve të vazhdueshme. Të paktën faktet nuk mund të fshiheshin. E vërteta mund të dilte në dritë nga hetimi ose mund të pranohej nga ty prej torturave. Ku ishte ndryshimi, në qoftë se nuk kishe qëllim të jetoje, por të mbeteshe njerëzor? Hetuesit nuk mund të t'i ndryshonin ndjenjat: ç'është e vërteta ndjenjat, edhe po të doje, nuk i ndryshoje dot as vetë. Ata mund ta nxirrnin në shesh, deri në hollësitë më të vogla, gjithçka që kishe bërë, thënë ose menduar, por thellësitë e zemrës, sekretet e së cilës as vetë nuk i dije, mbeteshin të paarritshme.

VIII

Ia kishin dalë mbanë, ia kishin dalë mbanë!

Dhoma ku qëndronin ishte e gjatë dhe me një ndriçim të zbehtë. Zëri i tele-ekranit qe ulur, qe kthyer në një mërmërimë; pushi i qilimit me ngjyrë blu të thellë të jepte përshtypjen sikur shkelje mbi kadife. O'Brajëni ishte ulur tek tavolina poshtë një drite jeshile në fund të dhomës, me nga një kapicë letrash në të dy krahët e tij. Nuk e ngriti kokën as kur shërbëtori i futi brenda Xhulian dhe Uinstonin.

Zemra e Uinstonit rrihte aq fort saqë ai pati frikë se nuk do të fliste dot. Nuk mundej të mendonte gjë tjetër veç që ia kishin dalë mbanë, më në fund ia kishin dalë mbanë. Ardhja këtu kishte qenë një veprim i nxituar, ndërsa ardhja së bashku budallallëk me brirë, megjithëse mbërritën nga drejtime të ndryshme dhe u takuan veç tek pragu i shtëpisë së O'Brajënit. Mirëpo, edhe vetë udhëtimi drejt një vendi të tillë ishte luftë nervash. Të shihje nga brenda shtëpinë e njërit prej Besnikëve të Partisë, madje edhe të hyje në atë pjesë të qytetit ku jetonin ata, ishte gjë shumë e rrallë. Gjithçka ishte e frikshme – atmosfera e blloqeve të pallateve, bollëku dhe madhështia e çdo gjëje, aroma e panjohur e ushqimit dhe duhanit cilësor, rrëshqitja poshtë e lartë pa zhurmë e ashensorëve me shpejtësi të pabesueshme, shërbëtorët xhaketabardhë duke nxituar tutje-tëhu. Edhe pse Uinstoni kishte arsye të fortë për vizitën, nuk i shqitej nga mendja frika se mos ndonjë nga rojet me uniformë të zezë i shfaqej në ndonjë qoshe, i kërkonte dokumentat dhe e urdhëronte të largohej. Megjithatë, shërbëtori i O'Brajënit i pranoi pa ngurim. Ishte një burrë shtashkurtër, flokëzi, xhaketëbardhë,

me një fytyrë në formë diamanti krejt pa shprehje, të cilin mund ta merrje për kinez. Korridori përgjatë të cilit u priu ishte shtruar me një qilim të ngushtë, muret të veshur me letër ngjyrë kremi dhe të pastruar për merak. Edhe kjo ishte e frikshme. Uinstonit nuk i kujtohej që të kishte kaluar nëpër ndonjë korridor me mure të panxira nga fërkimet e supet e njerëzve.

O'Brajëni mbante në dorë një copë letër dhe e këqyrte me vëmendje. Fytyra e tij e akullt, e përkulur aq sa mund të shikoje konturin e hundës, dukej e frikshme dhe inteligjente. Qëndroi pa lëvizur ndoshta për njëzet sekonda. Pastaj afroi shkrimoren nga vetja dhe shkroi një mesazh në zhargonin hibrid të Ministrive:

> dok një presje pesë presje shtatë të aprovuara plotshëm ndal sugjerime përmbledhur dok gjashtë mbidyfish qesharake kufi krimmendimi anullo ndal pavazhdim konstruksionshëm bëjtërësor mbiplotë vlerëson makineri lart ndal fund mesazh

Mandej O'Brajëni u ngrit me kujdes dhe eci drejti tyre mbi qilimin e pazhurmë. Hija e tij zyrtare dukej se ishte larguar disi së bashku me fjalët e Gjuhës së Re, por ishte më i zymtë se zakonisht, i pakënaqur që po e shqetësonin. Tmerri që e përfshiu Uinstonin ishte rrjedhojë e një hutimi normal. Edhe mund të kishte gabuar. Çfarë faktesh kishte që O'Brajëni ishte komplotist? Asgjë, veç një shkëmbimi vështrimesh dhe një fjalë shumëkuptimëshe, vetëm përfytyrimet e tij të fshehta me rrënjët në një ëndërr. Tashmë Uinstoni as nuk mund të shtirej se kishte ardhur gjoja për të marrë fjalorin ngaqë ishte e pamundur të justifikohej prania e Xhulias. Ndërsa kaloi pranë tele-ekranit, O'Brajëni dukej se vriste mendjen. Ndalci, u kthye anash dhe shtypi një çelës në mur. U dëgjua një kërcitje e mprehtë dhe zëri pushoi.

Xhulia lëshoi një zë të lehtë, një mërmërimë habie. Befasia ishte aq e madhe sa, edhe mes panikut që e kishte përfshirë, Uinstoni nxitoi të fliste:

- Të lejohet ta fikësh tele-ekranin! – tha.

- Po, - tha O'Brajëni, - më lejohet. E kam atë privilegj.

Tashmë ishin përballë. Trupi i lidhur dilte sipër tyre, ndërsa fytyra e tij vazhdonte të ishte e padeshifrueshme. Priste i vrenjtur që Uinstoni të fliste, por për çfarë? Ai të linte ende përshtypjen se ishte thjesht një njeri i inatosur që e kishin shqetësuar në punë. Heshtje. Pas fikjes së tele-ekranit dhoma kishte rënë në qetësi të thellë. Sekondat fluturonin marramendthi. Uinstoni mezi i rezistonte vështrimit të O'Brajënit. Befas fytyra e zymtë u deformua në trajtën e diçkaje që dukej si sythi i një buzëqeshjeje. O'Brajëni rregulloi syzat me lëvizjen e tij karakteristike.

- Ta them unë, apo do ta thoni ju? – pyeti.

- Do ta them unë, - tha Uinstoni. – Je i sigurt që tele-ekrani është i fikur?

- Po, është fikur gjithçka. Jemi vetëm.

- Ne kemi ardhur...

Uinstoni u ndal ngaqë kuptoi sesa të paqarta ishin motivet e tij. Nuk e kishte idenë se çfarë lloj ndihme donte nga O'Brajëni dhe nuk e kishte të lehtë të thoshte pse kishte ardhur. Vazhdoi, i ndërgjegjshëm që ajo çfarë thoshte mund të tingëllonte edhe e brishtë edhe e rëndësishme:

- Me sa dimë ne ekziston njëfarë veprimtarie e fshehtë, një lloj organizate sekrete që punon kundër Partisë dhe që ju keni lidhje me ta. Ne duam të hyjmë në lidhje me këtë organizatë dhe të punojmë për të. Nuk i besojmë parimet e Anglosocit. Jemi kriminelë mendimi. Edhe shkelës kurore. T'i themi këto se duam që fati ynë të kalojë në duart e tua. Në qoftë se dëshiron të bëjmë ndonjë krim tjetër, jemi gati.

O'Brajëni ndaloi dhe ktheu kokën anash me ndjesinë se dikush kishte hapur derën. Kishte të drejtë, shërbëtori i imët fytyrëverdhë hyri pa trokitur. Uinstoni vuri re që ai mbante një tabaka me një shishe dhe disa gota sipër.

- Martini është yni, - tha O'Brajëni ftohtë. – Martin, silli pijet këtu. Vendosi mbi tavolinë. Na mjaftojnë karriget? Atëherë mund të ulemi dhe të flasim rehat. Martin, merr një karrige për vete. Kjo është çështje serioze. Dhjetë minutat e ardhshme nuk je shërbëtor.

Burri i imët u ul i qetë, ende me pamjen e shërbëtorit, por i kënaqur nga privilegji. Uinstoni e këqyri me bisht të syrit. I bëri përshtypje që jeta e burrit të imët ishte luajtja e një roli dhe fakti që i dukej e rrezikshme ta braktiste atë rol qoftë edhe për një çast. O'Brajëni kapi shishen nga gryka dhe mbushi gotat me një lëng ngjyrë vishnje. Ky lëng ngacmoi kujtesën e Uinstonit në lidhje me diçka të parë shumë vite të shkuara në një mur apo një tavolinë reklamash – një shishe gjigante ndërtuar me drita që lëvizte poshtë e lart dhe derdhte lëngun në një gotë. I parë nga lart lëngu dukej i zi, por në shishe shkëlqente si rubin. Shpërndante një aromë të thartë, por të dashur. Uinstoni pa Xhulian që mori gotën dhe e nuhati me kuriozitetin e saj të çiltër.

- Quhet verë, - tha O'Brajëni me një buzëqeshje të zbehtë. – Patjetër që ke lexuar për të në libra. S'besoj se anëtarët e thjeshtë të Partisë e shohin shpesh. – Mori pamje solemne dhe ngriti gotën: - Mendoj se ia vlen t'ia nisim me një shëndet. Për Udhëheqësin tonë: për Emanuel Goldshteinin.

Uinstoni mori gotën gjithë dëshirë. Ai e njihte verën nga ëndrrat dhe kishte ëndërruar për të. Ashtu si edhe letërmbajtësja prej xhami, apo vjershat e gjysmëharruara të zotit Karrington, vera bënte pjesë në të shkuarën romantike të zhdukur, e dikurshmja siçi pëlqente ta thërriste në mendimet e tij më të fshehta. Pa e ditur pse, verën e kishte përfytyruar me shije të ëmbël, si reçel manaferrash dhe me cilësi dehëse të shpejta. Në fakt, kur e rrëkëlleu, u zhgënjye. E vërteta ishte se pas kaq vitesh xhini e kishte humbur aftësinë e të shijuarit. Uli gotën bosh mbi tavolinë.

- Domethënë, Goldshteini ekziston? – tha.

- Po, ekziston dhe është gjallë. Se ku, nuk e di.

- Po organizata e fshehtë? Ekziston? Nuk është shpikje e Policisë së Mendimit?

- Jo, ekziston vërtet. E quajmë *Vëllazëria*. Nuk keni për të mësuar gjë tjetër veç faktit që *Vëllazëria* ekziston dhe ju jeni anëtarë të saj. Do flasim edhe për atë. – Vështroi orën e tij të dorës. – Edhe për anëtarët e Besnikëve të Partisë nuk është e këshillueshme ta mbajnë fikur tele-ekranin më shumë se gjysmë ore. Nuk duhet të kishit ardhur bashkë dhe duhet të largoheni veçmas. Ti, shoqe -

përkuli kokën nga Xhulia – do të dalësh e para. Kemi edhe rreth njëzet minuta në dispozicion. S'do ta keni bezdi që t'ju bëj disa pyetje të caktuara. Me pak fjalë, për çfarë jeni të përgatitur të bëni?

- Gjithë ç'mund të kemi në dorë, - tha Uinstoni.

O'Brajëni lëvizi pak, u kthye përballë me Uinstonin. Pothuajse e la mënjanë Xhulian duke menduar se Uinstoni do të fliste edhe për të. Kapsalliti sytë një çast dhe nisi të pyeste me zë të ulët e pa shprehje, si të bënte ca pyetje rutinë, një lloj katekizmi, sikur i dinte parakohe shumicën e përgjigjeve.

- Jeni të gatshëm të jepni jetën?

- Po.

- Jeni të gatshëm të bëni vrasje?

- Po.

- Akte sabotimi që mund të shkatojnë vdekjen e qindra njerëzve?

- Po.

- Të shisni vendin tuaj tek armiqtë e jashtëm?

- Po.

- Jeni të gatshëm të mashtroni, falsifikoni, të merrni peng, të korruptoni mendjet e fëmijëve, të shpërndani droga që kthehen në ves, të inkurajoni prostitucionin, të përhapni sëmundjet veneriane – të bëni gjithçka që do të demoralizojë dhe dobësojë forcën e Partisë?

- Po.

- Në qoftë se do ta kërkojnë interesat tona që të hidhni acid sulfurik në fytyrën e fëmijës – jeni të përgatitur për ta bërë këtë?

- Po.

- Jeni të gatshëm të ndërroni identitetin, të jetoni gjithë jetën si kamarierë apo dokerë?

- Po.

- Jeni të gatshëm të vetëvriteni, kur dhe në qoftë se ju urdhërojmë ta bëni këtë?

- Po.

- Jeni të përgatitur të ndaheni e të mos takoheni më kurrë?

- Jo, - ndërhyri Xhulia.

Uinstonit iu duk se kaloi goxha kohë derisa ai u përgjigj. Madje një çast pati përshtypjen se kishte humbur aftësinë e të folurit. Gjuha lëvizte papushim, formonte rrokjet e para të një fjale e pastaj të një tjetre, sërish e sërish. Derisa e shqiptoi nuk e dinte se cilën fjalë do të thoshte.

- Jo, - tha më në fund.

- Bëtë shumë mirë që ma thatë, - tha O'Brajëni. – Është e nevojshme të dimë gjithçka.

O'Brajëni u kthye nga Xhulia dhe, me një zë më me ngjyra, shtoi:

- E kupton që edhe nëse ai mbijeton mund të jetë tjetër person? Mund të detyrohemi t'i japim identitet të ri. Fytyra, lëvizjet, forma e duarve, ngjyra e flokëve – madje edhe zëri do të jetë ndryshe. Kirurgët tanë mund t'i bëjnë njerëzit të mos njihen. Shpesh kjo është e nevojshme. Ka edhe raste kur u presim ndonjë gjymtyrë.

Uinstoni vështoi sërish me bisht të syrit fytyrën mongoliane të Martinit. Nuk pa asnjë vragë. Xhulia ishte zbehur, të paktën qukat kështu e tregonin, megjithatë vazhdonte të përballej me O'Brajënin pa iu dridhur qerpiku. Mërmëriti diçka që me sa dukej ishte miratim.

- Bukur. Atëherë ramë dakord.

Mbi tavolinë kishte një paketë të argjendtë me cigare. Disi i hutuar, O'Brajëni e shtyu drejt të pranishmëve, pastaj mori një për vete dhe u ngrit e filloi të lëvizte tutje-tëhu, sikur në këmbë i vinin më mirë mendimet. Ishin cigare cilësore, të trasha dhe të paketuara mirë, me një letër që ngjante si mëndafsh. O'Brajëni pa orën sërish.

- Martin, ti mund të kthehesh në qilar, - i tha. – Për çerek ore ndizet tele-ekrani. Para se të shkosh, shikoji edhe një herë shokët. Do t'i takosh sërish. Ndërsa unë edhe mund të mos i shoh më.

Pikërisht ashtu siç kishin bërë tek porta kryesore, sytë e zinj të burrit të imët u përpëlitën duke vështruar nga ata. Në veprimet e tij nuk kishte asnjë shenjë miqësie. Po mundohej të fiksonte fytyrat e tyre, pa pikën e interesit për atë që bënte, ose kështu dukej. Atëherë Uinstonit i ra ndërmend se fytyrat sintetike nuk

e ndërronin shprehjen. Martini doli pa folur apo përshëndetur. O'Brajëni bënte ecejake, njërën dorë e kishte futur në xhepin e kominosheve ndërsa me tjetrën mbante cigaren.

- Besoj që e kuptoni se do të luftoni në errësirë, - tha. Përherë në errësirë. Do të merrni dhe zbatoni urdhra pa e ditur pse. Më vonë do t'ju dërgoj një libër prej të cilit do të mësoni natyrën e vërtetë të shoqërisë në të cilën jetojmë dhe mënyrën si do ta shkatërrojmë. Kur të lexoni librin do të bëheni anëtarë të *Vëllazërisë* me të drejta të plota. Por, veç detyrave afatgjata dhe atyre të momentit, nuk do të mësoni asgjë. Mund t'ju them që *Vëllazëria* ekziston, por nuk mund të flas për anëtarësinë e saj, në është disa qindra vetë apo dhjetë milionë. Nga përvoja juaj vetjake nuk do të jeni në gjendje të thoni as që është një duzinë. Do të keni tre-katër bashkëpunëtorë të cilët do të ndryshojnë kohë pas kohe dhe do të zhduken. Meqë ky ishte kontakti juaj i parë, ai do të ruhet. Ju do të merrni urdhra nga unë. Në qoftë se kemi nevojë t'ju kontaktojmë kjo do të bëhet përmes Martinit. Kur të kapeni duhet të tregoni gjithçka. Kjo është e pashmangshme. Por do keni shumë pak për të treguar, vetëm veprimet tuaja. Nuk do të jeni në gjendje të implikoni më shumë se një grusht njerëzish të rëndësishëm. Ndoshta as mua nuk do të më implikoni dot. Megjithëse deri atëherë mund të kem vdekur ose mund të jem kthyer në tjetër njeri, me fytyrë të re.

O'Brajëni vazhdoi të bënte ecejake mbi qilimin e butë. Pavarësisht trupit kaba, lëvizjet e tij kishin një hijeshi të pashoqe, që shfaqej qoftë edhe në mënyrën sesi fuste dorën në xhep apo si mbante cigaren. Më tepër se forcë, ai rrezatonte siguri dhe zgjuarsi me nuanca ironie. Megjithatë, sado i sinqertë që mund të ishte, i mungonte vendosmëria e një fanatiku. Kur fliste për vrasje, vetëvrasje, sëmundje veneriane, gjymtyrë të prera, fytyra të ndryshuara, dukej sikur recitonte. "Kjo është e pashmangshme, - dukej sikur thoshte zëri i tij, - na duhet ta bëjmë, pa na u dridhur qerpiku." Uinstoni nisi ta shikonte O'Brajënin me admirim e dashuri. Për një çast e harroi krejt figurën e Goldshteinit. Kur shikoje supet e fuqishme të O'Brajënit, fytyrën me tiparet açike, e shëmtuar dhe e qytetëruar njëkohësisht, as që të binte në mendje

se ai mund të humbiste. Mund të rrinte i barabartë në krah të çdo strategu dhe të parandiente çdo rrezik. Madje edhe Xhulia ishte mahnitur. Ajo dëgjonte me aq vëmendje sa e harroi fare cigaren që digjej. O'Brajëni vazhdoi:

- Besoj se keni dëgjuar thashetheme për *Vëllazërinë*. S'ka dyshim që keni krijuar përfytyrimin tuaj. Ndoshta keni përfytyruar një organizatë masive komplotistësh që takohen fshehtas nëpër qilarë, që shkarravitin sllogane nëpër mure, që e njohin njëri tjetrin nëpërmjet parrullave ose lëvizjeve të veçanta të duarve. Asgjë nga këto nuk është e vërtetë. S'ka asnjë mënyrë që anëtarët e *Vëllazërisë* ta njohin njëri-tjetrin dhe për çdo anëtar të saj është e vështirë të njohë më shumë se një grusht njerëzish. Edhe sikur vet Goldshteini të binte në duart e Policisë së Mendimit, nuk do të ishte në gjendje t'u jepte listën e plotë apo informacion që mund të çonte në zbulimin e listës së plotë të anëtarëve. Një listë e tillë nuk ekziston. *Vëllazëria* nuk mund të asgjësohet sepse nuk është një organizatë në kuptimin e thjeshtë të fjalës. Ajo që e mban atë të bashkuar është një ide që nuk mund të shkatërrohet. Veç idesë asgjë tjetër nuk do t'ju lidhë me të. As ju anëtarëson kush dhe as ju mbështet njeri. Kur të kapeni s'do t'ju jepet asnjë përkrahje. Ne s'i ndihmojmë shokët. E shumta, kur duhet patjetër që dikujt t'i mbyllet goja, mund të dërgojmë fshehtas brisqe në qeli. Do t'ju duhet të mësoheni të punoni pa shpresë dhe pa fryte. Do punoni, do kapeni, do tregoni gjithçka dhe do vdisni. Këto janë të vetmet rezultate që do të shikoni. Nuk ka asnjë shenjë që mund të ndodhë ndonjë ndryshim i dukshëm sa të jemi gjallë. Jemi të vdekur. Jeta jonë e vërtetë shtrihet në të ardhmen, ku do të shfaqemi si pluhur dhe cifla kokallash. Askush nuk e di sa larg është e ardhmja. Ndoshta një mijë vjet. Tani për tani duhet veç të zgjerojmë zonën e ndikimit pak nga pak. Nuk mund të veprojmë si bashkësi. Veç mund të përhapim dijen tonë nga një individ tek tjetri, brez pas brezi. Ndën hundën e Policisë së Mendimit, s'ka rrugë tjetër.

O'Brajëni heshti dhe vështroi orën për të tretën herë.

- Për ty shoqe është koha të largohesh - i tha Xhulias. Prit. Shishja është ende në mes.

Mbushi të tri gotat dhe ngriti të vetën:

- Për çfarë do ta ngremë këtë radhë? – tha, sërish me të njëjtin vel ironie. – Për qorrollepsjen e Policisë së Mendimit? Për vdekjen e Vëllait të Madh? Për njerëzimin? Për të ardhmen?

- Për të shkuarën, - tha Uinstoni.

- E shkuara është më e çmuar, - e mbështeti O'Brajëni me solemnitet.

Të tre rrëkëllyen gotat, pas pak Xhulia u ngrit të largohej. O'Brajëni mori një kuti të vogël sipër bufesë dhe i zgjati një tabletë të bardhë petashuqe duke e këshilluar ta vinte poshtë gjuhës. Nuk duhet të kundërmosh aromë vere, i tha; punonjësit e ashensorëve qenë shumë të vëmendshëm. Me t'u mbyllur dera, pasi ajo doli, O'Brajëni dukej se e fshiu nga kujtesa. Bëri dhe nja dy hapa tutje-tëhu pastaj ndaloi.

- Duhen sqaruar edhe disa hollësira të tjera, - tha. – Besoj se keni gjetur ndonjë vend të fshehtë?

Uinstoni i foli për dhomën sipër dyqanit të zotit Karrington.

- Hëpërhë mirë e keni. Më vonë do t'ju gjejmë ndonjë vend tjetër. Ndërrimi i shpeshtë i bazave është shumë i rëndësishëm. Ndërkohë unë do t'ju dërgoj një kopje *të librit* – Uinstoni vuri re që edhe O'Brajëni i shqiptonte fjalët sikur të ishin me shkronja italike – Besoj e kupton, librin e Goldshteinit, sa më shpejt të jetë e mundur. Mund të më duhet pak kohë derisa të gjej një kopje. Besoj që e merr me mend që nuk ka shumë kopje në qarkullim. Policia e Mendimit i ndjek dhe i shkatërron po me atë ritëm që ne i prodhojmë. Por më kot. Ai libër nuk mund të zhduket. Edhe sikur kopja e vetme të zhdukej, jemi në gjendje ta riprodhojmë fjalë për fjalë. Me valixhe shkon në punë?

- Përgjithësisht, po.

- Ma përshkruaj pak?

- E zezë, e tejpërdorur, me dy vija.

- E zezë, dy vija, e tejpërdorur – bukur. Në një të ardhme shumë të afërt – nuk mund të them datë të saktë – njëri nga mesazhet në punën tënde të paradites do të ketë një gabim drejtshkrimor, ti do të kërkosh të rishkruhet. Të nesërmen do të shkosh në punë pa valixhe. Gjatë ditës, në rrugë, një burrë që do të të prekë në sup do të thotë: "Më duket se të ka rënë valixhja."

Në valixhen që ai do të të japë do të jetë libri i Goldshteinit. Pas katërmbëdhjetë ditësh duhet ta kthesh.

Për një çast ra heshtja.

- Ke dhe dy minuta kohë për të qëndruar, - tha O'Brajëni. – Do të takohemi përsëri – në qoftë se takohemi...

Uinstoni ngriti sytë dhe e vështroi:

- Në një vend pa errësirë, - tha me hezitim.

O'Brajëni pohoi me kokë, pa kurrfarë habie.

- Në një vend pa errësirë, - tha, sikur ta kishte kapur ku e kishte fjalën Uinstoni. – Ndërkohë, ke ndonjë gjë për të shtuar para se të largohesh? Ndonjë mesazh ose pyetje?

Uinstoni u mendua. Nuk kishte ndonjë gjë për të cilën të pyeste e aq më e paktë ishte dëshira të hapte gojë për të kërkuar gjëra të përgjithshme. Në vend të ndonjë ngjarjeje të lidhur drejtpërdejt me O'Brajënin apo Vëllazërinë, imagjinatën ia pushtoi dhoma e errët ku nëna e tij kishte kaluar ditët e saj të fundit, dhoma sipër dyqanit të zotit Karrington, letërmbajtësja prej qelqi, gravura e çeliktë me kornizën prej dru trëndafili. Dhe pyeti diçka pa lidhje:

- E ke dëgjuar ndonjë herë një vjershë që fillon me vargjet: Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat e Shën Klementit?

O'Brajëni miratoi me kokë sërish dhe e mbaroi gjithë strofën me një hije solemniteti:

Portokalle dhe limona, thërrasin kambanat e Shën Klementit,

Më keni borxh tre groshë, thërrasin kambanat e Shën Martinit,

Kur do m'i ktheni, pyesin kambanat e Bejlit të Vjetër,

Kur të bëhemi të pasura, thonë kambanat e Shorendiçit.

- Ditke edhe vargun e fundit! – u habit Uinstoni.

- Po, e di. Më vjen keq, por tani është koha të largohesh. Prit. Bën mirë të marrësh një nga këto tabletat.

Ndërsa Uinstoni u ngrit, O'Brajëni i zgjati dorën. Shtrëngimi i tij i fuqishëm e shkërmoqi dorën e Uinstonit. Tek dera Uinstoni

ktheu kokën të shikonte, por O'Brajëni dukej se ia kishte nisur punës për ta fshirë nga kujtesa. Ai po priste me dorën sipër çelësit të tele-ekranit të kontrolluar. Përtej tij Uinstoni pa tavolinën e shkrimit me abazhurin jeshil, shkrimoren me zë dhe shportën prej teli dinga me letra. Takimi kishte marrë fund. Për pak sekonda, mendoi Uinstoni, O'Brajëni do të kthehej tek tavolina për të vazhduar punën e tij të rëndësishme në shërbim të Partisë.

IX

Uinstoni ndiehej i xhelatinosur nga lodhja. I xhelatinosur qe fjala e duhur. E shfaqur në mendje papritmas. I dukej se trupi i tij nuk kishte vetëm dobësinë e xhelit, por edhe tejdukshmërinë e tij. Kishte përshtypjen se po të vendoste krahun para syve do të shikonte përmes tij si të ishte prej xhami. Puna e madhe që kishte bërë ia kishte thithur gjithë gjakun dhe lëngjet limfatike dhe e kishte lënë veç me një strukturë të brishtë nervash, kockash dhe lëkure. Gjithçka që shihte i zmadhohej: kominoshet i rëndonin në supe, trotuari i guduliste këmbët, madje edhe hapja dhe mbyllja e krahut i bënte kyçet të kërcisnin.

Si e gjithë Ministria, për pesë ditë kishte punuar më shumë se nëntëdhjetë orë. Deri të nesërmen në mëngjes s'kishte më punë, krejtësisht asnjë lloj pune në shërbim të Partisë. Gjashtë orë mund t'i kalonte në vendstrehim, ndërsa nëntë orët e tjera në shtëpinë e vet. I kujdesshëm nga patrullat, edhe pse e dinte që atë mbasdite nuk do ta shqetësonte kush, ngadalë-ngadalë, u nis drejt shtëpisë së zotit Karrington. Valixhja e rëndë që kishte në dorë përplasej pas gjurit në çdo hap që hidhte, duke i shkaktuar mornica në trup. Në valixhe ishte libri, të cilin e kishte shtënë në dorë qysh prej gjashtë ditës, por nuk e kishte hapur ende, as për një vështrim të shpejtë.

Ditën e gjashtë të javës së Urrejtjes, me mbarimin e procesioneve, klithmave, këngëve, flamujve, afisheve, filmave, punëve në dyll, damdumeve të daulleve dhe piskamave të trumpetave, ritmeve të këmbëve që parakalonin, gërricjeve të zinxhirëve të tankeve, hungërimave të aeroplanëve të organizuar

në kuadrate, breshërive të armëve – gjashtë ditë me kësi gjërash, kur orgazma masive dhe urrejtja për Euroazinë kishte arritur pikën e vlimit, që në qoftë se turma do t'i kishte shtirë në dorë 2000 robërit euroaziatikë që u varën në mënyrë publike ditën e fundit të festimeve padyshim që do t'i kishte bërë copa-copa – pikërisht atë moment u lajmërua se Oqeania nuk ishte në luftë me Euroazinë. Euroazia qe në luftë me me Azinë Lindore. Euroazinë e kishte aleate.

Natyrisht, askush nuk e pranoi ndryshimin që kishte ndodhur. Fare natyrshëm, me dhimbje të madhe dhe në të njëjtën kohë në çdo cep të sheshit, u bë e ditur se armiku ishte Azia Lindore dhe jo Euroazia. Kur ndodhi kjo, Uinstoni qe në një demonstratë në njërin nga sheshet qëndrore të Londrës. Qe natë dhe drita e projektorëve përflakte fytyrat e bardha dhe flamujt ngjyrë vishnjë. Sheshi ishte citë me njerëz, disa mijëra, përfshi edhe një kuadrat me rreth një mijë fëmijë të veshur me uniformat e Spiunëve. Nga një podium veshur me të kuqe, një burrë shtatshkurtër, thatanik, me duar të gjata, kokëgjerë dhe tullac, lëshonte drejt turmës fjalimin e oratorit të Besnikëve të Partisë. I vogël dhe i egër, si Rumpelstilskini[1], shfytyruar nga urrejtja, me njërën dorë shtrëngonte mikrofonin ndërsa me tjetrën - pëllëmba gjigante në fund të parakrahëve kockë e lëkurë – çirrte me thonj ajrin sipër kokës. Zëri i tij, i metalizuar nga amplifikatorët, përcillte drejt turmës një listë mizorish, masakrash, internimesh, bastisjesh, përdhunimesh, torturimesh të të burgosurve, bombardimesh të civilëve, propagande të rreme, agresionesh të padrejta, traktatesh të shkelura. Pasi e dëgjoje s'kishe rrugë tjetër, fillimisht e besoje pastaj çmendeshe. Çdo pak minuta zemërimi i turmës rikthehej në pikën e vlimit ndërsa zëri i oratorit përmbytej nga një klithmë bishash që dilte nga mijëra gurmaze. Klithmat më të egra vinin nga fëmijët e shkollave. Qysh nga fillimi i fjalimit kishin kaluar rreth njëzet minuta ndërsa një lajmëtar u ngjit në tribunë dhe i la folësit një letër në dorë. Ai e hapi pa e ndërprerë fjalimin. Në zërin, gjestet e folësit apo përmbajtjen e fjalimit nuk ndryshoi asgjë,

1 - Personazh negativ i një përralle të vëllezërve Grim.

ndërkohë që emrat e përmendur tash e tutje ishin të tjerë. Pa thënë asnjë fjalë, turmën e përfshiu një valë mirëkuptimi. Oqeania ishte në luftë me Azinë Lindore! Pas pak pati një rrëmujë të madhe. Sheshi qe zbukuruar me flamujt dhe afishet e gabuara! Pothuajse shumica e tyre kishin fytyrat që nuk duhet t'i kishin. Sabotim! Ua kishin hedhur agjentët e Goldshteinit! Më tej vijoi poterja, afishet u shqitën nga muret ndërsa flamujt u shqyen dhe u shkelën me këmbë. Spiunët ndërmorën veprime të rrezikshme, u ngjitën mbi çatira për të prerë banderolat që valëviteshin tek oxhaqet. Gjithçka zgjati dy ose tre minuta. Ende duke shtrënguar mikrofonin nga qafa, me supet përkulur para, me dorën e lirë që gërvishte ajrin, oratori nuk e kishte pushuar fjalimin. Një minutë më vonë, klithmat e egra të zemërimit shpërthyen sërish nga turma. Urrejtja vazhdoi njëlloj si më parë, vetëm se kishte ndërruar objektivi.

Uinstonit i bëri më shumë përshtypje që oratori kishte ndërruar pllakën në mes të fjalisë, pa marrë as frymë dhe pa e cënuar sintaksën. Por atë çast i duhej të merrej me gjëra të tjera. Pikërisht gjatë kohës së rrëmujës, kur griseshin afishet, një burrë fytyrën e të cilit nuk e pa, i pëshpëriti në vesh: "Më falni, më duket se ju ka rënë valixhja." Uinstoni mori valixhen i hutuar pa thënë asnjë fjalë. E dinte që vetëm pas disa ditësh do të kishte kohë ta hapte. Sapo demonstrata mbaroi ai u kthye në Ministrinë e të Vërtetës, megjithëse ishte ora njëmbëdhjetë e gjysmë e natës. Gjithë punonjësit e Ministrisë kishin bërë të njëjtën gjë. Urdhrat që vinin prej tele-ekranit, që ata të ktheheshin në vendet e tyre të punës, pothuajse nuk qenë të nevojshme.

Oqeania qe në luftë me Azinë Lindore: Oqeania kishte qenë në luftë të përhershme me Azinë Lindore. Pjesa më e madhe e dokumenteve politike të pesë viteve të fundit kishin dalë jashtë përdorimit. Raporte dhe arkiva të të gjitha llojeve, gazeta, libra, pamflete, filma, kolona zanore, fotografi – gjithçka duhej të korrigjohej me shpejtësinë e dritës. Megjithëse nuk ishte dhënë asnjë urdhër, dihej se drejtori parashikonte që brenda javës të mos mbetej asnjë gjurmë nga lufta me Euroazinë apo aleanca me Azinë Lindore. Puna ishte e madhe, dhe ajo që e shtonte edhe më barrën ishte fakti që proceset e përfshira nuk thirreshin me emrat e

tyte të vërtetë. Gjithë punonjësit e Drejtorisë së Arkivave punonin nga tetëmbëdhjetë orë në ditë, vetëm me dy ose tre orë gjumë. Dyshekët u nxorën nga bodrumet dhe u shtrinë gjithandej nëpër korridore, ushqimi ishte sanduiç dhe kafe Fitorja që punonjësit e mensës e sillnin në vendet e punës në një karrocë. Çdo herë që largohej në shtëpi për copëherën e tij të gjumit, Uinstoni përpiqej ta linte tavolinën e punës të pastër, dhe sa herë që u kthye, me sytë e skleposur që dhimbnin, e gjente të bardhë si bora nga cilindrat prej letre të cilët gati mbulonin edhe shkrimoren me zë dhe vazhdonin deri në dysheme, prandaj fillimisht vendoste rregull dhe hapte një hapësirë për të punuar. Më e keqja e gjithë të këqijave ishte se puna nuk qe thjesht mekanike. Shpesh kishte vetëm ndërrime emrash me emra të tjerë, por çdo raportim i detajuar i ngjarjeve kërkonte vëmendje dhe imagjinatë. Madje edhe njohuritë gjeografike që nevojiteshin për ta zhvendosur luftën nga njëra pjesë e botës në tjetrën kërkonte shumë punë.

Aty nga dita e tretë filluan t'i dhembnin sytë në mënyrë të padurueshme, ndërsa syzat kishin nevojë të fshiheshin çdo pesë minuta. Qe një përpjekje e përafërt me punën fizike, një punë që kishe të drejtën ta refuzoje, por, parpëseprapë, ishe i pushtuar nga ankthi i detyrimit për ta çuar në fund. Me aq sa atij i kujtohej, fakti se çdo fjalë që shqiptonte në mikrofonin e shkrimores apo çdo fjalë që shkruante ishte gënjeshtër e qëllimshme as që e shqetësonte. Ashtu si për gjithë kolegët, shqetësimi i tij ishte që gënjeshtra të dilte e përsosur. Mëngjesin e ditës së gjashtë vërshimi i cilindrave prej letre filloi të pakësohej. Ndodhte që gjatë gjysmë ore të vinte veç një cilindër, pastaj edhe një, mandej asgjë. Ngado ritmi i punës binte pothuajse në të njëjtën kohë. Një ofshamë e thellë dhe e fshehtë përshkonte gjithë korridorin. Ishte përmbushur një detyrë e rëndësishme e cila nuk do të përmendej kurrë. Nuk gjeje më njerëz që të vërtetonin me fakte që ishte bërë luftë me Euroazinë. Krejt papritur, në orën dymbëdhjetë u dha lajmi që gjithë punonjësit e Ministrisë qenë të lirë deri të nesërmen në mëngjes. Uinstoni, i cili e merrte me vete valixhen ku fshihte *librin* dhe që e kishte mbajtur mes këmbëve gjatë punës e poshtë trupit kur flinte, u

kthye në shtëpi, u rrua dhe gati sa nuk e zuri gjumi në vaskë megjithëse uji nuk ishte edhe aq i ngrohtë.

Uinstoni ngjiti shkallët sipër dyqanit të zotit Karrington me një kërcitje gudulisëse në kyçe. Ndiehej i lodhur, por jo përgjumësh. Hapi dritaren, ndezi furnelën e vogël e të pistë me vajguri, vendosi xhezvenë me ujë të ngrohej për kafe. Xhulia do të vinte nga minuta në minutë, ndëkohë që ishte në shoqërinë e *librit*. U ul në kolltukun e leckosur dhe zgjidhi rripat e valixhes.

Një libër i trashë, me qepje si mosmëkeq, pa emër apo titull në kapak. Edhe shkronjat dukeshin disi të çrregullta. Fletët ishin të grisura në cepa dhe shkëputeshin me lehtësi, dukej që kishte kaluar nëpër shumë duar. Në faqen e parë shkruhej:

TEORIA DHE PRAKTIKA E KOLEKTIVIZMIT OLIGARKIK
nga Emanuel Goldshtein

Uinstoni nisi leximin:

Kapitulli I: *Injoranca është forcë*

Përgjatë rrjedhës së historisë, ndoshta qysh prej fundit të epokës së Neolitit, në botë kanë ekzistuar tre lloje njerëzish: të Sipërmit, të Mesmit, dhe të Poshtmit. Këto grupe janë ndarë në shumë mënyra, janë emërtuar e riemërtuar pafundësisht, nga epoka në epokë, kanë ndryshuar edhe përmasat brenda vetes, edhe qëndrimet karshi njëri-tjetrit, por struktura bazë e shoqërisë nuk është cënuar kurrë. Madje edhe pas përmbysjeve të mëdha apo ndryshimeve të pakorrigjueshme, është vënë re e njëjta ndarje, ashtu si gjiroskopi, pavarësisht sa dhe nga cili krah shtyhet, e rifiton ekuilibrin gjithmonë.

Synimet e këtyre tre grupeve janë tërësisht të papajtueshme...

Uinstoni e ndali leximin, kryesisht për të shijuar faktin që po lexonte rehatshëm dhe i sigurt. Ishte vetëm: pa tele-ekran, pa vesh në vrimën e çelësit, pa shtysën për të parë fshehurazi nga tjetri, pa kujdesin të mbulonte fletën e librit me dorë. Freskia e ëmbël e verës i ledhej pas faqes. Diku prej së largu sosnin britma të zbehta fëmijësh, në dhomë nuk pipëtinte asgjë veç akrepave të orës. U zhyt edhe më në kolltuk dhe i vendosi këmbët sipër parmakut të oxhakut. Hare dhe përjetësi. Befas, siç ndodh kur njeriu e di që do ta lexojë e rilexojë pafundësisht çdo fjalë të një libri, duke shfletuar, u ndal në kapitullin e tretë dhe vazhdoi leximin:

Kapitulli III: Lufta është paqe

Ndarja e botës në tre supershtete qe parashikuar qysh në gjysmën e parë të shekullit të njezetë. Me gëlltitjen e Europës nga Rusia dhe të Perandorisë Britanike nga Amerika, Euroazia dhe Oqeania ishin tashmë dy fuqi të qenësishme. E treta, Azia Lindore, u shfaq si një bashkësi e vetme pas një dekade tjetër luftimesh të turbullta. Kufijtë midis tre supershteteve në disa vende janë të diskutueshëm e në disa vende të tjera variojnë sipas fatit të luftimeve, por në përgjithësi ndjekin ndarjet gjeografike. Euroazia përfshin gjithë pjesën veriore të Europës dhe Azisë, nga Portugalia në ngushticën Bering. Oqeania përfshin dy Amerikat, ishujt e Oqeanit Atlantik së bashku me ishujt britanikë, Australinë dhe pjesën jugore të Afrikës. Azia Lindore, më e vogël se dy të tjerat dhe me kufij perëndimorë disi të paqartë, përmbledh Kinën dhe vendet në jug të saj, ishujt japonezë dhe një pjesë të madhe – përherë në ndryshim - varijueshme të Mançurisë, Mongolisë dhe Tibetit.

Këto tre supershtete janë vazhdimisht në luftë dhe kështu kanë qenë këta njëzet e pesë vjetët e fundit, vetëm se gjithmonë në kombinime të ndryshme. Megjithatë lufta nuk është më një përpjekje e dëshpëruar dhe shfarosëse siç ishte në dekadat e para të shekullit të njëzetë. Tashmë është luftë me synim të kufizuar midis luftëtarësh që e kanë të pamundur shkatërrimin e njëri-tjetrit, nuk

kanë shkaqe materiale për të luftuar dhe dallimet ideologjike mes tyre pothajse nuk ekzistojnë. Kjo nuk do të thotë se lufta ose etja për të fituar, është bërë më pak e përgjakshme apo kalorsiake. Përkundrazi, histeria e luftës është e vazhdueshme dhe universale, veprime si përdhunimi, bastisja, therja e fëmijëve, kthimi i gjithë popullsisë në skllevër, dhuna ndaj të burgosurve e cila përfshin edhe vlimin dhe varrosjen për së gjalli, shihen si gjëra normale, madje nga pala e ushtrisë që i kryen kësi gjërash trajtohen si të lavdërueshme. Në kuptimin fizik në luftë marrin pjesë shumë pak njerëz, më së shumti forca të specializuara, dhe shkaktohen shumë pak viktima. Betejat, në qoftë se ndodh që të bëhet ndonjë, zhvillohen në kufij të mjegullt që njeriu i thjeshtë as nuk mund t'i marrë me mend se ku bien, ose përqark Kështjellës Pluskuese e cila vëzhgon pika strategjike në det të hapur. Në shekujt e qytetërimit më së shumti lufta shfaqet në mungesën e mallrave të konsumit dhe në shpërthimet e herëpashershme të raketave që mund të shkaktojnë disa dhjetra viktima. Në fakt, lufta e ka ndryshuar karakterin e saj. Ose më saktë, arsyet për të cilat nisin luftërat kanë ndryshuar radhë për nga rëndësia. Motivet që gjatë luftërave të mëdha në fillim të shekullit të njëzetë ishin të pranishme në përmasa të vogla, tashmë janë bërë sunduese, njihen në mënyrë të vetëdijshme dhe sipas tyre veprohet.

Të kuptohet natyra e luftës së tanishme – sepse, pavarësisht faktit që palët e përfshira në të ndërrojnë brenda pak viteve, është përherë e njëjta luftë – njeriu duhet ta kuptojë se është e pamundur që të arrihet në një konkluzion përfundimtar. Asnjëri supershtet nuk mund të mposhtet, qoftë edhe nga dy të tjerët së bashku. Të tre janë gati të barabartë, ndërsa mbrojtjet natyrale janë të pakalueshme. Euroazia është e mbrojtur nga hapësirat territoriale të pafundme, Oqeania nga gjerësia e oqeanit Atlantik dhe Paqësor, Azia Lindore nga pjelloria dhe puna e madhe e banorëve të saj. Pastaj, në aspektin material tashmë nuk ka asnjë arsye përse të luftohet. Me krijimin e ekonomive të vetëmjaftueshme, në të cilat prodhimi dhe konsumi mbështetin njëri-tjetrin, kacafytjet për tregje – që

ishin shkaku kryesor për luftërat e mëparshme – kanë marrë fund, ndërsa nevoja për lëndë të parë nuk është më çështje jetë a vdekje. Secili nga supershtetet ka aq shumë sipërfaqe territoriale sa mund t'i sigurojë brenda kufijve të vet gjithë materialet për të cilat ka nevojë. Edhe kur ndonjë luftë bëhet për qëllime ekonomike, qëllimi është sigurimi i forcës punëtore. Midis kufijve të supershteteve që nuk janë nën zotërimin e asnjërës palë në mënyrë të përhershme, shtrihet një katërbrinjësh me këndet në Tangjer, Brazavil, Darvin dhe Hon Kong, në të cilën jeton afërsisht një e pesta e popullsisë së botës. Pikërisht për zotërimin e kësaj hapësire me popullsi të dendur dhe të polit të veriut bëheshin luftërat. Realisht asnjë nga fuqitë nuk e kontrollon tërësisht zonën në fjalë. Disa pjesë të kësaj zone kalojnë dorë më dorë dhe pikërisht zotërimi, me anë të ndonjë tradhtie, i këtyre pjesëve dikton ndryshimet e përhershme të aleancave politike.

Gjithë territoret e diskutuara përmbajnë minerale të çmuara dhe një pjesë e tyre prodhojnë bimë të rëndësishme, për shembull kauçuk, përpunimi i të cilit në vendet e ftohta është shumë i shtrenjtë. Por mbi të gjitha, tërë këto territore janë hambar i një fuqie punëtore të pafundme. Cilado fuqi që kontrollon Afrikën ekuatoriale, ose vendet e Lindjes së Mesme, ose Indinë e Jugut, ose arkipelagun indonezian, shfrytëzon edhe ata dhjetra ose qindra miliona punëtorë të keqpaguar që punojnë pa u lodhur. Banorët e këtyre zonave, pak a shumë të kthyer në skllevër, kalojnë vazhdimisht nga një pushtues tek tjetri, dhe trajtohen si të ishin qymyr apo karburant në garën për armatim, për të pushtuar territore të reja, për të kontrolluar fuqi punëtore më shumë, për të prodhuar armatime më të sofistikuara, për të pushtuar territore të reja, dhe kështu pafundësisht. Ia vlen të theksohet se lufta pothuajse nuk del asnjëherë jashtë kufijve të zonave të diskutueshme. Kufijtë e Euroazisë luhaten midis pjesës së poshtme të Kongos dhe bregdetit verior të Mesdheut; ishujt e Oqeanit Indian pushtohen e ripushtohen në mënyrë ciklike nga Oqeania ose Azia Lindore; vija ndarëse midis Euroazisë dhe Azisë Lindore nuk është asnjëherë e fiksuar; të tria fuqitë synojnë territore të mëdha rreth Polit

të Veriut që në fakt janë territore të pabanueshme e madje të paeksploruara, por balanca e sundimit pothuajse është e barabartë dhe territoret kryesore të secilit supershtet nuk preken nga dhuna. Për më tepër, puna e zhfrytëzuar e banorëve rreth ekuatorit nuk ka ndonjë rëndësi për ekonominë botërore. Ata nuk shtojnë asgjë në kapitalin botëror sepse çfarëdo gjëje që ata prodhojnë përdoret për qëllime lufte, dhe qëllimi për të shpallur një luftë është të fitohet një pozicion më i mirë për të shpallur një luftë tjetër. Me punën e saj popullsia skllave mundëson që të shpejtohet ritmi i luftërave të vazhdueshme, por në qoftë se ata nuk do të ekzistonin, struktura e shoqërisë në rang botëror dhe proceset sipas të cilave ajo funksionon, nuk do të kishin ndonjë dallim thelbësor.

Qëllimi kryesor i luftës moderne (në përputhje me parimet e *mendimit të dyfishtë* ky qëllim njëkohësisht edhe pranohet edhe nuk pranohet, vetëm nga Besnikët e Partisë) është të përdorë prodhimet e makinerive pa e ngritur standartin e përgjithshëm të jetesës. Çështja se çfarë të bëhet me superprodhimin e mallrave të konsumit në vendet e industrializuara ka qenë problem qysh prej mbarimit të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Tani për tani, kur shumë pak njerëz kanë ushqim të mjaftueshëm, problemi nuk është urgjent dhe nuk dotë kishte qenë i tillë edhe sikur të mos vepronte procesi artificial i shkatërrimit. Krahasuar me botën para 1914-ës, bota e sotme është një botë e varfër, e uritur, në shkatërrim e sipër, dhe akoma më keq se kaq, në qoftë se e krahasojmë me të ardhmen që njerëzit e kësaj periudhe përfytyronin. Në fillim të shekullit të njëzetë, imazhi i një bote pabesueshmërisht të pasur, të ngeshme, me rregull dhe funksionale – një botë antiseptike dhe rrëzëllitëse prej xhami, çeliku dhe betoni të bardhë – qe pjesë e vetëdijes së çdo njeriu të arsimuar. Asokohe, meqënëse teknologjia po zhvillohej me shpejtësi marramendëse, dukej e natyrshme që ajo do të vazhdonte të zhvillohej. Por nuk ndodhi kështu, pjesërish nga varfëria që shkaktuan luftërat dhe revolucionet dhe pjesërisht ngaqë përparimi shkencor dhe teknik varej nga mënyra empirike e të menduarit, e cila nuk mund të mbijetojë në shoqëri krejtësisht të kontrolluara. Në përgjithësi, sot

bota është më primitive sesa qe para pesëdhjetë vjetësh. Një pjesë e fushave të prapambetura kanë përparuar, disa mekanizma, më së shumti të lidhura me luftën dhe spiunazhin, janë zhvilluar, por nga ekperimentet dhe shpikjet është hequr dorë, si dhe frika e viteve pesëdhjetë nga lufta atomike ende nuk është zhdukur tërësisht. Prapëseprapë, rreziqet nga makina janë ende të pranishme. Qysh prej momentit që makina u shfaq për herë të parë, për gjithë mendimtarët ishte e qartë se puna e rëndë, dhe për rrjedhojë edhe pabarazia njerëzore, do të zhdukej. Në qoftë se makina do të përdorej pikërisht për atë qëllim, atëherë, uria, puna e tepërt, pisllëku, analfabetizmi dhe sëmundjet do të ishin zhdukur vetëm në pak breza. Në fakt, edhe pa u përdorur për një qëllim të tillë, por vetëm automatikisht – duke prodhuar mall që shpeshherë ishte e pamundur të mos shpërndahej – makina e përmirësoi vërtet standartin e jetesës së njeriut të thjeshtë për një periudhë gati pesëdhjetëvjeçare, fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe fillimi i të njëzetit.

Megjithatë, ishte e qartë se shtimi i gjithanshëm i prodhimit kërcënonte – në njëfarë kuptimi ishte vërtet kërcënim – hierarkinë e shoqërisë. Në një botë ku secili punonte pak orë, kishte ushqim të mjaftueshëm, jetonte në një shtëpi me vaskë e frigorifer, zotëronte një makinë ose një aeroplan, elementët më të dukshëm ose më të rëndësishëm të pabarazisë do të zhdukeshin. Në qoftë se kapitali do të zotërohej nga të gjithë, atëherë nuk do të kishte dallime. Natyrisht që ishte shumë e mundshme të përfytyroje një shoqëri ku *kapitali*, në kuptimin e pronës private dhe luksit, të shpërndahej në mënyrë të barabartë ndërkohë që *pushteti* të mbetej në pak duar të privilegjuara. Por, në praktikë, një shoqëri e tillë nuk do të ishte e qëndrueshme për një kohë të gjatë. Sepse, në qoftë se gjithë njerëzit do të jetonin rehatshëm e të sigurt, masa e madhe e njerëzve, ata që zakonisht i lë analfabetë varfëria, do mësonin dhe do fillonin të mendonin, e me të arritur në këtë pikë, atëherë do ta shikonin që pakica e privilegjuar nuk qe funksionale dhe do ta rrëzonin. Një shoqëri hierarkike mund të ekzistonte për një kohë të gjatë vetëm e bazuar tek varfëria dhe injoranca. Kthimi në të

shkuarën agrokulturore, siç ëndërruan disa mendimtarë në fillim të shekullit të njëzetë, nuk ishte zgjidhje praktike. Kjo binte në kundërshtim me prirjen drejt mekanizimit e cila ishte bërë gjysmë instiktive pothuajse në gjithë botën, e për më tepër, çdo vend që mbetej mbrapa nga ana industriale do të ishte i pafuqishëm ushtarakisht dhe i detyruar të sundohej, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga rivalët e vet më të zhvilluar.

Edhe ideja për të kontrolluar superprodhimin, për të mbajtur të varfra masat e mëdha të popullsisë, nuk ishte zgjidhje e kënaqshme. Kjo mori përmasa të mëdha gjatë fazës përfundimtare të kapitalizmit, afërsisht midis viteve 1920-1940. Ekonomitë e shumë vendeve u ndalën, toka nuk punohej, pajisjet kryesore nuk përmirësoheshin, masa të mëdha njerëzish nuk u lanë të punonin dhe u mbajtën gjallë me ndihma nga shteti. Por edhe kjo solli dobësimin ushtarak dhe meqë pengesat që nxirrte ishin të panevojshme, atëherë përplasjet bëheshin të pashmangshme. Çështja ishte sesi të zhvillohej industria pa e shtuar kapitalin botëror. Të prodhoheshin materiale, por të mos shpërndaheshin. Dhe e vetmja mënyrë për ta realizuar këtë ishin luftërat e vazhdueshme.

Thelbi i një lufte është shkatërrimi, jo me patjetër i jetëve njerëzore, por i prodhimeve të punës së njeriut. Lufta është mënyra për të shfarosur, për të flakur në stratosferë, ose për t'i fundosur në det, materiale që mund të përmirësojnë jetën e masave të cilat për shkak të tyre mund të bëhen inteligjente në të ardhmen. Madje edhe kur armët nuk përdoren, fabrikat vazhdojnë të mbeten një mënyrë komode për të harxhuar fuqi punëtore dhe për të mos prodhuar gjëra për konsum. Për një Kështjellë Pluskuese, për shembull, është harxhuar aq punë sa mund të ishin ndërtuar me dhjetra anije transporti. Ajo nuk ka sjellë kurrë ndonjë të mirë dhe së fundi po trajtohet si e vjetëruar, ndërkohë që me një punë gjigante, po ndërtohet një tjetër Kështjellë Pluskuese. Në parim luftërat planifikohen që të harxhojnë tepricat e prodhimit, pasi janë plotësuar nevojat elementare të popullsisë. Realisht nevojat e popullsisë përherë janë më pak të vlerësuara, e kjo çon në mungesën e përhershme të ushqimeve më të

nevojshme; por kjo shihet si shenjë e mirë. Në sajë të një politike të qëllimshme, edhe grupet e favorizuara mbahen në kufijtë e skamjes, sepse mungesat shtojnë rëndësinë e privilegjeve të vogla dhe zamdhojnë dallimin midis grupeve të ndryshme. Sipas standarteve të fillimit të shekullit të njëzetë, edhe një anëtari të Besnikëve të Partisë i duhej të punonte shumë dhe të bënte jetë të thjeshtë. Prapëseprapë, disa privilegje që ai mund t'i gëzojë sot – shtëpia e madhe dhe me vendosje ideale, prerja me shije e rrobave, cilësia më e mirë e ushqimit, pijeve dhe duhanit, dy tre shërbëtorët, makina personale ose avioni – e vendos atë në një botë krejt tjetër nga ajo e një anëtari të thjeshtë të Partisë dhe anëtarët e thjeshtë kanë të njëjtin avantazh në krahasim me masën e quajtur "prolet". Atmosfera sociale i ngjan një qyteti të rrethuar, ku pasja e një cope mish kali ndan varfërinë nga pasuria. Dhe në të njëjtën kohë, ndërgjegjësimi për faktin e të qenit në luftë, për rrjedhojë në rrezik, e bën të natyrshëm kushtin e pashmangshëm për të mbijetuar, kalimin e pushtetit në duart e një grupi vogël.

Siç do të shihet, lufta jo vetëm që bën shkatërrimin e nevojshëm, por e bën këtë edhe në një mënyrë logjikisht të pranueshme. Në parim do të jetë e lehtë që fuqia punëtore e tepërt të harxhohet për ndërtimin e tempujve dhe piramidave, hapjen gropave dhe rimbushjen e tyre, ose do të prodhohen sasira të mëdha materialesh e pastaj thjesht do të digjen. Megjithatë kjo do të ofrojë bazën ekonomike për hierarkinë shoqërore, por jo bazën emocionale. Kjo nuk nëkupton moralin e masave, qëndrimi i të cilave është i parëndësishëm për aq kohë sa ato mbahen vazhdimisht të zëna me punë, por morali i vetë Partisë. Edhe anëtarët më të thjeshtë të Partisë duhet të jenë të zotët, të palodhur, madje, brenda limiteve të caktuara, edhe intelingjetë, por është po kaq e rëndësishme që të jenë naivë dhe injorantë, tek të cilët duhet të mbizotërojë ndjenja e frikës, urrejtjes, adhurimit dhe triumfit si në orgji. Me fjalë të tjera, duhet të kenë të ngulitur mendësinë e përshtatshme për luftë. Nuk ka rëndësi në bëhet apo nuk bëhet luftë dhe, meqënëse fitorja është e paarritshme, nuk ka rëndësi se cila është ecuria e saj. E nevojshme është ekzistenca e gjendjes së luftës. Dallimi i inteligjencës që

Partia kërkon nga anëtarët e saj dhe që arrihet më mirë në gjendje lufte, tashmë është pothuajse universal, por sa më lart në hieraki aq më i dukshëm bëhet. Urrejtja dhe histeria më e madhe kundër armikut gjendet tek Besnikët e Partisë. Një anëtari të Besnikëve, me detyrën e administratorit, i duhet të dijë se ky apo ai informacion nga lufta është i rremë, madje shpesh mund të dijë edhe që lufta është e gënjeshtërt – ose nuk bëhet fare ose bëhet për arsye krejt të kundërta nga ato që janë deklaruar – por ky lloj informacioni neutralizohet me lehtësi nga *mendimi i dyfishtë*. Ndërkohë që asnjë anëtar i Besnikëve nuk duhet të lëkundet në besimin e tij të patundur se: lufta *është* reale, do të përfundojë me fitore dhe Oqeania është fuqia e padiskutueshme e botës.

Të gjithë anëtarët e Besnikëve të Partisë besojnë në pushtimin e ardhshëm si të jetë e shkruar në librat e shenjtë. Ai do të arrihet ose duke fituar gjithnjë e më tepër territore ose duke shtënë në dorë ndonjë lloj arme të pashoqe. Kërkimi për armë të reja vazhdon pa ndërprerje dhe është një nga të vetmet aktivitete ku mendjet krijuese janë të lira. Në Oqeaninë e sotme, shkenca, në kuptimin tradicional të kësaj fjale, e ka humbur kuptimin. Në Gjuhën e Re fjala "shkencë" nuk ekziston. Metoda empirike e mendimit, ajo ku bazoheshin gjithë arritjet e së shkuarës, bie ndesh me parimet themelore të Anglosocit. Madje edhe progresi teknologjik lejohet vetëm kur produktet janë të përdorshme për kufizimin e lirisë së njeriut. Në të gjitha fushat e artit, bota ose po qëndron në vend numëro, ose bën mbrapa. Fushat punohen me parmenda, ndërsa librat shkruhen me makineri. Por si një çështje me rëndësi jetike – nënkupto, polici dhe spiunazh – përqasja empirike është ende e lejueshme, ose të paktën tolerohet. Dy qëllimet e Partisë janë: të sundojë gjithë sipërfaqen e globit dhe të zhdukë mendimin e lirë. Mirëpo ka edhe dy probleme që ajo është e interesuar t'i zgjidhë: si të zbulojë, kundër vullnetit të tij, çfarë është duke menduar një individ dhe si të vrasë qindra miliona njerëz në pak sekonda pa asnjë paralajmërim. Për aq kohë sa kërkimet shkencore do të vazhdojnë, ky do të jetë objektivi i tyre. Sot ka vetëm dy lloje shkencëtarësh: në njërën anë është një përzierje

e psikologut me inkuizitorin që studion detajet më të imëta në shprehjet e fytyrës, gjestet, vibrimet e zërit dhe ushtrimi i gjithë mënyrave për të zbuluar të vërtetën, drogat, elektroshokun, terapinë, hipnozën, torturat fizike, ndërsa në anën tjetër është kimisti, fizikani ose biologu që merret me degën e subjektit të tij të veçantë dhe që ka të bëjë me asgjësimin e vetvetes. Në laboratoret e stërmëdha të Ministrisë së Paqes dhe në stacionet eksperimentale të fshehura në pyjet e Brazilit, ose në shkretëtirën australiane, ose në ishujt e humbur të Antarktidës, ka ekipe ekspertësh që punojnë pa u lodhur. Disa merren vetëm me planifikimin e logjistikës së luftërave të ardhshme; disa krijojnë raketa gjithnjë e më të mëdha, eksploziv gjithnjë e më të fuqishëm, sisteme mbrojtjeje gjithnjë e më të padepërtueshëm; disa bëjnë kërkime për gaze të tjera vdekjeprurëse, ose helme që mund të prodhohen në sasira të tilla saqë mund të shkatërrojnë të korrat e një kontinenti të tërë, ose për lloje mikrobesh me imunitet ndaj antitrupave; disa përpiqen të ndërtojnë një makinë e cila do të eci ndën tokë si nëndetësja poshtë ujit, ose një aeroplan të pavarur nga baza e tij sa edhe anija; disa eksplorojnë gjëra edhe më të paarritshme si grumbullimin e rrezeve të diellit të zhvendosura në hapësirë me mijëra kilometra, ose të prodhojnë tërmete artificiale dhe dallgë deti duke zhfrytëzuar nxehtësinë në qendër të planetit.

Por të gjitha këto projekte janë shumë larg realizimit dhe asnjeri supershtet nuk del dot mbi të tjerët. Shumë i rëndësishëm është fakti që të tri superfuqitë e zotërojnë bombën atomike, një bombë shumë më e fuqishme se ato që mund të zbulojnë kërkimet. Megjithëse, siç e ka zakon, Partia pretendon se ajo është shpikësja, bomba atomike u shfaq për herë të parë në fillim të viteve dyzetë dhe u përdor në shkallë të gjerë rreth dhjetë vjet më vonë. Në atë periudhë u hodhën disa bomba në qendra industriale, kryesisht në Europë dhe Rusi, Europën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut. Qëllimi ishte për të bindur grupet sunduese të të gjithë vendeve se po të hidheshin edhe disa bomba të tjera do të vinte fundi i shoqërisë së organizuar, e për rrjedhojë edhe fundi i pushtetit të tyre. Qysh atëherë nuk u hodhën bomba të tjera, megjithëse nuk pati ndonjë marrëveshje të

përbashkët. Të tria fuqitë prodhojnë bomba atomike dhe i magazinojnë t'i kenë të gatshme për çastin që herët a vonë do të vijë. Qysh prej tridhjetë a dyzetë vjetësh arti i luftës nuk ka ndryshuar. Helikopterët përdoren më shumë se më parë, aeroplanët bombardues në pjesën më të madhe janë zëvendësuar nga predha që lëshohen vetë, ndërsa anijet luftarake lëvizëse dhe të brishta janë zëvendësuar nga pothuajse e pambytshmja Kështjellë Pluskuese; me përjashtim të këtyre nuk ka patur ndonjë përparim të madh. Tanku, nëndetësja, silura, automatiku, madje edhe pushka e granata e dorës, përdoren ende. Dhe pavarësisht kasaphanave që njoftohen në gazeta dhe televizione, betejat e dëshpëruara të luftërave të mëparshme, ku vriteshin qindra mijëra ose milona njerëz në pak javë, nuk janë përsëritur më.

Asnjëri nga të tre supershtetet nuk ndërmerr aksione që mund të përfundojnë në humbje të thella. Zakonisht sulmet e përmasave më të mëdha janë sulme të befta kundër ndonjë aleati. Strategjia që ndjekin ose pretendojnë se ndjekin, është e njëjtë. Plani është: duke kombinuar luftimet, duke bërë pazarllëqe dhe me anë të tradhtisë në kohën e duhur, të sigurohen baza për të rrethuar tërësisht njërin nga shtetet rivale dhe të nënshkruhet marrëveshje miqësie me rivalin tjetër, mandej të jetojnë në paqe derisa dyshimet t'i zërë gjumi. Në kohë paqeje, bombat atomike do të magazinohen në vendet strategjike që në kohën e duhur të lëshohen njëherësh për ta bërë kundërpërgjigjen e rivalit të pamundur. Mandej do të firmoset një marrëveshje miqësie me fuqinë tjetër dhe do nisin përgatitjet për sulmin e ardhshëm. Ky plan, s'ka nevojë të thuhet, është një ëndërr me sy hapur dhe vështirë se mund të realizohet. Pastaj, luftimet bëhen vetëm në territoret e diskutueshme, në ekuator dhe pol, nuk ka ndodhur kurrë që të pushtohet tokë kundërshtare. Kjo shpjegon faktin përse në disa vende kufijtë janë arbitrarë. Euroazia, për shembull, mund t'i sundojë fare lehtë ishujt britanikë, të cilët nga ana gjeografike janë pjesë e Europës, ose është shumë e mundshme që Oqeania t'i shtyjë kufijtë e saj deri në lumin Rin, bile deri në lumin Vistula. Mirëpo kjo do të dhunonte parimin e ndjekur nga të gjitha palët, por të pa formuluar

kurrë: integritetin kulturor. Në qoftë se Oqeania do të pushtonte vendet që dikur quheshin Francë dhe Gjermani, duhej që ose të shfaroste krejt banorët, diçka e pamundur në praktikë, ose të tentonte asimilimin e një popullsie gati njëqind milionëshe e cila ishte në të njëjtin nivel me të për nga teknika që zotëronte. Të tre supershtetet kanë të njëjtin problem. Është e domosdoshme që të mos ketë kontakt me të huajt, përveçse, dhe kjo në një masë të kufizuar, me robërit e luftës dhe skllevërit me ngjyrë. Edhe aleati zyrtar i çastit shikohet me dyshim. Përveç robërve të luftës, qytetari i thjeshtë i Oqeanisë nuk lejohet të ketë kontakte me qytetarë të Euroazisë ose Azisë Lindore, dhe i ka të ndaluara gjuhët e huaja. Në qoftë se ai lejohet të takojë të huaj atëherë do të zbulonte që ata nuk janë më të ndryshëm se vetë ai dhe çfarë i është thënë deri atë çast do dilte gënjeshtër. Bota e izoluar në të cilën jeton do të shkërmoqej, ndërsa frika, urrejtja dhe të drejtat prej të cilave varet morali i tij do të avullonin. Kështu që të tria palët e kanë kuptuar se s'ka rëndësi sa herë Persia, Egjipti, Java apo Sri Lanka, kalojnë nga një pushtues tek tjetri, kufijtë kryesorë nuk duhet t'i kalojë asgjë tjetër veç bombave.

Matanë kësaj fshihet një fakt që s'përmendet kurrë, por që kuptohet dhe respektohet: kushtet e jetesë janë gati të njëjta në të tre supeshtetet. Filozofia mbizotëruese e Oqeanisë është Anglosoci, e Euroazisë është Bolshevizmi i Ri, ndërsa në Azinë Lindore ka një emër kinez që mund të përkthehet si *adhurim i vdekjes*, ose e përshtatur më mirë: Shuarja e Vetes. Qytetarëve të Oqeanisë nuk u lejohet të njohin asgjë rreth parimeve të dy filozofive të tjera, por u mësohet t'i shikojnë si barbare dhe fyerje ndaj moralit dhe mendimit të shëndoshë. Në fakt, të tria filozofitë janë gati të njëjta, ndërsa sistemet socialiste që ato mbrojnë nuk kanë asnjë dallim. Në të tria vendet ekziston struktura piramidale, adhurimi për liderin gjysmëhyjnor, ekonomia që mbahet gjallë nga lufta dhe punon për luftën. Supershtetet jo vetëm që nuk mund ta sundojnë njëri-tjetrin, por nuk do të fitojnë asgjë edhe në se e bëjnë një gjë të tillë; ndërsa, për sa kohë që janë në luftë, mbështesin njëri-tjetrin si tre vandakë gruri. Dhe

si zakonisht, grupet sunduese të të tria fuqive edhe janë edhe s'janë të vetëdijshme për atë që bëjnë. Ata janë të përkushtuar ndaj sundimit botëror, por e dinë gjithashtu se është e domosdoshme që lufta të vazhdojë përjetësisht dhe pa fitore. Ndërsa mungesa e frikës nga pushtimi e bën më të lehtë mohimin e realitetit, gjë që është karakteristika kryesore e Anglosocit dhe sistemeve mendore rivale. Këtu ka nevojë të përsëritet diçka që është thënë më herët: duke u bërë e vazhdueshme, lufta ka ndryshuar karakter.

Në të shkuarën, herët apo vonë lufta mbaronte, zakonisht me humbje apo fitore të padiskutueshme. Në të shkuarën lufta ishte edhe një mjet me anë të të cilit shoqëritë njerëzore mbanin kontakt me realitetin fizik. Sundimtarët e të gjitha kohërave janë munduar të imponojnë tek ndjekësit e tyre një panoramë të rreme të realitetit, por kurrësesi nuk kanë guxuar të mëkonin iluzionin që cënonte veprimet ushtarake. Për sa kohë që humbja nënkuptonte humbje të pavarësisë, apo ndonjë pasojë tjetër të pa padëshiruar, atëherë duhej përgatitur seriozisht për fitore. Faktet fizike nuk mund të anashkaloheshin. Në filozofi, besim, etikë apo politikë, dy edhe dy mund të bëjnë pesë, por, kur njeriu punonte për ndërtimin e armëve, dy edhe dy duhet të bënin katër. Herët apo vonë, shtetet e dobëta sundoheshin nga të tjerët, përpjekjet për rezultat s'kishin lidhje me iluzionet. Për më tepër, për të qenë rezultativ qe e domosdoshme të mësoje nga e kaluara, që do të thoshte të kishe një ide pak a shumë të qartë për atë çfarë kishte ndodhur dikur. Natyrisht, gazetat dhe librat e historisë kanë qenë të njëanshëm, por falsifikimi që po praktikohet në ditët e sotme as që mund t'i shkonte kujt në mendje. Lufta ishte mbrojtësja më e mirë e kthjelltësisë mendore dhe për klasat sunduese kjo ishte mbrojtja më e rëndësishme nga të gjitha. Asnjë klasë sunduese nuk mund të tregohej e papërgjegjshme, ndërkohë që kishte një luftë për të fituar ose humbur.

Por kur lufta nis të bëhet e pambarimtë, pushon së qeni e rrezikshme. Kur lufta është e vazhdueshme, atëherë nuk mund të ketë gjëra të tilla si domosdoshmëria ushtarake. Përparimi teknik mund të ndalet dhe faktet më të dukshme mund të mohohen ose mund të mos përfillen. Siç e kemi

parë, kërkimet që mund të quhen shkencore bëhen ende për qëllime lufte, por në thelb janë ëndrra me sy hapur, në qoftë se dështojnë kjo nuk është e rëndësishme. Frytshmëria, madje edhe frytshmëria ushtarake, nuk ka vlerë. E vetmja gjë frytdhënëse në Oqeani është Policia e Mendimit. Përderisa secili nga supershtetet është i pa pushtueshëm, atëherë çdonjëri prej tyre është një univers më vete brenda të cilit mund të praktikohet çdo lloj çoroditjeje mendore. Realiteti e ushtron presionin e vet nëpërmjet nevojave të jetës së përditshme – nevoja për ushqim dhe pije, për strehë dhe veshje, për të shmangur gëlltitjen e helmeve apo hedhjen nga dritaret e kateve të kreut, e kësi gjërash. Edhe jeta me vdekjen apo kënaqësia fizike me dhimbjen fizike dallojnë nga njëra-tjetra, por kjo është e gjitha. Pa kontakte me botën e jashtme, qytetari i Oqeanisë është si një njeri në hapësirën ndëryjore, që nuk ka si ta dijë se nga cili drejtim është lart e cili poshtë. Sunduesit e një shteti të tillë janë më absolutë se faraonët apo perandorët romakë. Ata janë të detyruar të shmangin vdekjen e ndjekësve të tyre në shifra që mund t'u kërcënojnë karrigen dhe janë të detyruar ta mbajnë aq të ulët nivelin e teknikës ushtarake sa edhe rivalët, por me t'u arritur këto dy minimume, atëherë mund t'i japin realitetit çfarëdolloj forme që u do qejfi.

Prandaj, në qoftë se e gjykojmë me standartet e luftërave të mëparshe, lufta është thjesht një mashtrim. Diçka e ngjashme me përplasjet mes kafshëve ripërtypëse brirët e të cilave janë vendosur në një pozicion të atillë që nuk kanë mundësi ta dëmtojnë njëra-tjetrën. Dhe, lufta mund të jetë e rremë, por jo e pakuptimtë. Ajo gëlltit mbiprodhimin e të mirave materiale dhe ndihmon të ruhet atmosfera mendore për të cilën ka nevojë një shoqëri hierarkike. Siç do të shihet, tashmë lufta është një çështje e brendshme. Në të shkuarën, grupet sunduese në të gjitha vendet, megjithëse mund të kenë qenë të vetëdijshme për interesin e tyre të përbashkët dhe mund t'i kenë kufizuar pasojat shkatërrimtare të luftërave, luftuan kundër njëri-tjetrit dhe përherë fituesi plaçkiste e rroposte. Në kohën e sotme ata nuk luftojnë kundër njëri-tjetrit. Luftërat bëhen nga grupet sunduese kundër shtetasve të vet; qëllimi i

luftës nuk është të pushtojë territore ose të parandalojë pushtimin e vendit të vet, por të mbajë të pandryshuar strukturën e shoqërisë. Madje vet fjala "luftë" është bërë çorientuese. Ndoshta do të ishte më e saktë të thuhej që, duke u bërë e vazhdueshme, lufta nuk ekziston më. Presioni karakteristik që ajo ushtronte mbi njeriun qysh prej epokës së Neolitit e deri në shekullin e njëzetë është zëvendësuar nga diçka krejt e ndryshme. Edhe sikur tre supershtetet, në vend që të luftonin kundër njëri-tjetrit, të binin dakord për paqe të përhershme, secili i paprekshëm brenda kufijve të vet, pasojat do të ishin të njëjta. Sepse, në këtë rast çdonjëri prej tyre do të ishte një univers i mbyllur, çliruar përjetësisht nga rreziku i jashtëm që të bën esëll. Paqja e vërtetë dhe e përhershme do të ishte e njëjtë me luftën e vazhdueshme. Ky – megjithëse pjesa dërrmuese e anëtarëve të Partisë e kuptojnë në mënyrë sipërfaqësore – është kuptimi i sllloganit të Partisë: *Lufta është Paqe*.

Uinstoni ndali së lexuari për një çast. Diku në largësi gjëmoi një raketë. Hareja e të qenit vetëm me librin e ndaluar, në një dhomë pa tele-ekran, nuk ishte shuar ende. Vetmia dhe siguria qenë dy ndjesi fizike, të mpleksura disi me lodhjen e trupit të tij, me butësinë e karriges, me fshikjen e flladit që vinte nga dritarja dhe i ledhte mollëzat. Libri e mahniste, ose më saktë: i jepte siguri. Në fakt, ai nuk i thoshte ndonjë gjë të re, por kjo qe pjesë e joshjes. Libri thoshte ato çfarë mund t'i kishte thënë edhe ai, në qoftë se do të kishte qenë në gjendje t'i sistemonte mendimet e veta të hapërdara. Libri ishte prodhim i një mendjeje të ngjashme me të, por shumë më e fuqishme, më sistematike dhe më pak frikacake. Librat më të mirë, mendoi, janë librat që të thonë atë që e ke ditur. Porsa u rikthye tek kapitulli i parë, kur dëgjoi hapat e Xhulias në shkallë dhe u lëshua drejt derës ta takonte. Ajo lëshoi çantën ngjyrë kafe të veglave dhe iu lëshua ndër krahë. Nuk ishin parë prej më tepër se një jave.

- Tashmë *librin* e kam në dorë, - i tha ai pasi u shkëputën.

- Vërtet? Bukur, - tha ajo pa treguar ndonjë interes të madh dhe pothuajse u ul menjëherë në gjunjë pranë sobës për të bërë kafen.

Qëndruan rreth një gjysmë ore në krevat pastaj u kthyen sërish tek kjo temë. Mbrëmja ishte e freskët dhe ia vlente të mbuloheshe me kuvertë. Nga poshtë vinte zëri i njohur që këndonte dhe kërcitjet e këpucëve mbi pllakat e gurta. Gruaja zeshkane me krahë të kuq, që Uinstoni e kishte parë qysh në vizitën e parë, ishte pothuajse pjesë e kopshtit. Mesa dukej ajo e kalonte ditën duke u endur midis magjes dhe telit të rrobave, ose me kapëset e teshave në gojë ose me këngën epshore. Xhulia kishte gjetur rehat në njërin krah dhe gati sa nuk e zinte gjumi. Uinstoni mori librin nga dyshemeja dhe u mbështet pas kokës së krevatit.

- Duhet ta lexojmë, - tha. – Edhe ti. Gjithë anëtarët e *Vëllazërisë.*

- Lexoje ti, - tha ajo me sytë tashmë të mbyllur. – Lexoje me zë të lartë. Ashtu është më mirë. Përgjatë rrugës ma shpjegon edhe mua.

Akrepat e orës treguan gjashtë, gjashtë e mbasdites. Kishin dhe nja tre katër orë përpara. Uinstoni mbështeti librin mbi gjunjë dhe filloi të lexonte:

Kapitulli I: *injoranca është forcë*

Përgjatë rrjedhës së historisë, ndoshta qysh prej fundit të epokës së Neolitit, në botë kanë ekzistuar tre lloje njerëzish: të Sipërmit, të Mesmit dhe të Poshtmit. Këto grupe janë ndarë në shumë mënyra, janë emërtuar e riemërtuar pafundësisht, nga epoka në epokë kanë ndryshuar edhe përmasat brenda vetes edhe qëndrimet karshi njeri-tjetrit, por struktura bazë e shoqërisë nuk ka ndryshuar kurrë. Madje edhe pas përmbysjeve të mëdha apo ndryshimeve të pakorrigjueshme, është vënë re e njëjta ndarje, ashtu si gjiroskopi, pavarësisht sa dhe nga cili krah shtyhet, e rifiton ekuilibrin gjithmonë.

- Xhulia, zgjuar je? – tha Uinstoni.

- Po, i dashur, të dëgjoj. Vazhdo. Është i mrekullueshëm.

Uinstoni vazhdoi të lexonte:

Synimet e këtyre tre grupeve janë tërësisht të papajtueshme. Synimi i të Sipërmve është të qëndrojnë aty ku janë. Të Mesmit duan të ndërrojnë vendin me të Sipërmit. Synimi i të Poshtmëve, kur kanë ndonjë synim – sepse, është karakteristikë e përhershme e tyre, të Poshtmit, të shkërmoqur nga puna e rëndë, nuk kanë mundësi të interesohen për gjëra tej nevojave të përditshme – është të zhduken gjithë dallimet dhe të krijohet një shoqëri ku gjithë njerëzit të jenë të barabartë. E kështu, përgjatë gjithë historisë zhvillohet një betejë që në përgjithësi është e njëjta. Duket se të Sipërmit qëndrojnë të sigurt në pushtet për një kohë të gjatë, por, herët a vonë, vjen një çast kur humbasin ose besimin në vetvete ose aftësinë për të qeverisur me sukses, ose të dyja bashkë. Mandej përmbysen nga të Mesmit të cilët i bëjnë për vete të Poshtmit duke u shtirur sikur luftojnë për liri dhe drejtësi. Me të arritur qëllimin, të Mesmit i flakin sërish të Poshtmit aty ku kanë qenë, në pozicionin e shërbyesit, ndërsa vet bëhen të Sipërm. Në këtë kohë, nga njëri prej të dy grupeve shkëputet një grup i ri të Mesmish dhe kështu beteja rinis nga e para. Prej të tre grupeve, vetëm të Poshtmit nuk i realizojnë synimet e tyre as përkohësisht. Do të ishte teprim në qoftë se thuhej që nuk ka patur përparim në planin material. Edhe në ditët e sotme, një periudhë rënieje, njeriu mestar është fizikisht shumë më mirë se disa shekuj më përpara. Por as shtimi i kapitalit, as ndonjë reformë apo revolucion nuk e kanë zbutur qoftë edhe një milimetër barazinë shoqërore. Nga këndvështrimi i të Poshtmëve, ndryshimet historike kanë sjellë veç ndryshimin e emrave të sunduesve të tyre.

Nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë rishfaqja e këtij modeli u vu re nga shumë vëzhgues. Kështu u krijua shkolla e mendimtarëve që e interpretuan historinë si një proces ciklik dhe u përpoqën të vinin në dukje faktin që pabarazia ishte ligj i pandryshueshëm i jetës njerëzore. Natyrisht, kjo doktrinë kishte pasur përkrahësit e saj, por në mënyrën sesi u hodh tashmë në qarkullim kishte një ndryshim domethënës. Në të shkuarën, nevoja për një shoqëri hierarkike kishte qenë doktrinë e të Sipërmve. Ajo predikohej nga mbretër, aristokratë, priferinj, gjyqtarë

dhe të tjerë parazitë, duke premtuar njëkohësisht që kompesimi do të bëhej në botën e përtejme. Të Mesmit, kur ishin duke u përpjekur për pushtet, përdornin fjalët liri, drejtësi dhe vëllazëri. Megjithatë, tashmë koncepti i vëllazërisë nisi të përdorej nga njerëz që nuk ishin në pozicione udhëheqëse, por që shpresonin të ishin shumë shpejt. Në të shkuarën, të Mesmit kishin bërë revolucione në emër të barazisë dhe mandej kishin vendosur një tirani të re. E kështu, të Mesmit e rinj e shpallnin tiraninë e tyre qysh më herët. Socializmi, një teori që u shfaq në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë si hallka e fundit në zinxhirin e mendimit me rrënjët tek rebelimet e skllevërve në antikitet, ishte i ndikuar nga Utopistët e shekujve të mëparshëm. Por në çdo variant të socializmit që u shfaq pas 1900-ës e këtej, synimi për të vendosur lirinë dhe barazinë u braktis gjithnjë e më haptazi. Lëvizjet e reja që u shfaqën në mes të shekullit të njëzetë, Anglosoci në Oqeani, Bolshevizmi në Euroazi, Adhurimi i Vdekjes, siç quhet në përgjithësi, në Azinë Lindore, kishin synimin e vetëdijshëm të përjetësimit të mungesës së lirisë dhe pabarazisë. Natyrisht, këto lëvizje të reja rrodhën nga të vjetrat që ishin të prirura të ruanin emrat e vet dhe të lustronin ideologjinë e tyre. Ndërsa qëllimi i tyre ishte ta ndalnin progresin dhe historinë në një moment të caktuar. Përmbysja e njohur do të ndodhte edhe një herë tjetër dhe këtu merrte fund. Si zakonisht, të Sipërmit do të përmbyseshin nga të Mesmit të cilët do të bëheshin të Sipërm, por këtë radhë me ndërgjegje të pastër, të Sipërmit do ta ruanin pozicionin e tyre përjetësisht.

Doktrinat e reja shpërthyen për shkak të akumulimit të dijes së historisë dhe rritjes së ndjeshmërisë historike e cila, para shekullit të nëntëmbëdhjetë, pothuajse nuk kishte ekzistuar. Lëvizja ciklike e historisë u shfaq si më e kuptueshme, ose të paktën kështu dukej, dhe në qoftë se ishte e kuptueshme ishte edhe e ndryshueshme. Çështja kryesore, çështja bazë, ishte që barazia shoqërore qe bërë teknikisht e mundshme në fillim të shekullit të njëzetë. Vazhdonte të ishte i vërtetë fakti që ata nuk ishin të barabartë në talentet e tyre si dhe funksionet duhej të specializoheshin në mënyrë që disa individë të

përfitonin më shumë se të tjerët, por nuk kishte më nevojë për dallim klasor ose dallim të dukshëm në kapitale. Në shekujt e mëparshëm, dallimi klasor kishte qenë jo vetëm i pashmangshëm, por edhe i dëshiruar. Pabarazia ishte çmimi i qytetërimit. Megjithatë, çështja u ndryshua me zhvillimin e prodhimit të mekanizuar. Edhe në qoftë se ishte e domosdoshme që njerëz të ndryshëm të bënin punë të ndryshme nuk ishte më e nevojshme që ata të jetonin në nivele sociale apo ekonomike të ndryshme. Për rrjedhojë, nga këndvështrimi i grupit që ishin shumë afër ardhjes në fuqi, barazia shoqërore nuk ishte diçka për të cilën të luftohej, por një rrezik që duhej shmangur. Në kohëra më primitive, kur një shoqëri paqësore dhe e drejtë ishte e pamundur, ishte më e lehtë të besohej tek barazia shoqërore. Ideja e një parajse tokësore, që njerëzit mund të jetonin bashkë në gjendje vëllazërie, pa ligje dhe pa punë të rëndë, fanitej në imagjinatën njerëzore prej mijëra vitesh. Një përfytyrim i tillë kishte tërhequr deri në njëfarë mase edhe vetë ata që kishin përfituar nga çdo ndryshim historik. Trashëgmtarët e revolucionit francez, anlgez dhe amerikan kishin besuar në fjalët e tyre për të drejtat e njeriut, lirinë e fjalës, barazinë përpara ligjit, e kësi gjërash, madje, deri në njëfarë mase, lejuan që edhe të ndikohen. Por aty nga dekada e katërt e shekullit të njëzetë gjithë rrymat kryesore të mendimit politik qenë totalitare. Parajsa tokësore u diskretitua pikërisht atëherë që ishte bërë e realizueshme. Çdo teori politike e re, cilido qoftë emri i saj, u mbështet tek hierarkia dhe disiplina ushtarake. Hija ogurzezë që ra në vitet 1930, praktika që ishin braktisur prej kohësh – burgimi pa gjyq, kthimi i robërve të luftës në skllevër, ekzekutimet publike, torturimi për të nxjerrë informacion, marrja peng dhe zhvendosja masive e popullsisë – në disa raste braktisur prej qindra vjetësh, jo vetëm që u bënë sërish të zakonshme, por edhe u përkrahën nga njerëz që e mbanin vetën për të ditur e përparimtarë.

Vetëm pas një dhjetëvjeçari luftërash, luftërash civile, revolucionesh dhe kundër-revolucionesh në gjithë botën, Anglosoci dhe rivalët e tij u shfaqën si teori politike të plota. Por ato qenë lënë në hije nga sisteme të

ndryshme të quajtura totalitare, të cilat ishin shfaqur në fillim të shekullit, dhe kaosi që do të përfshinte botën pas fitores së tyre kishte qenë i dukshëm. Po kaq i dukshëm kishte qenë edhe fakti se ç'lloj njerëzish do të kontrollin këtë botë. Në shumicën e saj aristokracia e re përbëhej nga nëpunësit, shkencëtarët, teknicienët, sindikalistët, publicistët, sociologët, mësuesit, gazetarët dhe politikanët profesionistë. Këta njerëz, origjina e të cilëve ishte tek klasa e mesme rrogëtare dhe ajka e klasës punëtore, ishin formuar dhe bashkuar nga bota shterpë e monopoleve të industrisë dhe qeverisë së centralizuar. Krahasuar me grupet përkatëse në të shkuarën, ata qenë më pak lakmitarë, më pak të joshur nga luksi, më të etur për pushtet të pastër, e mbi të gjitha, më të vetëdijshëm për atë që bënin dhe më të vendosur në shkatërrimin e opozitës. Ndryshimi i fundit ishte themelor. Duke i krahasuar me të sotmet, tiranitë e të shkuarës ishin zemërbuta dhe të pazonjat. Grupet sunduese kishin qenë vazhdimisht të infektuara, deri në njëfarë mase, nga idetë liberale, ndërsa merrnin në konsideratë vetëm aksionet publike dhe nuk interesoheshin çfarë mendonin shtetasit e tyre. Krahasuar me standartet moderne, edhe Kisha Katolike e mesjetës ishte më tolerante. Pjesërisht ngaqë në të shkuarën qeveria nuk kishte mundësi t'i përgjonte gjithë qytetarët e vet. Megjithatë, shpikja e shtypit e bëri më të lehtë manipulimin e opinionit publik, ndërsa filmi dhe radioja e çuan edhe më tej. Me zhvillimin e televizionit dhe përparimit teknik që bëri të mundur filmimin dhe transmentimin e njëkohshëm nga i njëjti aparat, mori fund jeta private. Çdo qytetar, të paktën çdo qytetar që e meritonte të vëzhgohej, mund të mbahej nën përgjimin e policisë dhe të bombardohej me propagandë zyrtare njëzet e katër orë rresht ndërsa gjithë kanalet e tjera të komunikimit mbaheshin të mbyllura. Kështu erdhi në jetë për herë të parë mundësia e imponimit jo vetëm përulje ndaj vullnetit të shtetit, por edhe uniformitet të plotë të opinionit publik.

Pas periudhës revolucionarizuese të viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë, si gjithmonë, shoqëria u rigrupua në të Sipërmit, të Mesmit dhe të Poshtmit. Mirëpo grupi i të

Sipërmve të rinj, ndryshe nga paraardhësit, nuk vepronte në mënyrë instiktive, por e dinte mirë si të mbronte pozicionin e tij. Ishte kuptuar prej kohësh që mënyra më e mirë për ruajtjen e oligarkisë ishte kolektivizimi. Kapitali dhe privilegji mbrohen më lehtë kur janë të kolektivizuar. E ashtuquajtura "heqje e pronës private" që u bë në mesin e viteve pesëdhjetë ishte përqëndrim i kapitalit në më pak duar: por me një ndryshim, tashmë pronarët e rinj nuk ishin një masë e tërë individësh, por një grup i vogël njerëzish. Përveç gjërave të vogla personale, asnjë anëtar i partisë nuk zotëron pasuri. Në mënyrë kolektive, në Oqeani Partia është pronare e gjithçkaje, sepse kontrollon gjithçka, dhe i përdor prodhimet siç e shikon të arsyeshme. Në vitet pas Revolucionit i mori frenat e kapitalit pothuajse pa e kundërshtuar kush, sepse gjithë procesi u paraqit si kolektivizim. Dihej që shpronësimi i kapitalistëve do të shoqërohej me vendosjen e socializmit, ndaj kapitalistët u shpronësuan në mënyrë të padiskutueshme. Kapitalistëve iu mor gjithçka – fabrikat, minierat, tokat, shtëpitë, makinat, e përderisa këto kapitale nuk ishin më pronë private, atëherë do të ktheheshin në pronë kolektive. Anglosoci, i cili lindi nga lëvizjet e para socialiste dhe trashëgoi frazeologjinë e tyre, nuk bëri gjë tjetër veç zbatoi të parën pikë të programit socialist, të parashikuar qysh më herët, që pabarazia ekonomike ishte bërë e përhershme.

Por peripecitë për të përjetësuar një shoqëri hierarkike shkojnë edhe më thellë. Asnjëra nga fuqitë e mëdha që tani kanë në zotërim botën nuk mund të pushtohet, dhe e vetmja rrugë pushtimi janë ndryshimet e ngadalta demografike të cilat mund t'i evitojë vetëm një qeveri me fuqi të madhe. Ndërsa rreziku i dytë është vetëm teorik. Masat nuk ngrenë kurrë krye me dëshirën e tyre dhe nuk revoltohen kurrë vetëm e vetëm sepse janë të shtypura. Për sa kohë që ato nuk kanë standarte krahasimi atëherë nuk janë as në gjendje të kuptojnë se po shtypen. Krizat ekonomike periodike të së shkuarës nuk ishin të nevojshme dhe tani nuk lejohej më të ndodhnin, megjithëse bën vaki që çrregullime të tjera po aq të mëdha mund të ndodhin, por pa pasoja politike, ngaqë mungon mundësia

për artikulimin e pakënaqësisë. Ndërsa problemi i superprodhimit, që, qysh me shpikjen e makinave, ka qenë i pranishëm në shoqëri, zgjidhet me anët të luftës (shiko Kapitullin III), e cila është e domosdoshme për të mbajtur të kanalizuar moralin shoqëror. Prandaj, nga këndvështrimi i sunduesve të tanishëm, rreziqet serioze janë: ndarja e ndonjë grupi të ri me njerëz të zotë, të keqpunësuar e të etur për pushtet si dhe rritja e liberalizmit dhe skepticizmit në radhët e tyre. Me fjalë të tjera, problemi është problem edukimi. Një problem që kërkon vazhdimisht të modelohet vetëdija e grupit drejtues dhe grupit ekzekutiv më i madh se ai dhe poshtë tij. Vetëdija e masave duhet të ndikohet vetëm në mënyrë negative.

Me këtë sfond, mund të kuptohet fare qartë, nga dikush që nuk e di tashmë, struktura e përgjithshme e shoqërisë së Oqeanisë. Në majë të piramidës qëndron Vëllai i Madh: i pazëvendësueshëm dhe i plotëfuqishëm. Çdo sukses, çdo arritje, çdo fitore, çdo zbulim shkencor, gjithë dituria, gjithë mençuria, gjithë lumturia, gjithë virtytet, rrjedhin prej udhëheqjes dhe frymëzimit të tij. Vëllain e Madh s'e ka parë kush, kurrë. Ai është një fytyrë në afishe, një zë që vjen nga tele-ekrani. Jemi shumë të sigurt që është i pavdekshëm dhe ende nuk dihet me saktësi se kur ka lindur. Ai është petku që Partia vesh për t'u shfaqur në botë. Detyra e tij është të shërbejë si burim dashurie, frike, respekti, ndjenja që përjetohen më lehtë në lidhje me një njeri sesa me një organizatë. Poshtë Vëllait të Madh ndodhen Besnikët e Partisë, me rreth gjashtë milionë anëtarë, ose diçka më pak se 2 përqind e popullsisë së Oqeanisë. Poshtë Besnikëve ndodhen anëtarët e thjeshtë Partisë, të cilët, në qoftë se Besnikët përshkruhen si truri i Shtetit, mund të krahasohen me krahët. Poshtë këtyre ndodhen masat të cilat i quajmë "prole", afërsisht 85 përqind e popullsisë. Sipas termave të klasifikimit të mëparshëm, prolet janë të Poshtmit, ngaqë popullsia skllave e tokave ekuadoriale, të cilat kalojnë nga duart e një pushtuesi në duart e një tjetri, nuk janë pjesë e përhershme ose e domosdoshme e strukturës.

Në parim, anëtarësia e këtyre tre grupeve nuk është e trashëgueshme. Teorikisht fëmijët e Besnikëve të Partisë nuk janë anëtarë të saj. Pranimi në çdo degë të Partisë

bëhet me provim, mosha bazë është gjashtëmbëdhjetë vjeç. Nuk ka as dallime raciale dhe as ndonjë shenjë të dominimit të një krahine nga një krahinë tjetër. Çifutët, zezakët, amerikanojugorët me gjak të pastër indian, i gjen edhe në strukturat më të larta të Partisë, ndërsa njësitë lokale administrohen nga qytetarët e zonave përkatëse. Në asnjë pjesë të Oqeanisë nuk ekziston përshtypja se po sundohen nga një kryeqytet diku në largësi. Oqeania nuk ka kryeqytet dhe vendndodhja e personit në krye të saj nuk dihet. Përveç faktit që anglishtja është *lingua franca* e saj dhe Gjuha e Re është gjuha zyrtare, në Oqeani nuk ekziston centralizimi. Udhëheqësit nuk kanë lidhje gjaku, i bashkon vetëm doktrina e përbashkët. Ajo që duket sikur është trashëgimi në fakt është shtresëzim i shoqërisë, një shtresëzim i rreptë. Tashmë kalimet nga njëri grup tek tjetri janë shumë më të pakta seç ishin në kapitalizëm, apo në periudhën para-industriale. Midis dy degëve të Partisë ka njëfarë ndërkëmbimi, por vetëm për të përzënë ngordhalaqët nga radhët e Besnikëve, ndërsa ambiciozët e anëtarësisë së thjeshtë të Partisë bëhen të dobishëm duke u mundësuar ngjitjen. Proletarëve nuk u lejohet të futen në Parti. Më të talentuarit e tyre, ata që mund të bëhen bërthamë pakënaqësie, fillimisht ndiqen, pastaj eleminohen nga Policia e Mendimit. Por kjo gjendje nuk është e thënë të jetë e përhershme dhe nuk është çështje parimore. Partia nuk është shtresë shoqërore në kuptimin klasik të fjalës. Ajo nuk ka qëllim ta kalojë pushtetin tek fëmijët e udhëheqësve të saj, madje, në qoftë se nuk do të kishte mënyrë tjetër për të mbajtur në krye njerëzit më të aftë, atëherë ajo nuk do të ngurronte të rekrutonte një brez të tërë më të ri nga radhët e proletariatit. Fakti që Partia nuk ishte një trup që e trashëgonte pushtetin, ishte një ndihmesë e madhe për zbutjen e kundërshtarëve në kohët më të vështira për të. Socialistët e vjetër, të cilët ishin stërvitur të luftonin kundër diçkaje të quajtur "privilegj klasor", kujtuan se diçka që nuk është e trashëgueshme nuk mund të jetë e përjetshme. Nuk e kuptuan se vazhdimësia e një oligarkie nuk ka të bëjë me trashëgiminë fizike, dhe as nuk vunë re që aristokracitë e trashëgura kishin qenë jetëshkurtra, ndërsa organizatat e adoptuara,

si për shembull Kisha Katolike, në disa raste kanë zgjatur edhe për qindra apo mijëra vite. Thelbi i pushtetit oligarkik nuk është trashëgimia nga babai tek djali, por vijueshmëria e një këndvështrimi të botës dhe një mënyrë jetese e caktuar, që u imponohet të gjallëve nga të vdekurit. Një grup në pushtet është një grup në pushtet për aq kohë sa i zgjedh nga radhët e veta pasardhësit. Partia nuk është e shqetësuar për të përjetësuar gjakun e udhëheqësve të saj, por veten. Kush është në fuqi nuk ka rëndësi, për sa kohë që struktura hierarkike mbetet gjithmonë e njëjtë.

Gjithë besimet, zakonet, shijet, emocionet dhe qëndrimet mendore që karakterizojnë kohën tonë janë projektuar të mbrojnë sekretin e Partisë dhe të mos lejojnë perceptimin real të natyrës së shoqërisë në ditët tona. Rebelimi fizik, ose çdo hap që çon drejt rebelimit, as që mund të mendohet hëpërhë. Proletarët nuk përbëjnë asnjë lloj kërcënimi. Të lënë në hallin e tyre, ata do të vazhdojnë, brez pas brezi e shekull pas shekulli, të punojnë, të lindin dhe të vdesin, jo vetëm pa dëshirën më të vogël të ngrenë krye, por edhe pa e nuhatur që bota mund të jetë ndryshe nga çfarë është. Ata mund të bëhen më të rrezikshëm vetëm në qoftë se përparimi i teknikës industriale do të kërkojë edukim më të mirë të tyre, por, meqënëse konkurrenca ekonomike dhe ushtarake nuk janë më të rëndësishme, niveli i edukimit të popullit është në rënie. Fakti nëse kanë apo nuk kanë opinione masat është diçka që s'i kushton kush vëmendje. Masave mund t'u jepet liri intelektuale sepse nuk kanë intelekt. Ndërsa një anëtari të Partisë nuk i lejohet as devijimi më i vogël qoftë edhe për gjëra krejt pa rëndësi.

Një anëtar Partie jeton ndën vëzhgimin e Policisë së Mendimit nga lindja në vdekje. As kur është vetëm nuk mund të jetë i sigurt që është vetëm. Kudo që mund të ndodhet, në gjumë apo zgjuar, në punë apo pushim, në banjë apo në krevat, mund të vëzhgohet pa e ditur që po vëzhgohet. Gjithçka që bën ka rëndësinë e vet. Miqësia, pushimet, marrëdhëniet me gruan dhe fëmijët, shprehja e fytyrës së tij kur është vetëm, fjalët që mërmërit në gjumë, madje edhe lëvizjet karakteristike të trupit, këqyren me fanatizëm. Është e sigurt që do të pikasen, jo kundravajtjet

po e po, por edhe çdo lloj eksentrizmi, sado i vogël, çdo ndryshim në rutinë apo çdo tik nervor që s'mund të jetë gjë tjetër veç dëshmi e luftës së brendshme. Nuk ka liri zgjedhjeje në asnjë drejtim. Jo vetëm kaq, veprimet e tij nuk janë të përcaktuara me ligj apo nga ndonjë sistem rregullash mbi mënyrën e të sjellurit. Në Oqeani nuk ka ligj. Mendimet dhe veprimet, të cilat, kur zbulohen, të çojnë drejt vdekjes së sigurt, nuk janë të ndaluara zyrtarisht, ndërsa spastrimet e pafundme, arrestimet, torturat, burgimet, dhe avullimet nuk janë forma ndëshkimi për krimet e bëra, por për zhdukjen e personave që ndoshta mund të kryejnë krime në të ardhmen. Një anëtari partie i kërkohet të ketë jo vetëm mendimet e duhura, por edhe instiktet e përshtatshme. Një pjesë e mirë e mendimeve dhe qëndrimeve që duhet të zotërojë një anëtar partie nuk janë të shkruara e bardha mbi të zezë, dhe nuk shkruhen sepse dalin në shesh kontradiktat e brendshme të Anglosocit. Në qoftë se ai është fanatik (në Gjuhën e Re: *mendimtarimirë*), sido që të vijë puna, do ta kuptojë, pa u menduar dy herë, çfarë është mendimi i vërtetë dhe emocioni i dëshiruar. Sidoqoftë, një stërvitje mendore e përpunuar të cilës i nënshtrohet në fëmijëri, që vërtitet rreth fjalëve *ndalkrim, bardhëezi* dhe *mendim i dyfishtë*, nuk e ngacmon, apo e pengon, të thellohet për çfarëdolloj gjëje që mendon.

Një anëtar i Partisë nuk duhet të ketë ndjenja personale dhe nuk duhet të resht së qeni entuziast. Duhet që vazhdimisht të jetë i mbushur me urrejtje për armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, me ethet e triumfit për fitoret dhe të përulet para fuqisë dhe mençurisë së Partisë. Pakënaqësia nga jeta e keqe dhe jo e përmbushur është drejtuar qëllimisht ndaj gjërave jashtë tij, harxhohet me veprimtari si puna e Dy Minutave të Urrejtjes, ndërsa hamendjet që mund të prodhojnë qëndrime skeptike ose kryengritëse ndrydhen qysh herët me vetëdisiplinën e tij të brendshme. Faza e parë dhe më e thjeshtë e vetëdisiplinës, e cila mund t'u mësohet edhe fëmijëve të vegjël, në Gjuhën e Re quhet *ndalkrim*. *Ndalkrim* do të thotë të ndalosh, në mënyrë instiktive, sapo në mendje shfaqet ndonjë mendim i rrezikshëm. Kjo përfshin fuqinë për të mos kapur analogjitë, gabimet logjike,

keqkuptimet e argumenteve më të thjeshta në qoftë se janë në kundërshtim me Anglosocin, ose fuqia të mërzitesh dhe të tërhiqesh nga mendime që prijnë në drejtime heretike. Ndalkrim do të thotë budallallepsje mbrojtëse. Por budallallepsja nuk mjafton. Përkundrazi, partishmëri do të thotë të kontrollosh procesin tënd mendor njëlloj siç kontrollon muskujt e trupit një gjimnast. Shoqëria oqeanike beson se Vëllai i Madh është i gjithëfuqishëm ndërsa Partia e pamposhtur. Por, përderisa Vëllai i Madh nuk është realisht i gjithëfuqishëm dhe Partia nuk është e pamposhtur, atëherë lind nevoja e këqyrjes me kujdes, çast pas çasti, të fakteve. Fjala kyç është *bardhëezi*. Si edhe shumë fjalë të tjera të Gjuhës së Re, kjo fjalë ka dy kuptime të kundërta njëherësh. E përdorur nga kundërshtarët, do të thotë zakoni të pretendosh, në kundërshtim me faktet, që e zeza është e bardhë. E përdorur nga një anëtar i Partisë do të thotë gatishmëria për të thënë e zeza është e bardhë kur kështu e kërkon disiplina e Partisë. Por ajo ka edhe kuptimin që të *besosh* se e zeza është e bardhë, madje të *dish* që e zeza është e bardhë, dhe të harrosh që dikur ke besuar të kundërtën. Kjo kërkon ndryshimin e së shkuarës, diçka që është mundësuar nga sistemi i mendimit që përqafon gjithçka tjetër dhe që në Gjuhën e Re quhet *mendim i dyfishtë*.

Ndryshimi i së shkuarës ka rëndësi për dy arsye, njëra prej të cilave është ndihmëse, e le të themi, parandaluese. Arsyeja ndihmëse është që anëtari i Partisë, ashtu si proletarët, i pranon kushtet e tanishme ngaqë nuk ka asnjë standart krahasimi. Duhet të izolohet nga e shkuara ashtu siç duhet izoluar nga vendet e huaja, sepse duhet të besojë që jeton më mirë se paraardhësit e tij dhe që niveli mesatar i të mirave materiale është vazhdimisht në ngritje. Por shkaku kryesor pse duhej bërë rishikimi i të shkuarës ishte ruajtja e pushtetit të Partisë. Nuk është thjesht çështja të rifreskohen fjalimet, statistikat, dhe arkivat e çdo lloji, për të treguar që të gjitha parashikimet e Partisë kishin qenë të sakta, por të humbasin gjurmët e ndryshimeve të doktrinës apo vijës politike. Ngaqë ndryshimi i mendjes dhe i politikave shihen si dobësi. Në qoftë se sot, për shembull, Euroazia ose Azia Lindore, cilado qoftë prej

tyre, është armiku për momentin, atëherë ai shtet duhet të ketë qenë armiku i përhershëm. Në qoftë se faktet tregojnë të kundërtën, atëherë faktet duhet të ndryshohen. Kështu rishkruhet vazhdimisht historia. Fallsifikimi i përditshëm i të shkuarës që bëhet nga Ministria e së Vërtetës si dhe puna shtypëse dhe spiunazhi në Ministrinë e Dashurisë, janë hapa të nevojshëm për të ruajtur qëndrueshmërinë e regjimit.

Ndryshimi është dogma qëndrore e Anglosocit. E shkuara, argumentohet, nuk ekziston në mënyrë objektive, por mbijeton veç nëpërmjet shkrimeve dhe kujtesës njerëzore. E shkuara është ajo që thonë shkrimet ose kujtimet e njerëzve. Dhe meqë Partia ka kontrollin e plotë të arkivave dhe në po këto përmasa kontrollon edhe mendjet njerëzore, si rrjedhim e shkuara është ashtu siç thotë Partia. Megjithatë, ndryshimet e së shkuarës shoqërohen nga mëtimi që ajo nuk është ndryshuar qoftë edhe një herë të vetme. Sepse kur të shkuarës i është dhënë forma që është e nevojshme për momentin, ky version është e shkuara, s'ka sesi të ketë ekzistuar variant tjetër. Kjo është e vlefshme, dhe ndodh shpesh, edhe për raste kur një ngjarje duhet të ndryshohet sa të mos njihet më, disa herë rresht brenda një viti. Partia është në kontroll të përhershëm të së vërtetës absolute dhe kuptohet që e vërteta absolute nuk mund të ishte ndryshe nga ajo që është tani. Do të shihet se kontrollimi i së shkuarës, para së gjithash, varet nga stërvitja e kujtesës. Të sigurohesh që gjithë arkivat janë në harmoni me fanatizmin e momentit është thjesht një veprim mekanik. Por është edhe e rëndësishme që të *mos harrohet* se ngjarjet ndodhën sipas mënyrës së dëshiruar. Në qoftë se lind nevoja që të rirregullohen kujtimet e dikujt apo të falsifikohen shkrimet, atëherë është e domosdoshme *të harrohet* që diçka e tillë ka ndodhur. Marifeti për një gjë të tillë mund të mësohet si gjithë teknikat e tjera mendore. Mësohet nga shumica e anëtarëve të Partisë, natyrisht nga ata që janë inteligjentë dhe të përkushtuar. Me shumë sinqeritet, në Gjuhën e Vjetër diçka e tillë quhet "kontroll i realitetit". Në Gjuhën e Re quhet *mendim i dyfishtë*, megjithëse *mendimi i dyfishtë* përfshin më shumë se kaq.

Mendimi i dyfishtë do të thotë zotërimi dhe pranimi i dy mendimeve të kundërta në të njëjtën kohë. Intelektuali i Partisë e di në cilin drejtim duhen ndryshuar kujtimet e tij, për rrjedhojë e di që është duke luajtur me realitetin, por duke ushtruar *mendimin e dyfishtë* e beson se nuk e dhunon realitetin. Procesi duhet të bëhet me vetëdije përndryshe nuk do të kryhet me saktësi, ose së bashku me të mund të lindë ndjenja e falsifikimit e, njëkohësisht, edhe ndjenja e fajësisë. *Mendimi i dyfishtë* është vendosur në zemër të Anglosocit, përderisa veprimtaria kryesore e Partisë është të përdorë me vetëdije mashtrimin e njëkohësisht të pretendojë se gjithçka është bërë më sinqeritetin më të kulluar. Të gënjejë ashiqare e ndërkohë t'i besojë verbërisht, të harrojë çdo fakt të papërshtashëm, dhe pastaj, kur këto fakte t'i duhen t'i nxjerrë nga harresa për aq kohë sa do t'i hyjnë në punë, të mohojë ekzistencën e realitetit objektiv dhe në të njëjtën kohë ta vlerësojë realitetin që mohon – e gjithë kjo është domosdoshmërisht e nevojshme. Madje edhe për të përdorur togfjalëshin *mendim i dyfishtë* duhet shfrytëzuar *mendimi i dyfishtë*. Dihet që duke përdorur togfjalëshin *mendim i dyfishtë* realiteti nis të ngatërrohet, ndërsa me një përdorim të freskët të *tij* njeriu e shton këtë dije, e kështu pafundësisht, përherë me gënjeshtrën një hap më para se e vërteta. Tek e fundit, është pikërisht *mendimi i dyfishtë* mjeti me anë të të cilit Partia mundi – dhe, me sa duket, do të vazhdojë mijëra vjet – ta kapë prej fyti rrjedhën e historisë.

Gjithë oligarkitë e mëparshme u larguan nga pushteti ose ngaqë u ngurtësuan shumë ose ngaqë u zbutën në të njëjtën masë. Ose u treguan idiote dhe arrogante, nuk u përshtatën dot siç e kërkuan rrethanat dhe kështu u përmbysën, ose u treguan liberale dhe frikacake dhe bënë lëshime pikërisht atëherë kur duhet të kishin përdorur forcën, e sërish u përmbysën. Pra, mund të thuhet, që u përmbysën në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo të ndërgjeshme. Krijimi i një sistemi mendor ku mund të bashkëjetojnë të dyja kushtet është arritje e Partisë. Nuk ka asnjë mënyrë tjetër inteligjente që Partia të jetë e përhershme. Në qoftë se dikush do të sundojë, dhe të vazhdojë sundimin, atëherë duhet të ketë aftësinë për të

kushtëzuar realitetin. Sekreti i sundimit është kombinimi i bindjes se je i pamposhtur me aftësinë për të nxjerrë mësime nga gabimet e së kaluarës.

Është gati e panevojshme të thuhet që mjeshtrat e përdorimit të *mendimit të dyfishtë* janë ata që e shpikën dhe që e dinë se *mendim i dyfishtë* është sistem i të mashtruarit mendor. Në shoqërinë tonë, ata që e kanë të qartë më mirë se kushdo tjetër çfarë po ndodh, janë edhe njerëzit më të paftë për ta parë botën ashtu siç është. Me pak fjalë, sa më mirë të kuptosh aq më i madh është mashtrimi: sa më inteligjent, aq më pak i kthjellët. Shembulli më i mirë për këtë është fakti që histeria për luftë shtohet me ngjitjen e shkallëve në hierarkinë shoqërore. Njerëzit me qëndrimin më racional karshi luftës janë banorët e territoreve të diskutueshëm. Për ata lufta është thjesht një fatkeqësi e përhershme që lëviz tutje-tëhu sipër trupave të tyre si dallgë deti dhe nuk u bën hiç përshtypje cila palë është fituesja. Ata janë të vetëdijshëm se ndërrimi i sunduesve do të thotë të bëjnë të njëjtën punë për njerëz të tjerë të cilët sillen njëlloj me të parët. Ndërgjegjësimi për luftën i atyre që i quajmë "prole", disi më të favorizuarit nga lufta, është i luhatshëm. Kur e kërkon nevoja ata mund të ushqehen me frikë dhe urrejtje, por kur lihen mënjanë janë në gjendje ta harrojnë luftën për një kohë të gjatë. Ndërsa entuziazmi i vërtetë gjendet në radhët e Partisë, e mbi të gjitha tek Besnikët. Sundimi i botës besohet më tepër pikërisht nga ata që e dinë se kjo është e pamundur. Lidhja e ngushtë e kundërshtive – dijes me injorancën, cinizmit me fanatizmin – është një nga shenjat më dalluese të shoqërisë së Oqeanisë. Ideologjia zyrtare është e mbushur me kundërshti edhe kur nuk ka ndonjë arsye të dukshme. Partia shkel dhe diskrediton të gjitha parimet mbi të cilat u ngrit fillimisht lëvizja socialiste dhe e bën këtë pikërisht në emër të Socializmit. Ajo predikon përbuzje për klasën punëtore – diçka që nuk ndodhte në shekujt e mëparshëm, ndërkohë që anëtarët e vet i vesh me uniformë, karakteristikë kjo për punëtorët e krahut, dhe pikërisht për këtë arsye bëhet. Ajo e minon në mënyrë sistematike unitetin e familjes, ndërkohë që udhëheqësin e saj e thërrasin me një emër që evokon

ndjenjat familjare. Madje edhe emrat e katër ministrive që na qeverisin tregojnë njëfarë paturpësie sepse faktet flasin krejt për të kundërtën. Ministria e Paqes merret me luftën, Ministria e së Vërtetës me gënjeshtrat, Ministria e Dashurisë me torturat, ndërsa Ministria e Bollëkut me urinë. Këto kundërshti nuk janë të rastësishme dhe as nuk burojnë nga hipokrizia e zakonshme: ato janë rezultat i ushtrimit të qëllimshëm të *mendimit të dyfishtë*. Por vetëm duke pajtuar këto kontradikta mund të mbahet pushteti pafundësisht. Cikli i lashtë nuk mund të thyhet me rrugë tjetër. Që barazia të shmanget përjetësisht – që të Sipërmit, siç i kemi quajtur, t'i mbajnë vendet e tyre përgjithmonë – gjendja mendore që duhet të triumfojë është marrëzia e kontrolluar.

Por ekziston edhe një pyetje të cilën, deri në këtë çast, e kemi lënë mënjanë. *Përse* duhet të shmanget barazia shoqërore? Le të supozojmë se mekanizmat e procesit janë përshkruar siç duhet, cila është arsyeja për këtë përpjekje gjigante dhe të saktë për të ndalur historinë në një çast të dhënë të kohës?

Tashmë vijmë te sekreti i madh. Siç e kemi parë, e fshehta e Partisë dhe mbi të gjitha e Besnikëve, është mbështetja tek *mendimi i dyfishtë*. Por poshtë këtij gjendet arsyeja kryesore, instikti i padiskutueshëm që çoi në marrjen e pushtetit dhe vendosi *mendimin e dyfishtë*, Policia e Mendimit, lufta e vazhdueshme, dhe gjithë peripecitë që vijuan. Kjo arsye qëndron në...

Në këtë çast, ashtu si njeriu pikas një zë të ri, Uinstoni pikasi heshtjen. E kuptoi që Xhulia nuk ishte ndjerë prej një cope here. Ishte shtrirë në njërën anë, lakuriq nga mesi e lart, me kokën mbështetur mbi krahun e saj, me një tufë nga flokët e zinj varur midis syve. Kraharori ulej e ngrihej ritmikisht dhe ngadalë.

- Xhulia.

Heshtje.

- Xhulia, zgjuar je?

Heshtje. Flinte. Uinstoni mbylli librin, e uli me kujdes në dysheme, u shtri, dhe tërhoqi mbulesën sipër të dyve.

Ende, mendoi Uinstoni, nuk e kishte mësuar sekretin përfundimtar. E kuptonte *si*, por jo *pse*. Kapitulli i parë, ashtu si edhe kapitulli i tretë, nuk i kishte thënë asgjë të panjohur, thjesht kishte përmbledhur njohuri që ai i dinte qysh më parë. Por, pasi e lexoi, u bind që nuk ishte i çmendur. Të qenit pakicë, qoftë edhe pakicë me një anëtar, nuk do të thoshte se ishe i çmendur. Ekzistonte e vërteta dhe jo e vërteta, por në qoftë se kapeshe pas të vërtetës, edhe i vetëm kundër botës, nuk ishe i çmendur. Një rreze e verdhë, arratisur nga dielli që po perëndonte, shkrepi përmes dritares dhe ra sipër jastëkut. Uinstoni mbylli sytë. Dielli në fytyrë dhe trupi i butë i gruas ngjitur me të tijin i jepnin një ndjenjë të fuqishme gjumi dhe sigurie. Ishte i mbrojtur, çdo gjë shkonte shumë mirë. E zuri gjumi duke mërmëritur: "Kthjelltësia mendore nuk ka të bëjë me statistikat", me ndjesinë që kjo frazë fshihte një urtësi të thellë.

X

Uinstoni u zgjua me ndjesinë se kishte fjetur gjatë, por një vështrim mbi sendin e vjetër i rrëfeu se ora ishte tetë e gjysmë. Qëndroi shtrirë përgjumësh një copëherë, pastaj nga kopshti u ngjit sipër zëri i thellë:

Qe veç joshje e pashpresë
Që u shua si ngjyrë prilli
Por vështrimi, fjala dhe ëndrrat që trazuan!
E bënë të tyren zemrën time!

Kjo tregonte se kënga idiote pëlqehej ende. Ku nuk e dëgjoje. Ishte përhapur edhe më shumë se Kënga e Urrejtjes. Xhulia u zgjua prej zërit, u shtriq gjithë nur dhe u ngrit prej shtratit.

- Kam uri, - tha. – Bëjmë nga një kafe tjetër. Mos! Furnela është fikur ndërsa uji është ftohur. – Ngriti furnelën dhe e tundi: - Ka mbaruar vajguri.

- Mbase na jep pak zoti Karrington.

- E bukura është se unë u sigurova që e mbusha. Po vishem - shtoi ajo. – Sikur është pak ftohtë.

Edhe Uinstoni u ngrit dhe u vesh. Zëri vazhdoi i palodhur fare:

Thonë se koha i zbut dhimbjet
Thonë se mund të harrosh
Por buzëqeshjet dhe lotët përgjatë viteve
M'i prekin akoma telat e zemrës!

Ndërsa shtrëngonte rripin e pantallonave, Uinstoni çapiti drejt dritares. Dielli duhet të kishte kaluar mbrapa shtëpisë, ndriçimi ishte larguar nga kopshti. Pllakat e gurta dukeshin të lara rishtas dhe ai pati ndjesinë që edhe qielli sapo ishte larë, aq e freskët dhe e zbehtë iu duk bluja midis oxhaqeve. Gruaja ecte tutje-tëhu, duke vënë e duke hequr kapëse rrobash nga goja, herë duke kënduar e herë në heshtje, duke shtuar gjinjë e më shumë pelena në litar. Ndoshta, mendoi Uinstoni, gruaja lante për të nxjerrë bukën e gojës, ndoshta ishte skllave e nja tridhjetë a dyzetë nipave e mbesave. Xhulia u afrua dhe të dy vështronin me njëfarë mrekullimi gruan e fuqishme në kopsht. Ndërsa vështronte gruan – qëndrimin e saj, krahët e trashë që zgjateshin drejt telit, vithet e dala si të pelës – për herë të parë, Uinstoni mendoi se ajo ishte e bukur. Kurrë më parë nuk i kishte shkuar në mendje që një grua pesëdhjetë vjeçe, të cilës lindja e fëmijëve i kishte dhënë përmasa të papërfytyrueshme, ndërsa puna e rëndë e kishte ashpërsuar derisa mori pamjen e një rrepe të ardhur mirë, mund të ishte e bukur. Por ashtu ishte, e tek e fundit, mendoi, pse të mos ishte? Trupi pa linja dhe i ngjeshur si një bllok graniti, lëkura e kuqe dhe e ashpër, kishin të njëjtën lidhje me trupin e një vajze si një farë trëndafili me trëndafilin. Përse fruti duhet të ishte më i përulur para lules?

- Është e bukur, - mërmëriti.

- Pa frikë, një metër e gjerë në vithe, - tha Xhulia.

- Kjo është mënyra e saj e të qenit e bukur.

Uinstoni shtrëngoi belin elegant të Xhulias, qarkuar me krahun e vet. Këmbët u puqeshin nga çapoku deri tek gjuri. Trupat e tyre nuk do të lindnin fëmijë, ky ishte një hap që s'do ta hidhnin kurrë. Sekreti do të transmetohej vetëm me fjalën e gojës, nga mendja ne mendje. Gruaja aty poshtë nuk kishte mendje, ajo kishte veç krahë të fuqishëm, zemër dashamirëse dhe trup pjellor. Kushedi sa fëmijë kishte lindur, mendoi me habi Uinstoni. Pesëmbëdhjetë nuk do ishte çudi. Ajo kishte çelur, ndoshta për një vit, si trëndafil i harlisur, pastaj ishte mbufatur si një frut i kalbur dhe ishte ashpërsuar, kishte marrë ngjyrë të kuqe e pastaj jeta e saj kishte qenë larje rrobash, kruarje, arnim, gatim, fshirje, lyerje,

meremetim, kruarje, larje rrobash, fillimisht për fëmijët, pastaj për fëmijët e tyre – tridhjetë vjet papushim – e në fund të gjithçkaje vazhdonte të këndonte. Respekti i pakuptuar që ndjeu për të kishte njëfarë lidhjeje me bardhësinë e qiellit të zhveshur përtej oxhaqeve deri në pafundësi. Iu duk e çuditshme të mendonte që dielli ishte i njëjtë për të gjithë, edhe në Euroazi dhe në Azinë Lindore. Edhe njerëzit poshtë tij pothuajse ishin të ngjashëm – gjithandej në botë, qindra e mijëra milionë njerëz që nuk dinin gjë për ekzistencën e popujve të tjerë, të ndarë nga mure urrejtje dhe rrenash, e sërish gati të njëjtë – njerëz që s'kishin mësuar kurrë të mendonin, por që në zemrat, stomakët, muskujt e tyre, grumbullonin fuqinë që një ditë mund të përmbyste botën. Në qoftë se shpresa ekzistonte, ajo gjendej tek prolet! Edhe pa e lexuar *librin* deri në fund, e kuptoi që ky duhej të ishte mesazhi përfundimtar i Goldshteinit. E ardhmja u përket proleve. Por a mund të ishte i sigurt që kur të vinte ora e tyre ata do të ndërtonin një botë që për atë, Uinston Smithin, nuk do të ishte e huaj si bota e Partisë? Po, ngaqë të paktën ajo do të ishte një botë me kthjelltësi mendore. Shpejt apo vonë, por do të ndodhte, fuqia do të kthehej në ndërgjegjësim. Kur shikoje figurën trime në kopsht, nuk kishe pikë dyshimi që prolet ishin të pavdekshëm. Më në fund do të zgjoheshin. Dhe derisa të ndodhte kjo, edhe pse mund të kalonin një mijë vjet, ata do të mbeteshin gjallë kundër gjithë parashikimeve, si zogjtë, duke e kaluar nga trupi në trup gjallërinë që Partia nuk e kishte dhe as nuk e zhdukte dot.

- A të kujtohet, - tha, - tusha që këndonte për ne ditën e parë, në anë të pyllit?

- Nuk këndonte për ne, - tha Xhulia. – Këndonte për kënaqësinë e vet. Madje as për këtë. Thjesht këndonte.

Zogjtë dhe prolet këndonin, ndërsa Partia jo. Gjithandej nëpër botë, në Londër dhe Nju Jork, në Afrikë dhe Brazil, në tokat e ndaluara dhe misterioze përtej kufirit, në rrugët e Parisit dhe Londrës, në fshatrat mbi fushat e pafundme ruse, në pazaret e Kinës dhe Japonisë – kudo, qëndronte figura e fortë dhe e paepur, shfytyruar nga puna e rëndë dhe lindja e fëmijëve, që rropatej nga lindja në vdekje dhe nuk e pushonte këngën. Një ditë, një ditë nga ai bark i pamposhtur do të lidnin qenie të ndërgjegjshme.

Pikërisht atyre u përkiste e ardhmja, jo ty. Por të ardhmen mund ta kishit të përbashkët në qoftë se ti mbaje gjallë mendjen e ata trupin dhe nëse përcillnit në breza doktrinën e fshehtë: dy edhe dy bëjnë katër.

- Ne jemi të vdekurit, - tha Uinstoni.

- Ne jemi të vdekurit, - përsëriti Xhulia e bindur.

- Ju jeni të vdekur, - tha një zë metalik mbrapa tyre.

Ata u larguan prej njeri-tjetrit me nxitim. Uinstoni ndiehej si i ngrirë. Vështroi sytë e Xhulias, qenë zbehur krejt. Fytyra e saj kishte marrë një të verdhë qumështi. Në mollëza kishte një njollë të kuqe të theksuar e cila dukej sikur s'e prekte lëkurën poshtë saj.

- Ju jeni të vdekurit, - përsëriti zëri metalik.

- Ishte mbrapa kuadrit, - pëshpëriti Xhulia.

- Ishte mbrapa kuadrit, - tha zëri. – Qëndroni aty ku jeni. Mos lëvizni derisa të merrni urdhër.

Po fillonte, më në fund po fillonte! Nuk kishin ç'të bënin tjetër, shikuan njëri-tjetrin në sy. T'ia mbathnin, t'ia mbathnin për të shpëtuar kokën para se të qe vonë – as që u shkoi në mendje. As që bëhej fjalë të mos i bindeshe zërit që vinte nga muri. U dëgjua një kërcitje, sikur lëvizej llozi i derës, dhe një thyerje xhami. Kuadri ra në dysheme, tele-ekrani u shfaq i zbuluar.

- Tashmë po na shikojnë, - tha Xhulia.

- Po, tashmë ju shikojmë, - foli zëri. – Qëndroni në mes të dhomës. Me shpinën nga njëri-tjetri. Lidhni duart pas kokës. Mos e prekni njëri-tjetrin.

Ata nuk ishin prekur, por Uinstonit i dukej sikur e ndiente që Xhulia dridhej. Ose ndoshta ishte dredhja e trupit të vet. Kërcitjen e dhëmbëve e ndaloi, por gjunjët nuk i kontrollonte dot. Poshtë u dëgjuan kërcitje këpucësh, brenda dhe jashtë shtëpisë. Kopshti ishte mbushur plot me njerëz. Po zvarritnin diçka mbi pllaka. Kënga e gruas kishte pushuar në mënyrë të beftë. U dëgjua tringëllima e diçkaje metalike që rrokullisej, sikur t'i kishën rënë me shkelm magjes së rrobave, mandej u dëgjua një rrëmujë britmash që mbaruan me një klithmë të dalë prej dhimbjes.

- Shtëpia është e rrethuar, - tha Uinstoni.

- Shtëpia është e rrethuar, - tha zëri.

Uinstoni dëgjoi Xhulian që shtrëngoi dhëmbët.

- Ndoshta duhet të themi lamtumirë, - tha Xhulia.

- Po, mund të thoni lamtumirë, - tha zëri. Mandej ndërhyri një zë krejt tjetër, i hollë, goxha më i kultivuar, që Uinstonit iu duk sikur e kishte dëgjuar diku: - "Meqë ra fjala ndërsa po merremi me këtë çështje, "Po vjen qiriri të të prijë drejt shtrojës, po vjen hanxhari të të heqë kokën."!"

Në krevatin pas Uinstonit kërciti diçka. Koka e një shkalle theu xhamin e dritares. Dikush po ngjitej në dritare. Përgjatë shkallëve u dëgjua një rrëmujë këpucësh. Dhoma u mbush me burra të fuqishëm me uniforma të zeza, me këpucë me pafka metalike dhe shkopinj gome në duar.

Uinstoni nuk dridhej më. Bile nuk lëvizte as sytë. Vetëm një gjë kishte rëndësi: të mos lëvizte, të mos lëvizte, të mos u jepte shkak për ta qëlluar. Përballë tij qëndronte një burrë me nofulla të lëmuara luftëtari, me gojën si një e çarë në fytyrë, i cili e mbante shkopin e gomës horizontalisht mes gishtit të madh dhe gishtit tregues. Sytë e Uinstonit ndeshën sytë e tij. Ndjenja e të qenit lakuriq, me duart mbrapa koke dhe gjithë trupin të ekspozuar, qe e padurueshme. Burri nxori majën e gjuhës së bardhë, lëpiu vendin aty ku duhet të kishin qenë buzët, dhe vazhdoi më tutje. U dëgjua një thyrje tjetër. Dikush kishte marrë mbajtësen e letrave sipër tavolinës dhe e kishte flakur në vatër.

Copa e koralit, një rreth i vogël ngjyrë rozë, si një gonxhe trëndafili prej sheqeri sipër kekut, rrokullisej përmbi rrogoz. Sa e vogël, mendoi, sa e vogël që ishte! Mbrapa tij u dëgjua një dihatje dhe goditje: Uinstoni mori një goditje të fuqishme në kyç që gati sa nuk e rrëzoi për tokë. Njëri nga burrat qëlloi Xhulian me grusht në stomak, duke e përthyer vajzën si portofol. Ajo u lëshua në tokë, mezi merrte frymë. Uinstoni nuk guxoi ta kthente kokën asnjë milimetër, por fytyra e irnosur qëndronte në çip të syrit duke ngulçuar. Edhe mes gjithë këtij terrori iu duk sikur e ndjeu në trupin e vet dhimbjen, dhimbjen e tmerrshme që, prapëseprapë, nuk ishte aq alarmante sa frymëmarrja e vështirësuar e Xhulias. E dinte seç donte të thoshte: dhimbja e tmerrshme agonizuese që ishte aty gjatë gjithë kohës, por që nuk e ndiente sepse, para

së gjithash, duhet të mbushej me frymë normalisht. Pastaj dy prej burrave e ngritën Xhulian me duart poshtë shpatullave dhe gjunjëve dhe e nxorën jashtë si një thes. Uinstoni vështroi kalimthi fytyrën e saj, me vështrimin poshtë, e verdhë dhe e shfytyruar, me sytë mbyllur, ende me njollën e verdhë në të dy mollëzat; ky ishte vështrimi i fundit.

Uinstoni rrinte si i ngrirë. S'kishin filluar ta godisnin ende. Në mendje nisën t'i shfaqeshin gjithfarë pikëpyetjesh, jo shumë të rëndësishme, por që lindin natyrshëm. Pyeste në e kishin kapur apo jo zotin Karrington. Pyeste se çfarë i kishin bërë gruas në kopsht. Këtë çast ndjeu një dëshirë të madhe për të urinuar, dhe kjo e habiti disi sepse ai kishte urinuar vetëm para dy-tre orësh. Vuri re që ora në buhar tregonte nëntë e darkës. Mirëpo drita e ditës qe shumë e fortë. A nuk zbehej dita në orën nëntë të darkës në muajin gusht? Habitej se mos vallë ai edhe Xhulia kishin ngatërruar orën – mos kishin fjetur dymbëdhjetë orë rresht dhe kujtuan se ishte tetë e gjysmë e natës ndërkohë që mund të ishte ora tetë e gjysmë e mëngjesit. Megjithatë nuk e ndoqi më tej këtë mendim. Iu duk pa rëndësi.

Në korridor u dëgjuan hapa të tjerë, më të lehtë. Në dhomë hyri zoti Karrington. Sjellja e burrave me uniformë të zezë u bë më e kontrolluar. Edhe në fytyrën e zotit Karrington ndryshoi diçka. Vështroi copat e letërmbajtëses prej qelqi.

- Mblidhni ato copëza, - urdhëroi prerë.

Njëri nga burrat zbatoi urdhrin. Theksi i tij dialektor ishte zhdukur: befas Uinstoni e kuptoi se i kujt kishte qenë zëri që kishte dëgjuar në tele-ekran pak çaste më parë. Zoti Karrington mbante ende veshur xhaketën kadife, por flokët e tij, të cilët kishin qenë pothuajse të bardhë, tashmë kishin ngjyrë të zezë. Syzat i kishte hequr. I hodhi Uinstonit një vështrim të shpejtë dhe të vetëm, sikur të vërtetonte identitetin e tij, dhe nuk i kushtoi më vëmendje. Vazhdonte të ngjante me zotin Karrington të dikurshëm, por nuk ishte më i njëjti person. Trupi ishte drejtuar dhe dukej më i madh. Fytyra kishte pësuar vetëm ndryshime të lehta, por prapëseprapë dukej krejt e transformuar. Vetullat nuk ishin më aq të trasha, rrudhat ishin zhdukur, gjithë vijat e fytyrës dukeshin se ishin

ndryshuar, madje edhe hunda dukej më e shkurtër. Ishte kthyer në fytyrën e ftohtë dhe të vëmendshme të një njeriu midis moshës pesë dhe tridhjetë vjeç. Për herë të parë, Uinstoni e kuptoi që ai kishte qenë dhe vazhdonte të ishte bashkëpunëtor i Policisë së Mendimit.

PJESA E TRETË

I

Nuk dinte ku ndodhej. Ndoshta ishte në Ministrinë e Dashurisë, por mundësitë për të qenë i sigurt ishin të pakta.

Qelia tavanlartë ishte pa dritare, muret të veshur me porcelan të shdritshëm. Llampat e fshehura derdhnin një dritë të ftohtë, ndërsa dëgjohej një gumëzhitje e ulët dhe e qëndrueshme për të cilën ai mendonte se vinte nga ventilatori. Në të gjithë muret ishte vendosur një raft si punë stoli që ndërpritej vetëm nga dera dhe i mjaftueshëm për të ulur në të, ndërsa në anën tjetër, përballë me derën, ndodhej një sifon pa ndenjësen prej druri. Kishte katër tele-ekrane, një në çdo mur.

Uinstoni kishte një dhimbje topitëse në bark. Dhimbja i kishte filluar, dhe vazhdonte ende, qysh kur e futën të lidhur në furgonin e mbyllur. Ndërkohë kishte edhe uri, një uri gërryese, por jo e shëndetshme. Nuk ishte i sigurt në kishte qëndruar pa ngrënë njëzet e katër apo tridhjetë e gjashtë orë. Ende nuk e dinte, e ndoshta nuk do ta mësonte kurrë, në kishte qenë mëngjes apo darkë kur e arrestuan. Qysh kur e kishin arrestuar nuk i kishin dhënë ushqim.

Ulur në stolin e ngushtë, me duart kryqëzuar sipër gjunjve, qëndronte i qetë me aq sa mundej. Tashmë kishte mësuar të qëndronte palëvizur. Në qoftë se bëje lëvizje të paparashikuara atëherë nisnin britmat nga tele-ekrani. Ndërkohë gjakimi për ushqim po rritej. Nuk donte asgjë më tepër se një copë bukë. Kishte përshtypjen se në xhepat e kominosheve kishin mbetur do thërrime. Madje ishte e mundshme – këtë e mendoi sepse diçka i

çikte kofshën herë pas here – që në xhep të gjendej një kafshatë. Më në fund, tundimi për ta zbuluar doli më i fortë se frika dhe rrëshqiti dorën në xhep.

- Smith! – klithi zëri nga tele-ekrani. – 6079 Smith U.! Në qeli duart nuk futen në xhepa!

Uinstoni qëndroi sërish palëvizur, me duart kryqëzuar sipër gjunjëve. Para se ta sillnin këtu e kishin çuar diku tjetër, në ndonjë burg të rëndomtë, ose ndonjë dhomë izolimi që përdorej nga patrullat. Nuk e dinte sa kohë e kishin mbajtur aty; të paktën disa orë; pa orë dhe pa dritë ishte e vështirë të përcaktoje kohën. Ishte një vend i zhurmshëm dhe i qelbur. E kishin futur në një qeli të njëjtë me atë në të cilën ndodhej tani, por tejet e pistë dhe gjithmonë me dhjetë ose pesëmbëdhjetë vetë brenda. Shumica e tyre ishin kriminelë ordinerë, por tek-tuk kishte edhe ndonjë të burgosur politik. Qëndronte i heshtur pas murit, i shtypur nga trupa të pistë, me frikën dhe dhimbjen e barkut që s'e linin të këqyrte përreth, megjithatë, nuk i kaloi pa e vënë re dallimin midis të burgosurve politikë dhe ordinerëve. Të burgosurit politikë dukeshin të heshtur dhe të tmerruar, ndërsa kriminelët nuk e çanin kokë për askënd dhe për asgjë. I shanin gardianët, luftonin me tërbim për të mbajtur pajisjet kur ua merrnin autoritetet, shkruanin sharje në dysheme, hanin ushqimin që e kishin fshehur diku në rroba, madje bërtisnin në drejtim të tele-ekranit kur ky përpiqej të vendoste rregull. Kishte edhe nga ata që kishin marrëdhënie të mira me gardianët, i thërrisnin me nofka dhe i lajkatonin për të fituar ndonjë cigare nëpërmjet vrimës së çelësit. Edhe gardianët i trajtonin kriminelët ordinerë me një farë vetëpërmbajtjeje, madje edhe kur u duhej t'i kontrollonin me forcë. Flitej shumë për kampet me punë të detyruar ku pritej të përfundonin shumica e të burgosurve. Uinstoni vuri re se në burg nuk ishte aq keq, nëse kishe kontaktet e duhura dhe dije ta luaje pjesën. Punonte bakshishi, hatëret, dhe dallaveret e gjithëfarëllojshme, kishte homoseksualitet dhe prostitucion, madje gjeje edhe alkool patatesh të futur kaçakçe. Më të besuarit ishin kriminelët ordinerë, veçanërisht gangsterët dhe vrasësit, të cilët përbënin njëfarë aristokracie. Punët më të rëndomta u liheshin të dënuarve politikë.

Hynin e dilnin të burgosur të të gjitha llojeve: trafikantë droge, hajdutë, shitës në tregun e zi, pijanecë, prostituta. Disa nga pijanecët qenë aq të dhunshëm saqë të burgosurve të tjerë u duhej të bashkoheshin për t'i bërë sus. Një gërmadhë e stërmadhe gruaje, rreth gjashtëdhjetë vjeçe, me gjokse të mëdha dhe të varur, me kaçurrela të trasha dhe të lëshuara nga përpjekjet, që shkelmonte e bërtiste, u soll brenda nga katër gardianë të cilët e mbanin, njëri në çdo cep. Gruaja drejtoi trupin dhe i përcolli me një klithmë "Shkërdhata!" Mandej, pasi vuri re që ishte ulur mbi diçka jo të sheshtë, kaloi nga gjunjët e Uinstonit në stol.

- Më fal, i dashur, - tha. – Nuk doja, po ata mutërit më ulën aty. Ata s'ia kanë haberin të sillen me zonjat, apo jo? – Pushoi, çeku lehtë gjoksin, dhe gromësiu. – Më falni, - vazhdoi, - s'e nuk ndihem edhe aq mirë.

U përkul dhe lëshoi një lumë të vjellash në dysheme.

- Tani ndihem më mirë, - tha, duke u përkulur mbrapa me sytë mbyllur. – Kurrë mos e mbaj brenda, kjo është motoja ime. Nxirre ushqimin sa është i freskët në stomak.

U kthye e gjallëruar dhe vështroi sërish nga Uinstoni, dukej se i pëlqeu. E përfshiu me krahun e saj të madh dhe e tërhoqi nga vetja, duke kutërbuar birrë dhe të vjella.

- Si quhesh, i dashur? – e pyeti ajo.

- Smith, - tha Uinstoni.

- Smith, - tha gruaja. – qenka e fortë! Edhe unë quhem Smith. Ou, - vazhdoi me dhimbshuri, - mund të jem edhe nëna jote!

Edhe mund të ishte, mendoi Uinstoni. Ajo kishte afërsisht të njëjtën moshë dhe të njëjtin trup me nënën e tij, e kishte mundësi që të ishte edhe ajo sepse, pas njëzetë vjetëve në kamp me punë të detyruar, njeriu ndryshon disi.

Para gruas askush nuk e kishte marrë mundimin t'i fliste. Pjesa dërrmuese e kriminelëve ordinerë as që ua varnin të burgosurve politikë. "Politikët", i thërrisnin ata, me një lloj përçmimi dhe mospërfilljeje. Të burgosurit politikë kishin frikë të flisnin me njeri, e sidomos me njëri-tjetrin. Vetëm një herë, ndërsa ishin ngjeshur pas njëra-tjetrës në stol, mes zhurmës së zërave të tjerë, Uinstoni dëgjoi dy anëtare të Partisë të pëshpërisnin me

shpejtësi, që folën për diçka të quajtur "dhoma njëqind – eh –një", pa kuptuar pse bëhej fjalë.

Mund të kishin kaluar dy a tre orë qysh kur e kishin sjellë aty. Dhimbja topitëse e barkut nuk iu largua, por herë përmirësohej e herë përkeqësohej ndërsa mendimet zgjeroheshin ose tkurreshin sipas shkallës së dhimbjes. Kur dhimbja përkeqësohej ai mendonte vetëm për dhimbjen dhe dëshirën për të ngrënë. Kur dhimbja përmirësohej, atëherë e pushtonte paniku. Kishte çaste kur i parashikonte me aq vërtetësi gjërat që do t'i ndodhnin saqë zemra fillonte të galoponte ndërsa fryma të pushonte. Ndjeu fshikullimin e shkopinjve të gomës në bërryla dhe çizmet me pafka metalike në kërci; e pa veten duke u përpëlitur në dysheme, duke u lutur për mëshirë me dhëmbët e thyer. Për Xhulian s'mendoi fare. Nuk përqëndrohej dot tek ajo. E donte dhe nuk do ta tradhtonte, por ai ishte një fakt si gjithë të tjerët, si njohja e tabelës së shumëzimit, për shembull. Nuk ndiente dashuri dhe gati nuk e vrau mendjen se çfarë ndodhi me të. Gjithmonë me shpresë, mendoi më tepër për O'Brajënin. O'Brajëni duhet ta kishte marrë vesh arrestimin e tij. *Vëllazëria*, i kishte thënë ai, nuk përpiqet për shpëtimin e anëtarëve të saj. Megjithatë ekzistonte shansi i briskut, po qe se gjenin mundësi ata do t'ia dërgonin. Ndoshta gardianët do të vonoheshin edhe pesë sekonda para se të hynin në qeli. Brisku do t'i futej në mish me njëfarë ftohtësie, e do të priteshin deri në kockë edhe gishtat që do ta shtrëngonin. Mendimet ktheheshin e riktheheshin në trupin e sëmurë që tkurrej e dridhej edhe nga dhimbja më e vogël. Nuk qe i sigurt në do ta përdorte apo jo edhe në qoftë se shtinte briskun në dorë. Ishte më e natyrshme të jetoje çast pas çast, duke pranuar edhe dhjetë minuta të tjera jetë, edhe pse e dije që të prisnin torturat.

Shpeshherë u mundua të numëronte pllakat e porcelanit me të cilat ishte veshur muri. Nuk ishte e vështirë, por ai shkonte gjer në një farë numri dhe pastaj e humbiste fillin. Herë të tjera pyeste veten se ku ndodhej dhe ç'vakt i ditës ishte. Për një çast ishte i sigurt që jashtë ishte ditë, ndërsa pak më vonë mendonte të kundërtën. E dinte në mënyrë instiktive që aty dritat nuk do të shuheshin kurrë. Qelia ishte vend pa errësirë, tani e kuptoi ku

e kishte patur fjalën O'Brajëni. Ministria e Dashurisë nuk kishte dritare. Qelia mund të ishte në zemër të godinës ose ngjitur me murin e saj të jashtëm, mund të ishte dhjetë kate ndën dhé ose tridhjetë sipër. Lëvizi me mendje nga një vend në tjetrin, nga ndryshimet e brendshme të trupit të vet u përpoq të përcaktonte nëse gjendej në lartësi apo thellë ndën tokë.

Jashtë u dëgjua marshi i çizmeve. Dera e çeliktë u hap me një kërcitje metalike. Një oficer riosh, një figurë e rregullt me uniformë të zezë, që shndriste nga të gjitha anët për shkak lëkurës me lustër, fytyra e zbehtë me tipare të drejta si maskë prej dylli, u shfaq me hijeshi në derë. U bëri me shenjë gardianëve të sillnin brenda të burgosurin që mbanin pej krahësh. Poeti Ampëlforth hyri thuajse duke u lëkundur. Dera u mbyll sërish me kërcitje metalike.

Ampëlforthi bëri nja dy lëvizje të çrregullta sa andej-këndej, si për t'u siguruar që nuk kishte derë tjetër nga të largohej, mandej filloi ecejaket në qeli. Nuk e kishte parë ende Uinstonin. Sytë e shqetësuar i kishte ngulur në mur rreth një metër sipër kokës së tij. Ishte zbathur, nga vrimat e çorapeve nxirrnin kokën gishtat e pistë e të mëdhenj. Nuk ishte rruar prej ditësh. Fytyrën ia mbulonte një mjekër e shkurtër e cila i jepte pamje batakçiu, gjë që nuk shkonte me shtatin e madh, por të dobët dhe lëvizjet gjithë emocion.

Uinstoni u zgjua disi prej letargjisë. Duhet t'i fliste Ampëlforthit dhe le të bërtitej çfarë të bërtitej në tele-ekran. Ndoshta Ampëlforthi kishte sjellë briskun.

- Ampëlforth, - thirri.

Nga tele-ekrani nuk u dëgjua zë. Ampëlforthi ndaloi, disi i habitur. Sytë e tij u përqëndruan ngadalë tek Uinstoni.

- Ah, Smith! - tha. – Edhe ti!

- Cila është arsyeja që je këtu?

- Të them të vërtetën... - Ampëlforthi u ul me ngathtësi në stolin përballë Uinstonit. – Vetëm një shkelje mund të bëhet, apo jo?

- Dhe ti e ke bërë?

- Me sa duket, po.

Ampëlforthi vendosi dorën në ballë dhe shtypi tëmthat një çast, sikur donte të kujtonte diçka.

- Kësi gjërash ndodhin, - nisi të flasë turbullt. – Mua më kujtohet vetëm një rast, një rast i mundshëm. Padyshim që ishte pamaturi. Po përgatitnim një botim përfundimtar të poemave të Kiplingut. Unë lejova që fjala "Zot" të mbetej në fund të një vargu. S'e përmbajta dot veten! – shtoi pothuajse i prekur, ndërsa ngriti kokën të shikonte nga Uinstoni: - Ishte e pamundur ta ndryshoje atë varg, ngaqë rimonte dhe gjithë gjuha nuk ka më shumë se dymbëdhjetë fjalë që rimojnë me fjalën "Zot". E shtrydha trurin për ditë me radhë, por nuk arrita të gjeja një rimë tjetër.

Shprehja e fytyrës së tij ndryshoi. Mërzia iu largua dhe dukej pothujse i kënaqur. Njëfarë ngrohtësie intelektuale, hareja e pedantit që kishte gjetur një fakt koti, shkëlqeu mes shkurrnajës me qime të pista e të shkurtra.

- Të ka shkuar ndonjëherë në mendje, - tha, - që gjithë historia e poezisë angleze ka qenë e varur nga fakti që anglishtja nuk ka rima?

Jo, Uinstonit ky fakt nuk i kishte shkuar kurrë ne mendje. Dhe në ato rrethana, nuk iu duk as i rëndësishëm e as tërheqës.

- Mos e di çfarë ore është? – pyeti.

Ampëlforthi u zu në befasi.

- Kjo as që më kishte shkuar në mendje. Mua më arrestuan... dy... ose tre ditë më parë. – Sytë e tij fluturuan nëpër dhomë, në kërkim të një dritareje. – Në këtë vend nuk ka ndryshim midis ditës dhe natës. Nuk e kuptoj si mund ta llogaritim kohën.

Folën edhe do gjëra pa lidhje për ca minuta, pastaj, pa kurrfarë arsyeje të dukshme, një britmë nga tele-ekrani i bëri të pushonin. Uinstoni rrinte në heshje, me duart të kryqëzuara. Ndërsa Ampëlforthi, që mezi e nxinte stoli, kthehej sa nga njëra anë në tjetrën dhe i lidhte duart herë pas njërit gju e herë pas tjetrit. Tele-ekrani i lehu që të mos lëviste. Koha kalonte. Njëzet minuta apo një orë... ishte e vështirë ta thoje. Uinstoni ndjeu tkurrjen e zorrëve. Shpejt, shumë shpejt, ndoshta për pesë minuta, ndoshta tani, gjëmimet e çizmeve do të lajmëronin se i kishte ardhur radha.

Dera u hap. Në qeli hyri oficeri riosh me pamjen e ftohtë. Me një lëvizje të shpejtë të dorës shenjoi Ampëlforthin.

- Dhoma 101, - tha.

Ampëlforthi marshoi me plogështi mes gardianëve, me një turbullim të paqartë në fytyrë, por sikur s'kishte kuptuar asgjë.

Ajo që ishte dukur si kohë e pafund, kaloi. Dhimbja në barkun e Uinstonit u ringjall. Bënte ç'bënte dhe mendja vërdallisej mbi të njëjtat gjëra, si një top që bie vazhdimisht në të njëjtën radhë vrimash. Mendonte veç për gjashtë gjëra: dhimbjen e barkut, një copë bukë, gjakun dhe ulërimat, O'Brajënin, Xhulian dhe briskun. Ndjeu një tjetër spazmë në bark; çizmet e rënda po afroheshin sërish. Vala e ajrit që krijoi hapja e derës solli me vete një kutërbim të fortë djerse të ftohtë. Në qeli hyri Parsonsi. Veshur me pantallona të shkurtra ngjyrë kaki dhe një këmishë sportive.

Uinstoni u habit aq shumë sa harroi gjendjen në të cilën ndodhej.

- Po ti këtu! – tha.

Parsonsi i hodhi një vështrim që nuk tregonte as interes as habi, vetëm mjerim. Ngaqë nuk ruante dot qetësinë, nisi të bënte ecejake të çoroditura tutje-tëhu. Sa herë që i drejtonte gjunjët rondokopë dukej qartë që i dridheshin. Me sytë të shqyer, me një vështrim kundrues, sikur nuk e frenonte dot veten nga këqyrja e diçkaje në gjysmë distancë.

- Pse të sollën këtu? – tha Uinstoni.

- Për krim të mendimit, - tha Parsonsi, gati me dënesë. Zëri i tij kumtonte menjëherë pranimin e fajit dhe tmerr të pabesueshëm që një ditë kjo fjalë do të përdorej edhe për atë. Qëndroi përballë Uinstonit dhe nisi të qaravitej:

- A thua të më vrasin, o burrë i dheut? Thonë se nuk të vrasin në qoftë se nuk ke bërë gjë – vetëm të mendosh, diçka që nuk e frenon dot? E di që të gjykojnë me paanshmëri. Oh, për këtë kam besim! Ata e dinë veprimtarinë time, apo jo? Ti e di ç'lloj njeriu jam unë. Jam ai që jam, por jo njeri i keq. Natyrisht, jo gjeni, por njeri me këmbët në tokë. U përpoqa të bëja më të mirën e mundshme për Partinë, apo jo? Si thua, do t'ia hedh me pesë vjet? Ose, dhjetë? Dikush si puna ime mund të jetë shumë i dobishëm në kampet e punës. Të më vrasin se dola nga shinat vetëm një herë?

- A ndiehesh fajtor? – pyeti Uinstoni.

- Padyshim që ndihem fajtor, - u qaravit Parsonsi, duke parë me servilizëm nga tele-ekrani. – S'besoj se të shkon në mendje që Partia do të arrestonte një të pafajshëm, apo jo?

Fytyra e tij si e bretkosës u qetësua, madje e përfshiu një siguri e shtirur.

- Krimi i mendimit është diçka e tmerrshme, plako, - moralizoi. – Shumë tinzar. Të kap pa e kuptuar. E di si më kapi mua? Në gjumë! Po, pikërisht. Isha në punë, duke u përpjekur të jepja kontributin tim – se kisha ditur kurrë që kisha gjëra të këqija në mendje. Mandej fillova të flisja në gjumë. E di çfarë kisha thënë kur më dëgjuan?

E uli zërin si dikush që është i detyruar të mërmërijë diçka të turpshme për arsye mjekësore.

- Poshtë Vëllai i Madh! Po, e thashë! Siç duket, disa herë me radhë. Plako, të ngelet midis nesh, shyqyr që më kapën pa hedhur ndonjë hap tjetër. E di çfarë do të them kur të dal në gjyq? Faleminderit, do të them, faleminderit që më shpëtuat para se të ishte vonë.

- Kush të denoncoi? – pyeti Uinstoni.

- Ime bijë, - tha Parsonsi me një lloj krenarie prindërore. – Dëgjonte nga vrima e çelësit. Dëgjoi çfarë thoja dhe e përcolli tek patrullat qysh të nesërmen. Jo keq për një fëmijë shtatë vjeç, ë? As që jam prekur nga veprimi i saj. Madje, jam krenar, kjo tregon që e kam rritur ashtu siç duhet.

Parsonsi lëvizi i çoroditur poshtë e lart disa herë rresht me sytë ngulur mbi sifonin e banjës. Befas uli pantallonat e shkurtra.

- Plako, më fal, - tha. – S'e bëj me qëllim. E kam prej pritjes.

Mandej rrasi prapanicën e gjerë sipër sifonit. Uinstoni mbuloi fytyrën me duar.

- Smith! – klithi zëri në tele-ekran. – 6079 Smith U.! Zbulo fytyrën. Nuk mbulohet fytyra në qeli.

Uinstoni zbuloi fytyrën. Parsonsi e përdori sifonin me zhurmë dhe lirshmëri. Doli se shkarkuesi nuk punonte dhe qelia kutërboi me orë të tëra.

Parsonsin e morën. Të tjerë të burgosur erdhën dhe ikën në mënyrë misterioze. Një grua u dërgua në "Dhomën 101" dhe kur dëgjoi këto fjalë, Uinstoni vuri re se ajo nisi të rrudhej dhe të ndryshonte ngjyrë. Arriti një kohë që në qoftë se Uinstoni ishte sjellë aty në mëngjes, atëherë i binte të ishte mbasdite, në qoftë se ishte sjellë në mbasdite, i takonte të ishte mesnatë. Në qeli kishte gjashtë të burgosur, burra e gra. Të gjithë rrinin në qetësi. Përballë Uinstonit ishte një burrë pa mjekër, pa dhëmbë, si një lloj brejtësi i vëllimshëm dhe paqësor. Mollëzat laracuke e të shëndosha qenë aq shumë të fryra në fund saqë dukeshin të fshehura në palat e qafës. Sytë e tij të zbehtë fluturonin nga fytyra në fytyrë dhe largoheshin me vrik sapo ndeshnin sytë e tjetrit.

Dera u hap sërish, sollën një të burgosur tjetër që e bëri Uinstonin ta përshkonte një drithmë e ftohtë kur e pa. Një njeri pa ndonjë rëndësi të veçantë, modest, që mund të ishte inxhinier apo ndonjë lloj tjetër teknicieni. Fytyra e tretur të kallte datën. Gati si kafkë. Dobësia i tregonte sytë dhe gojën shumë të mëdha, ndërkohë që sytë dukeshin të mbushur me urrejtje vrasësi kundër dikujt apo diçkaje.

Burri u ul në stol, shumë afër Uinstonit. Uinstoni nuk ia hodhi më vështrimin, por fytyra-kafkë e torturuar ishte e gjallë në imagjinatën e tij njëlloj sikur ta kishte para syve. Befas e kuptoi si qëndronte puna: i porsaardhuri vuante nga uria. Të gjithë në qeli dukej se mendonin pikërisht këtë. Në gjithë stolin u vu re një trazim i lehtë. Sytë e burrit pa mjekër ndaleshin papushim tek njeriu fytyrë-kafkë, mandej largoheshin si të zënë në faj, për t'u kthyer sërish aty nga një joshje e parezistueshme. Tashmë nisi të lëvizte në ndenjësen e vet. Më në fund u ngrit, u çapit me vështirësi nëpër qeli, futi dorën në xhepin e kominosheve dhe i zgjati me drojë fytyrë-kafkës një copë bukë të ndotur.

Nga tele-ekrani u lëshua një hungërimë e zemëruar shurdhuese. Burri pa mjekër ndaloi menjëherë. Ndërsa burri fytyrë-kafkë i kaloi duart mbrapa, si të donte t'i thoshte botës që e kishte refuzuar dhuratën.

- Bamsted! – hungëriti zëri. – 2713 Bamsted J.! Hidhe në dysheme copën e bukës!

Burri pa mjekër e lëshoi copën e bukës në dysheme.

- Qëndro aty ku je, - urdhëroi zëri. – Ktheu me fytyrë nga dera. Mos lëviz.

Burri pa mjekër bëri siç i thanë. Mollëzat e tij të lëshuara dridheshin të lemerisura. U hap dera. Ndërsa oficeri riosh hyri dhe hapi rrugën, pas tij u shfaq një gardian i shkurtër, me krahë dhe supe të mëdhenj. U ndal përballë burrit pa mjekër dhe, pas një sinjali të oficerit, lëshoi një grusht të frikshëm që e shoqëroi me peshën e trupit, drejt në gojën e burrit pa mjekër. Forca e grushtit e ngriti peshë. Trupi i burrit pa mjekër fluturoi mbi ndenjësen e sifonit. Për një çast qëndroi shtrirë si pa ndjenja, me gjakun e errët që rridhte nga goja dhe hundët. U dëgjua një rënkim ose gulçim që dukej i pavullnetshëm. Mandej u rrotullua dhe, duke u lëkundur, u mbështet mbi pëllëmbët e duarve dhe mbi gjunjë. Nga goja, mes gjakut dhe jargëve, i doli një protezë e thyer më dysh.

Të burgosurit qëndruan palëvizur, me duart të kryqëzuara sipër gjunjëve. Mishi në njërën anë të fytyrës së burrit pa mjekër po mavijosej. Goja iu ënjt dhe u kthye në një masë pa formë me ngjyrë manaferre dhe një vrimë të zezë në qendër. Herë-herë mbi kominoshet e tij kullonte gjak. Sytë i kalonte sërish nga fytyra në fytyrë, me një ndjenjë faji më të madhe se kurrë, sikur përpiqej të zbulonte sesa e përbuznin të tjerët për poshtërimin.

U hap dera. Me një gjest të lehtë, oficeri iu drejtua burrit fytyrë-kafkë.

- Në dhomën 101, - tha.

Përanash Uinstonit u dëgjua një gulçimë dhe alarm. Burri fytyrë-kafkë ishte ulur në gjunjë me duart të shtrënguara fort.

- Shoku, oficer! – u lut. – Pse duhet të më çoni sërish në atë vend? A nuk ua kam treguar gjithçka? Çfarë doni të dini tjetër? Do pranoja gjithçka, gjithçka! Vetëm më thoni çfarë dhe unë do ta pranoja pa një pa dy. Shkruajeni dhe unë do ta firmos – çfarëdo që të jetë! Veç mos më çoni në dhomën 101!

- Në dhomën 101, - tha oficeri.

- Më bëni çfarë të doni, - klithi. – Ju më keni lënë pa ushqim me javë të tëra. Më lini të vdes. Më qëlloni. Më varni. Më dënoni me njëzet e pesë vjet. Mos doni t'ju kallëzoj për ndokënd? Vetëm

më thoni kush është dhe unë do t'ju them gjithë ç'doni. Kam gruan dhe tre fëmijë. Më i madhi është gjashtë vjeç. Mund t'u hiqni gurmazin para syve të mi dhe unë do rri t'i kundroj. Por mos më futni në dhomën 101!

- Në dhomën 101, - tha oficeri.

Burri vështroi me tërbim nga të burgosurit e tjerë, me mendimin se mund t'ia linte vendin e tij një viktime tjetër. I ndali sytë mbi fytyrën e shpartalluar të burrit pa mjekër. Shtriu krahun drejt tij.

- Atë duhet të merrni, jo mua! – bërtiti. – Nuk e dëgjuat çfarë tha pasi iu shkallmua fytyra. Më jepni një mundësi dhe unë do t'jua tregoj fjalë për fjalë. *Ai* është kundër Partisë, jo unë.

- Gardianët bënë përpara. Zëri i burrit u kthye në piskamë: - Ju nuk e dëgjuat! – përsëriti. – Tele-ekrani pati problem. *Ai* është ai që kërkoni. Merrni atë, jo mua!

Dy gardianët shtatshkurtër u përkulën ta kapnin nga krahët. Por ai u shtri në dysheme dhe u kap pas njërës nga këmbët e stolit. Ia nisi një ulërime pa fjalë, si kafshë. Gardianët e tërhoqën ta shkëpusnin, por ai mbahej me një forcë të çuditshme. Kjo vazhdoi ndoshta për njëzet sekonda. Të burgosurit qëndronin të heshtur, me duart kryqëzuar sipër gjunjëve, me sytë ngulur përpara. Ulërima u pre, burri nuk kishte më frymë për të harxhuar veç asaj që i duhej të rrinte mbërthyer. Mandej u dëgjua një klithmë tjetërlloj. Një shkelm me çizmen e gardianit i theu gishtat e dorës. E ngritën në këmbë me dhunë.

- Në dhomën 101, - tha oficeri.

E nxorën jashtë duke u lëkundur e me kokën ulur, ndërsa fërkonte dorën e vrarë, me të gjithë gishtat të thyer.

Kaloi një kohë e gjatë. Në qoftë se kishte qenë mesnatë kur morën burrin fytyrë-kafkë, atëherë atë çast ishte mëngjes: në qoftë se kishte qenë mëngjes, atëherë ishte mbasdite. Uinstoni ishte vetëm dhe kishte qenë vetëm prej disa orësh. Lodhja prej qëndrimit ulur në stol ishte aq e madhe saqë një herë Uinstoni u ngrit për ecejake në qeli pa miratimin e tele-ekranit. Copa e bukës ishte ende aty ku e kishte lënë burri pa mjekër. Në fillim e kishte vështirë që të mos e vështronte, por tani urinë e kishte

zëvendësuar etja. Goja i qe tharë dhe i mbante erë të keqe. Zëri mërmëritës dhe e bardha e pandryshueshme e dritës i shkaktonin marrje mendsh dhe një ndjenjë boshllëku. Ngrihej në këmbë sepse dhimja e eshtrave ishte e padurueshme, pastaj ulej ngaqë i merreshin mendtë dhe s'qe i sigurt në mund të qëndronte në këmbë. Sa herë që dhimbjet qetësoheshin pak, atëherë i rikthehej terrori. Mendonte edhe për O'Brajënin dhe briskun, por shpresa sa vinte shuhej. Në qoftë se i jepnin ushqim, qe e mundshme që bashkë me të t'i sillnin edhe briskun. Mendimet për Xhulian ishin më të errëta. Ndoshta ajo ishte duke vuajtur diku shumë më keq se ai. Atë çast mund të ishte duke ulëritur nga dhimbja. Mendoi: "A do të pranoja ta shpëtoja Xhulian po të shtohej dhimbja ime? Po." Por më tepër ky ishte një mendim inteligjent, ngaqë e dinte se ishte vendimi që duhet të merrte. Por nuk e ndiente. Në këtë vend nuk ndjeje gjë tjetër veç dhimbjes, asaj që përjetoje dhe asaj që të priste. Përveç kësaj, a kishte mundësi që, cilado qoftë arsyeja, të dëshiroje që dhimbja jote të shtohej? Kësaj pyetjeje nuk mund t'i përgjigjej ende.

Çizmet u afruan sërish. U hap dera. Hyri O'Brajëni.

Uinstoni u ngrit në këmbë. Befasia e bëri të mos tregohej i kujdesshëm. Për herë të parë në vite e harroi praninë e tele-ekranit.

- Të kapën edhe ty! – klithi.

- Mua më kanë kapur shumë kohë më parë, - tha O'Brajëni, me një ironi të butë, gati keqardhëse. U mënjanua. Pas tij u shfaq një gardian me kraharorin e gjerë dhe shkopin e gomës në dorë.

- Ti e dije, Uinston, - tha O'Brajëni. – Mos gënje veten. Ti e dije – ti gjithmonë e ke ditur.

Po, tashmë e pa që e kishte ditur gjithmonë. Por nuk kishte kohë të mendohej për këtë. Sytë e tij u ngulën vetëm tek shkopi i gomës në dorën e gardianit. Mund të godiste kudo: në shesh të kokës, në majë të veshit, në krah, në bërryl...

Bërryli! Uinstoni u lëshua në gjunjë, gati i paralizuar, duke shtrënguar me dorën tjetër bërrylin e goditur. Gjithçka kishte marrë ngjyrë të verdhë. E pabesueshme, e pabesueshme që një goditje e vetme mund të shkaktojë kaq dhimbje! Drita u qartësua

dhe ai arriti t'i shihte të dy burrat që e vështronin. Gardiani qeshte me shfytyrimin e tij. Të paktën një pyetje e mori përgjigjen: kurrë, për asnjë arsye, njeriu nuk mund të kërkojë t'i shtohet dhimbja. Për dhimbjen mund të dëshiroje vetëm një gjë: që të ndalonte. Asgjë në botë nuk ishte aq e keqe sa dhimbja fizike. Përballë dhimbjes nuk ka heronj, s'ka heronj, mendoi ndërsa përpëlitej në dysheme, duke shtrënguar pa dobi krahun e sakatuar.

II

Ishte shtrirë mbi diçka që dukej si krevat kampi, me ndryshimin që ai ishte më i lartë dhe i mbërthyer në mënyrë të atillë që të mos lëvizte. Drita, që dukej më e zbehtë se zakonisht, i binte në fytyrë. Anash ndodhej O'Brajëni që e vështronte me vëmendje. Në anën tjetër qëndronte një burrë me xhaketë të bardhë i cili mbante një shiringë hipodermike.

Pasi i hapi sytë, nisi pak nga pak të perceptonte gjërat përreth. Iu duk sikur po ngjitej në këtë dhomë nga një tjetër botë, një lloj bote nënujore poshtë saj. Se sa kohë kishte qenë aty nuk e dinte. Qysh prej çastit që e kishin arrestuar nuk kishte parë ditë ose natë. Përveç kësaj, kujtimet e tij nuk kishin lidhje të vijueshme. Kishte patur kohë kur vetëdija, edhe ajo lloj vetëdije që njeriu ka ndërsa është në gjumë, ishte ndërprerë për të rifilluar sërish pas një ndërkohe. Por nuk kishte mundësi ta merrte vesh nëse ndërkohat ishin ditë, javë apo sekonda.

Ëndrra e keqe kishte filluar me goditjen e parë në bërryl. Më vonë Uinstoni e kuptoi se ajo që ndodhi qe veç parapërgatije, një hutim rutinë të cilit i nënshtroheshin gjithë të burgosurit. Kishte një listë të gjatë krimesh – spiunim, sabotim, e kësi gjërash – që duhej të pranonte çdonjëri. Pranimi ishte formalitet, ndërsa tortura ishte e vërtetë. S'qe në gjendje të thoshte sesa herë ishte rrahur apo sa kishte zgjatur rrahja. Përherë kishte patur pesë ose gjashtë vetë që e rrihnin njëherësh. Njëherë përdornin grushta, njëherë shkopinj gome, njëherë shufra çeliku, njëherë çizmet. Kishte çaste kur rrokullisej në dysheme si kafshë, duke u përpëlitur sa andej këndej me shpresën t'u shmangej goditjeve ndërkohë që bënte

të kundërtën, ftonte të tjera goditje, në brinjë, në bark, në bërryl, në kërci, në ije, në testikula, në kërbishte. Herë-herë ky avaz vazhdonte derisa gjëja më e pafalshme, më mizore dhe e më e çuditshme nuk ishte fakti që gardianët e qëllonin papushim, por që ai nuk e detyronte dot veten të humbiste ndjenjat. Herë-herë kërkonte mëshirë qysh pa nisur goditjet, gritja e një grushti gati për t'i rënë mjaftonte që ta bënte të pranonte një lumë krimesh, realë e imagjinarë. Herë-herë fillonte me betimin se nuk do të tregonte asgjë, çdo fjalë duhej t'i nxirrej me forcë mes gulçimeve prej dhimbjes, por kishte edhe raste kur përpiqej të bënte kompromise të delikate: "Do të pranoj, por jo kaq herët. Duhet të rezistoj derisa dhimbja të bëhet e padurueshme. Edhe dy apo tri goditje të tjera dhe do t'u rrëfej gjithçka që duan." Herë-herë rrihej aq shumë sa nuk qëndronte dot në këmbë, flakej në dyshemenë e qelisë si thes patatesh, e linin pak kohë të merrte veten, pastaj e nxirrnin që ta rrihnin sërish. Kishte edhe periudha të gjata përtëritjeje të cilat nuk i kujtoheshin mirë ngaqë i kalonte në gjumë ose i trullosur. I kujtohej një qeli me një krevat dërrase, si një raft që del nga muri, një lavaman dhe vakte me supë të ngrohtë, bukë dhe ndonjeherë edhe kafe. Kujtonte një berber kokëmushkë që kishte ardhur ta rruante dhe ta qethte dhe burra me përparëse të bardha që i kontrollonin pulsin, reflekset, i ngrinin qepallat, e fërkonin me ashpërsi në kërkim të eshtrave të thyera, rrasnin gjilpëra në krahun e tij ta shtinin në gjumë.

Rrahjet filluan të rralloheshin, për ta kërcënuar kryesisht përdorej një tmerr me të cilin do të përballej në qoftë se përgjigjet që do të jepte nuk do të ishin të kënaqshme. Ata që e merrnin në pyetje nuk ishin më marifetçinjtë me uniforma të zeza, por intelektualë të Partisë, burra topolakë e të vegjël me lëvizje të shpejta dhe syze me skelet metalik, të cilët punonin me turne të cilët zgjatnin – nuk ishte i sigurt – dhjetë ose dymbëdhjetë orë njëri. Këta hetuesit e tjerë e panë që ai ishte në dhimbje të vazhdueshme, por ata nuk mbështeteshin tek dhimbja. E qëlluan me pëllëmbë në fytyrë, i përdrodhën veshët, i shkulën flokët, e vendosën të qëndronte me një këmbë, nuk e linin të urinonte, ia përqëndronin dritën në fytyrë derisa sytë mbyteshin në lotë,

por qëllimi i gjithë kësaj ishte thjesht poshtërimi dhe shkatërrimi i fuqisë së arsyetimit. Arma e tyre e vërtetë ishin pyetjet e pafund, orë pas ore, kapja pas gabimeve, ndërtimi i kurtheve, përdredhja e gjithçkaje që thoshte ai, fajësimi për çdo gabim e kontradiktë, derisa ai fillonte të qante nga turpi dhe lodhja nervore. Nganjëherë kishte raste që qante shtatë-tetë herë në një seancë. Shumicën e kohës e shanin dhe sa herë që stepej të fliste e kërcënonin se do ta dorëzonin tek gardianët, por shpeshherë ata e ndryshonin qëndrimin e tyre, e quanin shok, i bënin thirrje në emër të Anglosocit dhe Vëllait të Madh, e pyesnin me keqardhje që as pas gjithë këtyre nuk i kishte mbetur ndopak dashuri për Partinë që ta ndihmonte të korrigjonte të shkuarën. Kur nervat e tij ishin masakruar pas gjithë atyre orëve hetim, edhe kjo thirrje e shkrehte në vaj. Në fund, zërat acarues e zbërthyen tërësisht dhe shumë më lehtë se çizmet e gardianëve. Uinstoni u kthye në një gojë që mërmëriste dhe në një dorë që firmoste çdo gjë që i kërkohej. Meraku i tij i vetëm ishte që të dinte se çfarë duhej të pranonte dhe pastaj ta bënte këtë menjëherë, para se të fillonin ta poshtëronin prap. Pranoi vrasjen e anëtarëve të rëndësishëm të Partisë, shpërndarjen e pamfleteve armiqësorë, shpërdorimin e fondeve publike, shitjen e sekreteve ushtarake, sabotime të të gjitha llojeve. Pranoi që kishte punuar si spiun me pagesë për qeverinë e Azisë Lindore qysh prej vitit 1968. Pranoi që ishte besimtar fetar, adhurues i kapitalizmit dhe maniak seksual. Pranoi që kishte vrarë të shoqen, megjithëse e dinte dhe duhet ta dinin edhe hetuesit, që ajo ishte gjallë. Pranoi që kishte patur lidhje personale me Goldshteinin për vite me radhë dhe që ishte anëtar i një organizate ilegale në të cilën bënin pjesë gjithë krijesat njerëzore që ai kishte njohur ndonjëherë. Nuk ishte e vështirë të pranoje gjithçka dhe të implikoje këdo. Pastaj, në njëfarë mënyre, gjithçka qe e vërtetë. Ishte e vërtetë që kishte qenë armik i Partisë dhe në sytë e saj nuk kishte dallim midis mendimit dhe veprimit.

Por kishte edhe kujtime të një tjetër lloji, të cilat shfaqeshin pa kurrfarë lidhjeje, si pamje që pluskojnë në një sfond të zi.

Uinstoni ndodhej në qeli për të cilën nuk mund të thoshte nëse ishte me dritë apo e errët, sepse nuk shikonte asgjë përveç një palë syve. Jo shumë larg, një instrument që bënte tiktak ngadalë

dhe në mënyrë ritmike. Sytë zmadhoheshin dhe shkëlqenin edhe më. Befas rrëshqiti nga ndenjësja dhe sytë e gëlltitën.

Uinstonin e kishin fashuar pas një karrigeje rrethuar nga një sërë dhimbjematësish, poshtë një drite verbuese. Një burrë me xhaketë të bardhë lexonte dhimbjematësin. Jashtë dëgjohej marshi i çizmeve të rënda. U hap dera. Oficeri me fytyrë prej dylli hyri brenda, shoqëruar nga dy gardianë.

- Në dhomën 101, - tha oficeri.

Burri me xhaketë të bardhë nuk ua hodhi sytë, por nuk vështroi as nga Uinstoni, ai këqyrte vetëm dhimbjematësin.

Po vraponte përgjatë një korridori të stërmadh, një kilometër të gjerë, ndriçuar cep më cep nga një dritë e artë, duke u shqyer gazit dhe duke pranuar gjithçka me zë të lartë. Pranonte çdo gjë, madje edhe ato që nuk i kishte treguar gjatë torturave. Tërë historinë e jetës së vet po ia tregonte një audience që tashmë e dinte. Me të ishin gardianët, hetuesit, burri me xhaketë të bardhë, O'Brajëni, Xhulia, zoti Karrington, të gjithë duke vrapuar përgjatë korridorit, të shqyer gazit. Diçka e tmerrshme, e parashikuar të ndodhte diku në të ardhmen, kishte dështuar. Gjithçka shkonte bukuri, dhimbja ishte zhdukur, detaji i fundit i jetës së tij kishte dalë në dritë, ishte mirëkuptuar dhe falur.

Uinstoni kërceu përpjetë nga krevati me dërrasa me bindjen e mjegullt se kishte dëgjuar zërin e O'Brajënit. Megjithëse nuk e kishte parë, përgjatë gjithë hetimit ai kishte patur ndjesinë se mund ta prekte O'Brajënin me një zgjatje dore, vetëm se nuk dukej. Gjithçka ishte e dirigjuar nga O'Brajëni. Ai i kishte dërguar gardianët dhe ai nuk i kishte lënë ta vrisnin. Ai vendoste se kur duhej që Uinstoni të ulërinte nga dhimbja, kur duhej të çlodhej, kur duhej t'i jepej ushqim, kur duhej të flinte, kur duhej t'i injektoheshin drogat. Dhe ishte po ai që bënte pyetjet e sugjeronte përgjigjet. O'Brajëni ishte torturuesi, mbrojtësi, inkuizitori dhe miku. Ndërsa njëherë – Uinstonit nuk i kujtohej në ishte në gjumë normal apo të droguar, apo mos ishte zgjuar – dikush i mërmëriti në vesh: "Mos u mërzit, Uinston, je nën kujdesin tim. Të kam vrojtuar shtatë vjet rresht. Tashmë ka mbërritur ora e kthesës së madhe, do të të shpëtoj, do të të përsos." Nuk ishte i sigurt nëse kishte qenë zëri i O'Brajënit, por ishte po ai që i kishte thënë:

"Do të takohemi në një vend pa errësirë", në ëndrrën tjetër, shtatë vjet më parë.

Nuk i kujtohej sesi kishin mbaruar seancat e hetimeve. Në qelinë apo dhomën në të cilën ndodhej fillimisht kishte një ndërkohë errësire, ndërsa tashmë kishte filluar të lëndëzohej. Qe shtrirë në shpinë, i paaftë të lëvizte. Trupi ishte mbërthyer pas krevatit në çdo pikë thelbësore, madje edhe pjesa e mbrapme e kokës qe mbërthyer në njëfarë mënyre. O'Brajëni e vështronte me seriozitet dhe tejet i trishtuar. E parë nga poshtë, fytyra e tij dukej e vrazhdë dhe e lodhur, me qeska poshtë syve dhe rrudha nga hunda në mjekër. Qe më i moshuar nga ç'kishte menduar Uinstoni, ndoshta dyzet e tetë-pesëdhjetë vjeç. Poshtë duarve të tij kishte një dhimbjematës me levën sipër dhe figurat që vinin rrotull fytyrës.

- Të thashë, - tha O'Brajëni, - që në qoftë se do të takoheshim sërish, ky do të ishte vendi.

- Po, - tha Uinstoni.

Pa asnjë paralajmërim, përveç një lëvizjeje të lehtë të dorës së O'Brajënit, ia përshkoi trupin një valë dhimbjeje. Dhimja qe e frikshme ngaqë ai nuk mundej të shihte se çfarë po ndodhte dhe kishte ndjesinë se ndaj tij po ushtrohej një akt vdekjeprurës. Nuk e kuptonte nëse vërtet ndodhte diçka apo efekti prodhohej në mënyrë elektrike, veçse ndiehej gjithnjë e më i pafuqishëm dhe po zbërthehej në kyçe me ngadalë. Megjithëse dhimbja ia mbushi ballin me djersë, frika më e madhe ishte se mos i shkërmoqej shtylla kurrizore. Shtrëngoi dhëmbët dhe mori frymë me hundë, në përpjekje të shmangte klithmat sa më gjatë të qe e mundur.

- Ti ke frikë, - tha O'Brajëni ndërsa e vështronte në fytyrë, - se nga çasti në çast mund të thyhet diçka. Ke frikë se mos kjo është shtylla kurrizore. Ti ke një imazh të gjallë mbi zbërthimin e vertebrave dhe palcës kurrizore që do të rrjedhë prej tyre. Uinston, këtë po mendon, apo jo?

Uinstoni nuk u përgjigj. O'Brajëni shtyu mbrapa levën e dhimbjematësit. Vala e dhimbjes u largua aq shpejt sa kishte ardhur.

- Dyzet ishte, - tha O'Brajëni. – Ti e shikon që numrat e këtij dhimbjematësi shkojnë deri në njëzet. Të lutem, mos harro që gjatë bashkëbisedimit kam fuqinë të të shkaktoj dhimbje në çdo çast dhe të çfarëdo shkalle që më pëlqen. Në qoftë se më gënjen, ose në qoftë se përpiqesh të dredhosh, ose edhe në qoftë se bie më poshtë se niveli i zakonshëm i inteligjencës tënde, do të klithësh nga dhimbja në çast. Qartë?

- Po, - tha Uinstoni.

Sjellja e O'Brajënit u zbut disi. Rregulloi syzat mendueshëm dhe bëri ca ecejake. Fliste butë dhe shtruar. Sillej si doktor, mësues, ose prift, me shqetësimin që të shpjegonte dhe jo të ndëshkonte.

- Uinston, me ty po rrezikoj sepse ia vlen, - tha. – Ti e di shumë mirë cili është problemi yt. E ke ditur prej vitesh, por ke punuar kundër tij. Ti ke luajtur mendsh. Vuan nga kujtesa e dobët. Nuk je në gjendje të kujtosh ngjarjet e vërteta, ndërsa përpiqesh të kujtosh gjëra të tjera, të cilat nuk kanë ndodhur. Fatmirësisht, kjo gjë kurohet. Nuk e ke kuruar kurrë, sepse nuk të ka dashur qejfi. Kërkonte veç vullnet, por ti nuk e more kurrë mundimin. Jam i vetëdijshëm që edhe tani je i bindur që sëmundja tënde është virtyt. Po bëjmë një provë: me cilën fuqi është në luftë Oqeania këtë çast?

- Kur më arrestuan, Oqeania ishte në luftë me Azinë Lindore.

- Me Azinë Lindore. Bukur. A ka qenë gjithmonë Oqeania në luftë me Azinë Lindore?

Uinstoni mbajti frymën. Hapi gojën të fliste dhe nuk foli. Nuk mund t'i shqiste sytë nga dhimbjematësi.

- Uinston, të lutem, vetëm të vërtetën. Të vërtetën *tënde*. Më thuaj çfarë të kujtohet.

- Më kujtohet që një javë para se të arrestohesha, me Azinë Lindore nuk ishim në luftë, por në aleancë. Lufta, që kishte zgjatur për katër vjet, bëhej kundër Euroazisë. Para kësaj…

O'Brajëni e ndaloi me një lëvizje të dorës.

- Një tjetër shembull, - tha. – Ca vite më parë kishe ca iluzione vërtet për t'u shqetësuar. Mendoje se tre qytetarë, tre ish anëtarë të Partisë të quajtur Xhons, Aronson dhe Radhërford – që u

ekzekutuan për tradhti dhe sabotazh pasi e pranuan fajësinë – qenë të pafajshëm. Besoje se kishe parë fakte të pakundërshtueshme që vetëfajësimi i tyre ishte i rremë. Sipas haluçinacioneve të tua ekzistonte një fotografi, për të cilën ishe i bindur që e kishe parë. Një fotografi si kjo.

Midis gishtave të O'Brajënit u shfaq një rrip i gjatë gazete. Uinstoni pati mundësi ta shikonte rreth pesë sekonda. Ishte fotografi dhe nuk kishte asnjë dyshim për vërtetësinë e saj. Ishte *fotografia* në fjalë. Një tjetër kopje e fotografisë së Xhonsit, Aronsonit dhe Radhërfordit të dërguar nga Partia në Nju Jork, të cilën ai e kishte ndryshuar njëmbëdhjetë vjet më parë dhe e kishte shkatërruar. I dolën para syve vetëm një çast, pastaj u zhdukën përsëri. Por ai e kishte parë, padyshim që e kishte parë! U përpoq me dhimbje dhe dëshpërim të çlironte pjesën e sipërme të trupit, por ishte e pamundur që të lëvizte qoftë edhe një centimetër. Për momentin e kishte harruar fare edhe dhimbjematësin. Donte vetëm ta prekte fotografinë me duart e tij, ose të paktën ta shihte.

- Ekziston! – klithi.

- Jo, - tha O'Brajëni.

O'Brajëni u çapit nëpër dhomë. Në murin përballë kishit një vrimë kujtese. Ngriti kapakun. Fshehtas, shiriti i brishtë i gazetës u përpi nga rryma e ngrohtë e ajrit, po zhdukej në gjuhët e zjarrit. O'Brajëni u largua nga muri.

- Hi, - tha. – Madje hi që nuk mund të dallohet. Pluhur. Që nuk ekziston. Që nuk ka ekzistuar kurrë.

- Sigurisht që ka ekzistuar! Ekziston! Ekziston në kujtesë. Unë e mbaj mend, ti po ashtu.

- Mua s'më kujtohet, - tha O'Brajëni.

Uinstonin e lanë fuqitë. Ky ishte mendim i dyfishtë në mënyrën më të kulluar. Diçka që nuk e priste. Po ta kishte ditur që O'Brajëni gënjente nuk do t'i kishte bërë shumë përshtypje. Por kishte shumë mundësi që O'Brajëni e kishte harruar fotografinë vërtet. Dhe nëse qe kështu, atëherë ai duhet të kishte harruar që tha se nuk i kujtohej, e mandej do të harronte që kishte harruar. Si mund të ishe i sigurt që qe veç një truk? Ndoshta bllokimi në mendje ndodhte vërtetë, ky mendim e mposhtte Uinstonin.

O'Brajëni e vështronte me dyshim. Si kurrë më parë, ai po sillej si mësuesi me një nxënës të vështirë, por premtues.

- Partia ka një sllogan që flet për të shkuarën, - tha. – Përsërite, të lutem.

- Kush kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen, kush kontrollon të tashmen, kontrollon të shkuarën, - përsëriti Uinstoni i bindur.

- Kush kontrollon të tashmen, kontrollon të shkuarën, - tha O'Brajëni, duke miratuar me një përkulje të lehtë të kokës. - Uinston, mendon se e shkuara ekziston vërtet?

Uinstonin e lanë fuqitë sërish. I vajtën sytë tek dhimbjematësi. Jo vetëm që nuk e dinte se "po-ja" apo "jo-ja" do ta shpëtonte nga dhimjet, por nuk dinte as se cila prej tyre ishte përgjigjja e saktë.

O'Brajëni qeshi lehtë.

- Uinston, ti nuk je metafizikan. Deri tani as nuk e kishe shkuar në mendje se çfarë është ekzistenca. Ose më saktë: a ekziston e shkuara në mënyrë konkrete, në hapësirë? Ka diku një vend, një botë objektesh lëndore, ku e shkuara ndodh ende?

- Jo.

- Atëherë, në qoftë se e shkuara ekziston, ku ndodhet?

- Në arkiva. E shkruar.

- Në arkiva. Dhe...

- Në mendje. Në kujtimet e njeriut.

- Në kujtesë. Qartë, atëherë. Ne, Partia, kontrollojmë arkivat dhe kujtimet. E kështu kontrollojmë të shkuarën, apo jo?

- Por si mund *t'*i ndaloni njerëzit mos të kujtojnë? – klithi Uinstoni, duke e harruar për një çast dhimbjematësin. – Të kujtuarit është diçka e pavullnetshme. Jashtë qenies. Si mund ta kontrolloni kujtesën. Ju s'keni mundur të kontrolloni kujtesën time?

O'Brajëni u vrenjt sërish. Afroi dorën tek dhimbjematësi.

- Përkundrazi, - tha, - *ti* nuk e ke kontrolluar. Dhe kjo është arsyeja pse ndodhesh këtu. Je këtu sepse nuk je nënshtruar dhe nuk ke treguar vetëdisiplinë. Ti nuk pranove të bindeshe siç bën çdo njeri me dy pare mend në kokë. Ti zgjodhe të ishe i çmendur, të bëje sipas kokës. Uinston, vetëm mendjet e disiplinuara mund ta shikojnë realitetin. Ti mendon se realiteti është diçka objektive,

e jashtme dhe ka të drejtën të ekzistojë i pavarur. Ti beson që natyra e realitetit është e dukshme. Kur zhytesh në mendime dhe shikon diçka ti mendon se gjithë bota shikon të njëjtën gjë. Por ja ku po ta them Uinston, realiteti nuk është diçka e jashtme. Realiteti ekziston vetëm në mendjen njerëzore dhe askund tjetër. Jo në mendjen e individit, i cili mund të bëjë gabime ose mund të zhduket, vetëm në mendjen e Partisë e cila është kolektive dhe e pavdekshme. E vërteta është ajo që Partia e mban për të vërtetë. Realiteti mund të shikohet vetëm me sytë e Partisë. Këtë duhet ta mësosh edhe një herë nga e para, Uinston. Kjo kërkon vullnet dhe një masë vetëshkatërrimi. Para se të fitosh kthjelltësinë mendore duhet të përulesh.

O'Brajëni heshti një çast, si të linte kohë që ajo që tha të mbërrinte aty ku duhej.

- Të kujtohet, - vazhdoi, - kur shkrove në ditar: Liri është liria të thuash që dy edhe dy bëjnë katër?

- Po, - tha Uinstoni.

O'Brajëni ngriti dorën e majtë me shpinë nga Uinstoni, me gishtin e madh të ulur ndërsa katër të tjerët ngritur.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Katër.

- Po në qoftë se Partia thotë që janë pesë – atëherë sa janë?

- Katër.

Kjo fjalë u shoqërua me një klithmë. Gjilpëra e dhimbjematësit shkoi tek pesëdhjetë e pesa. Uinstoni u mbulua i gjithi në djersë. Ajri që nxirrte nga mushkëritë dilte në formën e gulçimeve të thella edhe pse ai shtrëngonte dhëmbët që t'i ndalonte. O'Brajëni e vështroi, me katër gishtat gritur ende lart. Uli levën e dhimbjematësit. Këtë radhë dhimbja vetëm sa u lehtësua pak.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Katër.

Gjilpëra shkoi tek gjashtëdhjeta.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Katër! Katër! Çfarë të them tjetër? Katër!

Gjilpëra u ngjit përsëri, por ai nuk ia hodhi sytë. Fytyra e

vrenjtur dhe katër gishtat nuk e linin të shikonte. Katër gishtat qëndronin para syve të tij si kolona gjigante, të mjegullt dhe dridheshin pak, por se luante as topi që ishin katër.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Katër! Mjaf, mjaft! Si është e mundur të vazhdosh! Katër! Katër!

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Pesë! Pesë! Pesë!

- Jo, Uinston, s'e ha kush këtë. Ti gënjen. Ti ende mendon që aty janë katër. Sa gishta janë, të lutem?

- Katër! Pesë! Katër! Sa të duash ti. Veç mjaft, ndaloje dhimbjen!

Befas Uinstoni e pa veten ngritur, me krahun e O'Brajënit në sup. Ndoshta kishte humbur ndjenjat pak çaste. Fijet që ia mbanin trupin lidhur qenë liruar. Kishte shumë ftohtë, dridhej në mënyrë të pakontrollueshme, dhëmbët i kërcisnin, lotët i rrëshqisnin faqeve. Për një çast u rehatua në krahun e O'Brajënit, si fëmijë. Me ndjesinë se O'Brajëni ishte mbrojtësi i tij, dhimbja ishte diçka që vinte nga jashtë, që buronte tjetërkund, dhe O'Brajëni do ta shpëtonte prej saj.

- Uinston, ti mëson shumë ngadalë, - tha O'Brajëni me të butë.

- Si mund ta bëj një gjë të tillë? – dënesi ai. – Si mund ta bëj kur para syve kam vetëm katër gishta? Dy dhe dy bëjnë katër.

- Uinston, nganjëherë bëjnë pesë, ndërsa herë të tjera tre. Ndonjëherë edhe tre edhe pesë njëherësh. Duhet të përpiqesh më shumë. Nuk është e lehtë të fitosh kthjelltësinë mendore.

E shtriu Uinstonin në krevat. Gjymtyrët iu shtrënguan sërish, por dhimbja iu largua dhe dridhja e trupit pushoi, ndihej i dobët dhe kishte ftohtë. O'Brajëni i bëri shenjë me kokë burrit me xhaketë të bardhë i cili kishte qëndruar pa lëvizur gjatë gjithë seancës. Burri me xhaketë të bardhë u përkul dhe këqyri nga afër sytë e Uinstonit, i kontrolloi pulsin, e dëgjoi me vesh, e preku në vende të ndryshme dhe miratoi me kokë nga O'Brajëni.

- Sërish, - tha O'Brajëni.

Trupin e Uinstonit e përfshiu dhimbja. Shigjeta duhet të kishte shkuar tek shtatëdhjeta ose shtatëdhjetë e pesa. E dinte që gishtat ishin ende aty dhe sërish katër. E rëndësishme ishte që të mbetej gjallë derisa të mbaronte spazma. Nuk e kuptonte dot më në qante apo jo. Dhimbja u zbut sërish. Hapi sytë. O'Brajëni kishte ulur levën.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Katër. Besoj se katër. Do të shihja pse po të mundja. Po përpiqem të shohë pesë.

- Ti do që të më bindësh mua se shikon, apo do që t'i shikosh vërtet?

- T'i shikoj vërtet.

- Menjëherë, - tha O'Brajëni.

Ndoshta gjilpëra shkoi te tetëdhjeta ose nëntëdhjeta. Herë pas here nuk e kuptonte më se cili qe shkaku i dhimbjes. Para qepallave të tij të leqendisura vallëzonte një pyll gishtash, valëzonin tutje-tëhu, zhdukeshin pas njëri-tjetrit dhe shfaqeshin përsëri. Përpiqej t'i numëronte, por nuk i kujtohej pse. Dinte vetëm që ishte shumë e vështirë t'i numëronte dhe kjo ndodhte për shkak të njëfarë identiteti të fshehtë midis katrës dhe pesës. Dhimbja u zbut përsëri. Kur hapi sytë vuri re se ishte duke parë të njëjtën gjë. Një pafundësi gishtash, si pemë lëvizëse, venin e vinin në të dy drejtimet, duke kaluar e parakaluar njëri-tjetrin. Uinstoni mbylli sytë përsëri.

- Sa gishta janë këtu, Uinston?

- Nuk e di. Nuk e di. Më mirë vramë sesa ta bësh prap. Katër, pesë, gjashtë – sinqerisht, nuk e di.

- Kjo është përgjigje më e mirë, - tha O'Brajëni.

Në krahun e Uinstonit rrëshqiti një gjilpërë. Pothuajse në të njëjtën kohë ia përshkroi trupin një ngrohtësi shëruese dhe harendjellëse. E harroi krejt dhimbjen. Hapi sytë dhe vështroi O'Brajënin në shenjë mirënjohjeje. Zemra i lëvizte vendit kur shikonte fytyrën serioze plot rrudha, të shëmtuar dhe inteligjente. Po të kishte mundur do kishte zgjatur krahun ta mbështeste në supin e O'Brajënit. Kurrë më parë nuk e kishte dashur kaq

shumë, dhe shkaku nuk qe ndalimi i dhimbjes. Ju kthye përsëri ndjenja e vjetër, nuk kishte rëndësi fakti në e kishte mik apo armik O'Brajënin. Ai qe njeri me të cilin mund të flisje. Ndoshta njeriu do më shumë që ta kuptosh sesa ta duash. Torturat e O'Brajënit e kishin çuar deri në kufijtë e çmendurisë dhe ishte e qartë që për një copë herë mund ta vdisnin. S'kishte rëndësi. Në njëfarë kuptimi bëhej fjalë për diçka më të madhe se shoqëria, intimiteti; megjithëse fjalët e vërteta mund të mos përmendeshin, këtu apo diku tjetër, ekzistonte një vend ku ata mund të bisedonin. Fytyra e O'Brajënit kishte marrë një pamje që kumtonte se në mendjen e tij po shfaqej i njëjti mendim. Ai nisi të fliste me një ton të shtruar bisedimor.

- Uinston, - tha, - a e di ku ndodhesh?

- Jo, por mund ta marr me mend. Në Ministrinë e Dashurisë.

- E di për sa kohë ke qenë këtu?

- Jo. Disa ditë, javë, muaj... muaj, ma ha mendja.

- Si thua, pse i sjellim njerëzit në këtë vend?

- Të rrëfehen.

- Jo, nuk është ajo arsyeja. Provoje edhe njëherë.

- T'i ndëshkoni.

- Jo! – klithi O'Brajëni. Zëri i tij ndryshoi krejtësisht, fytyra iu bë e egër dhe më e zhdërvjellët. – Jo! As të dëgjojmë rrëfimet e tua dhe as të të ndëshkojmë. Të ta them pse të kemi sjellë këtu? Të të shërojmë! Të të kthejmë kthjelltësinë mendore! Uinston, e kupton që askush nga ata që kemi sjellë këtu nuk është larguar pa u shëruar? Nuk jemi të interesuar për krimet e tua pa ndonjë vlerë. Partisë nuk i interesojnë krimet që duken, mendimi është ajo çfarë na shqetëson. Ne nuk mjaftohemi me shkatërrimin e armikut, ne duam ndryshimin. E kupton ku e kam fjalën?

U përkul sipër Uinstonit. Për shkak të afërsisë fytyra e tij dukej e stërmadhe dhe, meqë shikohej nga poshtë, tmerrësisht e shëmtuar. Për më tepër, ishte mbushur me një lloj ngazëllimi çmendurak. Uinstonit iu prenë fuqitë edhe një herë tjetër. Po të qe e mundur do të ishte kruspullosur edhe më. E ndjeu që O'Brajëni ishte gati ta ngrinte levën sërish, thjesht për qejf.

Megjithatë, atë çast O'Brajëni u largua. Bëri disa ecejake, pastaj foli me vrull:

- Gjëja e parë që duhet të kuptosh është se në këtë vend nuk ka martirizime. Ti ke lexuar për ekzekutimet fetare në të shkuarën. Për inkuizicionin e mesjetës, që ishte një dështim i plotë. Ai u krijua për të zhdukur herezinë dhe përfundoi duke e zhvilluar atë. Në vend të një heretiku që digjej, ngriheshin mijëra të tjerë. Pse do të thuash? Sepse inkuizicioni i vriste armiqtë në publik dhe i vriste ndërsa ata nuk ishin penduar akoma; në fakt, i vriste ngaqë ata nuk pendoheshin. Njerëzit vdisnin sepse nuk i braktisnin bindjet e tyre. Dhe kështu që lavdia i përkiste viktimës ndërsa turpi inkuizitorit që e digjte. Më vonë, në shekullin e njëzetë, u shfaqën ata që quheshin totalitarë. Nazistët gjermanë dhe komunistët rusë. Rusët e ndëshkonin herezinë në mënyrë më çnjerëzore se inkuizicioni. Ata mendonin se kishin mësuar nga gabimet e së shkuarës, të paktën e dinin që nuk duhej të lindnin martirë. Para se t'i nxirrnin viktimat në gjyqe publike, u shkatërronin dinjitetin. I lodhnin me tortura dhe vetmi derisa ata bëheshin të neveritshëm, mjeranë të përulur, të cilët pranonin gjithçka që u kërkohej, që shanin vetveten, që akuzonin mbrapa krahëve, që qaraviteshin për mëshirë. Por pas disa vitesh përsëritej e njëtja gjë. Të vdekurit bëheshin martirë dhe harrohej fare degradimi i tyre. Por pse ndodhte kjo përsëri? Së pari, sepse gjithçka qe e gënjeshtërt, krimet qenë pranuar nga torturat. Ndërsa ne nuk bëjmë gabime të asaj natyre. Gjithë krimet që pranohen këtu janë të vërteta. Ne i bëjmë të tilla. Dhe mbi të gjitha, nuk i lejojmë të vdekurit të ngrihen kundër nesh. Uinston, duhet të heqësh dorë nga mendimi se do të ta marrin hakun pasardhësit. Ata nuk do të dëgjojnë kurrë për ty. Ti do të fshihesh nga historia. Do të të kthejmë në gaz dhe do të flakim në stratosferë. Prej teje nuk do të mbetet asgjë; as emër në regjistër, as kujtim në mendjet e njerëzve. Do të avullohesh nga e shkuara dhe e ardhmja. Nuk do të kesh ekzistuar kurrë.

Atëherë pse lodheni duke më torturuar, mendoi Uinstoni, me një hidhërim të çastit. O'Brajëni kontrolloi veprimet e veta sikur

Uinstoni të kishte menduar me zë të lartë. Fytyra e tij e shëmtuar, me sytë të zvogëluar, u qas pak më shumë.

- Ti mendon, - tha ai, - se përderisa vendosëm të të shkatërrojmë tërësisht, ato që mund të thuash apo bësh nuk kanë asnjë rëndësi – kështu që pse e marrim mundimin të të hetojmë? A nuk mendoje pikërisht kështu, Uinston?

- Po, - tha Uinstoni.

O'Brajëni buzëqeshi lehtë.

- Sepse ti je përjashtim në gjithë këtë sistem, Uinston. Një njollë që duhet fshirë. A nuk të thashë pak më parë se ne jemi ndryshe nga persekutorët e së shkuarës? Ne nuk kënaqemi me përuljen nga detyrimi, madje as me nënshtrimin më mjeran. Kur të nështrohesh, ky nënshtrim duhet të bëhet me vullnetin tënd të lirë. Ne nuk e asgjësojmë heretikun sepse na bën rezistencë, për sa kohë që ai na reziston nuk e asgjësojmë. Ne e shndërrojmë, I depërtojmë në thelbin e trurit, i japim trajtë të re. Ia nxjerrim jashtë gjithë iluzionet dhe të keqen, e sjellim në anën tonë, jo sa për sy e faqe, por realisht, me zemër dhe shpirt. Për ne është e pafalshme që diku në botë të ekzistojë një mendim i gabuar, sado i fshehtë apo i dobët që mund të jetë. Ne nuk lejojmë devijime as në momentin e vdekjes. Në të shkuarën një heretik ecte drejt turrës së druve si heretik, duke shpallur herezinë e tij, i ngazëllyer prej saj. Madje edhe viktimat e spastrimeve ruse, ndërsa ecnin në rresht drejt plumbit, e merrnin me vete, mbyllur në kafkën e tyre, rebelimin. Ndërsa ne nuk e hedhim trurin në erë pa e përsosur më parë. Urdhëri i regjimeve despotike të vjetra ishte: "Ti nuk duhet". Urdhri i regjimeve totalitare ishte: "Ti duhet". Ndërsa urdhri ynë është: "Ti je". Asnjëri nga ata që sjellim në këtë vend nuk na bën dot ballë. Të gjithë pastrohen. Madje edhe tradhtarët e ndyrë për të cilët, dikur, ti mendoje se ishin të pafajshëm – Xhonsi, Aronsoni dhe Radhërfordi – në fund u zbërthyen. Unë mora pjesë vetë në hetimin e tyre. Pashë si sfiliteshin ngadalë-ngadalë, dënesnin, përpëliteshin, qanin – dhe në fund nuk triumfoi dhimbja apo frika, por durimi. Kur mbaruam punë, ata ishin kthyer në guaska njerëzore. Në fund s'u kishte mbetur gjë tjetër veç pikëllimit për atë që kishin bërë

dhe dashurisë për Vëllain e Madh. Mënyra si e donin ishte prekëse. Na u lutën t'i qëllonim pa humbur kohë, që truri i tyre të ishte i pastër.

Zëri i tij kishte nisur të bëhej ëndërrimtar. Me ngazëllimin dhe entuziazmin çmendurak ende në fytyrë. Nuk shtiret, mendoi Uinstoni, nuk është hipokrit, ai e beson çdo fjalë që thotë. Ajo që e brengosi Uinstonin ishte vetëndërgjegjësimi për inferioritetin intelektual. Vështronte trupin e rëndë, por të hijshëm, që vinte tutje-tëhu, herë brenda e herë jashtë rrezes së tij të shikimit. O'Brajëni ishte një qenie më e madhërishme nga ai në çdo drejtim. Nuk kishte ide nga të tijat që O'Brajëni nuk i kishte ndeshur shumë më herët, i kishte ekzaminuar dhe i kishte flakur. Mendja e tij *përmbante* mendjen e Uinstonit. Në qoftë se ishte kështu, atëherë si mund të ishte i çmendur O'Brajëni? Patjetër që i lajthituri duhet të ishte Uinstoni. O'Brajëni u ndal dhe e vështroi. Zëri i tij ishte egërsuar sërish.

- Sado i plotë të jetë nënshtrimi yt, Uinston, mos mendo që do të shpëtosh. Askush nuk ka shpëtuar, qoftë edhe ata që kanë devijuar vetëm një herë. Edhe sikur të të lejojmë të jetosh tërë jetën, prapëseprapë s'do të na shmangesh dot. Ajo çfarë të ndodh këtu të ndodh përgjithmonë. Kuptoje parakohe. Do të të shkatërrojmë deri në pikën ku nuk ka më kthim. Do të të ndodhin gjëra prej të cilave nuk do ta marrësh veten edhe sikur të jetosh njëmijë vjet. Nuk do të kesh kurrë më ndjenja njerëzore të zakonshme. Gjithçka brenda teje do të vdesë. Nuk do të jesh kurrë më i aftë për dashuri, miqësi, gëzim, gjallëri, të qeshësh, të bëhesh kurioz, të kesh kurajo apo integritet. Do të jesh kufkë. Do të të shtrydhim dhe do të të mbushim me veten tonë.

Pushoi dhe i bëri shenjë burrit me xhaketë të bardhë. Uinstoni e ndjeu se pas kokës së tij po vendosnin një aparat të rëndë. O'Brajëni ishte ulur përanash krevatit, me fytyrën ballas me të Uinstonit.

- Tre mijë, - foli, sipër kokës së Uinstonit, me burrin me xhaketë të bardhë.

Në tëmthat e tij u fiksuan dy tamponë pak të njomur.

Uinstoni u drodh. Filloi dhimbja, një lloj i ri dhimbjeje. O'Brajëni e preku lehtë në sup, gati miqësisht.

- Këtë herë s'ka për të të dhembur, - i tha. – Më shiko në sy.

Atë çast pati një shpërthim, ose diçka që dukej si shpërthim, megjithëse nuk ishte i sigurt në pati zhurmë apo jo. Padyshim që pati një dritë verbuese. Uinstoni nuk ishte dëmtuar, veç ndihej i traskapitur. Megjithëse kishte qenë ashtu i shtrirë që prej fillimit pati ndjesinë sikur e kishte flakur dikush në atë pozicion. Një shpërthim i tmerrshëm, pa dhimbje, e kishte bërë petë. Brenda kokës së tij kishte ndodhur diçka. Kur rifitoi vështrimin, u kujtua kush ishte, ku ndodhej, njohu fytyrën që këqyrte fytyrën e tij, por diku ndodhej një boshllëk i madh, sikur t'i kishin hequr një copë truri.

- Nuk zgjat shumë, - tha O'Brajëni. – Më vështro në sy. Me cilin vend është në luftë Oqeania?

Uinstoni u mendua. E kuptonte fjalën Oqeani dhe e dinte që ishte qytetar i saj. Edhe Euroazia dhe Azia Lindore i kujtohej, por se cilat ishin palët në konflikt nuk ia kishte idenë. Në fakt, nuk dinte në kishte patur me të vërtetë ndonjë.

- S'më kujtohet.

- Oqeania është në luftë me Azinë Lindore. Të kujtohet tani?

- Po.

- Oqeania ka qenë në luftë të përhershme me Azinë Lindore. Qysh në fillim të jetës tënde, qysh në fillim të jetës së Partisë, qysh në fillim të historisë, lufta ka vazhduar pa ndërprerje dhe ka qenë e njëjta luftë. Po kjo të kujtohet?

- Po.

- Njëmbëdhjetë vjet më parë krijove një legjendë për tre qytetarë që ishin dënuar me vdekje për tradhti. Pretendoje se kishe parë një copë gazetë e cila faktonte pafajësinë e tyre. Kjo copë letër s'ka ekzistuar kurrë. E shpike ti dhe pastaj fillove ta besoje. Tani të kujtohet çasti kur e shpike për herë të parë, apo jo?

- Po.

- Pak më parë unë ngrita gishtat e dorës. Ti pe pesë gishta. Të kujtohet?

- Po.

O'Brajëni ngriti dorën e majtë lart, me gishtin e madh të fshehur.

- E shikon që janë pesë gishta?

- Po.

Dhe për një çast, para se pamja të ndërronte i pa pesë gishtat, pa deformimin më të vogël. Pastaj çdo gjë u kthye në normalitet, frika, urrejtja dhe hutimi i vjetër u kthyen sërish. Por kishte patur një çast qartësie të shndritshme – nuk mund të thoshte sa i gjatë, ndoshta tridhjetë sekonda – kur çdo sugjerim i O'Brajënit kishte mbushur një boshllëk dhe qe bërë e vërtetë absolute, kur dy edhe dy mund të bënin tre po aq lehtë sa bënin pesë, në qoftë se kjo do të kishte qenë përgjigjia që kërkohej. Një çast që u shua para se O'Brajëni të ngrinte dorën, por, edhe pse nuk mund ta rrokte më, të paktën e kujtonte, si njeriu mund të kujtojë një ngjarje të shënuar në të shkuarën e largët, i ndikuar nga prania e dikujt tjetër.

- Tani e shikon që është e mundur, - tha O'Brajëni.

- Po, - tha Uinstoni.

O'Brajëni u ngrit i kënaqur. Në të majtë të tij, Uinstoni pikasi burrin me xhaketë të bardhë që theu një ampulë dhe mbushi shiringën. O'Brajëni u kthye nga Uinstoni me buzën në gaz. Pastaj rregulloi syzat sipas stilit të vjetër.

- Të kujtohet, - tha, - kur shkruaje në ditar se nuk prishte punë nëse unë isha mik apo armik, ngaqë të paktën isha një njeri që kuptoja dhe me të cilin mund të bisedohej? Kishe të drejtë. Më pëlqen të flas me ty. Mendja jote më tërheq. Ngjan me timen, vetëm se ti ke probleme mendore. Po qe se ke dëshirë, mund të pyesësh pa mbaruar seanca.

- Çfarëdolloj pyetje?

- Po. – O'Brajëni vuri re që sytë e Uinstonit qenë ngulur tek dhimbjematësi. – Është i fikur. Cila është pyetja e parë?

- Ç'keni bërë me Xhulian?

O'Brajëni buzëqeshi sërish.

- Ajo të tradhtoi, Uinston. Menjëherë – dhe pa rezerva. Hera e parë që kam parë dikë të dorëzohet aq shpejt. Po ta shikoje nuk do ta njihje. Gjithë natyra e saj rebele, mashtruese, marroke – gjithçka, i është pastruar. Ishte një bashkëbisedim i mrekullueshëm, si të që i shkruar në letër.

- E torturuat?

O'Brajëni nuk u përgjigj.

- Pyetja tjetër, - tha.

- Ekziston Vëllai i Madh.

- Patjetër. Ai dhe Partia. Ai është personifikimi i Partisë.

- Ekziston ashtu siç ekzistoj unë?

- Ti nuk ekziston, - tha O'Brajëni.

Uinstonit iu prenë sërish fuqitë. I dinte, ose mund t'i merrte me mend, argumentat që vërtetonin mosekzistencën e tij, por ato ishin absurditete, veç lojë fjalësh. A nuk kishte një kundërshti edhe vetë deklarata: "Ti nuk ekziston"? Por ç'kuptim kishte të kundërshtonte? Mendja e tij u tkurr ndërsa mendoi marrëzinë me të cilën do ta shkatërronte O'Brajëni.

- Mendoj se unë ekzistoj, - tha i këputur. – Unë jam i vetëdijshëm për identitetin tim. Kam lindur dhe do të vdes. Kam këmbë e duar. Mbush një boshllëk të caktuar në hapësirë. Asnjë trup nuk mund ta zërë këtë vend në të njëjtën kohë me mua. Pra, ekziston Vëllai i Madh sipas këtij rregulli?

- S'ka rëndësi. Ai ekziston.

- Do të vdesë Vëllai i Madh një ditë.

- Natyrisht, jo. Si mund të vdesë ai? Pyetja tjetër.

- Ekziston *Vëllazëria*?

- Uinston, këtë s'ke për ta mësuar kurrë. Edhe në qoftë se ne vendosim të të lirojmë dhe, edhe nëse ti do të arrish të nëntëdhjetat, sërish s'ke për ta mësuar nëse përgjigjja e asaj pyetje është po apo jo. Kjo do të jetë enigmë në mendjen tënde për gjithë jetën.

Uinstoni qëndronte shtrirë në heshtje. Kraharori i ngrihej e ulej pak më shpejt. Nuk e kishte bërë ende pyetjen që e kishte menduar të parën. Donte ta bënte, por buzët nuk i bindeshin. Në fytyrën e O'Brajënit kishte një hije zbavitjeje. Madje edhe syzat

e tij dukeshin sikur kishin një shkëlqim ironik. Ai e di, mendoi Uinstoni papritur, e di për çfarë do pyes! Fjalët i dolën njëkohësisht me mendimin:

- Çfarë ka në dhomën 101?

Fytyra e O'Brajënit nuk reagoi fare. Foli thatë:

- Ti e di se çfarë ka në dhomën 101, Uinston. Të gjithë e dinë se çfarë ka në dhomën 101.

I bëri me shenjë burrit me xhaketë të bardhë. Ky ishte fundi i seancës. Në krahun e Uinstonit depërtoi një gjilpërë. Ra në gjumë të thellë gati menjëherë.

III

Kthimi yt në shoqëri kalon në tre faza, - tha O'Brajëni. – Të mësuarit, të kuptuarit dhe pranimi. Për ty ka ardhur koha të kalosh në fazën e dytë.

Uinstoni qe shtrirë në shpinë si gjithmonë. Së fundi lidhjet i qenë liruar pak. Ende ishte i karfosur pas krevatit, por tashmë mund të lëvizte pak gjunjët, mund ta kthente kokën nga njëra anë në tjetrën dhe kishte lirinë ta ngrinte bërrylin. Edhe dhimbjematësi kishte nisur të bëhej më pak terrorizues. Po të tregohej i shkathët mund t'u bishtnonte dhimbjeve të shkaktuara prej tij, O'Brajëni e ngrinte levën vetëm kur ai jepte përgjigje prej budallai. Kishte raste kur dhimbjematësi nuk përdorej gjatë gjithë seancës. Procesi nisi të zgjaste në kohë – ndoshta edhe me javë – ndërsa ndërkohat mes seancave mund të zgjatnin herë me ditë të tëra e herë vetëm një orë ose dy.

- Gjatë kohës që ke qenë i shtrirë, - tha O'Brajëni, - të ka bërë përshtypje – madje edhe më ke pyetur – se cili është qëllimi që Ministria e Dashurisë harxhon kaq shumë kohë e mund me ty. Ndërsa kur ishe i lirë të mundonte pothuajse e njëjta pyetje ngaqë ishe në gjendje t'i lexoje ligjet e shoqërisë në të cilën jetoje, por nuk kuptoje motivet që fshiheshin poshtë tyre. Të kujtohet kur shkrove në ditar: "E kuptoj *si*, por nuk kuptoj *pse*"? Dhe pikërisht kur doje të dije *pse-në* vure në dyshim gjendjen tënde mendore. Por tashmë ti e ke lexuar *librin*, librin e Goldshteinit, ose pjesë të tij. A gjete në të ndonjë gjë që më parë nuk e dije?

- Domethënë ti e ke lexuar?

- Unë e shkrova. Ose më mirë, bashkëpunova për ta shkruar. Siç e di, asnjë libër nuk shkruhet nga një person i vetëm.

- Janë të vërteta ato që thotë libri?

- Për sa i përket përshkrimit po, ndërsa programi që paraqet është absurd: akumulimi i fshehtë i informacionit, progresi intelektual në mënyrë graduale, rebelimi proletar si akti përfundimtar, përmbysja e pushtetit të Partisë. Ti e more me mend që kjo do të ishte përmbajtja e librit. E gjitha absurditet. Proletariati nuk do të ngrejë krye kurrë, as për një mijë ose një milion vjetë. Nuk mundet. Besoj se nuk është nevoja të ta them arsyen, ti e di vetë tashmë. Në qoftë se ke ushqyer ndonjë iluzion për kryengritje të dhunshme bën mirë të heqësh dorë. S'ekziston asnjë mënyrë për të rrëzuar Partinë. Sundimi i saj është i përjetshëm. Filloi prej këtij fakti mendimet e tua të përditshme.

O'Brajëni u afrua edhe më tek krevati.

- Përjetësisht, - tha. – Dhe tani le të rikthehemi tek pyetjet *si* dhe *pse*. Ti e kupton shumë mirë mënyrën sesi Paria ruan pushtetin. Tashmë më thuaj *pse* e kemi kaq të vështirë të heqim dorë prej tij, cili është motivi? Përse duhet ta duam pushtetin? Hë, fol, - shtoi O'Brajëni, ndërsa Uinstoni heshtte.

Sidoqoftë, Uinstoni vazhdoi të heshtte edhe pak çaste. U ndie i lodhur. Në fytyrën e O'Brajënit ishte rikthyer një rreze e zbehtë entuziazmi. Uinstoni gati e dinte se çfarë do të thoshte ai. Që Partia nuk kërkoi të merrte pushtetin për veten e saj, por për të mirën e masave. Sepse midis masave gjendeshin qytetarë të brishtë që nuk mund ta përballonin lirinë apo të vërtetën dhe për këtë u duhej të sundoheshin dhe mashtroheshin në mënyrë sistematike nga të tjerët. Sepse shoqëria njerëzore duhet të zgjidhte midis lirisë dhe lumturisë dhe, për pjesën më të madhe të shoqërisë, më e pëlqyeshmja ishte lumturia. Që Partia ishte mbrojtësja e përjeshtme e më të dobtëve, një sekt i përkushtuar të bënte keq me qëllim të sillte të mirën, që sakrifikonte lumturinë e saj për atë të të tjerëve. Gjëja më e tmerrshme, mendoi Uinstoni, ishte fakti që O'Brajëni i besonte ato që thoshte. I lexohej në fytyrë. O'Brajëni dinte gjithçka. Ai e dinte mijëra herë më mirë se Uinstoni në ç'gjendje ndodhej bota, në çfarë shkalle degradimi jetonte shoqëria njerëzore, e me çfarë gënjeshtrash dhe mënyrash barbare i mbante në atë gjendje Partia. Ai e kishte kuptuar, e kishte analizuar dhe nuk i bënte

përshtypje: gjithçka qe e justifikuar nga qëllimi përfundimtar. Si të sillesh, mendoi Uinstoni, me një të marrë që është më inteligjent se ty, që t'i dëgjon me qetësi të gjitha argumentat dhe pastaj këmbëngul në çmenduritë e tij?

- Domethënë, po na sundoni për të mirën tonë, - tha vakët. - Pra, besoni që qeniet njerëzore nuk janë të afta të qeverisen vetë dhe për pasojë...

Dhe gati sa nuk ia dha një klithme. Një dhimbje e fuqishme i përshkroi trupin. O'Brajëni e kishte ngritur levën tek tridhjetë e pesa.

- Kjo është marrëzi, Uinston, marrëzi! – tha. – Duhet të ishe menduar më mirë para se të flisje.

Uli levën dhe vazhdoi:

- Tani do të të sqaroj pyetjen time, përgjigjja e së cilës është: Partia e kërkon pushtetin vetëm për qëllimet e saj. Nuk na intereson mirëqenia e të tjerëve, ne jemi të interesuar vetëm për pushtetin. S'bëhet fjalë për pasuri, luks, jetëgjatësi apo lumturi, por vetëm pushtet, pushtet i kulluar. Se çfarë nënkuptohet me pushtet të kulluar do ta kuptosh tani. Ndryshimi mes nesh dhe oligarkive të së shkuarës qëndron në faktin që ne jemi të vetëdijshëm për atë që bëjmë. Gjithë të tjerët, bile edhe ata të ngjashëm me ne, qenë frikacakë dhe hipokritë. Nazistët gjermanë dhe komunistët rusë përdorën gati të njëjtat metoda me ne, por ata nuk e patën kurrë kurajon që t'i bënin të njohura motivet e tyre. Ata pretendonin, e ndoshta e besuan, që e kishin marrë pushtetin pa dëshirë dhe vetëm për një afat kohor të shkurtër dhe pas kthesës më të afërt shtrihej parajsa ku njerëzit do të ishin të lumtur dhe të barabartë. Ndërsa ne nuk jemi si ata. Ne e dimë që askush nuk e merr pushtetin me qëllim që të heqë dorë prej tij. Pushteti nuk është mënyrë, por fund. Njeriu nuk vendos diktaturën të mbrojë revolucionin, por bën revolucionin që të vendosë diktaturën. Qëllimi i persekutimit është persekutimi. Qëllimi i torturës është tortura. Qëllimi i pushtetit është pushteti. Fillove të kuptosh ndonjë gjë?

Uinstoni u hutua, siç ishte hutuar edhe më parë, nga lodhja në fytyrën e O'Brajënit. Një fytyrë e fortë, e tultë dhe e vrazhdë, gjithë inteligjencë dhe pasion para së cilës ai ndihej i pafuqishëm;

por e lodhur. Rrathët e syve i kishte të fryrë dhe lëkura poshtë kockës së mollëzave ishte gjithë rrudha. O'Brajëni u përkul sipër tij, duke e afruar qëllimisht fytyrën e vyshkur.

- Tani mendon që fytyra ime është e plakur dhe e lodhur, - i tha. Ti mendon që unë flas për pushtetin ndërkohë që nuk jam në gjendje të ndaloj vyshkjen e trupit tim. A nuk e kupton që njeriu është vetëm një qelizë, Uinston? Lodhja e qelizës është fuqia e trupit. A vdes njeriu kur pret thonjtë?

O'Brajëni u largua nga krevati dhe filloi të ecejakej nëpër dhomë, me njërën dorë futur në xhep.

- Ne jemi veç priftërinj të pushtetit, - tha. – Pushteti është Zoti. Por, hëpërhë, për ty pushteti është vetëm një fjalë. Ka ardhur koha të fillosh të kuptosh se çfarë do të thotë pushtet. Gjëja e parë që duhet të kuptosh është fakti që pushteti është i përbashkët. Individi ka pushtet vetëm atëherë kur pushon së qeni individ. Ti e di parrullën e Partisë: 'Liria është skllavëri". Të ka shkuar ndonjëherë ndër mend ndërrimi i vendit të fjalëve të saj? Skllavëria është liri. Vetëm – i lirë – njeriu është i humbur. Dhe kështu duhet të jetë sepse çdo qenie njerëzore është e përcaktuar të vdesë dhe ky është dështimi më i madh. Ndërsa po të nështrohet tërësisht, të braktisë identitetin e tij, në qoftë se shkrihet brenda Partisë, pra, të bëhet Partia, vetëm atëherë mund të jetë i plotfuqishëm dhe i pavdekshëm. Gjëja e dytë që duhet të kuptosh është se pushteti është pushtet mbi njerëzit. Mbi trupin – e mbi të gjitha, mbi mendjen. Pushteti mbi materien – realiteti i jashtëm siç mund të thuhet – nuk ka ndonjë rëndësi. Kontrolli ynë mbi materien tashmë është absolut.

Uinstoni e harroi dhimbjematësin për një çast. U përpoq gjithë vrull të ngrihej përgjysmë dhe vetëm sa i shkaktoi trupit të vet dhimbje të tjera.

- Si mund ta kontrolloni materien? - shpërtheu. – Ju nuk e kontrolloni dot as motin apo ligjin e gravitetit. Pastaj po sëmundjet, dhimbjet, vdekja...

O'Brajëni e bëri të heshtte me një lëvizje të dorës.

- Ne kontrollojmë materien sepse kontrollojmë mendjen. Realiteti është brenda kafkës. Do ta mësosh shkallë-shkallë,

Uinston. Për ne s'ka asgjë që nuk e bëjmë dot. Padukshmëri, flurim, gjithçka. Në qoftë se dua, mund të ngrihem në ajër mbi këtë dysheme si një flluskë sapuni. Por nuk dua sepse nuk do Partia. Duhet të heqësh dorë nga idetë e shekullit të nëntëmbëdhjetë për ligjet e natyrës. Ligjet e natyrës i bëjmë ne.

- E vërteta është që nuk mundeni! Ju nuk kontrolloni dot as këtë planet. Po Euroazia dhe Azia Lindore? Nuk i keni pushtuar ende.

- S'ka rëndësi. Do t'i pushtojmë kur ta shohim të arsyeshme. Pastaj, ç'ndryshim ka në qoftë se nuk i pushtojmë? Mund t'i fshijmë fare nga ekzistenca. Oqeania është bota.

- Por bota është veç një thërrmijë pluhuri, ndërsa njeriu është tejet i imët – dhe i pafuqishëm! Sa kohë që ka ardhur në jetë? Për miliona vite bota ka qenë e pabanuar.

- Budallallëqe. Bota është aq e lashtë sa edhe ne. Si mund të jetë më e lashtë? Gjithçka ekziston vetëm falë vetëdijes njerëzore.

- Mirëpo shkëmbinjtë janë plot me eshtra kafshësh të zhdukura – mamuthë, mastodontë dhe zvarranikë gjigantë që kanë jetuar në tokë shumë kohë para njeriut.

- Uinston, i ke parë ndonjëherë këto eshtra? Natyrisht që jo. Ato i shpikën biologët e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Para njeriut nuk kishte asgjë. Pas njeriut, në qoftë se njeriu merr fund një ditë, nuk do të mbetet asgjë. Jashtë njeriut nuk ekziston gjë.

- Mirëpo gjithë universi është jashtë nesh. Shiko yjet! Disa prej tyre janë miliona vite dritë larg. Përjetësisht larg mundësisë që t'i prekim.

- Ç'janë yjet? – tha O'Brajëni me indiferencë. – Ca thëngjij disa kilometra larg nesh. Po të duam mund t'i arrijmë. Mund t'i hedhim në erë. Qendra e botës është Toka. Dielli dhe yjet vijnë rrotull saj.

Uinstoni bëri një tjetër përpëlitje. Kësaj radhe nuk ktheu përgjigje. O'Brajëni vazhdoi sikur i kundërpërgjigjej dikujt:

- Natyrisht, për disa veprimtari të caktuara kjo nuk është e vërtetë. Kur lundrojmë apo kur parashikojmë eklipsin na duket më e përshtatshme të themi që toka lëviz rreth diellit ose që yjet

janë miliona kilometra larg. Por çfarë do të thotë kjo? Mendon se është e vështirë të krijojmë një sistem astronomik paralel? Yjet mund të jenë larg ose afër, kjo varet nga dëshira jonë. A nuk të mbushet mendja që matematikanët tanë mund ta bëjnë këtë? E ke harruar mendimin e dyfishtë?

Uinstoni u krodh sërish në krevat. Çfardo që thoshte i shkatërrohej si me një të rënë çomage nga përgjigjet e buta. Megjithatë e dinte, e dinte që kishte të drejtë. Padyshim që duhet të kishte një mënyrë e cila vërtetonte të kundërtën e mendimit se jashtë mendjes së njeriut nuk ekziston asgjë. A nuk ishte zbuluar shumë kohë më parë se ishte gabim? Madje ajo kishte edhe një emër që ai e kishte harruar. Buzët e O"Brajënit u harkun në një buzëqeshje të lehtë ndërsa vështronte nga ai.

- Të kam thënë, Uinston, - tha, - që metafizika nuk është pika jote më e fortë. Fjala të cilën t'i kërkon quhet solipsizëm. Solipsizëm kolektiv, nëse mund të themi kështu. Por ai është diçka tjetër; në fakt, krejt e kundërta. Gjithë kjo është shmangie, - shtoi O'Brajëni me një tjetër ton të zërit. – Pushteti i vërtetë, pushteti për të cilin na duhet të luftojmë ditë e natë, nuk është pushteti mbi sendet, por mbi njeriun.

O'Brajëni pushoi një hop, për të rifituar edhe një herë pamjen e një drejtori shkolle që merr në pyetje një nxënës shumë premtues:

- Uinston, si e fiton njeriu pushtetin ndaj një njeriu tjetër?

Uinstoni u mendua.

- Duke e bërë atë të vuajë, - tha?

- Pikërisht, duke e bërë tjetrin të vuajë. Nënshtrimi nuk mjafton. Si mund të jesh i sigurt që dikush i nështrohet vullnetit të tij dhe jo tëndit, në qoftë se ti nuk e bën të vuajë? Pushtet do të thotë të shkaktosh dhimbje dhe poshtërim. Pushtet do të thotë t'i çmontosh mendjet njerëzore e pastaj, gjatë rimontimit, t'i japësh instrumentit formë të re. Hë, e kupton ndopak se çfarë bote po krijojmë? Është krejt e kundërta nga utopitë hedonistike që përfytyruan reformistët e vjetër. Botën e frikës, pabesisë dhe mundimit, botën me të shtypur dhe shtypës, një botë e cila do të bëhet e pamëshirshme ndërsa do të vetëpërmirësohet. Progres

në botën tonë do të thotë të ecësh drejt më shumë dhimbjeje. Qytetërimet e vjetra mendonin se në themelet e krijimit të tyre qëndronte dashuria dhe drejtësia. Qytetërimi ynë është ngritur mbi urrejtje. Në botën tonë nuk do të ketë ndjenja të tjera veç frikës, zemërimit, triumfit dhe vetëposhtërimit. Gjithçka tjetër do të shkatërrohet. Tashmë kemi filluar nga puna të shkatërrojmë zakonet e të menduarit të mbetura nga koha para Revolucionit. Kemi prerë lidhjet midis prindit dhe fëmijës, midis burrave me njëri-tjetrin, dhe midis burrave dhe grave. Ka ikur koha kur mund t'i zije besë gruas, fëmijës, apo shokut. Ndërsa në të ardhmen nuk do të ketë as bashkëshorte dhe as fëmijë. Fëmijët do merren nga nënat qysh në lindje, ashtu siç merren vezët nga pula. Instikti seksual do të zhduket. Lindja do të jetë formalitet i përvitshëm, si përshembull ripërtëritja e tollonave të racionit. Nuk do të ketë orgazmë; neurologët po punojnë ta eleminojnë atë. Nuk do të ketë besnikëri tjetër veç besnikërisë ndaj Partisë. Nuk do të ketë dashuri tjetër veç dashurisë për Vëllain e Madh. Nuk do ketë të qeshura veç të qeshurave pasi të kemi triumfuar mbi armikun. Nuk do të ketë as art, as letërsi, as shkencë. Ne jemi të gjithëfuqishëm, nuk kemi nevojë për shkencën. Nuk do të ekzistojë më dallimi midis të bukurës dhe të shëmtuarës. Nuk do të ketë kureshtje apo gëzim të jetës. Gjithë kënaqësitë konkuruese do të shkatërrohen. Por gjithmonë – Uinston, këtë mos e harro – puhsteti gjithmonë ka për të qenë dehës, vazhdimisht në rritje e vazhdimisht më i rafinuar. Përherë, në çdo çast, do të ekzistojë dridhma e fitores, ndjenja e shtypjes së një armiku të pafuqishëm. Në qoftë se do një imazh të së ardhmes, atëherë përfytyro një çizme të ngjeshur në fytyrën e dikujt – përjetësisht.

O'Brajëni pushoi, sikur priste që të fliste Uinstoni. Uinstoni u përpoq të kruspullosej edhe më në krevat. Nuk qe në gjendje të përgjigjej. Zemra i qe bërë akull. O'Brajëni vazhdoi:

- Dhe mos harro që është përgjithmonë. Fytyra do të ekzistojë përjetësisht, që të shkelmohet. Heretikët, armiku i shoqërisë, do të ekzistojnë përjetësisht që një ditë të munden dhe poshtërohen. Gjithçka që ti ke përjetuar qyshkur ke rënë në duart tona – do të vazhdojë, madje edhe më keq. Spiunimi, tradhtia,

arrestimet, torturat, ekzekutimet, zhdukjet, do të ekzistojnë përjetësisht. Terrori dhe triumfi do të jenë të barabartë. Sa më e fuqishme që të bëhet Partia, aq më pak tolerante do të tregohet, sa më e dobët opozita, aq më i egër despotizmi. Golsteini dhe herezitë e tij do të jenë të përjetshme; do të munden, diskretitohen, përqeshen, pështyhen çdo ditë e çdo çast - por do të vazhdojnë të mbijetojnë. Kjo dramë që unë kam luajtur me ty do të përsëritet brez pas brezi, përherë në formë më të përpunuar. Gjithmonë do të ketë heretikë që do të kërkojnë mëshirë nga duart tona, që do të ulërasin nga dhimbja, që do të thyhen të përbuzur – dhe në fund do të jenë thellësisht të penduar, të shpëtuar prej vetvetes, do të lëpihen pas çizmes sonë me dëshirën e tyre. Kjo është bota që ne po përgatisim, Uinston. Një botë me fitore pas fitoresh, me triumf pas triumfi: një nxitje, nxitje, nxitje e pafundme e nervit të pushtetit. E shikoj që ke filluar ta kuptosh sesi do të jetë bota në të ardhmen. Por në fund do shkosh më tej se të kuptuarit: do ta mirëseardhësh atë botë, do ta pranosh, do të bëhesh pjesë e saj.

Uinstoni e kishte mbledhur veten dhe ishte në gjendje të fliste:

- Nuk e bëni dot, - tha me zë të dobët.

- Çfarë do të thuash me këto fjalë, Uinston?

- Nuk e ndërtoni dot botën që sapo përshkrove. Është e pamundur, është veç një ëndërr.

- Pse?

- Është e pamundur që të ndërtosh një qytetërim me frikë, urrejtje dhe mizori. Do të ketë jetë shumë të shkurtër.

- Pse jo?

- Ka për t'i munguar vitaliteti. Do të degjenerojë dhe do të bëjë vetvrasje.

- Gjepura. Ti mendon se urrejtja shteron më herët se dashuria. Përse duhet të ndodhë kjo? E në qoftë se po, ku është ndryshimi? Mendo sikur të vendosim të shpejtojmë rraskapitjen e vetes. Mendo sikur të vendosim të shpejtojmë kohën e jetës së njeriut, që njerëzit të plakeshin qysh tridhjetë vjeç. Ku do të ishte ndryshimi? A nuk e kupton Uinston se vdekja e individit nuk është vdekje? Partia është e pavdekshme.

Si përherë, zëri i tij kthente tek Uinstoni një gjendje pafuqishmërie. Për më tepër, ai rrinte me zemër të ngrirë se po të këmbëngulte tek mendimi i tij atëherë O'Brajëni mund të lëvizte levën e dhimbjematësit. I dobët, pa fakte, pa asgjë për të mbrojtur veten veç tmerrit të paqartë prej atyre çfarë kishte thënë O'Brajëni, Uinstoni u kundërpërgjigj.

- Nuk e di... dhe s'dua t'ia di. Por e ndiej që do të dështoni. Do të mundeni nga diçka. Ka për t'ju mposhtur jeta.

- Uinston, ne e kontrollojmë jetën në të gjitha nivelet. Ti mendon se ka diçka që quhet racë njerëzore e do të revoltohet prej atyre që bëjmë dhe do të ngrihet kundër nesh. Por racën njerëzore e krijojmë ne. Mund të farkëtosh një pafundësi njerëzish. Ndoshta ti je kthyer tek ideja e vjetër që proletarët apo skllevërit do të ngrihen dhe do të na përmbysin. Ngulite në mendje: ata janë të pafuqishëm, si kafshët. Njerëzimi është Partia. Të tjerët janë jashtë saj – dhe pa vlerë.

- S'prish punë. Në fund ata do të jenë fitimtarë. Herët apo vonë do ta shikojnë se cilët jeni dhe do t'ju bëjnë copë e thërrime.

- Ke ndonjë fakt që tregon se kjo po ndodh? Apo, shikon ndonjë arsye pse duhet të ndodhë?

- Jo, thjesht e besoj. *E di* që do të dështoni. Në këtë univers ka diçka – njëfarë shpirti apo parimi – që nuk do ta mposhtni dot.

- Uinston, beson tek zoti?

- Jo.

- Atëherë çfarë është ky parimi që do të na mposhtë?

- Nuk e di. Ndoshta shpirti i njeriut.

- Dhe ti e quan veten njeri?

- Po.

- Në qoftë se ti je njeri, Uinston, atëherë je njeriu i fundit. Lloji juaj është zhdukur, ne jemi trashëgimtarët. E kupton që je *vetëm*? Jashtë historisë, që nuk ekziston. – Sjellja e tij ndryshoi, foli më ashpër: - Ti e konsideron veten më të lartë se ne gënjeshtarët dhe mizorët?

- Po, patjetër.

O'Brajëni nuk foli. U dëgjuan dy zëra të tjerë. Pas një grime Uinstoni e njohu që njëri prej tyre ishte zëri i tij. Ishte biseda që

kishte bërë me O'Brajënin atë natë që u pranua në *Vëllazëri*. Dëgjoi veten që premtonte të gënjente, të vidhte, të mashtronte, të vriste, stimulonte përdorimin e drogës dhe prostitucionin, të përhapte sëmundjet venerale, të hidhte acid sulfurik në fytyrat e fëmijëve. O'Brajëni bëri një lëvizje të lehtë që tregonte se nuk ia vlente ta bënte këtë rikujtim. Pastaj rrotulloi një buton dhe zëri pushoi.

- Çohu prej krevatit, - urdhëroi.

Kapëset qenë liruar. Uinstoni zbriti në dysheme dhe u ngrit në këmbë duke u lëkundur.

- Ti je njeriu i fundit, - tha O'Brajëni. – Gardiani i shpirtit njerëzor. Shikoje veten ashtu siç je. Zhvishu.

Uinstoni zgjidhi spangon me të cilën kishte lidhur kominoshet. Zinxhiri kishte kohë që ishte prishur. Nuk i kujtohej në i kishte hequr ndonjëherë rrobat qysh kur ishte arrestuar. Poshtë kominosheve trupi ishte mbushur me copa të verdha e të pista që mezi kuptoheshin që ishin mbetjet e rrobave të brendshme. Ndërsa i rrëzoi në dysheme, vuri re se në fund të dhomës ndodhej një pasqyrë. Eci drejt saj, pastaj ndaloi. Shpërtheu në një të qarë të pavullnetshme.

- Vazhdo – tha O'Brajëni. – Qëndro midis krahëve të pasqyrës që të shikohesh edhe në profil.

Uinstoni u ndal ngaqë u tremb. Një trajtë e kërrusur, e thinjur, diçka si skelet njeriu, po afrohej drejt tij. Ajo që të kallte datën ishte pamja dhe jo fakti që ai e dinte se ajo pamje i përkiste atij. U afrua drejt pasqyrës. Për shkak të kërrusjes së trupit, të krijohej përshtypja se fytyra e asaj krijese do të ngelej jashtë; fytyrë mjerane e një të burgosuri, ballë i fryrë që vazhdohej nga kafka tullace, hundë e lakuar, mollëza të shtypura, ndërsa vështrimi i rreptë dhe i vëmendshëm; faqet qenë rrudhosur e buzët ishin futur brenda. Natyrisht që ishte fytyra e vet, por atij i dukej se kishte ndryshuar më shumë së jashtmi sesa së brendshmi. Ndjenja që lexoi së jashtmi ishte e ndryshme me atë që ndjeu së brendshmi. Një pjesë e flokëve i kishin rënë. Fillimisht mendoi edhe që ishte thinjur, por në fakt vetëm e mashtronte ngjyra gri e kafkës. Me përjashtim të duarve dhe një rrethi në fytyrë, gjithë trupi kishte marrë ngjyrë gri për shkak të një ndotjeje të rrënjosur prej shumë

kohësh. Aty-këtu poshtë ndotjes shfaqeshin njollat e kuqe të plagëve, ndërsa afër syrit të këmbës malcimi ishte kthyer në një plagë me lëkurën rrotull të rrjepur. Por gjëja më e frikshme e trupit të tij ishte ligështia. Kafazi i kraharorit ishte aq i ngushtë sa ai i një skeleti, këmbët ishin tkurrur aq shumë saqë gjunjët ishin më të trashë se kofshët. Tani e kuptoi se ku e kishte patur fjalën O'Brajëni kur e nxiti të shikohej edhe në profil. Kurbatura e shtyllës kurrizore ishte e pabesueshme. Supet e hollë qenë përkulur para sikur donin ta kthenin kraharorin në zgavër, ndërsa qafa thatanike qe përkulur dyfish nga pesha e kafkës. Me hamendje mund të thoshte se ai trup i përkiste një gjashtëdhjetëvjeçari që vuante nga ndonjë sëmundje e pashërueshme.

- Ti ke menduar shpesh, - tha O'Brajëni, - që fytyra ime – fytyra e një anëtari të Besnikëve të Partisë – duket e vjetër dhe e lodhur. Ç'mund të thuash për fytyrën tënde?

E kapi Uinstonin nga krahët dhe e ktheu që të ishin përballë njëri-tjetrit.

- Shiko si je katandisur! – tha. – Shiko zhulin që të ka mbuluar. Shiko pisllëkun mes gishtave të këmbës. Shiko plagën e neveritshme në këmbë që të sjell të vjella. E ndien që qelbesh si dhi? Ndoshta nuk je më në gjendje ta vësh re. Shiko drobitjen tënde. E shikon? Mund ta mbështjellësh gjithë kraharorin vetëm një dorë. Mund të ta thyej qafën si karrotë. A e di se qysh kur ke rënë në duart tona ke rënë nga pesha njëzet e pesë kilogramë? Madje edhe flokët të bien me tufa. Shiko? – Zgjati dorën drejt kokës së Uinstonit dhe e largoi me një tufë flokësh në të. – Hape gojën. Nëntë, dhjetë, njëmbëdhjetë dhëmbë të mbetur. Sa kishe kur erdhe këtu? Edhe këta që kanë mbetur po bien. Shiko!

Me gishtin e madh dhe treguesin, O'Brajëni kapi njërin nga dhëmbët e përparmë të Uinstonit. Nofullën e përshkoi një dhimje therëse. O'Brajëni shkuli nga rrënja një dhëmb të lirë. E flaku tutje.

- Po shkërmoqesh, - i tha, - po bëhesh thërrime. Çfarë je? Veç një thes me pleh. Kthehu dhe shikohu në pasqyrë sërish. E shikon atë gjënë përballë teje? Ai është njeriu i fundit. Në qoftë se ti je njeri, atëherë ky është njerëzimi. Tani vishu.

Uinstoni nisi të vishej ngadalë, me ngathtësi. Dukej se deri tani nuk e kishte vënë re sesa i dobët dhe i pafuqishëm ishte. E ngacmoi veç një mendim: në qeli kishte kaluar kohë më shumë se ç'kishte kujtuar. Mandej, krejt befas, ndërsa hidhte leckat sipër trupit, e përfshiu një keqardhje e thellë për gjendjen në të cilën ishte katandisur trupi i tij. Pa e kuptuar, u rrëzua në stol, në stolin pranë krevatit, dhe ia plasi të qarit. Ishte i vetëdijshëm për shëmtinë dhe hijeshinë e humbur, një grusht eshtrash poshtë veshjeve të qelbura që qante ulur në stol nën dritën e bardhë dhe të fuqishme, por nuk e përmbante dot veten. O'Brajëni i vuri dorën në sup, pothuajse me dashamirësi.

- Kjo gjendje nuk do të zgjasë përgjithmonë, - tha. – Mund të shpëtosh prej saj kur të duash. Gjithçka varet nga ty.

- Ti ma ke bërë këtë gjë, - u ngashërye Uinstoni. – Ti më ke katandisur në këtë gjendje.

- Jo, Uinston, ti ia bëre vetes. Kur vendose të dalësh kundër Partisë, bëre edhe zgjedhjen. Gjithçka ishte përfshirë në aktin e parë. Nuk ka ndodhur asgjë që ti nuk e kishe parashikuar.

O'Brajëni heshti një hop dhe vazhdoi:

- Uinston, ne të mundëm. Të thyem. Tashmë ti e ke parë si është trupi dhe po në të njëjtën gjendje është edhe mendja jote. S'besoj se të ka mbetur edhe aq shumë krenari. Je shkelmuar, fshikulluar dhe fyer, ke ulëritur nga dhimbja, je përpëlitur në dysheme mes gjakut dhe të vjellave të tua. Je qaravitur për mëshirë, i ke tradhtuar të gjithë dhe gjithçka. Mund të thuash një lloj poshtërimi që nuk të është bërë?

Uinstoni kishte pushuar së qari, megjithëse lotët vazhdonin t'i kullonin ende. Vështroi O'Brajënin.

- S'kam tradhtuar Xhulian, - tha.

O'Brajëni e vështroi mendueshëm.

- Po, - tha, - po, kjo është e vërtetë. Xhulian nuk e ke tradhtuar.

Zemrën e Uinstonit e përmbyti sërish respekti i veçantë për O'Brajënin, diçka që dukej se qe e paasgjësueshme. Sa inteligjent, mendoi, sa inteligjent! Nuk ndodhte kurrë që O'Brajëni të mos e kuptonte diçka që i thuhej. Gjithkush tjetër do të ishte përgjigjur

rrëmbimthi se ai e *kishte* tradhtuar Xhulian. Ç'kishte mbetur pa u nxjerrë prej tij pas gjithë atyre torturave? U kishte treguar gjithë ç'dinte për të: zakonet, karakterin, të shkuarën. Ai kishte pranuar deri në detajet më të imta gjithçka që kishte ndodhur në takimet e tyre, ushqimet e blera në tregun e zi, tradhtitë bashkëshortore, kurthet e mjegullta kundër Partisë – gjithçka. Mirëpo, sipas kuptimit që ai e përdori atë fjalë, nuk e kishte tradhtuar. Dashuria e tij për Xhulian nuk kishte njohur luhatje, ndjenjat në lidhje me të kishin mbetur të njëjtat. O'Brajëni e kishte pikasur ku e kishte patur fjalën ai, pa qenë nevoja e një shpjegimi.

- Më thuaj, - tha Uinstoni, - cila do të jetë mënyra që do të më pushkatojnë?

- Kjo mund të zgjasë, - tha O'Brajëni. – Ti je një rast i vështirë. Por mos i humb shpresat. Herët apo vonë gjithkujt i gjendet ilaçi. Dhe në fund do të të vrasim.

IV

Ndihej shumë më mirë. Çdo ditë, nëse mund të flasim me ditë, shtonte në peshë dhe rifitonte energji.

Drita e bardhë dhe zëri mërmëritës vazhdonin si gjithmonë, por qelia ishte pak më e rehatshme se të mëparshmet. Krevati prej dërrasash kishte dyshek dhe jastëk, nuk mungonte asnjë stol për t'u ulur. Tani ndodhej në një qeli me banjë dhe i lejohej të lahej më shpesh, në një lavaman llamrine. Madje i kishin dhënë edhe ujë të ngrohtë për t'u larë. Malcimin në kyçin e këmbës ia kishin lyer me pomadë. Ia kishin hequr dhëmbët e mbetur dhe e kishin pajisur me proteza.

Duhet të kishin kaluar javë ose muaj. Uinstoni mund të kishte llogaritur edhe kohën në qoftë se do të kishte dashur sepse tashmë ushqimi i jepej me ndërkoha të rregullta. Sipas gjykimit të tij, i jepeshin tre vakte në njëzet e katër orë, nganjëherë pyeste vetën nëse ia jepnin ditën apo natën. Për habi ushqimi ishte cilësor, me mish në çdo tre vakte. Madje njëherë i dhanë edhe një paketë cigare. Nuk kishte shkrepse, por ia ndizte gardiani përjetësisht i heshtur që i sillte ushqimin. Kur ndezi cigaren e parë iu morën mendtë, por nuk e flaku paketën dhe, duke pirë një gjysmë cigare në ditë, e përdori për një kohë të gjatë.

I kishin dhënë një pllakë shkrimi me një copë lapsi të lidhur në cep. Fillimisht nuk e përdori. Edhe kur qe zgjuar ndihej i topitur. Shpesh qëndonte pa lëvizur gjatë gjithë kohës mes vakteve, herë duke fjetur e herë i zhytur në ëndërrime që e bënin të vështirë hapjen e syve. Kishte kohë që ishte mësuar të flinte me dritën e fuqishme ndezur. Përveç faktit që ëndrrat qenë më koherente,

nuk sillte ndonjë ndryshim. Gjatë gjithë kësaj kohë ëndërronte shumë dhe shumica e ëndrrave qenë të mbara. Do të gjendej ose në Tokën e Artë, ose mes gërmadhash antike gjigante të ndriçuara nga dielli, me nënën, Xhulian, O'Brajënin – pa bërë asgjë, thjesht rrinin në diell, duke biseduar për gjëra të paqme. Mendimet që kishte kur ishte zgjuar ishin të lidhura me këto ëndrra. Tashmë që nxitësi i dhimbjes ishte larguar, i dukej se e kishte humbur fuqinë intelektuale. Nuk mërzitej, nuk kishte dëshirë të fliste, nuk bëhej kurioz. Mjaftonte të qe vetëm, të mos rrihej, të mos merrej në pyetje, të kishte për të ngrënë dhe të mbahej krejt i pastër.

Dalëngadalë filloi të flinte më pak, por sërish nuk kishte dëshirë të ngrihej prej shtratit. Gjakimi i tij ishte të rrinte shtirë dhe të ndiente energjinë që mblidhte trupi. Herë pas here prekte trupin aty-këtu që të bindej se rritja që pësonin muskujt dhe tendosja e lëkurës nuk ishin vegime. Më në fund nuk kishte asnjë dyshim që muskujt ishin mbushur, fakti që kofshët ishin më të gjera se gjuri dukej ashiqare. Pas kësaj, fillimisht jo me shumë dëshirë, filloi të bënte ushtrime fizike. Në një kohë shumë të shkurtër ishte në gjendje të ecte tre kilometra – duke e matur dhomën me hapa, ndërsa shpatullat nisën t'i drejtoheshin. Synoi ushtrime më të përpunuara dhe u habit e u ndie i poshtëruar njëkohësisht, kur vuri re që disa ushtrime nuk i bënte dot. Përveç ecjes nuk bënte dot gjë tjetër, nuk e mbante dot stolin me krahun e shtirë, nuk qëndronte dot me një këmbë. U ul galiç dhe zbuloi se kur ngrihej tashmë e kapnin dhimbje të fuqishme në kofshë dhe pulpa. U shtri barkazi dhe u përpoq të ngrihej me ndihmën e duarve. Ishte e kotë, nuk ngrihej dot asnjë centimetër. Por pas disa ditësh – disa ndërkoha vaktesh – edhe ky ushtrim filloi të përmirësohej. Erdhi një kohë kur bënte gjashtë ulje-ngritje njëra pas tjetrës. Filloi të ndihej krenar për trupin e vet dhe të ushqente bindjen e herëpashershme që fytyra po i kthehej në gjendjen e saj normale. Vetëm kur vendosi rastësisht dorën në kafkën tullace iu kujtua fytyra e rrudhosur dhe e shkatërruar që e kishte këqyrur nga brenda pasqyrës.

Mendja e tij filloi të bëhej më vepruese. U ul në krevatin prej dërrase, me shpinën kthyer nga muri dhe pllakën e shkrimit mbi gjunjë, filloi të punonte i vendosur që të riedukonte veten.

S'kishte asnjë dyshim që kishte kapitulluar. Me sa shikonte tani, e vërteta është që kishte qenë i gatshëm të kapitullonte shumë kohë më parë se të merrte vendimin. Mendjelehtësinë e përpjekjes për t'u ngritur kundër Partisë e kishte pikasur qysh prej çastit kur u ndodh brenda Ministrisë së Dashurisë – madje qysh gjatë atyre minutave kur kishin qenë të pafuqishëm ndërkohë që zëri metalik nga tele-ekrani i kishte urdhëruar se çfarë të bënin. Tashmë e dinte që Policia e Mendimit e kishte vëzhguar për shtatë vite rresht si një buburrec poshtë xhamit zmadhues. Nuk kishte veprim apo fjalë të thënë me zë të lartë që ata nuk e kishin pikasur dhe nuk kishte mendim që ata nuk ia dinin përfundimin. Madje ata e kishin zëvendësuar me kujdes edhe kokrrën e zbardhëllemë të rërës që ai kishte lënë si shenjë mbi ditar. Kishin luajtur kolona zanore për të, i kishin treguar fotografi. Një pjesë e tyre ishin fotografi të tij me Xhulian. Po, madje edhe... Nuk mund të luftonte më kundër Partisë. Përveç kësaj, Partia kishte të drejtë. Dhe kështu duhet të ishte, si mund të gabonte truri kolektiv dhe i pavdekshëm? Me çfarë standartesh të jashtme mund të kontrolloje gjykimin e tij? Kthjelltësia mendore qe veç statistikë. Çështja ishte të mësoje të mendoje sipas mënyrës që mendonin edhe ata. Vetëm...!

Lapsi iu duk i trashë ndërsa gishtat lëvizën me ngathtësi. Filloi të shkruante mendimet që i vinin në kokë. Fillimisht, shkroi me shkronja të mëdha dhe të shtrembëra:

LIRIA ËSHTË SKLLAVËRI

Mandej, pothuajse pa ndaluar, vazhdoi më poshtë:

DY EDHE DY BËJNË PESË

Në këtë pikë nisi një farë vetëkontrolli. Sikur t'i fshihej diçkaje, mendja dukej e paaftë të përqëndrohej. Ai e dinte që e dinte se çfarë e kishte radhën, por atë çast nuk e kujtonte dot. Më në fund e kujtoi vetëm falë arsyetimit me vetëdije dhe jo në mënyrë spontane. Shkroi:

Pranoi gjithçka. E shkuara ishte e ndryshueshme. E shkuara nuk ishte ndryshuar kurrë. Oqeania ishte në luftë me Azinë Lindore. Oqeania kishte qenë në luftë vetëm me Azinë Lindore. Xhonsi, Aronsoni dhe Radhërfordi qenë fajtorë për krimet që ishin dënuar. Ai nuk e kishte parë kurrë fotografinë që fliste për pafajësinë e tyre. Fotoja nuk kishte ekzistuar ndonjëherë, ajo kishte qenë shpikje e tij. Iu kujtua koha kur kujtonte gjëra të kundërta, por ato qenë kujtime të rreme, sajime të një njeriu vetëmashtrues. Sa e lehtë që ishte! Vetëm të dorëzoheshe dhe gjithçka tjetër rridhte vaj. Ishte njëlloj sikur të notoje kundër rrymës e cila, pavarësisht përpjekjeve të tua, të shtynte në të kundërt, dhe befas ti kthehesh dhe vendos të notosh në një drejtim me të. Përveç qëndrimit tënd nuk kishte ndryshuar asgjë: në çdo rast ndodhte e paracaktuara. Gati nuk e dinte pse ishte rebeluar. Gjithçka qe e lehtë, me përjashtimi të...!

Që gjithçka mund të ishte e vërtetë. Të ashtuquajturat ligje të natyrës qenë budallallëqe. Po kështu qenë edhe ligjet e gravitetit. "Po të dua – kishte thënë O'Brajëni, - mund të ngrihem në ajër si një flluskë sapuni." Uinstoni nisi të bënte llogari: "Në qoftë se ai *mendon* që mund të ngrihet në ajër, dhe, ndërkohë, unë *mendoj* që ai e bën, atëherë kjo gjë ndodh." Befas, siç dalin mbi ujë copat e një anijeje të mbytur, iu shfaq në kokë një mendim: "Nuk ndodh vërtet, por ne imagjinojmë sikur ndodh. Qenka haluçinacion." E përzuri rrëmbimthi këtë mendim. Gabimi ishte i dukshëm. Kjo do të thoshte që diku, jashtë njeriut, na qenkësh një botë "reale" ku ndodhnin gjëra "reale". Po si mund të ishte e mundur një botë e tillë? Çfarë njohurish për gjërat kemi të ruajtur në mendjet tona? Gjithë ngjarjet janë në mendje. Ajo që ndodh në mendje, në gjithë mendjet, ndodh vërtet.

Nuk e pati të vështirë ta rregullonte gabimin, dhe s'kishte frikë se mos bëhej preja e tij. Megjithëse e kuptoi që ai gabim nuk duhet të ishte shfaqur kurrë. Mendja duhet të pajisej me një sistem mbrojtës kundër mendimeve të rrezikshme. Procesi duhet të ishte automatik, instiktiv. Në Gjuhën e Re quhej *ndalkrim*.

Filloi të bënte ushtrime ndalkrimi. Përfytyroi çështje të ndryshme – "Partia thotë që Toka është e sheshtë", "Partia thotë që akulli është më i rëndë se uji" – dhe stërviti veten të mos i shikonte apo kuptonte argumentat kundërshtuese. Nuk qe e lehtë. Kërkonte forcë arsyetimi dhe improvizimi të madhe. Për shembull, problemet aritmetike, si deklarata "dy edhe dy bëjnë pesë", bie fjala, qenë përtej aftësisë së tij intelektuale. Aritmetika kishte nevojë për një mendje atletike, me aftësinë që në një çast të përdorte logjikën në mënyrën më delikate dhe pak më vonë të mos reagonte ndaj gabimeve logjike trashanike. Ngathtësia ishte po aq e domosdoshme sa edhe mprehtësia mendore dhe po aq e vështirë për t'u zotëruar.

Një copë herë, vetëm me një pjesë të mendjes së vet, përfytyroi sesi do ta pushkatonin. "Gjithçka varet nga ty", kishte thënë O'Brajëni, por ai e dinte që ajo ishte diçka që nuk mund ta ofronte me vetëdije. Mund të ndodhte dhjetë minuta ose dhjetë vite më vonë. Mund ta mbanin në izolim për vite me radhë, mund ta dërgonin në ndonjë kamp pune, ose, diçka që kishte ndodhur edhe më parë, mund ta lironin për njëfarë periudhe. Madje qe shumë e mundshme që, para se të pushkatohej, gjithë drama e arrestimit të tij të vihej në skenë edhe një herë nga e para. I sigurt ishte vetëm fakti që vdekja nuk mund parashikohej. Tradita – tradita e heshtur: diçka që dihej, por nuk thuhej me zë të lartë – ishte të të qëllonin nga mbrapa, përherë mbrapa kokës, pa paralajmërim, ndërsa ecje përgjatë korridorit nga qelia në qeli.

Një ditë – "një ditë" nuk qe shprehja e duhur, sepse mund të kishte qenë edhe mesnatë; njëherë – u krodh në një ëndërr të lumtur dhe të çudishme. Po ecte përgjatë korridorit, në pritje të plumbit. E priste nga çasti në çast. Gjithçka ishte sqaruar, zbutur, pajtuar. Nuk kishte më dyshime, mosmarrëveshje, dhimbje apo frikë. Fizikisht ishte i shëndetshëm dhe i fuqishëm. Ecte me hap të lehtë, me kënaqësinë e lëvizjes dhe ndjesinë që çapitej në dritën e diellit. Nuk ndodhej më në korridoret e ngushtë të Ministrisë së Dashurisë, por në një shteg gjigant, një kilometër të gjerë, të driçuar nga dielli, përgjatë të cilit ecte në një jerm të shkaktuar nga drogat. Ishte në Tokën e Artë, duke ecur në gjurmët e kamionëve

në lëndinën me ushqim lepujsh. Ndiente plisat e lehtë poshtë këmbëve dhe dritën e butë të diellit në fytyrë. Buzë arës ngriheshin vidhat me degët që lëkundeshin lehtë, dhe përtej kësaj pamjeje, poshtë shelgjeve, ishte burimi dhe pellgjet me cironka.

Befas u ngrit i tmerruar. Menjëherë e mbuluan djersët e ftohta në shtyllën kurrizore. Dëgjoi veten tek bërtiste:

- Xhulia! Xhulia! Xhulia, shpirt! Xhulia!

Për një çast pati një gjendje haluçinante, i bindur që ajo ishte e aty. Madje jo vetëm aty, por edhe brenda tij. Sikur t'i ishte futur poshtë lëkurës. As kur kishin qenë bashkë dhe të lirë s'e kishte dashur aq shumë sa atë çast. Dhe ishte i bindur që ajo ishte diku, ende gjallë, dhe që kishte nevojë për ndihmën e tij.

U shtri në krevat dhe u përpoq të mblidhte veten. Çfarë kishte bërë? Sa vite qëndrim në qeli i kishte shtuar vetes me atë çast dobësie?

Pak më vonë dëgjoi kërcitjet e këpucëve përjashta. Shpërthimi i tij nuk mund të kalonte pa u ndëshkuar. Në qoftë se nuk e kishin parë, e mësuan tani që ai shkeli marrëveshjen e vendosur mes tyre. Edhe i bindej Partisë, edhe e urrente. Dikur kishte fshehur mendjen heretike pas një pamjeje komformiste. Tani kishte hedhur një hap tjetër: mendërisht ishte dorëzuar, por kishte shpresuar të ruante të paprekur thellësitë e zemrës. E dinte që po gabonte, por kështu i pëlqente. Ata do ta kuptonin - edhe O'Brajëni. E kishte zbuluar gjithçka veç me një klithmë mendjelehtë.

Tashmë do t'i duhej ta niste gjithçka nga e para. Kjo mund të kërkonte vite. Në përpjekje të miqësohej me format e reja, preku fytyrën me dorë. Në faqe kishte brazda të thella, kockat e mollëzave ishin të mprehta, hunda e sheshtë. Përveç kësaj, qyshkur e kishte parë veten për herë të fundit në pasqyrë, i kishin dhënë një komplet të ri dhëmbësh. Nuk ishte e lehtë të ruaje padepërtueshmërinë kur nuk e kishe idenë sesi dukej fytyra jote. Sidoqoftë, kontrolli i thjeshtë i tipareve nuk mjaftonte. Për herë të parë kuptoi se të ruash një sekret së pari duhet t'ia fshehësh vetes. Ta dish që ndodhet brenda teje, por, në qoftë se nuk është e nevojshme, të mos e lësh të mbërrijë në

vetëdijen tënde në një formë që kërkon emër. Këtej e tutje i duhej jo vetëm të mendonte, por edhe të ndiente dhe të ëndërronte ashtu si duhej. Duhej që ta fshihte urrejtjen gjatë gjithë kohës, ta mbyllte si një send që ishte pjesë e tij dhe njëkohësisht i palidhur me të tërën, një lloj lunge.

Vendimi që ai të pushkatoj do të merrej një ditë. Nuk mund të thuhej se kur, por mund të hamendësohej pak sekonda para pushkatimit. Goditja vinte gjithmonë nga mbrapa, kur do të ishe duke ecur përgjatë një korridori. Dhjetë sekonda ishin të mjaftueshme. Dhjetë sekonda mjaftonin që brenda tij të përmbysej bota. Mandej, krejt befas, pa thënë asnjë fjalë, pa i kontrolluar hapat, pa ndryshuar asnjë linjë të fytyrës, papritur do të hiqej maska dhe do të shpërthente urrejtja. Ajo do ta mbushte trupin e tij si flakët kërcëllitëse të zjarrit dhe pothuajse në të njëjtin çast – shumë vonë, ose shumë herët – do të tërhiqej këmbëza. Do t'ia hidhnin trutë në erë para se ta kthenin në rrugë të mbarë. Mendimi heretik do të mbetej i pa ndëshkuar, i papenduar, nuk do ta shtinin kurrë në dorë. Do të hapnin një vrimë në përsosmërinë e tyre. Liri do të thoshte të vdisje duke i urryer.

Uinstoni mbylli sytë. Ishte më e vështirë se të pranoje një disiplinë intelektuale. Ishte çështja të poshtëroje dhe sakatoje veten. Duhej të zhytej në pisllëkun e pisllëqeve. Cila ishte gjëja më e neveritshme? Solli ndërmend Vëllain e Madh. Fytyra e stërmadhe (ngaqë përherë e shikonte në afishe, atë fytyrë e përfytyronte një metër të gjerë), me mustaqet e zeza dhe të trasha, me sytë që të ndiqnin ngado që shkoje, pluskonte në mendjen e tij sipas qejfit. Çfarë ndiente ai realisht për Vëllain e Madh?

Në korridor u dëgjua gjëmimi i çizmeve. Dera e çeliktë u hap duke kërcitur. Hyri O'Brajëni. Pas tij vinte oficeri me fytyrë prej dylli dhe gardianët me uniforma të zeza.

- Çohu, - tha O'Brajëni. – Eja këtu!

Uinstoni i qëndroi përballë. O'Brajëni e kapi nga supet dhe e këqyri nga afër.

- Ke patur mendime për të më mashtruar, - i tha. – Ky është budallallëk. Qëndro më drejt. Më vështro në sy.

Heshti një hop, pastaj vazhdoi me zë më të butë:

- Në fakt, po përmirësohesh. Nga ana intelektuale nuk ke probleme. Pjesa ku ti ke mbetur në vend është ana emocionale. Më thuaj, Uinston – pa gënjeshtra, dakord, ti e di që unë i nuhas gënjeshtrat – më thuaj, çfarë ndien për Vëllain e Madh?

- Urrejtje.

- Urrejtje. Bukur. Atëherë ka ardhur koha që të hedhësh hapin e fundit. T'i bindesh Vëllait të Madh nuk mjafton, duhet ta duash.

O'Brajëni e lëshoi duke e shtyrë në drejtim të gardianëve.

- Dhoma 101, - tha.

V

Në çdo fazë të burgimit e kishte ditur, ose dukej sikur e kishte ditur, që kishte qenë vetëm në qeli pa dritare. Ndoshta ndryshimi midis tyre qëndronte në presionin e ajrit. Qelitë ku ishte rrahur nga gardianët kishin qenë pak sipër tokës. Dhoma ku e mori në pyetje O'Brajëni kishte qenë lart, diku afër çatisë. Vendi ku ndodhej së fundi ishte shumë metra ndën dhe, më poshtë nuk shkohej.

Ishte një qeli më e madhe se shumica e të tjerave, po Uinstoni nuk i kushtoi shumë vëmendje. Gjithë ç'pa qenë dy karrige përballë tij, të dyja mbuluar me kadife jeshile. Njëra ishte veç një apo dy hapa larg tij, ndërsa tjetra ishte më tej, afër derës. Ai ishte fashuar pas karriges, aq fort sa nuk mund të bënte asnjë lëvizje, madje nuk mund të lëvizte as kokën. Mbrapa kokës e ngacmonte një shtresë e butë, e cila e detyronte të shikonte vetëm përpara.

Për një çast Uinstoni ishte vetëm, pastaj u hap dera dhe hyri O'Brajëni.

- Dikur, - tha O'Brajëni, - më pyete se çfarë kishte në dhomën 101. Unë të thashë që ti e dije çfarë kishte. Të gjithë e dinë. Ajo çfarë është në këtë dhomë është gjëja më e tmerrshme në botë.

Dera u hap sërish. Hyri një gardian që mbante në dorë diçka të thurur me tel, diçka si punë kutie apo kosh. E vendosi mbi tavolinë. Vendndodhja e O'Brajënit e pengonte Uinstonin të shikonte se çfarë ishte ai send.

- Gjëja më e tmerrshme në botë, - tha O'Brajëni, - nuk është e njëjtë për të gjithë njerëzit. Mund të jetë varrosja për së gjalli,

vdekje me pushkatim, mbytje, ngulje në hunj, dhe pesëdhjetë lloje të tjera vdekjesh. Ka edhe raste kur nuk është vdekje, por diçka pa rëndësi.

O'Brajëni lëvizi pak dhe kështu Uinstoni kishte mundësi ta shikonte më mirë sendin sipër tavolinës. Ishte një kafaz i gjatë prej teli. Në faqen e tij të përparme kishte diçka që dukej si rrjetë, me kurbën nga jashtë. Edhe pse kafazi ishte tre ose katër metra larg, ai arriti të dallonte që ishte i ndarë në dy pjesë dhe të dyja me ca krijesa brenda. Ishin minj.

- Në rastin tënd, Uinston, fati e deshi që gjëja më e tmerrshme në këtë botë të jenë minjtë.

Qysh kur e pa për herë të parë kafazin Uinstoni pati një parandjenjë drithëruese, një frikë që ai nuk ishte i sigurt nga i vinte. Por atë çast e kuptoi se çfarë ishte pjesa e kafazit që dukej si maskë. Iu drodhën zorrët e barkut.

- Mos të lutem! – klithi me zë të lartë dhe të dridhur. – Mos ma bëj këtë! Nuk mund ta bësh! Është e pamundur!

- Të kujtohen, - tha O'Brajëni, - çastet e tmerrit që të shfaqeshin në ëndrra? Një mur i zi përballë dhë një tingull ulëritës ndër veshë. Në anën tjetër të murit ishte diçka e tmerrshme. Ti e dije që ti e dije se çfarë ishin, por nuk guxoje ta pranoje. Në anën tjetër të murit ndodheshin minjtë.

- O'Brajën! – tha Uinstoni, duke u përpjekur të kontrollonte zërin. – Ti e di që kjo s'është e nevojshme. Çfarë kërkon nga unë?

O'Brajëni nuk u përgjigj menjëherë. Kur fliste, ai bëhej tërheqës me mënyrën e të folurit si drejtor shkolle. Vështronte mendueshëm në largësi, sikur njerëzit me të cilët komunikonte ndodheshin matanë Uinstonit.

- Shpesh, nuk mjafton vetëm dhimbja, - tha. – Ka raste kur njeriu e duron dhimbjen, madje edhe dhimbjet vdekjeprurëse. Por për secilin ka diçka që nuk e duron dot – diçka që as nuk mund të qaset ndërmend. Guximi dhe frika s'kanë të bëjnë fare. Kur je duke rënë nga një lartësi nuk tregohesh frikacak në qoftë se kapesh pas litarit. Në qoftë se del prej ujit nuk je frikacak kur mbush mushkëritë me ajër. Është thjesht një instikt që nuk mund

të shkatërrohet. E njëjta gjë ndodh edhe me minjtë. Për ty ata janë të padurueshëm. Është një formë presioni që ti nuk e përballon dot edhe po të duash. Kështu do të bësh çfarë të kërkohet.

- Por çfarë do që të bëj, çfarë? Si mund ta bëj kur nuk e di çfarë është?

O'Brajëni e solli kafazin tek tavolina më e afërt. E vendosi me kujdes sipër kadifesë. Uinstonit iu drodhën zorrët e barkut. Kishte ndjesinë se ishte tërësisht vetëm. Sikur ishte në mes të një shkretëtire të pafund, të sheshtë, bosh, përmbytur me diell dhe plot tinguj që vinin nga largësi të pamata. Ndërkohë që kafazi me minj ishte veç dy metra larg tij. Minj të stërmëdhenj. Në moshën kur turiri bëhet i fortë ndërsa qimja merr ngjyrë kafe në vend të ngjyrës gri.

- Megjithëse klasifikohet si brejtës, - tha O'Brajëni, sërish duke folë me njerëzit e padukshëm në largësi, – miu është mishngrënës. Besoj që e di dhe padyshim që ke dëgjuar për gjërat që ndodhin në periferitë e varfra të këtij qyteti. Në disa lagje nëna nuk guxon ta lërë fëmijën vetëm në shtëpi as për pesë minuta. Patjetër që do ta sulmojnë minjtë. Pesë minuta janë kohë e mjaftueshme që ta gëlltisin. Minjtë sulmojnë edhe njerëzit e sëmurë apo ata që janë duke dhënë shpirt. Kanë një inteligjencë të jashtëzakonshme për të kuptuar se cilët njerëz janë të pafuqishëm.

Prej kafazit u dëgjua një tufë piskamash. Uinstonit iu duk sikur vinin prej së largu. Minjtë po luftonin me njëri-tjetrin për të marrë copën e vet. Uinstoni dëgjoi edhe një rënkim të dëshpëruar. Dhe, edhe ky, vinte nga një pikë jashtë tij.

O'Brajëni mori kafazin në dorë dhe, ndërsa bëri këtë veprim, shtypi diçka. U dëgjua një kërcitje e mprehtë. Uinstoni u përpoq me të gjitha forcat të çlironte veten nga karrigja. Por më kot, çdo pjesë e trupit të tij, edhe koka, qenë lidhur në mënyrë të palëvizshme. O'Brajëni afroi kafazin. Tashmë ishte jo më larg se një metër nga fytyra e Uinstonit.

- Lëviza levën e parë, - tha O'Brajëni. – Besoj e shikon si është ndërtuar ky kafaz. Maska do të vendoset në kokën tënde dhe nuk ka dalje tjetër. Kur të shtyp levën tjetër, dera e kafazit do të ngrihet lart. Këto egërsira të uritura do të lëshohen si plumb.

Ke parë ndonjë mi të kërcejë në ajër? Ata do të kërcejnë drejt në fytyrën tënde dhe do të mbeten aty. Nganjëherë e nisin sulmin nga syte. Herë të tjera gërmojnë në faqe dhe përlajnë gjuhën.

Kafazi u afrua, po afrohej gjithnjë e më tepër. Uinstoni dëgjoi një seri piskamash që dukej sikur vinin nga ajri sipër kokës së tij. U përpoq me të gjitha fuqitë të mposhtte panikun. Të menduarit, të menduarit, edhe në të qindën e sekondës të mbetur – të menduarit ishte shpresa e vetme. Befas kutërbimi i qelbur i kafshëve sosi në vrimat e hundës së tij. Gati sa nuk i ra të fikët nga dallga e neverisë. Shikonte vetëm errësirë. Për një çast ishte veç një kafshë e çmendur që klithte. Mirëpo një mendim i fundit e ndriçoi disi. Për të shpëtuar veten kishte vetëm një rrugë. Duhej të vendoste një qenie tjetër njerëzore, *trupin* e një njeriu tjetër, midis tij dhe minjve.

Goja e maskës ishte aq e madhe sa nuk linte vend për pamje tjetër. Dera ishte veç dy pëllëmbë larg nga fytyra e tij. Minjtë e dinin ç'i priste. Njëri prej tyre kërcente poshtë e lart, tjetri, një veteran gjirizesh, u ngrit dhe, me këmbët e para hedhur në tela, nuhuriti me egërsi ajrin. Uinstoni i dalloi mustaqet dhe dhëmbët e verdhë. E përfshiu paniku i verbër sërish. Qe verbuar, qe i pafuqishëm, i trallisur.

- Në perandorinë kineze ky ishte ndëshkim i zakonshëm, - tha O'Brajëni, më ftohtë se kurrë.

Maska po afrohej tek fytyra e Uinstonit. Telat e prekën në faqe. E mandej – jo, nuk ishte çlirim, veç shpresë, një grimë shpresë. Shumë vonë, ndoshta shumë vonë. Befas i ra ndër mend se kishte vetëm *një* njeri në botë tek i cili ai mund ta kalonte këtë ndëshkim – *një* trup që ai mund ta vendoste mes vetes dhe minjve. Dhe nisi të bërtiste e bërtiste pa pushim:

- Bëjani Xhulias! Bëjani Xhulias! Jo mua! Xhulias! S'dua t'ia di çfarë bëni me të. Prishjani fytyrën, rripeni të gjallë. Jo mua! Xhulian! Jo mua!

U rrëzua mbrapa, në thellësi të pafundme, larg minjve. Ishte ende i fashuar pas mbështetëses, por vazhdonte të rrëzohej, së bashku me karrigen, përmes mureve të ndërtesës, thellë në tokë, në oqean, në atmosferë, jashtë hapësirës, në hapësirat mes

yjeve – gjithmonë larg e më larg, sa më larg qe e mundur nga minjtë. Ndodhej vite drite në largësi, por O'Brajënin e kishte ende përkrah. E ndiente akoma ftohtësinë e telit në faqe. Megjithatë, përmes errësirës që e kishte mbështjellë, dëgjoi një kërcitje tjetër dhe e dinte që dera nuk ishte hapur, por mbyllur.

VI

Kafe *Gështenja* ishte pothuajse bosh. Një rreze dielli që depërtonte nga dritarja bëhej e verdhë sipër tavolinave të pluhurosura. Qe vetmia e orës tre mbasdite. Nga tele-ekrani vinte një muzikë e ulët.

Uinstoni u ul në cepin e tij të zakonshëm, dhe vështronte një gotë bosh. Herë pas here ngrinte sytë nga fytyra e stërmadhe e cila e këqyrte prej murit përballë. VËLLAI I MADH JU VROJTON, shkrunte diçitura. Pa e porositur, kamarieri u afrua dhe i mbushi gotën me Xhin Fitorja, duke shtuar në të disa pika nga një shishe tjetër me tapë me pikatore. Ishte sakarinë aromatike me karafil, specialitet i lokalit.

Uinstoni po dëgjonte tele-ekranin. Atë çast jepej vetëm muzikë, por, nga momenti në moment, pritej të jepej një emision i veçantë lajmesh. Lajmet që vinin nga Afrika ishin tejet shqetësuese. Kjo e kishte pikëlluar Uinstonin gjatë gjithë ditës. Një ushtri euroaziatike (Oqeania ishte në luftë me Euroazinë, Oqeania kishte qenë përherë në luftë me Euroazinë) po përparonte drejt jugut me shpejtësi të paparë. Lajmet e drekës nuk kishin përmendur asnjë vendndodhje të përcaktuar, por qe shumë e mundshme që sheshbeteja të ishte gjiri i Kongos. Brazavila dhe Leopoldvili ishin në rrezik. Nuk ishte nevoja të shikoje hartën për të kuptuar përse bëhej fjalë. Nuk ishte çështja se humbej Afrika Qëndrore, por kërcënohej, për herë të parë gjatë gjithë luftës, territori i vetë Oqeanisë.

Një emocion i dhunshëm, nuk mund quhej frikë, por diçka e paqartë, u ndez dhe u shua menjëherë brenda tij. E hoqi mendjen

nga lufta. Tashmë nuk mund të përqëndrohej në një çështje më shumë se disa sekonda. Ngriti gotën dhe e boshatisi me një të kthyer. Si gjithmonë, xhini i jepte të dridhura, madje i shkaktonte një ndjenjë të lehtë përzierjeje. Pija ishte e keqe. Karafilat dhe sakarina, edhe ato vetë i shkaktonin të vjella, nuk e mposhtnin dot aromën vajore – më e keqe se aroma e xhinit, diçka që jetonte me atë natë e ditë, e ngatërruar në mënyrë të pazgjidhshme në mendjen e tij me aromën e atyre...

Nuk i përmendi kurrë me emër, as në mendime, dhe, me sa kishte mundësi, as nuk i përfytyronte. Ishte gjysmë i vetëdijshëm se ato ishin gjëra që i vinin rrotull fytyrës, një aromë që s'i shqitej nga hunda. Nën ndikimin e xhinit, buzët ngjyrë vishnje lëvizën nga gromësimat. Pas daljes nga burgu Uinstoni ishte shëndoshur, kishte rifituar ngjyrën e vet – madje më tepër se kaq. Tiparet e fytyrës ishin mbushur, te lëkura e hundës dhe eshtrave të mollëzave ishte kthyer e kuqja e theksuar, madje edhe balli flokërënë kishte marrë ngjyrë rozë të thellë. Sërish pa e porositur, kamarieri solli fushën e shahut dhe numrin më të fundit të *Times*-it, me faqen e hapur tek problemi i shahut. Mandej, kur pa se gota e Uinstonit qe bosh, solli shishen dhe e mbushi. S'qe nevoja të porosiste. Ia dinin zakonin. Fusha e shahut qe në pritje, tavolina në cep rrinte përherë e rezervuar, madje edhe kur kafeneja ishte e mbushur ai e kishte gjithë tavolinën të tijën, sepse askush nuk pëlqente t'i afrohej. Për të numëruar gotat që pinte as që i shkonte në mendje. Herë pas here, në një copë letër të pistë, kamarieri i sillte llogarinë dhe, përherë, Uinstoni mendonte që ata i bënin lëshime. Por edhe nëse do të ndodhte e kundërta asgjë s'do të ndryshonte. Tashmë ai i kishte paratë me bollëk. Madje kishte një punë me më pak telashe dhe me më shumë para se e dikurshmja.

Muzika në tele-ekran u zëvendësua nga një zë. Uinstoni u përqëndrua të dëgjonte. Megjithatë, për luftën s'u tha asgjë. Veç një njoftim i thjeshtë i Ministrisë së Bollëkut. Siç dukej, prodhimi i lidhëseve të këpuceve për tremujorit e fundit qe tejkaluar me 98 përqind.

Pa me vëmendje problemin e shahut dhe hapi gurët. Ishte një fund i koklavitur, me disa lëvizje kuajsh. "Lëvizjen e kanë të

bardhët, mat me dy lëvizje." Uinstoni ngriti sytë nga portreti i Vëllait të Madh. Përherë të bardhët bëjnë mat, me një lloj misticizmi të mjegullt. Gjithmonë, pa përjashtim, kështu ishte vendosur. Qysh prej krijimit të botës gurët e zinj nuk kishin fituar asnjë problem shahu. A nuk simbolizonte kjo triumfin e përjetshëm dhe të pandryshueshëm të së Mirës ndaj së Keqes? Fytyra gjigante ia ktheu vështrimin, gjithë fuqi dhe qetësi. Të bardhët fitojnë përherë.

Zëri në tele-ekran u ndal një hop dhe shtoi me ton tjetër dhe më serioz: "Ju paralajmërojmë të qëndroni në gatishmëri për një lajm të rëndësishëm në orën tre e gjysmë. Në tre e gjysmë! Lajm shumë i rëndësishëm. Kujdes të mos e humbisni. Në tre e gjysmë!" Muzika e butë nisi sërish.

Zemra e Uinstonit rrahu furishëm. Duhet të ishte lajm nga fronti dhe e parandiente që ishte lajm ogurzi. Mendimin për një fitore madhështore, me shpërthime të vogla gëzimi, e kishte mbajtur në mendje gjithë ditën. E përfytytonte ushtrinë euroaziatike tek derdhej drejt kufirit të pathyer kurrë dhe tek vërshonte drejt pikës më të skajshme të Afrikës si karvanë milingonash. Si ishte e mundur që nuk ishte gjetur një mënyrë për t'ju afruar me krahmarrje? Bregdeti i Afrikës perëndimore ishte i gjallë në mendjen e tij. Bëri një lëvizje me kalin e bardhë. *Kjo* ishte një pikë kyçe. Edhe kur e përfytyronte hordhinë e zezë duke vrapuar drejt jugut pa edhe një forcë tjetër, të grumbulluar fshehurazi, befas e shfaqur mbrapa shpine, duke prerë lidhjet nga toka dhe deti. Pati ndjesinë se po e sillte në jetë atë forcë në mënyrë të vullnetshme. Duhet të veprohej pa humbur kohë. Në qoftë se ata do të shtinin në dorë gjithë Afrikën, në qoftë se shtinin në dorë aeroportet dhe bazat detare të Kejpit, atëherë do ta ndanin Oqeaninë në dy pjesë. Mund të ndodhte gjithçka: humbje, trazirë, rindarje e botës, shkatërrim i Partisë! U mbush thellë me frymë. Brenda tij luftonte një përzierje ndjenjash – në fakt nuk ishte tamam përzierje, më tepër ngjante me shtresa ndjenjash të njëpasnjëshme që e bënin të pamundur të thoje kush ishte në themel.

Spazma kaloi. E ktheu kalin e bardhë aty ku ishte, por nuk përqëndrohej dot tek problemi i shahut. Mendimet iu arratisën

përsëri. Pothuajse në mënyrë të pavetëdijshme shkroi me gisht në pluhurin e tavolinës:

2+2=5

- Nuk mund të futen në kokën tënde, - i kishte thënë ajo. Në fakt mund të futeshin. "Çfarë të ndodh këtu mbetet *përgjithmonë*," i kishte thënë O'Brajëni. Ishte shumë e vërtetë. Kishte gjëra, vetë veprimet e tua, prej të cilave nuk mund të shëroheshe. Diçka ishte vrarë në kraharorin tënd, ishte shkatërruar, djegur me hekur.

Ai e kishte parë, madje i kishte folur. Kjo s'përbënte ndonjë rrezik. E dinte, gati instiktivisht, që veprimeve të tij nuk u kushtohej ndonjë vëmendje. Në qoftë se ata do të kishin dashur mund edhe ta kishin rregulluar të takoheshin. Në fakt, u takuan rastësisht. Kjo ndodhi në park, një ditë të keqe marsi, kur toka ishte kthyer në shkëmb dhe kur syri nuk të kapte bar apo sythë të çelur, me përjashtim të ndonjë shafrani i cili kishte ngritur krye veç të shkatërrohej nga era. Uinstoni ishte duke vrapuar, me duar të mardhura dhe sytë që lotonin, kur e pa atë, jo më larg se dhjetë metra. Kur pa që ajo kishte ndryshuar për keq, u prek. U shkëmbyen pa asnjë përshëndetje, pastaj e ndoqi, jo me shumë dëshirë. E dinte që s'rrezikonte gjë, askush nuk do t'u kushtonte vëmendje. Ajo nuk foli. Ecte sipër barit dhe dukej sikur përpiqej t'i shmangej, pastaj, kur ai i doli në krah, u dorëzua. Tashmë ndodheshin midis kaçubesh pa gjethe që nuk ndihmonin as për t'u fshehur as për t'u mbrojtur nga era. U ndalën. Ishte tmerrësisht ftohtë. Era fishkëllente nëpër degë dhe trazonte krokullat e rralla e të shpifura. Kaloi dorën rreth belit të saj.

Tele-ekranët s'dukeshin gjëkundi, por duhet të kishte mikrofonë të fshehtë rrotull, megjithëse ata mund të shiheshin fare qartë. Sidoqoftë, nuk kishte rëndësi, asgjë s'kishte rëndësi. Në qoftë se donin të shtriheshin në tokë edhe mund ta *bënin*. Uinstonit iu ngjeth mishi kur e mendoi. Ajo nuk reagoi fare ndaj krahut, nuk u përpoq as të lirohej prej tij. Tashmë ai e dinte se çfarë kishte ndryshuar tek ajo. Fytyra e saj ishte më e fryrë, midis ballit kishte një vragë të madhe, pjesërisht e fshehur nga flokët, por nuk

ishte ky ndryshimi. Ndryshimi qëndronte tek beli që ishte trashur dhe ngurtësuar në mënyrë të habitshme. Solli ndër mend sesi njëherë, pas shpërthimit të një rakete, kishte ndihmuar të nxirrte një kufomë nga rrënojat dhe sesi ishte habitur jo vetëm nga pesha e pabesueshme e kufomës, por edhe nga ngurtësia dhe kaballëku që e bënte trupin sikur të ishte prej guri dhe jo prej mishi. Pikërisht kështu iu duk edhe trupi i saj. Vuri re që lëkura e saj ndryshonte shumë nga ajo që kishte qenë dikur.

Ai nuk rrek ta puthte dhe nuk shkëmbyen asnjë fjalë. Ndërsa ecnin sipër barit, ajo e vështroi për herë të parë. Veç një vështrim i çastit, plot përbuzje dhe antipati. Uinstoni vriste mendjen se ku e kishte burimin ajo antipati, thjesht në të shkuarën apo mos ishte frymëzuar nga fytyra e mbufatur dhe uji që era shtrydhte nga sytë e tij. U ulën në dy karrige metalike, krah për krah, por jo shumë ngjitur. Pa që ajo ishte gati të fliste. Ajo lëvizi këpucën e madhe disa centimetra dhe theu një degë qëllimisht. Vuri re që këmbët e saj ishin zmadhuar.

- Unë të tradhtova, - tha Xhulia.

- Unë të tradhtova, - tha ai.

Ajo i hodhi një tjetër vështrim antipatie.

- Ka raste, - tha ajo, - ata të kërcënojnë me diçka që nuk mund t'i bësh ballë, madje as që të shkon mendja. E kështu ti thua: "Mos ma bëj mua këtë gjë, bëja dikujt tjetër, bëja filanit apo filanes." Ndoshta më vonë mund të pretendosh që ishte veç një marifet që e bëre për t'i detyruar të ndalonin dhe se nuk e kishe thënë me gjithë zemër. Por është e vërtetë. Në kohën që e thua e thua seriozisht. Ti mendon se nuk ka rrugë tjetër dhe je e gatshme ta shpëtosh veten në atë mënyrë. Ti *do* që ajo t'i ndodhë personit tjetër. As që të bëhet vonë sesa vuan ai. Vetëm vetja të intereson.

- Vetëm vetja të intereson, - përsëriti ai.

- Pas kësaj nuk ndien më të njëjtën gjë për atë person.

- Jo, - tha ai, - nuk ndien më të njëjtën gjë.

Dukej se nuk kishin ç'të thonin tjetër. Era u ngjiste kominoshet e holla për trupi. Pothuajse njëkohësisht të dy u ndien të turpëruar, që të rrinin aty në heshtje; pastaj, ishte shumë ftohtë. Ajo tha diçka për trenin që duhet të kapte, u ngrit dhe u largua.

- Duhet të takohemi sërish, - tha Uinstoni.

- Po, - tha ajo, - duhet të takohemi sërish.

Uinstoni e ndoqi i pavendosur një copë rrugë, gjysmë hapi mbrapa. Nuk folën më. Ajo nuk e përzuri, por ecte me shpejtësi sikur donte që ai të mos e arrinte. Ai kishte vendosur ta shoqëronte deri tek metroja, por, befas, ndjekja në atë të ftohtë iu duk e pakuptimtë dhe e padurueshme. Nuk e përmbajti dot dëshirën të kthehej tek kafe *Gështenja*, jo për t'u larguar nga Xhulia, por kafeneja nuk i ishte dukur kurrë aq tërheqëse sa atë çast. Nuk e duroi dot përfytyrimin nostalgjik me tavolinën e tij në cep, me gazetën dhe fushën e shahut, si dhe me xhinin që rridhte përjetësisht. Dhe mbi të gjitha, aty do të ishte më ngrohtë. Pak më pas, jo krejt rastësisht, kur ndeshën një grup njerëzish, ai u nda prej saj. Fillimisht bëri një përpjekje të vakët për ta arritur, pastaj e uli shpejtësinë, u kthye, dhe mori drejtimin kundërt. Pas pesëdhjetë metrash ktheu kokën. Rruga nuk kishte shumë njerëz, por sërish nuk e dalloi dot Xhulian. Çdonjëra nga figurat që nxitonin mund të kishte qenë ajo. Ndoshta trupi i saj i trashur dhe i ngurtësuar nuk mund të dallohej më nga mbrapa.

- Në kohën që ndodh, - kishte thënë ajo, - ti e ke seriozisht.

Ai e kishte patur me gjithë mend. Nuk e kishte thënë, por e kishte dëshiruar. Kishte dëshiruar që minjtë t'i hidheshin asaj dhe jo...

Diçka ndryshoi në muzikën e butë që vinte nga tele-ekrani. U dëgjua një zë, kërcitës, therës, i verdhë. Pastaj – ndoshta nuk ishte duke ndodhur, ndoshta ishte veç një kujtim që ngjante me atë zë – zëri këndoi:

Ndën gështenjën degëgjerë
Ti shite mua unë shita ty...

Iu mbushën sytë me lotë. Kamarieri që kaloi aty vuri re se gota e tij ishte bosh dhe u kthye me një shishe xhini.

Ngriti gotën dhe e nuhati. Pas çdo gllënjke pija bëhej gjithnjë e më e pështirë. Por ishte kthyer në elementin themelor.

Ishte jeta, vdekja dhe ringjallja e tij. Xhini ia mpinte trurin çdo darkë dhe xhini e gjallëronte çdo mëngjes. Kur zgjohej, rrallë para orës njëmbëdhjetë, me qepallat të ngjitura, me gojën të tharë, me shpinën si të shkërmoqur, ishte e pamundur të ngrihej edhe përgjysmë, sikur, tek koka e krevatit, të mos rrinte gjatë natës shishja e xhinit dhe filxhani. Me fytyrën pa shprehje, ditën e kalonte me shishe në dorë dhe duke dëgjuar tele-ekranin. Nga ora tre mbasdite deri sa mbyllej, ai ishte orendi e *Gështenjës.* Askush nuk e çante më kokën se me se merrej, asnjë tingull nuk e ngacmonte, asnjë tele-ekran nuk e qortonte. Herë pas here, ndoshta dy herë në javë, shkonte në zyrën e tij të pluhurosur dhe të harruar në Ministrinë e së Vërtetës dhe bënte ndonjë punë, ose atë çfarë quhej punë. Ishte zgjedhur në një nënkomitet të një nënkomiteti që mugullonte nga njëri prej komiteteve të shumta të cilët merreshin me probleme të vogla që dilnin nga hartimi i Botimit të Njëmbëdhjetë të Fjalorit të Gjuhës së Re. Ishin të zënë me hartimin e diçkaje të quajtur Relacion Provizor, por se për se bënte fjalë ky relacion Uinstoni nuk e mori vesh kurrë me saktësi. Diçka që kishte të bënte me faktin nëse presjet duhet të vendoseshin brenda apo jashtë kllapave. Komiteti kishte edhe katër vetë të tjerë, edhe ata të ngjashëm me të. Kishte ditë kur mblidheshin dhe menjëherë shpërndaheshin, ndërsa pranonin me sinqeritet se nuk kishin çfarë të bënin. Por kishte edhe ditë të tjera kur gjakonin t'ia nisnin punës, duke harxhuar çdo minutë që kishin në dispozicion për të hartuar memorandume të gjata të cilët mbeteshin pa u mbaruar kurrë sepse diskutimi për të cilin ata bënin fjalë fillonte të bëhej tmerrësisht i ngatërruar dhe i komplikuar, nuk binin dakort për përkufizimet e fjalëve, shmangeshin tërësisht nga tema, grindeshin, madje edhe kërcënonin për t'u ankuar tek autoritetet më të larta. Mandej jeta arratisej prej tyre dhe uleshin rrotull tavolinës duke vështruar njëri-tjetrin me sytë pa jetë, si fantazmat që shuhen me rënien e ditës.

Tele-ekrani ra në qetësi për një çast. Uinstoni ngriti kokën sërish. Lajmet! Por jo, thjesht u ndryshua muzika. Hartën e Afrikës e përfytyroi si ta kishte para syve. Lëvizja e ushtrive ishte një

diagram, një shigjetë e zezë që ecte drejt jugut dhe një shigjetë e bardhë që fluturonte drejt lindjes, sipër bishtit të së parës. Si për t'u siguruar Uinstoni hodhi sytë nga fytyra e qetë në portret. A mund të mendohej që shigjeta e dytë ishte pjellë e fantazisë?

E largoi sërish vëmendjen nga lajmet. Ktheu një gllënjkë tjetër nga xhini, kapi kalin e bardhë dhe tentoi një lëvizje tjetër. Sheh. Por dukej që nuk ishte lëvizja e duhur sepse...

Një kujtim iu shfaq në mënyrë të pavullnetshme. Pa një dhomë të ndriçuar me qiri, një krevat me mbulesë të bardhë dhe veten, nëntë ose dhjetë vjeç, ulur në dysheme, duke tundur një kuti zaresh dhe duke qeshur i lumtur. Nëna ishte ulur përballë tij, edhe ajo qeshte.

Kishte ndodhur gati një muaj para se të zhdukej nëna e tij. Ishte një çast pajtimi, kur uria grindavece në stomakun e tij ishte shuar dhe kur ishte rikthyer dashuria për të ëmën. I kujtohej shumë mirë ajo ditë, me shiun që derdhej me gjyma, parvazët që përcillnin rrëke dhe errësirë në dhomën ku drita e qiririt nuk mjaftonte për të lexuar. Mërzia e dy fëmijëve në errësirë në dhomën e vogël u bë e padurueshme. Uinstoni kuiste, grindej, kërkonte bukë me kohë e pa kohë, vraponte nëpër dhomë duke shkulur dhe lëvizur prej vendit gjithçka, shkelmonte veshjet prej druri derisa fqinjët i binin murit nga ana tjetër, ndërsa motra më e vogël qante herë-herë. Më në fund nëna i kishte thënë: "Sillu mirë që të të blej një lodër. Një lodër të mrekullueshme – që do të të pëlqejë", dhe kështu kishte shkuar nëpër shi tek kioska që vazhdonte të hapej herë pas here dhe ishte kthyer me një kuti kartoni me pjesët e lojës Gjarpërinjtë dhe Shkallaret[1] brenda. E kishte të freskët ende aromën e kartonit të lagësht. Pjesët e lojës qenë si mos më keq. Fusha qe e krisur ndërsa zaret qenë prerë aq keq saqë ishte e vështirë të gjeje në to një faqe të sheshtë. Uinstoni e vështoi lodrën pa qejf. Atëherë nëna ndezi një copë

---

1 - Lojë tavoline shumë e përhapur, në të cilën, mbas hedhjes së dy zareve, lojtarët lëvizin gurët në fushë (e ngjashme me një fushë shahu) derisa të arrijnë një sasi të caktuar pikësh. Nëse gjatë lëvizjeve të tyre hasin shkallë – ngjiten; po të ndeshin gjarpërinj, zbresin përsëri. (shën. përkth)

qiri dhe ata u ulën në dysheme të luanin. Shumë shpejt ai u dha pas lojës dhe qeshte me të madhe, ndërsa shikonte gurët me ngjyra që ngjiteshin shkallareve dhe zbrisnin, me rrëshqitje, mes gjarpërinjve pothuajse te pika e fillimit. Bënë tetë lojë, duke fituar katër secili. Motra imcake, shumë e vogël për ta kuptuar lojën, kishte qëndruar gjatë gjithë kohës mbështetur pas një jastëku dhe duke qeshur ngaqë edhe të tjerët qeshnin. Gjithë atë mbasdite qenë të lumtur, si gjatë gjithë fëmijërisë së tij të hershme.

E largoi mendjen nga ajo ngjarje. Ishte një kujtim i rremë. Kujtimet e rreme e shqetësonin kohë pas kohe. Kur e dije se çfarë ishin nuk kishin kurrfarë rëndësie. Disa gjëra kishin ndodhur, disa jo. U rikthye tek fusha e shahut dhe mori sërish kalin e bardhë. Gati në të njëjtin çast kali i ra nga dora në fushë duke kërcitur. U tremb sikur ta kishte shpuar dikush me gjilpërë.

E çjerra e një borie i shpoi veshin. Ishin lajmet! Fitore! Kur lajmet parapriheshin nga boria kjo lajmëronte fitore. Gjithë kafenenë e përfshiu një drithërimë elektrike. Boria kishte trembur edhe kamarierët që nisën t'i bëjnë veshët pipëz.

Boria lëshonte një tingull shurdhues të lartë. Në tele-ekran kishte nisur të llomotiste një zë i lumtur, por ende pa filluar e mbyti gumëzhima entuziaste nga jashtë. Lajmi ishte përhapur nëpër rrugë si me magji. Uinstoni dëgjoi vetëm aq sa mjaftonte për ta kuptuar se kishte ndodhur ashtu siç e kishte parashikuar ai: një armatë detare e grumbulluar në fshehtësi, një sulm kundër armikut me shpinëmarrje, shigjeta e bardhë duke fluturuar drejt bishtit të shigjetës së zezë. Fragmente frazash ngadhnjimtare mundoheshin të çanin mes zhurmës: një manovër strategjike në shkallë të gjerë – koordinim i përsosur – shkatërrim tërësor – gjysmë milionë robër – demoralizim tërësor – kontroll të të gjithë Afrikës – e bën edhe më të afërt fundin e luftës – fitore – fitorja më e madhe në historinë e njerëzimit – fitore, fitore, fitore!

Këmbët e tij dridheshin poshtë tavolinës. Nuk kishte lëvizur nga vendi, por, me mendje, ishte duke vrapuar, vraponte nëpër rrugë, në mes të turmave përjashta, duke brohoritur me sa fuqi që kishte. Vështroi portretin e Vëllait të Madh sërish. Kolosi që

kalëronte botën! Shkëmbi pas të cilit thyenin kokën hordhitë e Azisë! Solli ndërmend sesi dhjetë minuta të shkuara – po, vetëm dhjetë minuta – në zemrën e tij, ndërsa vriste mendjen nëse lajmi do të sillte fitoren apo humbjen, kishte patur dyshime. Ah, ishte zhdukur diçka më shumë se ushtria euroaziatike! Qysh prej ditës së parë në Ministrinë e Dashurisë tek ai kishin ndryshuar shumë gjëra, por ndryshimi shërues, përfundimtar dhe i domosdoshëm, si kurrë më parë, ndodhi atë çast.

Zëri nga tele-ekrani ishte duke derdhur përrallën me robërit, trofeun material, kasaphanën, ndërsa britmat në rrugë ishin qetësuar disi. Kamarierët po ktheheshin në punë. Njëri prej tyre u afrua me shishen e xhinit. Uinstoni, i humbur në një ëndërr të lumtur, nuk i kushtoi vëmendje ndërsa kamarieri i mbushte gotën. Nuk vraponte apo brohoriste më. Ishte kthyer në Ministrinë e Dashurisë, gjithçka e falur, me shpirtin të bardhë si dëbora. Ndodhej në bankën e gjyqeve publike, duke pranuar gjithçka, duke implikuar kë të mundej. Ishte duke ecur përgjatë korridorit me pllaka të bardha, me ndjesinë e shëtitjes në diell, i ndjekur nga një gardian i armatosur. Plumbi i pritur prej kohësh po i depërtonte në tru.

Vështroi fytyrën e stërmadhe. Iu deshën dyzet vjet të mësonte se çfarë lloj buzëqeshjeje ishte fshehur poshtë mustaqeve të zeza. O keqkuptim mizor, i panevojshëm! O arratisje, kokëfortë dhe e vetkërkuar, nga gjoksi i dashur! Dy pika loti me aromë xhini rrëshqitën në të dy anët e hundës. Gjithçka në rregull, gjithçka në rregull, përpjekja kishte marrë fund. Kishte fituar mbi veten. E donte Vëllain e Madh.

Fund

SHTOJCË

Parimet e Gjuhës së Re

Gjuha e Re ishte gjuha zyrtare e Oqeanisë dhe ishte hartuar që të plotësonte nevojat ideologjike të Anglosocit, ose Socializmit Anglez. Në vitin 1984 nuk kishte njeri që e përdorte Gjuhën e Re si mjetin e vetëm të komunikimit, qoftë për të folur, qoftë për të shkruar. Artikujt kryesorë të gazetës *Times* qenë shkruar në Gjuhën e Re, por kjo ishte veç një *tour de force* që mund të realizohej vetëm nga specialistët. Parashikohej që deri në vitin 2050 Gjuha e Re të flitej më shumë se e folmja e vjetër (ose anglishtja standarte, siç duhet ta quajmë). Ajo fitonte terren në mënyrë të qëndrueshme. Gjithnjë e më tepër, në bisedat e përditshme, anëtarët e Partisë qenë të prirur të përdornin fjalë dhe forma gramatikore të Gjuhës së Re. Versioni që përdorej në vitin 1984, i përfshirë në Botimin e Nëntë të Fjalorit të Gjuhës së Re, ishte i përkohshëm dhe kishte shumë fjalë dhe forma të tepërta të cilat do të hiqeshin më vonë. Në këtë shtojcë flitet vetëm për Botimin e Njëmbëdhjetë të Fjalorit, varianti më i përsosur dhe përfundimtar.

Qëllimi i Gjuhës së Re nuk ishte vetëm ofrimi i një mjeti për të shprehur pikëpamjet mbi botën dhe zakonet mendore të përshtatshme për të përkushtuarit e Anglosocit, por edhe të bënte të pamundur mënyrat e tjera të mendimit. Synohej që kur Gjuha e Re të qe përshtatur njëherë e përgjithmonë, ndërsa e folmja e vjetër të qe harruar, do të ishte e pamundur që të kishte mendime heretike – mendime të kundërta me parimet e Anglosocit – të

paktën mendime që kërkonin përdorimin e fjalëve. Fjalori i saj ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që të jepte kuptimin e saktë dhe here-herë shprehje shumë të detajuara të cilat do të përdoreshin nga çdo anëtar i Partisë, duke përjashtuar gjithë mendimet e tjera dhe mundësitë e mbërritjes te këto mendime me metoda jo të drejtpërdrejta. Kjo qe arritur pjesërisht me shpikjen e fjalëve të reja, por kryesisht me anë të eleminimit të fjalëve me kuptime të rrezikshme dhe, brenda mundësive, pastrimin e fjalëve të mbetura nga mendimet dytësore të çdo lloji. Për shembull: fjala *i/e lirë* vazhdonte të ishte edhe në Gjuhën e Re, por mund të përdorej vetëm në kuptime të tilla si "kjo rrugë është e lirë". Kjo fjalë nuk mund të përdorej në kuptimin e vjetër të të qenit "politikisht i lirë" ose "intelektualisht i lirë", ngaqë liria politike dhe intelektuale nuk ekzistonin as si koncepte, dhe për rrjedhojë kishin mbetur pa emra. Përveç heqjes së fjalëve tërësisht heretike, shkurtimi i fjalorit konsiderohej si një qëllim më vete, ndërsa kur kishte fjalë mungesa e të cilave nuk prishte punë, atëherë hiqeshin. Gjuha e Re ishte planifikuar jo që ta shtonte llojshmërinë e mendimit, por ta zvogëlonte, dhe ky objektiv realizohej duke pakësuar fjalët sa më shumë të qe e mundur.

Gjuha e Re kishte si bazë anglishten e sotme, por shumë fjali të saj, të cilat edhe mund të mos jenë fjalë të krijuara së fundi, do të ishin shumë të vështira për t'u kuptuar nga një folës i anglishtes së ditëve tona. Fjalët qenë ndarë në tre grupe të veçanta të cilat njiheshin si: grupi A, grupi B, grupi C (të quajtura edhe fjalë të përbëra). Do të ishte më lehtë të diskutonim çdo grup veçmas, por karakteristikat e gjuhës do të trajtohen në pjesën kushtuar grupit A, ndërkohë që për të gjitha kategoritë përdoren të njëjtat rregulla.

Grupi A. Tek A-ja futen fjalët që përdoren në punët e përditshme – si ngrënia, pirja, puna, veshja, ngjitja dhe zbritja e shkallëve, lëvizjet me makina, mirëmbajtja e kopshtit, gatimi, e gjëra të ngjashme. Grupi A përbëhej pothuajse vetëm nga fjalë që i kemi patur në përdorim – për shembull, *gjuaj, vrapoj, qen, pemë, sheqer, shtëpi, fushë* – por, në krahasim me fjalorin e anglishtes

së sotme, numri i tyre ishte tejet i vogël, ndërsa kuptimet të përcaktuara me rreptësi. Paqartësitë dhe hijet kuptimore qenë pastruar. Me aq sa mund të arrihej, një fjalë e këtij grupi ishte një tingull më vete që shprehte *një* kocept lehtësisht të kuptueshëm. Përdorimi i fjalëve të grupit A për qëllime letrare ose biseda politike dhe filozofike ishte i vështirë. Me atë grup synohej të shpreheshin vetëm mendime të thjeshta të cilat zakonisht kishin të bënin me objekte konkrete ose veprime të natyrës fizike.

Gramatika e Gjuhës së Re kishte dy karakteristika themelore. E para ishte ndërkëmbimi pothuajse tërësor i pjesëve të ndryshme të ligjëratës. Çdo fjalë (në parim kjo cilësi ishte e përshtashme edhe për fjalë tejet abstrakte si *nëse* apo *kur*) mund të përdorej si folje, emër, mbiemër dhe ndajfolje. Mes foljes dhe emrit, kur kishin të njëjtën rrënjë, nuk kishte ndryshim, ky rregull shkatërronte shumë fjalë arkaike. Për shembull, në Gjuhën e Re nuk ekzistonte fjala *mendim*. Në vend të saj përdorej fjala *mendoj*, edhe si folje edhe si emër. Këtu nuk ndiqej asnjë parim etimologjik: për t'u mbajtur mend në disa raste përdorej emri, në raste të tjera folja. Madje edhe kur një emër dhe një folje e ngjashme nuk qenë të lidhura etimologjikisht, njëra prej tyre do të hiqej. Për shembull, fjala *pres* ishte hequr dhe rolin e saj e luante fjala, emër dhe folje, *thikë*. Mbiemrat krijoheshin duke i shtuar fjalës, që ishte edhe folje edhe emër, prapashtesën *isht* dhe ndajfoljet duke shtuar prapashtesën *shëm*. Përshembull, *vrapisht* do të thoshte "i shpejtë", ndërsa *vrapshëm* do të thoshte "nxitimthi". Disa nga mbiemrat e sotëm si për shembull, *i/e mirë, i/e fortë, i madh/e madhe, i zi/e zezë, i/e butë*, qenë ruajtur, por ishin shumë të paktë. Ndërsa nuk ishte ruajtur asnjë nga ndajfoljet e ditëve tona, me përjashtim të atyre që mbaronin me *shëm*, prapashtesa *shëm* qe e pandryshueshme. Për shembull, ndajfolja *mirë* qe zëvendësuar nga fjala *mirshëm*.

Çdo fjalë – edhe ky parim ishte i vlefshëm për të gjitha fjalët e gjuhës – mund të bëhej negative duke i shtuar parashtesën *jo*, ose mund të forcohej duke shtuar parashtesën *mbi*, ose mund të përforcohej edhe më tej, me *edhe*. Për shembull, *joftohtë* kishte kuptimin *ngrohtë*, ndërsa *mbiftohtë* dhe *edhembiftohtë*

kishin kuptimet "shumë ftohtë" dhe "jashtëzakonisht ftohtë". Ndërkohë, ashtu si edhe në gjuhën e sotme, që - duke përdorur parashtesa si *kundër, pas, lart, poshtë* – qe e mundur t'i modifikoje pothuajse kuptimin çdo fjale. Këto metoda bënin të mundur sjelljen në gjuhë të një fjalori të bollshëm. Për shembull, në qoftë se marrim fjalën *i/e mirë,* nuk kishte nevojë për fjalët *i keq/e keqe* përderisa kuptimi i kërkuar jepej njëlloj – madje edhe më mirë – nga fjala *i/e jomirë.* Në qoftë se dy fjalë formonin një çift natyral të kundërtash, e vetmja gjë që nevojitej ishte marrja e vendimit se cila prej tyre do të hiqej. *Errësirë,* për shembull, mund të zëvendësohej nga *jodritë,* ose *dritë* nga *joerrësirë,* varej nga parapëlqimi.

Karakteristika e dytë themelore e gramatikës së Gjuhës së Re ishte rregullsia e saj. Përveç disa përjashtimeve që përmenden më poshtë, eptimet ndodhin në përputhje me të njëjtat rregulla. Koha e shkuar e largët dhe pjesorja e shkuar ishin të njëjta dhe mbaronin me ur. E kryera e thjeshtë e foljes *vrapoj* ishte *vrapur,* e *mendoj* ishte *mendur* e kështu me radhë. Forma si *mësova, mendova, lexova, qesha, shkova* e të tjera ishin hequr. Shumësi merrte gjithmonë mbaresën *t* ose *të,* sipas rastit. Shumësi i *pemë, shtëpi, lopë, fëmijë,* ishte *pemët, shtëpitë, lopët, fëmijtë.* Shkallët e mbiemrit formoheshin duke shtuar *të* ose *test* (i/e mirë, i/e mirtë, i/e mirtest) ndërsa mënyra e krahasimit duke shtuar *më* (i/e mirë) ose *shumë* (i/e mirë) ishte hequr.

Të vetmit grupe fjalësh të cilëve u lejohej të ndryshonin vazhdimisht ishin përemrat, lidhëzat, mbiemrat dëftorë dhe foljet ndihmëse. Të gjitha këto përdoreshin po ashtu si në të shkuarën, me përjashtim të përemrit *cilin* që ishte hequr si i panevojshëm dhe trajta *do të* e kohës së ardhme që ishte shkurtuar në *do.* Kishte edhe disa parregullsi të cilat krijoheshin prej nevojës për një komunikim më të thjeshtë dhe më të shpejtë. Një fjalë që ishte e vështirë për t'u shqiptuar, ose e prirur të keqkuptohej kur dëgjohej, konsiderohej *ipso facto* fjalë e keqe: prandaj, për hir të bukurtingëllimit, herë pas here, fjalëve u shtoheshin shkronja të tjera ose ruhej forma e vjetër. Por kjo nevojë bie më shumë në sy në fjalët e grupit B. *Pse* i kushtohej

kaq shumë vëmendje një shqiptimi më të lehtë do të qartësohet më vonë në këtë ese.

Grupi B. Ky grup përfshinte fjalë të cilat ishin formuar me paramendim për qëllime politike: fjalë që jo vetëm kishin njëfarë nënkuptimi politik, por edhe që ishte patur parasysh, qysh në formimin e tyre, të impononin një lloj qëndrimi mendor tek personi që i përdorte. Përdorimi i saktë i këtyre fjalëve qe i vështirë në qoftë se nuk kuptoheshin mirë parimet e Anglosocit. Në disa raste mund të përktheheshin në të folmen e vjetër, ose në fjalë që bënin pjesë në grupin A, por kjo, zakonisht, kërkonte perifrazime të gjata dhe përherë shoqërohej me humbjen e nuancave kuptimore. Fjalët e grupit B, në të shumtën e rasteve, qenë një lloj stenografie gojore mendimesh të tëra të citosura në pak rrokje, dhe, në të njëjtën kohë, më të sakta dhe më bindëse se gjuha e zakonshme.

Të gjitha fjalët e grupit B ishin fjalë të përbëra.[1] Dy ose më shumë fjalë, ose pjesë fjalësh, të shkrira në një formë me shqiptim të lehtë. Produkti i kësaj shkrirje, si gjithmonë, ishte edhe folje edhe emër, dhe ndryshonte në përputhje me rregullat. Ja një shembull i vetëm: fjala *mirëmendim*, që, afërsisht, do të thoshte, "partishmëri", ose, në qoftë se do të përdorej si folje, "të mendosh me partishmëri". Kjo ndryshonte si më poshtë: emër dhe folje, *mirëmendoj*; koha e kryer e thjeshtë dhe, *mirëpasmenduar*, *mirëmendim*; mbiemër, *mirëmendishëm*; ndajfole, *mirëmendimisht*; emër foljor, *mirëmendues*.

Fjalët e grupit B nuk qenë formuar sipas ndonjë plani etimologjik.

Fjalët prej të cilave qenë sajuar mund të ishin çdo pjesë e ligjëratës, mund të vendoseshin në çdofarë radhe dhe mund të shkurtoheshin në gjithfarë mënyrash mjafton që të bëheshin më të thjeshta për t'i shqiptuar e ndërkohë të ishte e

1 - *Fjalët e përbëra si* flasshkruaj *i përkisnin fjalorit A, por këto ishin thjesht shkurtime të përshtatshme që nuk kishin ndonjë ngjyrim ideologjik të veçantë.*

lexueshme ende prejardhja. Për shembull tek fjala *krimmendoj* (mendimkriminal) fjala mendim vendosej e dyta, ndërsa tek fjala *mendopol* (Policia e Mendimit) ishte në fillim. Për shkak të vështirësisë së bukurtingëllimit, në grupin B kishte më shumë fjalëformime të parregullta se në grupin A. Për shembull, forma mbiemërore e *Minivër, Minipaq* dhe *Minidash* ishin *Minivisht, Minispisht, Minidisht,* vetëm sepse *–vërisht, – paqisht* dhe *– dashisht* ishin disi të vështira për t'u shqiptuar. Megjithatë, në parim, gjithë fjalët e grupit B mund të ndryshonin, të gjitha sipas të njëjtit rregull.

Disa fjalë të grupit B kishin kuptime tejet të ndërlikuara dhe ishin pothuajse të pakuptueshme për ata që nuk e zotëronin gjithë gjuhën. Ja një shembull me një fjali tipike nga editoriali i gazetës *Times*: "Vjetërmendimtar jobarkndjej Anglosoc". Përkthimi më i shkurtër i mundshëm i kësaj fjalie në të folmen e vjetër është: "Ata, mendimet e të cilëve u formuan para Revolucionit, nuk mund t'i kuptojnë emocionalisht parimet e Socializmit Anglez". Por edhe ky nuk është përkthim i mjaftueshëm. Së pari, duhet thënë se për ta rrokur të plotë kuptimin e fjalisë në Gjuhën e Re të cituar më sipër, duhet patur një idē e qartë se çfarë do të thotë *Anglosoc*. Më tej, vetëm një person i rrënjosur në Anglosoc mund të shijojë gjithë fuqinë e fjalës *barkndjej*, e cila kumton miratim entuziazt dhe të verbër – i vështirë për t'u imagjinuar në ditët e sotme; ose fjala *vejtërmendimtar* e cila qe e lidhur në mënyrë të pazgjithshme me nocionet poshtërsi dhe dekadencë. Megjithatë, cilësia kryesore e disa fjalëve të Gjuhës së Re, njëra prej të cilave ishte edhe *vjetërmendimtar*, nuk ishte shprehja e kuptimeve të caktuara, por shkatërrimi i tyre. Kuptimet e këtyre fjalëve, domosdoshmërisht të pakta në numër, ishin zgjeruar aq shumë derisa përfshinin në vetvete një zinxhir të pafundmë fjalësh të cilat, meqë përfaqësoheshin plotësisht nga një term i kuptueshëm, tashmë mund të flakeshin në harresë. Vështirësia më e madhe me të cilën u përballën hartuesit e Fjalorit të Gjuhës së Re nuk ishte shpikja e fjalëve të reja, por që, pasi i shpiknin, të ishin të sigurt për kuptimin e tyre: të mbanin mend se cilët zinxhirë fjalësh kishin fshirë nga ekzistenca.

Siç e kemi parë tashmë në rastin e fjalës *i/e lirë*, fjalët që dikur kishin patur kuptim heretik vazhdonin të ekzistonin, por të pastruara nga kuptimet e padëshirueshme. Një pafundësi fjalësh të tjera si *nder, drejtësi, internacionalizëm, demokraci, shkencë* dhe *fe*, nuk ekzistonin më. Kuptimet e tyre i mbulonin një grup fjalësh, dhe, duke i mbuluar, i zhduknin krejt. Për shembull, gjithë fjalët e grupuara rreth koncepteve *liri* dhe *barazi*, përmblidheshin në një fjalë të vetme, *krimmendoj*, ndërsa gjithë fjalët e grupuara rreth konceptve *objektivitet* dhe *racionalitet* përmblidheshin në fjalën *vjetërmendoj*. Një saktësi më e madhe do të kishte qenë e rrezikshme. Nga anëtarët e Partisë kërkohej një këndvështrim i përafërt me atë të çifutëve të vjetër që, edhe pse nuk shquheshin për dije, qenë të bindur se gjithë popujt, përveç popullit të tyre, adhuronin "zota të rremë". Çifutët s'kishin nevojë të dinin se këta zota quheshin Baal, Osiris, Molok, Astarot, e me radhë: ndoshta sa më pak dinin aq më mirë ishte për përkushtimin ndaj zotit të tyre. Njihnin Jehovain dhe urdhrat e Jehovait dhe kështu e dinin që gjithë zotat me emra dhe cilësi të tjera ishin të rremë. Gati në të njëjtën mënyrë, anëtarët e Partisë e dinin cilët ishin elementët e një sjellje të mirë, dhe në mënyrë tejet të paqartë dhe të përgjithshme, i njihnin llojet e devijimit prej saj. Për shembull, jeta seksuale e tyre ishte rregulluar vetëm nga dy fjalë të Gjuhës së re, *sekskrim* (imoralitet seksual) dhe *mirëseks* (dëlirësi). *Sekskrim* mbulonte gjithë sjelljet seksuale jashtë normës. Mbulonte kurvërinë, tradhtinë bashkëshortore, homoseksualitetin dhe devijime të tjera, si dhe nuk duhet harruar: iterkursin që bëhej vetëm për kënaqësi. Nuk qe nevoja që këto dukuri të përmendeshin një e nga një sepse të gjitha ishin faje të së njëjtës shkallë dhe, në parim, të gjitha të dënueshme me vdekje. Në grupin C, që përbëhej nga fjalë shkencore dhe teknike, mund të lindte nevoja që shkarjeve seksuale t'u jepeshin emra të caktuar, por këto nuk i hynin në punë qytetarit të thjeshtë. Ai e dinte se ç'kuptim kishte fjala *mirëseks* – që do të thoshte interkurs normal midis burrit dhe gruas duke patur si qëllimin të vetëm lindjen e fëmijëve dhe që gruaja të mos përjetonte kënaqësi fizike, e kundërta konsidorehej *sekskrim*. Ndërkohë, në Gjuhën e Re ekzistonte mundësia që ta

ndiqje një mendim të ndaluar përtej kufirit të lejuar, por përtej kësaj pike nuk ecej më sepse nuk ekzsitonin fjalët e nevojshme.

Në grupin B nuk kishte asnjë fjalë ideologjikisht asnjanëse. Shumë prej tyre ishin eufemizma. Për shembull, *kamphareje* (kamp me punë të detyruar) ose *Minipaq* (Ministri e Paqes, ndryshe: Ministria e Luftës) kishin kuptim krejt të kundërt nga përshtypja që linin së jashtmi. Ndërsa disa fjalë të tjera ishin më dorëlëshuara në përçimin e imazhit të natyrës së vërtetë të shoqërisë oqeanike. Për shembull, fjala *proleushqej*, që nënkuptonte argëtimin mjeran dhe lajmet e gënjeshtërta që Partia u ofronte masave popullore. Disa fjalë të tjera ishin të ndërlikuara në përdorim sepse, kur përdoreshin në lidhje me Partinë merrnin ngjyrim "pozitiv", ndërsa kur përdoreshin në lidhje me armikun merrnin ngjyrim "negativ". Ndërkohë që kishte edhe një numër të madh fjalësh të cilat me vështrim të parë dukeshin si shkurtime dhe e merrnin ngjyrimin ideologjik jo nga kuptimi, por nga struktura e tyre.

Me aq sa qe e mundur, çdo fjalë që kishte ose mund të kishte domethënie politike të çfarëdolloji ishte futur në grupin B. Emri i çdo organizate, grupi njërëzish, doktrine, institucioni, ose ndërtese publike, sipas rastit, shkurtohej deri sa merrte në një formë të pranueshme: një fjalë e vetme lehtësisht e shqiptueshme, me numrin më të vogël të mundshëm të rrokjeve pa i humbur gjurmët e burimit fillestar. Për shembull, Drejtoria e Arkivave në Ministrinë e së Vërtetës, vendi ku punonte Uinstoni, quhej *Drejark*, Drejtoria e Trillimeve quhej *Drejtrill*, Drejtoria e Tele-programeve quhej *Drejtel*, e kështu me radhë. Kjo nuk bëhej vetëm për të kursyer kohë. Shkurtimi i fjalëve kishte qenë karakteristikë e gjuhës politike në dekadat e para të shekullit të njëzetë, dhe, sipas vëzhgimeve, kishte rezultuar që vendet të cilat qenë më të prirura të përdornin shkurtime ishin vendet diktatoriale. Për shembull, *Nazizëm, Gestapo, Komintern, Inmprekor, Agitrop*. Fillimisht kjo praktikë qe huazuar në mënyrë instiktive, ndërsa në Gjuhën e Re ishte bërë në mënyrë të ndërgjegjshme. Mendohej se duke shkurtuar emrin zvogëlohej shumica e asosacioneve ndërkohë që ngushtohej dhe, pa u kuptuar, ndryshohej kuptimi i fjalës. Fjala *Komunizmi internacional*, për shembull, ndillte përfytyrimin

e vëllazërimit njerëzor universal, flamurët e kuq, barrikadat, Karl Marksin, dhe Komunën e Parisit. Ndërsa fjala *Komintern* të lë përshtypjen e një organizate të bashkuar fort me një doktrinë të përkufizuar qartë. Ajo ka lidhje me diçka e cila mund të dallohet si një send i thjeshtë, karrige për shembull, dhe po kaq i kufizuar edhe në funksion. *Komintern* është një fjalë që mund të shqiptohet pothuajse pa u menduar fare, ndërsa *Komunizmi Internacional* është një fjalë për të cilën, qoftë edhe shumë pak, duhet të mendohesh. Në po këtë mënyrë, asosacionet që ndjell fjala *Minvër* janë më të pakta dhe më të kontrollueshme sesa ato që ndjell togfjalëshi *Ministria e së Vërtetës*. Kjo shpjegonte jo vetëm zakonin për të bërë shkurtime kudo që ishte e mundur, por edhe kujdesin e tepërt që tregohej për ta lehtësuar shqiptimin e çdo fjale.

Në Gjuhën e Re, pas saktësisë kuptimore të fjalës, bukurtingëllimi ishte cilësia që i kushtohej më tepër rëndësi. Përherë, rregullsia e gramatikës sakrifikohej për hir të tij. Dhe me të drejtë, sepse kërkoheshin, para së gjithash për qëllime politike, fjalë të shkurtra, me kuptim tejet të qartë, që shqiptoheshin me shpejtësi, dhe që ndillnin minimumin e mundshëm të asosacioneve në mendjen e folësit. Madje fjalët e grupit B bëheshin më të fuqishme prej faktit që ishin shumë të ngjashme me njëra-tjetrën. Pothuajse pa asnjë ndryshim, këto fjalë – *mirëmendim, Minipaq, proleushqim, sekskrim, kamphareje, Anglosoc, mendopol,* dhe shumë të tjera – ishin fjalë me tre ose katër rrokje, me theksin rregullisht në rrokjen e parë dhe të dytë. Përdorimi i tyre e kthente ligjërimin në një llomotitje me shkëputje dhe monotone. Pikërisht këtu synohej, që ligjërimi – veçanërisht ligjërimi ideologjikisht i njëanshëm – të fitonte sa më shumë pavarësi të qe e mundur prej vetëdijes. Padyshim që në jetën e përditshme ishte e nevojshme, ose ishte e nevojshme herë pas here, të mendoheshe para se të flisje, mirëpo një anëtar i Partisë, i caktuar të jepte një gjykim politik apo etik, duhet të ishte në gjendje të jepte mendimet e sakta me ritmin që automatiku lëshon plumbat me breshëri. Ai ishte i përgatitur për këtë, gjuha i ofronte një instrument që e ruante nga gabimet,

ndërsa struktura e fjalëve – me tingujt e ashpër dhe shëmtinë e qëllimshme, që ishin në harmoni me shpirtin e Anglosocit – e ndihmonin procesin edhe më.

Të njëjtin efekt kishte edhe fakti që dallimi nga njëra fjalë në tjetrën ishte i kufizuar. Krahasuar me gjuhën tonë, fjalori i Gjuhës së Re ishte i vogël, ndërkohë që mënyrat për ta zvogëluar më tej shtoheshin. Fakti që fjalori i saj në vend që të pasurohej tkurrej gjithnjë e më tepër, vit pas viti, e bënte Gjuhën e Re të ndryshme nga të gjitha gjuhët. Tkurrja ishte përfitim, ngaqë, sa më e vogël bëhej mundësia për të zgjedhur fjalët, aq më e vakët ishte dëshira për të menduar. Shpresohej se një ditë do të ishte e mundur që njerëzit t'i nxirrnin fjalët drejt nga laringu, pa qenë e nevojshme të përdornin qendrat e epërme të trurit. Ky objektiv ishte pranuar me sinqeritet me një fjalë të Gjuhës së Re që quhej *rosëfolme* e cila do të thoshte "të përkuleshe si rosë". Si shumë fjalë të tjera të grupit B, edhe fjala *rosëfolme* kishte kuptim të dyfishtë. Por, në qoftë se mendimet që shprehte ishin në përputhje me vijën e Partisë, atëherë ajo nënkuptonte vetëm lavdërime, ndërsa kur ndonjë orator i Partisë cilësohej në gazetën *Times* si *dyfishmëmirë rosëfolës* kjo frazë ishte një kompliment i çmuar.

Grupi C. Krahasuar me grupet e tjera, grupi C ishte shtojcë e tyre dhe kryesisht përbëhej nga fjalë shkencore e teknike. Këto fjalë ngjanin me termat e sotëm dhe dilnin nga e njëjta rrënjë, por, kuptohet, që ishte treguar kujdesi i zakonshëm për t'i përkufizuar me rreptësi dhe për t'i pastruar nga kuptimet e padëshiruara. Ato ndiqnin të njëjtat norma gramatikore si edhe fjalët e dy grupeve të tjera. Shumë pak prej fjalëve të grupit C mund të gjendeshin qoftë në bisedat e përditshme qoftë në ligjëratat politike. Çdo punëtor shkencor ose teknik i gjente gjithë fjalët që i duheshin në listën kushtuar profesionit të vet, ndërsa njohja e fjalëve në listat e tjera ishte shumë e përciptë. Listat kishin shumë pak fjalë të përbashkëta, ndërsa nuk kishte fjalë që të shprehte funksionin e shkencës si një proces mendor, apo metodë mendimi, pavarësisht degëve të saj të veçanta. Në

të vërtetë, fjala "shkencë" nuk ekzistonte fare, dhe çdo kuptim i mundshëm për t'u njohur mbulohej nga fjala *Anglosoc*.

Nga sa thamë më lart do të shohim se në Gjuhën e Re, deri në një nivel minimal, ishte e pamundur shprehja e mendimit jofanatik. Natyrisht, ekzistonte mundësia të përdorje shprehje heretike të çfarëdo lloji, madje edhe mund të blasfemoje. Për shembull, mund të thoje: *Vëllai i Madh është jomirë*. Kjo deklaratë, që për një vesh fanatik ishte veç absurditet i dukshëm, nuk mund të mbrohej me anë të arsyetimit sepse nuk ekzistonin fjalët e nevojshme. Idetë e kundërta me Anglosocin shfaqeshin vetëm në formë të mjegullt, pa fjalë, dhe përmblidheshin në një kuptim shumë të gjerë i cili përfshinte dhe dënonte, pa i përcaktuar veç e veç, grupe të tëra fjalësh heretike. Gjuha e Re mund të përdorej për qëllime armiqësore vetëm duke e përkthyer, fshehtaz, në të folmen e vjetër. Për shembull, *Gjithë njerëzit janë të barabartë* ishte një fjali e mund të përdorej edhe në Gjuhën e Re, por vetëm në kuptimin që kishte në të folmen e vjetër fjalia *Gjithë njerëzit janë flokëkuq*. Ajo nuk kishte asnjë gabim gramatikor, por shprehte diçka që nuk qe e vërtetë, që gjoja gjithë njerëzit ishin të barabartë në gjatësi, peshë, forcë. Koncepti i barazisë politike nuk ekzistonte më, kështu që fjala *barazi* ishte pastruar prej këtij kuptimi dytësor. Në 1984, kur e folmja e vjetër ishte ende gjuha normale e komunikimit, teorikisht ekzistonte rreziku që duke përdorur fjalë të Gjuhës së Re njerëzit mund të sillnin ndër mend kuptimin e tyre fillestar. Ndërsa në praktikë, për çdo person të miqësuar me mendimin e dyfishtë, nuk ishte shumë e vështirë të bëhej shmangia e duhur, ndërsa pas nja dy brezash, mundësia për gabime të tilla, do të zhdukej krejt. Një person që do të rritej me gjuhë të vetme Gjuhën e Re nuk do ta mësonte kurrë që, dikur, fjala *barazi* kishte patur edhe kuptimin e dytë "politikisht i/e barabartë", ose që fjala *i/e lirë* kishte patur kuptimin "i/e lirë intelektualisht" ose dikush që nuk kishte dëgjuar kurrë për shahun nuk do të dinte gjë për kuptimet e dyta të fjalëve *mbretëreshë* dhe *torre*. Do të kishte shumë krime dhe gabime që ky njeri nuk do të kishte mundësi t'i bënte vetëm ngaqë ato do të ishin pa emër e për rrjedhojë të papërfytyrueshëm. Parashikohej

që me kalimin e kohës karakteristikat dalluese të Gjuhës së Re do të thelloheshin gjithnjë e më tepër – fjalori do të vinte duke u zvogëluar në mënyrë progresive, kuptimet e fjalëve më të rrepta, dhe mundësia për t'i përdorur me sukses gjithmonë e më e brishtë.

Heqja tërësore nga përdorimi i të folmes së vjetër do të thoshte që kështu shkatërrohej përfundimisht edhe lidhja e fundit me të shkuarën. Tashmë historia ishte rishkruar, por nga letërsia e së shkuarës, natyrisht e censuruar keqaz, kishin mbetur ende fragmente të saj, të cilat, për sa kohë që njeriu do të njihte të folmen e vjetër, do të ishte në gjendje t'i lexonte. Në të ardhmen, edhe nëse mbijetonin, këto fragmente do të ishin të pakuptueshme dhe të papërkthyeshme. Përkthimi i materialeve nga e folmja e vjetër në Gjuhën e Re ishte diçka e pamundur, me përjashtim të materialeve teknike, ose të veprimeve shumë të thjeshta të përditshme, ose në qoftë se kishte prirje fanatike (mirëmendimisht do të ishte shprehja në Gjuhën e Re). Kjo do të thoshte që asnjë libër i shkruar, afërsisht, para vitit 1960 nuk mund të përkthehej i plotë. Ndërsa letërsia e pararevolucionit mund të përcillej vetëm duke iu nënshtruar përkthimit ideologjik – që do të thoshte: ndryshim kuptimi dhe gjuhe. Marrim për shembull fragmentin e mirënjohur nga Deklarata e Pavarësisë:

Ne i konsiderojmë si tejet të dukshme këto të vërteta: që të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë, që të gjithë janë pajisur nga krijuesi me disa të drejta të patjetërsueshme, dhe disa nga këto të vërteta janë: jeta, liria dhe kërkimi i lumturisë. Që qeveritë, pushteti i të cilave buron nga pëlqimi i atyre që qeverisen, krijohen të sigurojnë këto të drejta. Që, kurdoherë që një Qeveri nuk plotëson këto të drejta, atëherë është e drejta e Popullit ta ndryshojë ose rrëzojë dhe të vendosë një Qeveri të re...

Përkthimi i këtij fragmenti në Gjuhën e Re, duke ruajtur kuptimin e origjinalit, ishte diçka që s'bëhej. Më e shumta që mund të bëhej ishte që i gjithë paragrafi të gëlltitej nga një fjalë e vetme: krimmendoj. Përkthimi i plotë mund të ishte vetëm përkthim ideologjik me anën e të cilit, fjalët e presidentit Xheferson, do të ktheheshin në panegjirik për qeverinë.

Dhe me të vërtetë, shumica e letërsisë së të shkuarës e kishte pësuar tashmë një ndryshim të tillë. Për hir të krenarisë kombëtare dilte e nevojshme që disa figura të shquara të ruheshin, ndërkohë që veprat e tyre duhej të ishin në përputhje me parimet e Anglosocit. Disa shkrimtarë si Shekspiri, Miltoni, Suifti, Bajroni, Dikensi dhe të tjerë si këta, ishin duke u përkthyer: kur të mbaronte përkthimi, shkrimet e tyre origjinale dhe gjithçka tjetër që kishte mbijetuar nga letërsia e së shkuarës, do të shkatërrohej. Përkthimi ishte i vështirë dhe kërkonte kohë kështu që mendohej të mbaronte në dekadën e parë ose të dytë të shekullit të njëzetë e njëtë. Përveç kësaj lloj literature kishte edhe sasi të mëdha literature praktike – manuale teknike të domosdoshme e kësi gjërash – në pritje për t'iu nënshtruar të njëjtit proces. Për shkak të kohës që kërkonin gjithë këto përkthime paraprake, afati përfundimtar i futjes së Gjuhës së Re si gjuhë e vetme ishte caktuar viti 2050.

NË VEND TË PASTHËNIES

E parathëna: falli i fallit

Ninety Eighty-Four (subjekt bote 1984; objekt botim 1948).

Këmbim kah një parashikimi profetik. Dhe një kumbim gjithëpërfshirës, me jehonë shtrirë gjerë e gjatë në kohë e hapësirë.

Një roman apo një kritikë e totalitarizmit?

Lefor: 1984-a aq e famshme, mbetet ndërkohë gjithaq e panjohur për ata që e veçojnë pjesën e të qenit roman nga ajo e paraqitjes edhe si një kritikë e universit totalitar.

Gjithsesi, papërcaktueshmëria e një përgjigjeje të plotë do të ishte çelësi i leximit dhe kuptimit.

Atëherë, tash që gjithçka ka përfunduar (si histori e aktit të leximit e jo si lexim i aktit të historisë), le ta lemë gjuhën të shkojë ku dhemb dhëmbi... për t'u përqendruar nga ana e dhimbjes e përvojës sonë si autententike më shumë se sa te ambivalenca e shenjuesit orwellian lidhur me sisteme e regjime edhe të përkundërta.

1984. Kumbim profecie. Shqip - një përkim kryefund tragjik me kohën e tonit Vëlla i Madh përçor, tek zë e përçartet shtruar mu në bash të vendit, bash kur një farë Gjergj Oruelli nis të përçojë me fall gjithë ditarin utopik të kuvendit. Që në krye të erës së diktatit e gjer në duhmën funeste të tiranit. Si ka mundësi?!

Kuptoj si; nuk kuptoj përse! Dhe vërtet ashtu si ky Orwell, që i tromaksur nga teoria do të ketë preferuar kalimin te finksioni, po e

tentoj një qasje ndaj të pamundurës e të pavolitshmes përgjigje (ajo që e bën unik por dhe e çon në rrokulli Winstonin, është kërkimi i fundit të fundit, e siç e vërente Lefor, dëshira për të ditur përse), po e synoj, pra, duke iu besuar befasisë së një farë skenari, që më mbiu në kokë si nën dëshirën e pandashme nga ajo për të gjetur të shkuarën...

E ndjej paraprakisht se një i tillë imazh, i përkthyer në situatë parodike si më poshtë, rrezikon papëlqyeshmërinë letrare dhe etike, por do t'ishte e tepërt të shpjegohej, aq më tepër këtu, synimi i posaçëm sak për të mbërritur këtë:

Aty nga vitet tridhjetë, Oruelli ecejakej poshtë e përpjetë
"Pa një dyshkë nëpër Paris e Londër" siç e thotë veten te ky titull.
Si militant i bredhur, na qenkej takuar me Tarasin tonë rishtar në një
celulë përçimi të ideve kuqalashe të Kominternit ngadhnjimtar.
Të dy me prirje të thekëshme për fallxhorë, u bënë miq
tek i shtinin fall njëri-tjetrit orë e pa orë.
Tarasi i shihte filxhanin, ndërkaq, tjetri i ngjizte historinë
që mikut të ri, krejt si për çudi, po na i përshfaqej në dorë.
Shtangu ai, e u këndell për një çast kur anglezi po i shihte fallin, andaj
që ky të vijonte, i hodhi me kast nja dy kacidhe pse ia dinte tjetrit hallin.
Për dy franga dhe pa e bërë dysh, Oruelli fallxhor nis t'i kallë e kallëzojë
mbarë e prapë jetën që e priste, bukuroshit tonë të përkorë.
Pastaj e yshti që të mos e merrnin m'sysh për
fatin e lumë e për lumë që i pat kqyrur në dorë.
Ngurrur si një cung prej ngërçit, Oruelli paskej lexuar një tmerr
më të pështirat e historisë së njerëzisë: Legjendën e Përçit.
Pa e përçmuar rastin fatlum që i mbiu mu në dorë të mikut, shkruesi
na e hedh të zezën mbi të bardhë, dhe pastaj, si të ish vepër e tij
ia vërvit ai njerëzimit këtë soj historie cit me pabesi,
Mandej, me ndoca erëza pikante saksone, ia gatit botës mbarë
që mbarë bota ta gëlltitë si një Legjendë të Përçudnimit.

Me ta parë shfaqur në dorë të Tarasit, sikur në një film:
Njeriun Fringo, Ekranet, Gjuhën e Re, ardhmërinë e krejt mynxyrën
Oruellit s'do t'i duhej aq shumë marifet për ta shkruar një libër
dhe, kështusoj, për ta gjetur në një farë mënyre mënyrën.
Zëfilli e pat titulluar "Njeriu i fundmë në Evropë", pastaj e zuri
rrëfimin përfund dhe na e shpalli pagëzuar me një emër fundfalli
të numëruar - '84.
Njerëzia, që si gjithherë mezi shquan e nuk di se numri flet,
edhe sot e gjithë ditën e thërret libri i shekullit të njëzetë.
Mendimtarija e kohës e përqas Oruellin me Nostradamus
dhe për të kuptuar historinë e kësokohës librin e tij e mban për kyç.
Por historia e dy militantëve rishtarë krejt ndryshe na paskej qenë
si në një lojë bizare të lojtur zaresh në kartonin katror për yç.
Kështu, Tarasi i posanxënë me destinin e ri, tanimë e dinte
tërë ç'do bënte vaki, ç'prej kreut e gjer në fund
pse na e paskish patur kryekreje të parathënë.
Në këmbim të ndonjë napoloni flori, Oruelli shtrëngohej
të dëgjonte edhe turpe e paudhësira nga Tarasi i panginjur.
Baba Çeni, pajtor i këtij të fundit, edhe ato dy grosh që kish,
ia dërgonte nipit të bënte shkollë të madhe, por ky i uruar, si dëshmi
dëftese kolegji, i niste ungjit pakopostale çmimet e sallatrave ruse
të një menuje nga gjelltoret e lagjeve të Parisit, që Çeni i gjorë
i hante si nota për t'u lëvduar.
Një plak, më i kënduari në sokak, i dëftoi Baba Çenit se dëftesa e nipit,
ku shkruhej Universi i Pede... (pjesa e dëmtuar e palexueshme mbet
e pakuptuar, dhe lexohet siç rastis) s'ish tjetër veç fletushkë rasti e
ndonjë klubi nate, ku notat e larta gjer më 30 qenkëshin centimetra
fallike, pa asnjë lidhje me shkollën superiore Pedagogjike, që çaprazte
i paudhi Taras në gënjeshtrën e sajuar.
Baba Çeni jepte e merrte me mendje pa i bërë bisht, të kuptonte
nëse nipi përnjëmend: e jepte apo e merrte!
Porse, nuk i dilte hiç hesapi se qysh e përse nipi i prapë,

qoftë kur e jepte, qoftë në e merrte, prapëseprapë paguante ai sërish.
Përkthyesi bënte be e rrufe se as atij vetë s'ia rrokte mendja, ngaqë
në perëndim shpërblimi i harbimit është ca i koklavitur.
Një rast pedagogjik që s'mund të mbahej dot vetëm me logjik.
Baba Çenit, megjithatë, i dhimbsej aq shumë nipi.
Vëllai i madh, babai i vërtetë i djalit, kishte kohë që kish shkarrë
e s'ish më për këtë botë.
Ai veç haraksej sokakëve dhe, kujtdo që shihte me karpuz në dorë,
i qepej këmba-këmbës, gjer sa t'ia rrëmbente e t'i ngjiste veshin
për ta kërcitur e ndjerë zhurmën e krisjes së rrumbullit mes pëllëmbëve.
Pastaj sokëllinte në kup të qiellit parashikimin në do dilte a s'do dilte i kuq.
Njerëzia atypari ia bënte jetën malore, duke e ndjellë
prej qafës së sokakut me ndonjë topth, ngaqë ia dinin prej kohësh këtë huq.
Më vonë, kur Tarasi themeloi Gjuhën e Re të njeriut të Ri, jo thjesht
për hakmarrje a qesëndi, por që njerëzia ta hante pa e zënë në gojë,
i gjeti frutit të mallkuar një emër më të qëruar.
Paskëtaj, tashmë i plotfuqizuar, përshëndoshte nga tribunat
me grushtin grusht, dhe fill pas pabesisë së englezit që fallin
na e botëroi libër, e shtriu pëllëmbën për ta yshtur haptaz mizërinë
shesheve tek kundronte poshtazi mizorinë. *Fall in love.*
Tarasit s'i lypsej tjetër veç të lante hesapet me Oruellin
e t'i jepte udhë hallit: Shkruesin e gjetën të vdekur vetëm pak kohë
pasi kish dalë në dritë libri i fallit.
Shkuli ambasadën angleze, qepi kufirin tejendanë, preu fillin
me botën dhe e la fallin të bënte hatanë. *Fall by itself.*
Për t'i prerë shtegun edhe qesëndisë në "Fermën e Kafshëve" vendosi:
që mbi këtë faqe të dheut të mos hynte as derr as dosë, e as libra apo
personazhe e subjekte përqasës.
Kur e kishte pisk me mjerimin pllakosur dilte dhe i bërtiste Anglisë
t'i kthente qypat e florinjve të mbretërisë së të vetëshpallurit
të të ashtuquajtur satrapit.

Por anglezi, si englez që qe, na i quante haraç këmbimi për kopjimin e Oruellit pa të drejtë përdorimi.
Ec e gjeje... si leshtë e arapit.
Sidoqoftë, çdo gjë vaj e sipas fallit. Në vijë, si në vijat e dorës në kohërat e mallit. Veçse një gjë i vinte përkundër, makthi: se mos libri binte, kush e di, në dorë të djallit.
Qëkurse iu faneps se Oruelli, tek i bënte "Homazh Katalonjës" në luftën e Spanjës, bën vaki të ish rrëfyer për fallin te miku sheh partizan, Tarasi u dalldis e çakërdis përfundimisht.
Sapo vetvrau e lau duart me krahun e tij të djathtë, i mbiu në kokë se mos ky, kushedi, i kishte shfryrë bëmën e fallit fqinjëve të tribusë rretherreth shtëpisë.
Ndaj hartoi listën pa hamendje e rastësi dhe vijoi qetë-qetë gjëmën ta stisë.
Fall Down.

KRENAR ZEJNO



Mbrojtës i lirisë së individit, Orwell luftoi kundër çdo forme shtypjeje. Ndëshkimi i totalitarizmit fillimisht shprehet në alegorinë e veprës *Ferma e Kafshëve* (1945), një roman që pati popullaritet të gjerë në gjithë botën, me tone të një shpotie të thekshme që merr shtysë nga ngjarjet e Revolucionit rus dhe tradhtisë që Stalini u bëri idealeve të tij, dhe më pas në utopinë negative të romanit *Njëmijë Nëntëqind e Tetëdhjetë e Katër*, (1949), një kuadër tronditës i një shoqërie ku Vëllai i Madh mishëron një fuqi të aftë të kushtëzojë dhe shtypë individualitetin e qytetarit. Me shkrimeve të tjera me tone autobiografike të Orwell-it, mund të përmendim përmbledhjet e letrave dhe artikujve, esetë dhe romanin *Keep the Aspidistra Flying* (1936).

Nuk do ketë të qeshura
veç të qeshurës së triumfit mbi armikun.
Në doni një imazh të së ardhmes,
përfytyroni një çizme
ngjeshur në fytyrën e dikujt,
...përjetësisht.

Ky epigraf i profecisë së veprës, me valencë shumëpërfshirëse, është i vlerëshëm të na e risjellë, fare shqip, edhe kumtin mbi imazhin e të shkuarës nën vragën e çizmes, edhe përfytrimin e të ardhmes si marrëdhënie me leximin në vijim... Nëse doni një pamje të ndjesisë së fundme të një lexuesi të ndjeshëm, përfytyroni shenjimin e shollës në fytyrën e tij ...përgjithmonë. Sugjerimi ndaj lexuesit, veçanërisht shqiptar, për të mos e nisur këtë libër, mbetet i barasvlerëshëm me lutjen për të mos e evituar kurrësesi.